


# LETËR VETES SIME

## 35-VJEÇARE

Do të shkruan një mik...  
...dijesh, i cili ka qenë pjesë në lojërat e  
...mban mend? Epo, s'të vë faj. Besoj  
...me, më e gjatë, më e pjekur. Mirëpo,  
...atyre rindhave; që mund të  
...atyre fijeve të flokut, që  
...fasi mbi ta është shkun-  
...ditëve më shumë, duhet të jesh  
...e vogël, e qeshur ngahera,  
...tari dhe lozonjare. Tani, ç'po  
...Besoj se duhet të jesh në ndonjë  
...punuar një projekt të ndonjë  
...pari besoj se mban mend sa të  
...arkitektura. Gjithë...  
...hapur se sa shumë...  
...dash të...  
...jellosh...  
...Ëndrra...  
...isht, kur...  
...shpësoj m...  
...realitet në...  
...Gjithashtu...  
...mbështetë...  
...metode...  
...tërë fan...  
...do di...  
...si, tam...  
...gjithmonë...  
...unë do...



afilli e hershme e  
tua të fëmijërisë.  
se ke ndryshuar  
unë e ndjej se  
jeni thëlluar  
janë  
dur pesha e  
po ti, një  
ëndërrim-  
lën?  
zyrë duke  
pallati,  
pëlqente  
me sy  
plane fasa-  
zgjoheshe, tëh-  
matematikës.  
që në vogëli, sigur-  
profesion. Thjesht  
sirtar të bëhet  
dime.  
familje, ku të  
të madhe ku  
kur mblidhet e  
të realizuar, ku  
reja. Gjithë...  
mbash mend...  
shërë një











*Shkolla 9 - Vjesare "Turgut Özal"*

*Një letër për të mos harruar...*

*Letër vetës sime*  
*35-vjeçare*

*Idëja: Selman FETTAHOĞLU*

*Kryeredaktore: Imelda PRENÇE*

*Redaktore: Merita OSMENAJ*  
*Albana ÇORJA*  
*Iris HAJDINI*  
*Suela HOXHALLI*  
*Esmeralda DIBRA*  
*Irma DERJAJ*  
*Gidiola HËSA*

*Designer: Dorjan PITANI*



Të dashur lexues

Libri që gjendet në duart tuaja është një vepër e realizuar nga bashkëpunimi midis nxënësve dhe mësuesve, rreth 1400 vetë, të kolegjit "Turgut Özal". Fillimisht i menduar si një projekt, ai u finalizua në trajtën e një libri.

Nëpërmjet këtij projekti dëshironim të arrinim disa objektiva. Nga më të rëndësishmet po përmendim zhvillimin e aftësisë së të shkruarit të nxënësve tanë, t'u mësonim atyre një stil të ndryshëm letrar... Ndërkohë që këto letra shtypeshin në kompjuter, u kujdesëm që nxënësit dhe mësuesit të përdornin drejt shkronjat "ë" dhe "ç", të cilat shpesh anashkalohen edhe pse kanë shumë rëndësi për gjuhën shqipe dhe për më tepër shfaqen shpesh në të.

Bashkëpunimi dhe harmonia gjatë realizimit të një pune në grup janë sa të rëndësishme po aq dhe të vështira. Arritja e këtyre dy vlerave nëpërmjet shkrimit të një libri për ne është plotësimi i njërit prej synimeve tona.

Gjatë punës sonë përdorimi i teknologjisë na siguron lehtësira të mëdha. Por teknologjia duhet përdorur drejt dhe në vendin e duhur. Microsoft Word është një program që përdoret në mbarë botën për dokumentet e shkruara. Për t'iu përgjigjur kësaj kërkesë kaq të madhe janë në treg një sërë versionesh të këtij programi dhe shpesh kjo shfaqet si pengesë teksa punohet në grup. Nxënësit dhe mësuesit tanë gjatë realizimit të librit kanë mësuar si të përdorin një program më të njëtrajtëzuar, Google Docs, i cili lehtëson bashkëpunimin.

Si përfundim i një periudhe të gjatë dhe plot lodhje arritëm të kemi në dorë një vepër konkrete, të cilën nxënësit tanë do e hapin vite më vonë dhe do të kujtojnë këto ditë, ditët kur shpresat e së ardhmes i hodhën në letër për të mos i harruar kur të rriten. Shembuj të ngjashëm të kësaj veprë nuk gjenden shumë nëpër botë. Duke qenë një punim prej rreth 1400 vetësh dhe me përmbajtjen e pasur që ka, kjo vepër në të ardhmen mund të bëhet edhe objekt për studime të ndryshme psikologjike.

Dëshiroj të shpreh falenderimet e mia për të gjithë nxënësit dhe mësuesit që mundësuan realizimin e kësaj veprë. Uroj që shpresat dhe dëshirat e shkruara në këtë libër të realizohen në formën më të mirë dhe më të bukur të mundshme.

**Selman Fettahoğlu**



## *Përsyrtimi im 14-vjeçar*

Tanimë në moshën 70-vjeçare, kur vitet ma kanë mbuluar ballin me brazda rrudhash dhe kokën ma mbulojnë thinjat e bardha bore. Ndalem një çast dhe meditoj...

Meditoj për moshën time 14-vjeçare...

"O vite të moshës së shkuar, vite të adoleshencës sime të hershme! Rrodhët, u zhdukët si ujërat e kristalta pranverore."

Edhe pse kalova një fëmijëri tejet të vështirë, fëmijëri pa fëmijëri, unë kam nostalgji për atë moshë. Është diçka e lidhur me vetë natyrën njerëzore, sado të shumta të kenë qenë vështirësitë.

Unë 14-vjeçari i atëhershëm jam në kontrast me 14-vjeçarët e sotëm.

Për atë kohë, pasioni ynë ishin librat. Edhe pse të pakët, ne i përpinim ata me etje. Mungonin mjetet elektronike. Të kishe një radio ishte luks i madh.

14-vjeçarët e sotëm kanë nëpër duar botime të shumta, cilësore, me ngjyra. Interneti ka hapur një revolucion të paparë.

Eh, sikur të isha sot 14-vjeçar!

Megjithatë, të rinjve të sotëm do t'i këshilloja që të na arrijnë ne, në pasionin e të lexuarit. E theksoj këtë se sot sikur është zbehur dhe tkurrur etja për lexim.

Le të jetë libri kryefjala e të rinjve të sotëm, sepse ai të formon, të dituron, pasi mjetet elektronike vetëm informim të japin.

Sot ka mundësi ç'të zgjedhësh e të lexosh.

Unë, 14-vjeçari i dikurshëm, merrja ç'të më binte në dorë. Botimet e atëhershme ishin të censuruara, të sotmet janë të lira.

Megjithatë, unë jam i lumtur, që nipërit dhe mbesat e mia e kanë pasion librin!

Uroj që ky pasion të mos fashitet kurrë, sepse kështu ata do të bëhen të denjë për veten, familjen dhe shoqërinë.

Realizofshi dëshirat dhe pengjet tuaja, të dashur nipër e mbesa!

**Llazar Fype**



*Letër vetes sime...*

*Nga mësuesit*



## Letër vetes sime shumë, shumë vite më parë.

E dashur Merita e vogël,

M'ua dha rasti të të shkruaj këtë letër, ndoshta pas një kohe shumë të gjatë, por dije se gjithmonë ke qenë pranë meje, përherë me ata sy të qeshur dhe atë fytyrë engjëjllore.

Ke patur fatin të rritesh në një familje ku të kanë dhuruar shumë dashuri e përkushtim, si vajza më e vogël me dy motra të rritura dhe një vëlla që përkujdesen aq shumë për ty. Dije se dhe unë kërkoj dhe uroj gjithçka të mirë e të bukur në jetën tënde. Përpara të pret një jetë e gjatë, ndaj në radhë të parë të uroj shëndet, pa harruar asnjëherë se mbetesh shoqja dhe mikja më e mirë në këtë jetë.

Si një vajzë e urtë, e bindur e kureshtare që je, unë besoj tek e ardhmja jote.

Shpesh kemi folur bashkë në netët e gjata dhe unë kujtoj bisedat tona për të ardhmen tënde. Në sytë tanë kjo e ardhme na shfaqet e bukur dhe e rrethuar me dashurinë e njerëzve që të duan aq shumë, por me frikën që të kaplonte, kur mendoje se jeta mund të godiste me ndarjen e tyre nga kjo jetë.

Është e vërtetë, të më besosh, qenka e hidhur kjo ndarje! Unë provova hidhërimin e vdekjes së babait tim që kur isha në moshën 24 vjeçare. Ishte një goditje e madhe për mua. Bota m'ua përmbys, por Zoti më ngushëlloi me ardhjen në jetë të një krijese të bukur, të djalit tim, fiks pas dy javë të largimit të babait tim.

Pse i them këto? Doja të të tregoj se si pata guximin e kurajon të vazhdoja pa rënë në dëshpërim të thellë, sepse tek fëmija im do të bëja gjithçka që im atë dhe nëna ime bënë me mua. Do të ndiqja shembullin e tyre, fjalën e ngrohtë dhe të ëmbël të tyre, kujdesin e tyre. Them me plot gojë se ata mbeten krenaria ime dhe shembulli më i bukur në jetë, të cilin e kam udhërrëfyes në rrugën time, në edukimin e fëmijëve të mi.

Jo vetëm kaq. Të vështroj ty me sytë e së ardhmes dhe shoh një Rita të rritur, me përparësen e bardhë të mjekes, pasi kjo ka qenë ëndrra jote.

E bukur kjo apo jo!? Çfarë ngjashmërie!!! Edhe unë me përparëse të bardhë, por me një ndryshim të madh, pasi unë tashmë jam mësuese, me këtë punë kaq fisnike, atë të edukimit të brezave.

E ç'rëndësi ka ngjyra e bardhë e përparëses, se sa e përbashkëta që kanë këto dy profesione kaq fisnike në shërbim të njeriut? Unë në edukimin dhe formimin, kurse profesioni yt tepër human, në shërbim të jetëve të tyre.

Ndaj mos u dorëzo, por bëje realitet këtë dëshirë!

Bëje për ato krijesa të vogla që të rriten të shëndetshme! Bëje për ata të rinj e të reja që të mposhtin dhimbjen dhe të ndërtojnë një jetë të re e të bukur!

Bëje për ato nëna e baballarë që gjatë jetës së tyre kanë kaluar shumë dallgë e mundime dhe meritojnë një jetë të qetë e të paqtë.

Puna ime si mësuese?

Në pak rreshta është e vështirë të futësh vite të tëra pune, jete, mudi, sakrifice



e lodhjeje. Kujtimet mbeten pjesë e krenarisë së punës, këto gjurmë që do të mbeten të pashlyeshme në kujtesë deri në frymën e fundit.

Kthej vështrimin pas dhe e shoh veten të rrethuar nga librat e fletoret, pjesë të pandara të punës sime. I vështroj dhe më flasin shumë: për emocionin, për netët pa gjumë, për shpinën e kërrusur mbi to, për gishtat e lodhur nga shkrimi i shpejtë, apo për sytë që pak nga pak po humbin qartësinë e të parit, por që fitojnë qartësinë kur dita e re nis me ritmin e ri dhe entuziazmin e zakonshëm.

Vitet kalojnë shpejt. Pa dashur dhe pa e kuptuar e sheh veten disi të mplakur në trup, por jo në shpirt, por jo në mendime.

Edhe te nxënësit e mi kam parë atë potencial të fuqishëm për të arritur më të mirën, për të arritur cilësinë. I kuptoj për dëshirat, ëndrrat, ndonjëherë për tekat e përtacitë e tyre. Me gjallërinë dhe buzëqeshjet e tyre më mbajnë të re në shpirt...

U zgjata shumë më duket. Kontaktojmë sërish për të reja të tjera, se për mua mbetesh përherë ajo vajza e vogël me ato sy kureshtarë.

Të dua për dashurinë e madhe që ke për jetën, për të bukurën, për artin, për muzikën, për ngjyrat.

Të adhuroj për optimizmin që të karakterizon.

Të dua për qetësinë që na fal gjithmonë, por edhe për pafajësinë me të cilën i sheh e i beson disa gjëra të jetës, si një fëmijë. Mendoj se një zemër e vetme nuk na mjafton që të mbajmë gjithë këtë dashuri për njerëzit që na rrethojnë, për vlerat e tyre, për lulet, zogjtë, detin.

Shoh te ti se si i jeton ndjenjat plot me vrull, gëzimet, të qeshurat, ashtu edhe zënkat. Ndonjëherë të kam zili, sepse e ndiej se me shpirt e zemër je më e re se unë. Ky vrulli yt më jep forca të bëj përpara me më shumë dëshirë dhe së bashku ta vlerësojmë jetën si diçka të çmuar për vlerat dhe parimet që mbart. Të dua me shpirt, të shëndetshme, të qeshur, të lumtur dhe plot jetë!

Të uroj të jetosh aq shumë, sa unë të jetoj!

Së bashku në përjetësi

Merita



E dashur Marta e vogël,

Gjithmonë nostalgjia më ka shoqëruar në jetë, kjo për të qenë sa më pranë teje e dashur Marta duke të risjellë në kujtesë me atë fytyrën e qeshur dhe sytë që vështronin dhe flisnin shumë. Fati të ledhatoi të rriteshe me dashurinë e pafund të familjes tënde jo të vogël (dy vëllezër dhe dy motra). Të kam ndjekur në vijueshmërinë tënde të jetës dhe me vëmendje kam arkivuar hapat e tu për të ardhur deri këtu ku je. Si një vajzë e shkathët, kureshtarë dhe me dashuri të madhe për jetën, unë në sytë e tu lexoja një të ardhme të ndritur dhe suksesplotë. Të kujtoj mjaft mirë kur ti luaje me shokët e



shoqet dhe gjithmonë garoje për të qënë e para...Nga kjo kuptoja që vërtet do të ishte e përkushtuar ndaj arritjes e suksesit. Të kujtoj me shumë mall në rolin e mësueses së moshatarëve të tu që në mënyrën më të qënësishme pozicionoheshë si mësuese e vërtetë në një moshë prej fëmije.

Prindërit tanë punonin shumë për të na rritur e edukuar ndaj nuk kam si të mos i falenderoj për gjithçka që kanë bërë për ne, për dashurinë e tyre prindërore, përkushtimin e tyre ndonëse me vështirësi. Janë modeli më i përkryer për ne. Paçin jetën e gjatë dhe uroj të vijojnë jetët e tyre rrethuar me dashurinë tonë! Janë ata që më bënë të mos harroj virtytet e tyre që u bënë modeli për mua edhe në pozicionin e të qënit prind i një djali që mundohem t'ia transmetoj të gjitha me shumë dashuri për ta përgatitur më së mirë për jetën e tij.

Të vështroj me vëmendje dhe më shfaqesh një Marta e rritur veçse jo më një mësuese fëmijë si atëherë, por një mësuese që ëndrrën e dikurshme e bëre realitet. Ja tek je, e veshur me përparësen e bardhë rrethuar nga nxënësit e tu që me kureshtje të dëgjojnë tek tregon këtë ëndërr dhe secili prej tyre ngacmohet për ëndrrën e tij apo të saj për ta arritur në jetë duke ndjekur edhe një shembull si ky.

Është shumë e vështirë që në kaq pak rreshta të shprehë historinë e jetës, por kujtimet mbeten pjesa më e bukur e saj dhe më e paharruara. Ndonëse koha ecën me ritmin e saj pa e konstatuar ti e sheh veten disi larg mësueses së dikurshme fëmijë, por mendimet vetëm thellohen e shpirti pasurohet tek sheh nxënësit që avancojnë për arritjen e më të mirës, dëgjon ambiciet e tyre që t'i shprehin plot dashuri e sinqeritet e herë herë duke të pyetur nëse do të jenë të zotët të arrijnë ëndrrën, ashtu si edhe ti e arrite më së miri.

Shkruajta pak gjatë, por shpresoj që ta ruajmë letërkëmbimin tonë duke u njoftuar për çdo të re të jetës, sepse sinqerisht mbetesh akoma në mendjen time ajo Marta e qeshur, e shkathët dhe energjike. Të adhuroj shumë për pozitivitetin që ke, për përkushtimin, për sinqeritetin, për mirësinë dhe dashurinë që fal për njerëzit që të rrethojnë e shoqërojnë në jetë. Të shoh se si e jeton plot shpresa jetën e përditshme, por jam pak ziliqare për ty, Marta e vogël, se normale je më e re se unë. Të admiroj për shtysën që më jep për të vlerësuar jetën si diçka shumë të çmuar tek të sjell në kujtesë ty.

Dëshiroj më të mirën për ty dhe qofsh gjithmonë e qeshur, e lumtur e plot jetë! T'i kam ngulur sytë sikur kërkoj qendrën e vështrimit dhe lexoj në sytë e tu pyetjen: "Mbase ke frikë prej meje?" ... por po të them me shumë pastërti e plot sinqeritet: "Kurrë!" Kam veç një frikë: "Mos të të humb në letërkëmbimin tim

Qofsh jetëgjatë e plot suksese!

Përjetësisht Marta



Përshëndetje bashkudhëtarja ime më besnike...

Je pikërisht Ti, ajo që nuk më ka braktisur kurrë, si në momentet më të bukura, ashtu dhe në ato të trishtat .... Në fund të fundit të gjitha janë pjesë e jetës. Nëse nuk do kishim momentet tona të zhgënjimit dhe të sprovës, si mund t'ua dinim vlerën momenteve që vërtet duhet t'i ruash të shtrenjta.

E di që je mirënjohëse ndaj meje për njerëzit me të cilët të kam njohur, sepse ke patur se ç'të mësosh prej tyre. Janë vërtet njerëz me vlera, duhet ta pranojmë. Dakord ose jo me zgjedhjet dhe vendimet e mia të falenderoj që ke qenë gjithmonë miratuese e heshtur. Më është dashur dhe më duhet shpesh të kthej kokën nga Ty dhe më duhet të pranoj se gjykimi yt është shpesh më i paanshëm se imi.

Të ndiej sesi rri e më vështron teksa unë hedh sytë nëpër shkrimet që kam para meje dhe si emocionohesh teksa lexon bashkë me mua. Ti e kupton më së miri botën, realitetet dhe të vërtetat e këtyre fëmijëve. Ti i kupton më së miri emocionet, sjelljet, reagimet e tyre, ndaj dhe më duhet gjithmonë të kthej kokën nga Ty e të shoh sytë e Ty për të kuptuar dhe unë, e rritura, sadopak botën e tyre.

Ti gjithmonë thua se njeriu duhet të jetë i guximshëm, madje disa herë edhe më i guximshëm. Nuk duhet t'i lerë mundësitë të ikin, sepse asnjëherë nuk e dimë se cila është mundësia më e mirë. Dhe mbi të gjitha, cila do të rezultojë eksperiencia më me vlerë më vonë.

Duhet t'i japësh vetes gjithmonë hapësirë për gjërat. Kushdo mund ta gjejë kohën për lexim, art, sport dhe udhëtime.

Më pëlqen ende shprehja jote: "Ndonjëherë realiteti e tejkalon fantazinë dhe bëhet më i bukur, mjafton dëshira." Këta fëmijë kanë dëshirën, ndaj realiteti i tyre ka për të qenë edhe më i bukur se fantazia.

Gjithçka kemi nevojë janë mesazhet pozitive dhe optimizmi!

Gjithmonë me ty Imelda.

*Klasat e 9-ta*



E dashur Jera,

Ta shkruaj këtë letër në një moshë që tani ty të duket fare e vogël. Shpresoj të jesh mirë dhe çdo gjë të ketë shkuar sipas planit që unë po nis të hartoj. Shpeshherë përpiqem të të përfytyroj e shpeshherë ndjej frikë e pasiguri. Druaj se ndoshta imazhi që të shfaqet ty në pasqyrë do të jetë ndryshe nga ai që shoh tani në imagjinatën time.

Kam aq shumë ëndrra e dëshira, sa nganjëherë më duket e pamundur t'ia dal. Më duket sikur janë aq shumë sa që kur njerëzit më pyesin unë s'di të them asgjë. Po aq sa janë ëndrra imagjinare të mbushura me gëzim e lumturi, janë edhe shumë problem e pasiguri brenda meje. Nuk e lë dot të shkuarën të lirë dhe mendoj aq shumë për të ardhmen sa besoj se nuk ka si të më gjej të papërgatitur. Kështu harroj më të rëndësishmen, të jetoj në të tashmen. Jam aq e zhytur në trurin tim, sa shumë pak njerëz arrijnë të më nxjerrin nga deti im i mendimeve. Besoj se heshtja ime e vazhdueshme, është një maskë që arrin t'i gënjejë njerëzit për sadopak e t'i mbajë ata larg betejave brenda meje. Në imagjinatën time ekziston një e ardhme ideale, ku rafti i trofeve është i mbushur plot, e albumet fotografike janë të pushtuara nga të qeshurat.

Shpresoj që të jesh e lumtur e të kesh realizuar çdo ëndërr e çdo dëshirë. Shpresoj që të zgjohesh çdo mëngjes me diellin që të hyn në dritare e të presësh me padurim të nisësh ditën. Shpresoj që ata njerëz që më nxirrin mua në sipërfaqe, të vazhdosh t'i mbash pranë. Shpresoj që të vazhdosh të bësh mirë. Shpresoj që të vazhdosh të ndjesh një oqean me emocione nga teksti i një kënge ose thjesht melodia e saj. Shpresoj të vazhdosh ta dashurosh të bukurën. Së fundmi, mos lejo askënd të të ulë poshtë e të të lëndojë. Vazhdo të qeshësh. Vazhdo të mendosh.

Vazhdo të mësosh gjëra të reja e vazhdo të jesh Jera.

**Jera Isakaj 9A**



Rudi,

Shpresoj mos të kesh harruar si ishe në fëmijëri. Po ta rikujtoj, ishe 14 vjeç kur e shkruajte këtë letër, në orën e gjuhës, e ulur me shoqen tënde të ngushtë. Po ëndrrat që kishe, a i mban mend? Atëherë kur doje të krijoje biznesin më të fuqishëm në botë? Po atëherë kur doje të shkruaje një libër? Je bërë nje femër e fuqishme? Shpresoj të kesh ndërtuar karrierën që gjithmonë ke kërkuar. A e ke gjetur gjysmën tënde në këtë botë? I ke harruar shokët dhe shoqet, ata që të mbështesnin në çdo hap që hidhje në fushë. Mos harro! Mos harro njerëzit që kanë qenë gjithmonë aty për ty! Kurrë mos harro ëndrrat, sakrificat dhe ambiciet e tua. Shpresoj të jesh e lumtur në ato që ke arritur. Kur të bëhesh 35 vjeç, hape këtë letër e më kujto! Mos harro kush ke qenë e kush doje të ishe.

**Rudina Kerri 9A**



E dashur Adisa,

Po ta nis këtë letër në një ditë të freskët e me diell, shpresoj që edhe kur ta marrësh të jetë po kështu. Sot edhe pse jo më e vogël, por edhe e pjekur aq sa duhet, idetë për jetesën, shkollën etj, i ke akoma të paqarta. Shpresoj që çdo gjë të jetë qartësuar, realizuar nuk mendoj pasi në këtë jetë nuk mund t'i kesh të gjitha, por të jesh e kënaqur me ato që ke arritur e me ato që ke. Shpresoj, që ëndrra për të vazhduar shkollën për drejtësi, e të bëhesh një gjykatëse e zonja të jetë realizuar. Pyetjet e mia për ty janë të shumta, por nuk dua t'ua di përgjigjen të gjithave, pasi dua që një pjesë e jetës sime të jetë një surprizë e papritur, por edhe e bukur. Shpresoj se nga karakteri të të mos ketë ndryshuar asgjë, e shpresoj që me qetësinë që të karakterizon të jetosh e lumtur. Vazhdo të jesh Adisa që ke qenë gjithmonë. Shpresoj që të kesh krijuar vatrën tënde të familjes, e mbi të gjitha shpresoj me gjithë zemër të jesh e kënaqur me jetën që po jeton e të jesh krenare për ç'ka ke arritur.

Të gjetë mirë kjo letër!

**Adisa Mehmeti 9A**



E dashur Ambra,

Këtë letër e ke shkruar kur ishe 13 vjeç. Ishe ulur me shoqen tënde të ngushtë dhe mbi një fletë të zbrazët po shkruanit për të ardhmen. Ndoshta mbi këtë letër nuk do të shkruaj pyetjet që i bëhen një 35-vjeçari, por do të përpiqem. Si fillim, a je bërë një nga njerëzit më të pasur në botë? A po e ruan të njëjtën shoqëri si dikur? A po punon në një nga markat më të pasura dhe suksesshme në botë? Ashtu shpresoj. A po jeton në Amerikë, në një shtëpi të vogël mes New Jersey-t? Mes gjithë këtyre ideve je ulur e fantazon, e ulur në bankat e shkollës duke thurur plane për të ardhmen. Por a do të realizohen nuk e di. A je martuar? Nëse po a ke dy fëmijë siç doje? Gjithsesi. Të uroj më të mirat e gjithë botës. Dhe mos harro; hape vetëm në 35-vjetorin e ditëlindjes tënde. Edhe 100 vjeç!

**Ambra Kepi 9A**



E dashur Flonja,

Tani që po e shkruaj këtë letër jam 15 vjeçe, e ulur në bankat e shkollës dhe mendoj se çfarë do të shkruaj. Kur ta lexoj këtë letër, do doja që të gjitha dëshirat e mia për të ardhmen të jenë plotësuar. Do të ketë kaluar shumë kohë, kur kjo letër do të jetë prapë në dorën time. Shumë gjëra do të kenë ndryshuar. Nuk e di a do t'i mbaj mend të gjitha çfarë kam kaluar, por di vetëm që kam pasur familjen dhe shoqërinë më të mirë, atë që kam ëndërruar gjithmonë.

Me kaq po e mbyll këtë letër duke të uruar një jetë të mbarë.

**Flonja Zadeja 9A**





E dashur Armelinda,

Sot që po të shkruaj këtë letër jam 14 vjeç.

Shpresoj të jesh duke e lexuar me krenari këtë letër, shpresoj shumë që t'i kesh plotësuar të gjitha ëndrrat dhe dëshirat. A je bërë një biznesmene e njohur? Besoj se tani që po e lexon këtë letër do të jesh duke festuar ditëlindjen tënde të 35-të së bashku me familjen dhe shpresoj t'i kesh ruajtur marrëdhëniet me shokët dhe shoqet. Shpresoj që të jetosh në vilën e ëndrrave tona, pranë detit dhe të kesh qenin, që ke dashur gjithmonë. E di që nuk mund të realizohen të gjitha dëshirat, pasi këto janë ëndrrat e një 14- vjeçareje, por uroj me gjithë zemër që të jesh rehat dhe e lumtur me jetën që bën, uroj të jesh e suksesshme në punë dhe në jetën sociale. Me kaq po e mbyll këtë letër.

Gjithë të mirat!

**Armelinda Valteri 9A**



E dashur Sara,

Po të filloja të shkruaja një letër me destinacion veten time, s' do i jepja rëndësi kohës apo vendit ku e shkruaj. S' do i jepja rëndësi as letrës. Le të ishte një fletë e rëndomtë fletoreje, sepse unë dua vetëm të shkruaj dhe rëndësi kanë vetëm fjalët e mia. Tani që po shkruaj ndodhem në bankën e parë tek e 9A, në shkollën "Turgut Özal".

Hapja s' do të ishte kaq modeste, sepse atë letër unë nuk e mendoj si një ese shkollore, por si një forcë shtytëse për të nesërmen. Nuk dua ta mbivlerësoj veten, por është e vërtetë se synimi im ka nevojë për diell përpara që të ma rrezatojë udhën. Unë eci drejt së ardhmes për të cilën nuk e di as se ku mbaron. Por, prapë se prapë vazhdoj e eci. Askush s' ma pret rrugën dhe askush s' ma ndal dot hapin. Sa herë që rrëzohem, unë ngrihem prapë. Jam akoma gjallë derisa jam në këmbë. S' dua t'i di sfidat e jetës që do vijnë. Unë thjesht, do t'i pres e do i kapërcej edhe pse s' besoj të jetë e lehtë. Gjatë jetës kemi mundësi që s' mbarojnë kurrë, por vendimet që t'i marrësh, më mirë shqyrtoi dy herë. Mund të jetë rrugë pa krye. Shpresoj të kem ndërtuar një jetë sa më të lumtur dhe të kem arritur çdo gjë që kam dëshiruar. Shpresoj të jem pjekur, të kem mbaruar shkollën dhe të jem bërë një biznesmene e suksesshme. Shpresoj që të mos i kem harruar gjërat që kam kaluar në fëmijëri dhe shoqërinë e 9-të vjeçares. Shpresoj që dhe familja dhe njerëzit që më rrethojnë të jenë të lumtur dhe të gëzuar pranë meje. Shpresoj që të më kujtosh dhe ta lexosh këtë letër në moshën 35-vjeçare.

**Sara Jaupi 9A**



Përsëndetje Dimitri!

Unë nuk e di ku ndodhesh tani apo çfare je duke bërë, por mund të them se ku ishe kur po shkruaje këtë letër. Ti ishe 15 vjeç, në klasë të nëntë, në shkollën "Turgut Özal", ulur në bankë të parë duke shkruar këtë letër mbi librin e gjuhës. Shpresoj që çdo gjë të ketë kaluar mirë. Shpresoj që të jesh mirë me shëndet, por, mbi të gjitha, shpresoj të jesh i rrethuar me shokë e shoqëri që të duan të mirën. Kam besim se ke arritur t'ia dalësh mbanë në realizimin e ëndrrave të tua. Në këtë moshë, shoh shumë të rritur, të cilët janë mbytur në stres dhe në halle. Duket sikur çdo ngjyrë u ka dalë nga shpirti dhe shohin vetëm bardhë e zi. Kjo gjë nuk më bezdis fare, sepse e di që nuk do të përfundosh ashtu. Nuk jam i sigurt se si do ia dalësh, por e di që nuk do ta lejosh veten në atë gjendje. Tani jam vetëm 15 vjeç dhe ndoshta nuk e kuptoj dot jetën mbas 20 vitesh, por, do të lutesha me gjithë shpirt mos të humbisje fëmijën brenda teje. Do doja të të kujtoja gjithashtu mos të lësh gjërat, për të cilat ke pasion mbas dore. Shpresoj që shoqëria me shokët e fëmijërisë të mos ketë humbur. Shpresoj që dhe ata të kenë arritur qëllimet e tyre në jetë. Por mbi të gjitha, të uroj ty lumturi!

**Dimitri Pelari 9A**



E dashur Eleni,

Është e hënë, data 17 e tetorit të vitit 2016.

Unë jam 13 vjeç dhe jam nxënëse e ulur në bankat e shkollës "Turgut Özal" duke shkruar një letër, që do ta lexosh në ditëlindjen tënde të 35-të. Deri më sot kam përjetuar aventura nga më të shumëllojshmet, kam mësuar gjëra të reja dhe kam njohur njerëz që shpresoja dhe nuk shpresoja të njihja. Jeta ime është e bukur dhe jam një fëmijë shumë i lumtur. Kam dy prindër të mrekullueshëm që më ndihmojnë dhe motivojnë çdo moment. Gjithashtu kam edhe vëllaqkon e vogël, që më bën çdo ditë për të qeshur. Po përpiqem të zbuloj se çfarë do të bëhem kur të jem në moshën tënde, por është më mirë që disa gjëra të zbulohen më vonë. S'jam e sigurt se çfarë dua të bëhem, por shpresoj se do të më pëlqejë shumë kur ta zbuloj. Kam shumë pyetje që dua të të bëj, por është më mirë të jenë sekret për disa kohë dhe t'i zbuloj më vonë. Shpresoj të kesh një jetë të lumtur dhe të jesh e kënaqur me ato që ke. Me dashuri, Vetja jote e vogël.

**Eleni Naço 9A**



Ajdi,

Po ta shkruaja këtë letër në orën e gjuhës pranë Flonjës.

Me siguri sot duhet të jetë 31 gusht dhe ti po feston 35 vjetorin. Kushedi ku do të jesh tani...

Çfarë ke bërë me jetën tënde? Jam shumë kurioze, por në të njëjtën kohë edhe



e sigurt që tashmë je një grua e plotësuar me familjen më të lumtur e një karrierë të suksesshme. Besoj se i ke realizuar qëllimet e tua dhe këtë letër po e lexon me mall...

Dije që Ajdi e vogël është dhe do të jetë gjithmonë krenare për çdo gjë që ti do të bësh. Vetëm mos harro: "Ndiq ëndrrat dhe pasionet e tua e qëndroji pranë njerëzve që të vlerësojnë për atë që je."

Të uth fort.

**Ajdi Hasekiu 9A**



E dashur Elisa,

Nuk e di se si të ka gjetur kjo letër. Nuk e di se në çfarë gjendjeje mund të jesh për momentin. Ndoshta jeta të ka formuar si një njeri të fortë e plot virtyte, i cili mund t'i kalojë mjaft lehtë këto vështirësi ose ndoshta si një njeri mendjelehtë e të dobët, i cili nuk i përballon dot. Shpresoj me gjithë zemër të jetë e para. Kur të kam shkruar këtë letër kam qenë 15 vjeç. Një fëmijë i papjekur e i nxituar, i cili mendon se di gjithçka për të gjitha. Një fëmijë i pavendosur për të ardhmen e tij. Nga njëra anë shpresoj që të kenë ndryshuar shumë gjëra tek unë në të ardhmen. Shpresoj të jem bërë një grua e pavarur, konfidente, e vendosur, të cilës nuk i duhet aprovimi i askujt. Janë aq shumë gjëra, të cilat dua të kem përmbushur deri atëherë. Një karrierë të suksesshme, një familje të lumtur, një shtëpi të mbushur me qen e dashuri. Dua të dish se pavarësisht gjithçkaje që ka ndodhur e të gjithave që ke kaluar, unë jam shumë krenare për ty që ke arritur deri aty. Shpresoj mbi të gjitha të jesh e lumtur me jetën tënde dhe të gësh forcë tek vetja dhe njerëzit që ke zgjedhur të të rrethojnë për të vazhduar përpara.

Me shumë dashuri.

**Elisa Dushkaj 9A**



I dashur Enso,

Uroj t'ia kesh kaluar mirë gjithë këto vite! Në këto momente jam në shkollën "Turgut Özal" dhe po shkruaj këtë letër për ty. Në këto momente që po të shkruaj letrën, jam 14 vjeç.

Shpresoj që të kesh realizuar çdo dëshirë. Shpresoj që të jesh bërë një doktor mjaft i mirë dhe të respektohesh nga çdo njeri. Uroj të kesh krijuar një familje të mirë dhe që të do. Shpresoj me gjithë zemër t'i kesh realizuar këto dëshira. Shpresoj të mos i kesh harruar ata shokë që ke pasur në klasë të 6, 7, 8, 9 etj. Shpresoj me gjithë zemër që t'i kujtosh ata shokë me shumë dashuri. Shpresoj të mos i kesh harruar momentet e bukura dhe të trishtuara.

Enso, shpresoj të jesh duke e lexuar këtë letër me shumë nostalgji.

Me dashuri, Enso.

**Enso Isaraj 9A**



I dashur Ervin,

Shpresoj që të jesh mirë. Tani që po të shkruaj këtë letër jam 14 vjeç. Shpresoj të kesh gjetur një grua simpatike dhe të sjellshme. Uroj që mami, babi dhe motrat të jenë mirë. Besoj se ke arritur atë që doje dhe ndihesh shumë i lumtur. Shpresoj që ke blerë një shtëpi të madhe dhe të bukur në periferi të qytetit, ku jeton bashkë me familjen tënde. Unë jam shumë i dashur, por edhe pak i zhurmshëm, po ti a ke ndryshuar? Më pëlqejnë shumë sportet, sidomos futbollin. Shpresoj që dhe ti të ndihesh njësoj. Gjithashtu më pëlqen shumë matematika dhe shpresoj shumë që të pëlqen dhe ty. Besoj se ke arritur të bësh shumë para. Po fëmijë a ke? Në moshën tënde, unë do të doja të kisha 2 vajza dhe 2 djem. Po babi me çfarë pune merret? Shpresoj që të jesh i lumtur, që ke arritur të bëhesh dikushi.

Të uroj gjithë të mirat! Me dashuri.

**Ervin Valteri 9A**



I dashur Ilko,

Sa qenke rritur! Për pak nuk të njoha! Nejse, shpresoj që këtë letër të jesh duke e lexuar në vendin ku ëndërroje të jetoje dhe shpresoj të kesh krijuar një familje të madhe, si dhe shpresoj të jesh duke bërë gjërat që do. Gjatë kohës që kjo letër priste të vinte tek ty, besoj se ke kaluar shumë aventura. Kur ta shkruajta këtë letër, isha 15 vjeç dhe ishte ora e gjuhës. Kur mësuese Albana na tha t'i shkruanim një letër vetes sonë në të ardhmen, u lumturova shumë. Kur nisa të shkruaj më erdhën shumë mendime në kokë. Nuk dija se çfarë të të thoja më parë. Ishte shumë e çuditshme. Por ja që letrën e mbarova dhe shpresoj që të të pëlqejë. Po e mbyll duke të uruar më të mirat në jetë.

P.S: Po të lë si detyrë, pasi ta kesh hapur këtë letër, t'i shkruash vetes tënde përsëri pas 30 vitesh.

**Ilko Velija 9A**



I dashur Olsi,

Shpresoj të jesh mirë dhe mbi të gjitha i lumtur. Unë si një djalë 14-vjeçar me objektiva madhore për të ardhmen, por ende në bankat e shkollës. Mendoj se ti je i destinuar për të qenë i suksesshëm. Kjo do të thotë, që në moshën 35-vjeçare do të kesh në duar shumë pushtet në atë çfarë merresh ose punon çdo ditë. Do doja shumë që të rrethohesh nga njerëzit që do më shumë në këtë jetë. Ajo ç'ka unë parashikoj, është që ti do arrish suksese të shumta në jetë falë miqësisë dhe shoqërisë së zgjeruar.

Ti gjithmonë ke qenë ambicioz dhe ke tentuar gjithmonë të jesh perfekt. Gjë që s'ndodhi kurrë, pasi në fund të fundit imperfekzioni ka qenë gjithmonë ajo ç'ka të ka mbajtur gjallë duke tentuar gjatë gjithë kohës për më mirë. Gjithmonë duhet të mbash mend që askush, nuk mund të kalojë mbi ty, po



nuk u përkule më parë. Kjo dëfton shumë për karakterin tënd. Siç mund ta vësh re nga ky shkrim i imi, ti që në vegjëli ke menduar për gjëra madhore duke përpunuar më shumë seç duket në trurin tënd. Gjithmonë e ke ditur se jeta kontrollohet nga dy leva: frika dhe interesi personal. Duke i kuptuar shumë mirë këto dy gjëra, unë jam i sigurt që ti ke arritur të jesh dikushi në jetë. Tani në ditëlindjen tënde të 35-të, të uroj të bëhesh edhe 100 dhe kurrë mos u kënaq me aq sa ke. Gjithmonë do të ketë diçka për t'i marrë jetës!

**Olsi Canaj 9A**



E dashur Samela,

Nuk e di si je apo ku je, e vetmja gjë që di është se ke mbushur 35 vjeçe. Je ulur dhe ke hapur këtë letër me destinacion veten tënde, të cilën e kam shkruar para 21 vitësh kur isha 14 vjeç, e ulur në bankat e klasës 9-të A të shkollës "Turgut Ozal". Në fillim nuk dija si ta filloja këtë letër. E fillova me një "e dashur Samela" dhe më pas mendimet rrodhën papritur...

Uroj të jesh sa më e lumtur dhe të kesh ndërtuar një jetë dhe një familje sa më të mirë.

Mbase gjatë jetës ke patur pengesa, por jam shumë e sigurt që ke ditur t'i kalosh më së miri ato. Shpresoj të jesh bërë ajo, që ke dashur të bëhesh që e vogël, të kesh mbaruar shkollën të jesh e rrethuar nga njerëzit që do, të kesh mbajtur miqësinë me shokët dhe shoqet dhe të jesh bërë një arkitekthe shumë e suksesshme.

Nuk mendoj se i ke harruar ato që ke kaluar në fëmijëri. Gjithsesi shpresoj të jesh bërë shumë herë më e mirë se ç'ke qenë.

Me kaq po e mbyll...

**Samela Spahiu 9A**



Përsëndetje!

Shpresoj që gjithçka të ka vajtur mbarë, ose të paktën ke arritur t'i gëzohesh një pjese të madhe të kohës që ke pasur në dorë. Në fakt, kjo ishte një prej shumë gjërave, që do doja të të shpresoja, ose të paktën, një përmbajtje e çdo të them më poshtë.

Në këto momente jam e mbushur plot kuriozitet; A thua kam arritur të gjej punën e ëndrrave të mia? A kam arritur të siguroj jetesën time, të jem e rrethuar nga njerëzit e duhur ose nëse kam arritur të krijoj një familje të shëndetshme që më bën të lumtur?

Këto gjëra nuk kam si t'i di. Jam ende 14 vjeç dhe kam plot mbi 20 vite përpara meje. Nuk mund ta parashikoj dot të ardhmen time e ç'mund të ndodhë, por mund t'i shpresoj vetes vetëm atë ç'ka kam shpresuar gjithmonë; gëzim dhe lumturi.



Shpresoj të kesh arritur t'i kalosh provat e jetës, edhe ato më të vështirat, e të jesh ndjerë krenare për atë, pasi ajo është prova e aftësisë tënde. Nëse arrin të gëzosh plot 35 vite, do të thotë se ke pasur një jetë plot aventura e të papritura, një jetë të pasur me momente plot vlera. Jam e sigurt se ke arritur të përballesh me ngjarje që edhe deri në këto momente, nuk mund t'i kesh imagjinuar. Plot surpriza e të papritura. Ku i dihet se sa aventura do kesh kaluar me miqtë e tu. Ku i dihet se me kë ke arritur të ruash shoqërinë nga ata që rrethohesh në këto momente, ose me sa miq të rinj ke arritur të formosh një shoqëri të denjë. Ti do kesh mbaruar shkollën dhe universitetin. Nuk mund ta di ç'profesion ose ç'drejtim ka marrë rruga jote, por shpresoj që të kesh realizuar ëndrrat tua. Ty mund të të imagjinoj në mënyrat më të paparashikueshme e më të çuditshme por një gjë e di; Të ardhmen do ta kesh vetëm ti në dorë, prandaj jam e sigurt që do ta shpenzosh çdo sekondë në maksimum. Por nëse është e nevojshme; Të uroj fat, dhe një jetë plot gëzime!

**Kejsi Hoxhallari 9B**



Përshëndetje Zhaklin!

Nuk e di nëqoftëse më mban mend. Jam unë Zhaklin, sot 14 vjeç. Po të shkruaj këtë letër, që ta hapesh kur të kesh mbushur plot 35 vjeç, kur të jesh rritur e të kesh krijuar jetën tënde, të më kujtosh mua, momentet e mia më të bukura, momentet e mia më të këqija, që kujtoje se kurrë nuk do të kalonin. Të kujtosh familjen e shoqërinë që mbase kur të kesh hapur këtë letër nuk do t'i kushtosh shumë vëmendje e ndoshta i ke harruar. E vetmja gjë që dua te bëj është të të kujtoj. Kur filloj të imagjinoj se çfarë ke arritur gjatë gjithë këtyre viteve më vijnë në mendje shumë gjëra. Janë shumë gjëra që dua t'i arrish. Tani mund të kesh krijuar një familje, ndoshta mund të jesh bërë jashtëzakonisht e suksesshme, por shpresoj që mos të kesh harruar se nuk e ke bërë e vetme të gjithë këtë. Shpresoj të jesh mirënjohëse ndaj familjes dhe njerëzve që të rrethojnë e mos të jesh bërë ndonjë njeri i fiksuar me punën e me suksesin, siç shpesh herë kam frikë se do bëhesh. Gjithmonë të kam thënë që mos ta lësh vullnetin të të mundë, por s'e di nëqoftëse më ke dëgjuar. Mezi po pres të kalojnë vitet e të shoh se ku do jesh e çfarë do jesh duke bërë, por gjithashtu nuk dua dhe që të rritesh.

Ndonjëherë dua të rrisht vetëm 14 vjeç. Mos të rritesh. Mos të përballesh me vështirësitë e jetës. Thjesht të rrisht ajo vajza që je tani, në këto momente që po të shkruaj. Që shqetësimi yt i vetëm të jenë mësimet e problemet e moshës e jo ndonjë vendim që do të të ndryshojë jetën. Nuk dua ta zgjas shumë këtë letër, sepse tani mund të jesh në mes të një mbledhjeje pune, ose duke kaluar kohën e lirë me familjen. Thjesht dua të të them që të mos më harrosh kurrë. Një ditë do të takohemi e do të shoh se çfarë ke arritur nga dëshirat e shumta që kishe. Të uroj fat dhe lumturi!

**Zhaklin Ruço 9B**



Përshëndetje,

Më duket e çuditshme që po i shkruaj vetes time, por e ndiej të nevojshme të flas për disa momente të fëmijërisë sime, pasi e di që nuk i mbaj mend mirë gjërat e besoj se as ti.

Tani ti mund të jesh i martuar, me fëmijë, etj. Kjo s'ka rëndësi. E rëndësishme është që ti ta lexosh këtë letër deri në fund. Po filloj. Është e mërkurë, 25 tetor 2016. Numri 25, është një nga tre numrat e mi të fatit (dy të tjerët janë 15 dhe 7), ndërsa numri im i tersit është 13.

Gjithsesi sot është një ditë e vrenjtur. E kam javën të mbushur plot me provime. Kjo javë po më duket e mërzitshme. Tani që u kujtova, kur isha i vogël, si çdo fëmijë tjetër kisha frikë nga errësira. Kur duhet të firmosja për ndonjë gjë në shkollë nervozohesha, pasi s'dija të firmosja. Më pëlqen të luaj futboll dhe ping-pong. Nuk e di se çfarë do të bëhem kur të rritem, prandaj s'e di se çfarë pune bën, por puno sa më shumë. Nuk po të shkruaj më, sepse ndoshta ti s'do të kujtosh ndonjë gjë nga fëmijëria jote.

Të përshëndes, Miredi.

**Mired Kazazi 9B**



Përshëndetje Breana,

Kur të jesh duke lexuar këtë letër, do të kesh ndryshuar shumë, ndoshta s'do të jetosh në të njëjtën shtëpi ku je rritur, ose ndoshta dhe në të njëjtin vend. Ndoshta jeta të ka bërë surprizë ndonjë vend, të cilin ti, as nuk e kishe menduar se mund të jetoje. Gjithsesi, ja ku të shoh të ulur në një kolltuk të vogël, ke hapur rreth teje dhjetëra kuti me kujtime nga fëmijëria jote, fotografi, fletore, të cilat i ke ruajtur, ditare, lodra të dashura, dhe mes tyre ja ku është dhe kjo letër, ndoshta pak e zhubrosur, e palosur dhe e futur brenda në një zarf të bardhë.

Nëse do të mund të flisnim bashkë, pyetjet e mia do të ishin të shumta. Ka kaq shumë gjëra që dua të di për kohën kur ti jeton. Si ka ndryshuar bota e si e sheh ti atë tashmë që je një grua?

Shpeshherë mendoj për profesionin që po ushtron. Hamendësoj nëse ke anuar nga degët shkencore, të cilat i ke preferuar gjithnjë. Sidoqoftë, ka diçka për të cilën nuk të imagjinoj dot. Pavarësisht të gjitha sukseseve që mund të kesh arritur, familja është një nga arritjet më të mëdha, është mbështetje në çdo moment, ashtu sikurse është për mua tani familja ime dhe dua të di nëse dhe ti e ke gjetur këtë mbështetje, je bërë nënë dhe je e lumtur.

Po e mbyll këtu letrën time, me dëshirën që një ditë të kthehem e të buzëqesh duke e lexuar, e me të, të kthehet pas çdo moment i bukur e çdo përjetim që kam pasur dikur.

**Breana Shehetila 9B**



Përshëndetje Brian,

Më duket shumë e çuditshme që po i shkruaj vetes sime. Edhe pse është e çuditshme, janë disa gjëra të nevojshme që dua të them në lidhje për të ardhmen tate. Po në fillim le të flasim pak për të shkuarën tënde. Unë kam lindur më 1 mars 2002. Kam lindur në Nju Jork, Amerikë. Kam jetuar në një apartament me mamin, babin, vëllain, xhajën, tezen dhe dy kushërinjtë. Arsyeja pse unë erdha në Shqipëri ishte se prindërit e mi gjetën punë më të mirë. Ne jetuam në Amerikë për një vit. Në Shqipëri jetojnë gjithashtu dhe gjyshërit e mi. Familja ime në përgjithësi është një familje shumë argëtuese. Unë takohem me kushërinjtë e mi çdo verë. Edhe pse unë kam 3 vite, 5 vite dhe 9 vite diferencë me kushërinjtë dhe me vëllain, ne prapë kemi marrëdhënie shumë të mira me njëri-tjetrin. Unë gjithmonë luaj me lojëra elektronike. Gjithashtu kam shumë qejf të jem aktiv duke luajtur futboll ose basketboll dhe kam qejf të krijoj. Unë kam studiuar në shkollën "Turgut Özal" që kur kam qenë në kopsht. Kaq mund të flas në lidhje për të shkuarën time. Tani le të flasim për të ardhmen time. Unë kam pëlqyer të krijoj dhe të vizatoj. Kështu që unë kam vendosur të bëhem arkitekt. Dua të shkoj në shkollën më të mirë për arkitekturë. Unë do të studioj ose në Europë ose në Amerikë. Dua që të njihet arti im në botë. Për familjen time dua të kem 2 fëmijë, ose djem, ose vajza, prapë se prapë, ata do të jenë fëmijë shumë të dashur dhe jam i sigurt se ata do të më bëjnë krenar. Gjithashtu nuk dua të humbas kontaktet me familjen time, as me shokët e mi. Mbarova duke folur për të ardhmen dhe shpresoj që të realizohen. Mezi pres ta lexoj këtë letër përsëri, pasi do jem një person më i mirë, më i rregullt dhe më serioz.

**Brian Shehu 9B**



Përshëndetje, Bjorni!

Shpresoj t'ia kesh kaluar mirë tërë këtë kohë pa folur bashkë!

Besoje se të kujtohen momentet, që po shkruaje këtë letër! Të them të vërtetën, nuk di nga t'ia nis. Jam shumë kurioz të di se ç'po mendon tani, por duhet ta pranosh, që po kënaqesh. Mos u çudit se të njoh shumë mirë. Nuk e ke marrë aq seriozisht këtë letër, kështu që vlerësoje mundin tim dhe tëndin bashkë. Gjëja e parë, që dua të të pyes është: Se si e gjete këtë letër? Sot si për çudi ka qenë hera e parë, që shkolla pezullohet për arsye klimaterike. Mund të themi me plot gojë, që jemi bërë Europeanë, se ngelën Amerikanët duke bërë pushim tërë dimrin. Ndërsa ne bëjmë GDS. Ky është viti i fundit në 9-vjeçare dhe jam shumë i emocionuar për provimet e lirimt. Sikur të mos na mjaftonin këto, kemi edhe një provim pranimit. Po s'kemi çfarë t'i bëjmë. E di që janë për të mirën time, po më duket sikur e kanë tepruar pak. Të paktën ti i ke kaluar këto halle o mik. Pasioni im për makinat s'besoj të jetë shuar, apo jo? Po e mbyll këtë letër duke të thënë se mezi po pres të shoh se ç'më ka siguruar e ardhmja.

**Bjorn Kotarja 9B**





Përshëndetje Alesia,

Sa shumë kohë ka kaluar dhe sa shumë gjëra kanë ndryshuar.

Shpresoj të jesh mirë dhe besoj se do të jesh bërë një grua e suksesshme. Tani jam 14 vjeç dhe jam në klasë të nëntë. Gjërat sa vijnë dhe po vështirësohen, gjatë tërë kohës kemi provime, por edhe kënaqemi duke ndenjtur me njëritjetrin. Pavarësisht çdo gjëje, jeta vazhdon po ashtu në atë ritmin e përditshëm. Ditët kalojnë dhe çdo ditë ndodh ndonjë gjë e re. Do të më mungojnë shumë kohët e klasës së nëntë. Shpresoj që t'i kujtosh këto kohë kaq të bukura. Jeta do të kalojë sa hap e mbyll sytë dhe do të doja që çdo gjë të shkojë siç ke ëndërruar. Mendoj që do të arrish shumë gjatë këtyre viteve dhe do të plotësohen të gjitha dëshirat. Do të doja që ta lexoje këtë letër, sepse e di që shumë gjëra të bukura do të kujtohen. Mendoj se do të jesh bërë një grua e suksesshme dhe do të bësh krenarë prindërit e tu. E di që do të jetë një rrugë e gjatë dhe e vështirë, por besoj se do t'ia dalësh. Do të doja shoqërinë e këtyre viteve do ta kesh ruajtur deri atëherë. Dua që gjatë këtyre viteve të vazhdoj të krijosh eksperiencën akoma më të bukura dhe më të vlefshme për ty, të vazhdosh një rrugë të mirë për veten dhe t'i bësh të gjithë krenarë.

**Alesia Gjana 9B**



Ç'kemi Geri.

Besoj se do ta lexosh këtë letër të krijuar 15 vjet më parë, nga vetë dora jote 15-vjeçare. Besoj se e mban mend apo jo? Tani ti duhet të jesh ulur në kolltukun tënd në dhomën e ndenjies dhe po lexon të gjitha kujtimet që ti mund t'i kesh ruajtur në një kuti të stërmadhe. Mbase edhe mund të jesh i martuar, mund të kesh edhe fëmijë, besoj se po. Gjithsesi ... E shkruajta këtë letër për të provuar nëse unë mund ta ruaja deri në moshën 30-vjeçare, dhe besoj se e kam arritur. Nuk jam tip i letrave, por këtë letër e kam shkruar me ndrojtje për të ardhmen time dhe se çfarë gjërash më presin në jetë. Po të kujtoj disa gjëra që mund t'i kesh harruar. Le të fillojmë me hobin tënd, i cili ka qenë të dilje gjithmonë i pari në gjërat që ti dije t'i bëje më mirë, gjithashtu ke pëlqyer edhe futbollin, voleybollin etj... Jo për mburrje, por fobi s'kam pasur, as nga këto fobitë e çuditshme si; numerophobia (frika nga numrat), schoolorophobia (frika nga shkolla, këtë doja ta kisha dhe unë). Kjo e fundit ishte shaka. Ke pasur marrëdhënie të mira shoqërore me shokët, nuk është se ziheshe si i çmendur për diçka të kotë. Ke qenë tip i "urtë", të paktën kështu të quanin zyshat dhe profesorët... Të thashë dhe njëherë që nuk jam tip i letrave, prandaj kjo ishte letër e shkurtër dhe mendoj se ka qenë domethënëse për mua (ose ty). Më pëlqen fakti që një ditë do të jem duke e lexuar këtë letër të vyer.

Nga vetja jote, Geri.

**Gerald Lika 9B**



Ç'kemi Alex!

Tani ti do të jesh rritur dhe do jesh duke lexuar këtë letër, e cila mbas 21 vitesh do të jetë rrudhosur dhe vjetëruar. Shpresoj që kjo letër do të bëjë të kujtosh kohën kur ishe një vajzë 14 vjeçare, e cila kishte shumë ëndrra dhe plane për jetën. Mendoj se je akoma një fanse e 5SOS, do kesh shkuar në shumë koncerte të tyre dhe do kesh takuar të gjithë anëtarët e grupit (ti e di që e kam qëllim të flas me Calum). Tani që po shkruaj këtë letër, pyes veten nëse akoma i pëlqen njëbrirëshat (të dyja ne e dimë shumë mirë që ata ekzistojnë)? Shpresoj që të flasësh sa më shumë gjuhë të huaja dhe babi mos të të ketë dërguar për universitet në Maltë, por në Harvard (universiteti i ëndrrave). Kam shumë pyetje për të të bërë...

A e mësove kitarën? (A të la mami ta ndjekësh këtë ëndërr?) ... Po flokët a ke provuar t'i lyesh me ngjyra të ndryshme? ... A je duke jetuar në LA me burrin dhe pesë fëmijët e tu, të cilët mami thotë, që nuk ke për t'i duruar dot? Tre vajza dhe dy djem, apo jo?... Moj vajzë, po me shoqërinë e 9-vjeçares ose edhe të gjimnazit, a ke akoma muhabet? A e mban mend rreshtin nga ana e derës, në klasën e 9-të që ti dhe Ingisi mendonit që ishit rreshti më unik, sado të çuditshëm që ishim. A e mban mend sesi nga një projekt u krijua "70", ku varet e ardhmja ime dhe e Dorës. Besoj se e ke kuptuar që ke patur një fëmijëri dhe adoleshencë të lezetshme. Kur lexoj fjalët që kam shkruar në këtë letër mendoj se s'ke për t'i harruar asnjëherë galletat dhe "aventurat", të cilat ke kaluar me personat, të cilët të kanë shoqëruar në çdo hap të jetës tënde dhe gjithmonë të kanë mbështetur dhe të kanë bërë ajo që je sot. Kjo letër filloi vetëm si një detyrë, por kjo letër po më bën të kuptoj se sa shumë do të më marrë malli për këto kohë kaq të bukura, të cilat nuk do të kem mundësi t'i rikthej... Dëshiroj jashtë mase që t'i kesh arritur të gjitha qëllimet dhe kurrë mos të ndalosh së ëndërruari dhe të kesh qëllime të tjera, të cilat do të bëjnë të ecësh para në jetë. Dua të vazhdosh të jesh po aq e lumtur sa ç'ke qenë. Të përqafoj dhe të puth nga 2016.

Versioni yt, 14 vjeçar.

**Alexia Bare 9C**





E dashur Ambra,

Sa shpejt kaluan vitet, sot je 35 vjeçe, një vajzë e pjekur me një profesion dhe me përgjegjësi. E mendon se sa shpejt iku koha kur ke qenë një vajzë e vogël dhe ëndërroje për gjëra, të cilat ishin të parealizueshme, për lodrat me princesha apo për pallatet mbretërore, në të cilat do të doje të jetoje. Të kujtohet shkolla, në të cilën vazhdove nga klasa e parë dhe deri në universitet? Të mungon shoqëria e vjetër?.... Koha që kalove me ta?.... Lojrat dhe gjithashtu të qeshurat, me të cilat kaloje pjesën më të madhe të kohës? Por tani mos harro që je një vajzë e rritur dhe me përgjegjësi të mëdha. Duhet të kujdesesh për familjen, të ndash shoqërinë dhe të silllesh se një njeri i denjë dhe pozitiv. Tashmë je bërë dikushi në jetë, sepse të jesh një infermiere është një profesion sado i bukur, por dhe i vështirë. Tani do të të uroj të gjithë të mirat në jetë, dhe të uroj që valët e detit të të përplasnin me dallgët e lumturisë!  
Të përqafoj me mall.

**Ambra Nuredini 9C**



Përshëndetje, Bora!

Dukesh më e madhe, më e bukur, dhe më elegante. Sa kohë kanë kaluar pa qenë këtu, në këtë vend që je rritur, dhe që të ka marrë malli shumë. Emri yt është i dëgjuar në mbarë botën, sepse tani ëndrra jote më në fund u realizua me sukses. Je një nga këngëtarët më të mira të çarteve botërore. Vëllezerit e tu, Joni i cili është 27 vjeç, ndoshta një futbollist i shkëlqyer dhe Klevi tani 40 vjeç, sigurisht një biznesmen i madh, duke krijuar një familje të mrekullueshme, që ai ka pasur gjithmonë ëndërr. Mami, babi janë me ty kudo, pasi tani, ti ke turin botëror, jeton në një shtëpi të madhe dhe të ngrohtë pranë familjes që ke sapo krijuar. Tani sigurisht je më e madhe dhe quhesh zyrtarisht një e "Rritur", ndoshta një prind dhe një hallë e mrekullueshme, sepse gjithmonë i ke pasur qejf fëmijët. Në qoftë se je me fëmijë dhe me personin që do ta kalojë jetën me ty, atëherë ke një punë dhe një përgjegjësi shumë të madhe. Ka ardhur koha ta marrësh jetën seriozisht, jo më si një fëmijë. Duhet t'i sigurosh fëmijëve një të ardhme të mirë e duhet të jesh pranë tyre në çdo të keqe dhe të mirë, t'i qortosh kur të bëjnë gabime, t'i këshillosh, t'u përgjigjesh pyetjeve të shumta që ata do të bëjnë, etj. Duhet të qëndrosh me prindërit e tu, të cilët, tani në pension dhe ta kanë nevojën më shumë se çdo herë tjetër dhe duhet t'ia dish vlerën atyre përpara se të jetë vonë.....

Bora, uroj të jesh mirë në çdo aspekt! Të përqafoj.

**Borena Çelaj 9C**



Mirëdita, o vetja ime 35 vjeçare,

A vallë më mban mend apo më ke harruar si ato kujtimet e tua të vyera, që të sjellin ndërmend ato çaste, kur shkoje tek dritarja e tekta vështroje përjashta, e thoje brenda vetes se do të bëja diçka në të ardhmen time.

Po sot ç'je bërë? A e ke përmbushur qëllimin tënd vallë? A munde të bëje diçka në këtë botë? A i ke harruar ato çastet kur shihje fëmijë të gëzuar, që vraponin nëpër rrugë e qeshje me vetveten. A i harron dot ato çastet e tua kur shkoje për pushime e shikoje detin blu sikur e kishte pikturuar ndonjë piktor i njohur. Po ato çaste kur tensionoheshe para provimeve. Ato tensionime ose strese kanë qenë të kota në krahasim me ç'po kalon tani. Të kujtohen ato çaste fëminore që kaloje. Të vjen për të qeshur tani apo jo. Herët a vonë do e dija se shakatë e humori do ishin vetëm një çështje kohe, ku më vonë duhet të paraqisje aftësitë e tua në jetë për të pasur një jetë sa më të mirë, ato audicione për t'u pranuar në ato universitete ku ëndërroje të shkoje për të pasur një shkollim sa më të mirë. Peripeci, e dija që do të kishe për të mposhtur të padrejtën që të rrethonte si një ushtri, kur rrethon një kala, e kalaja përpiqet të shfaqë rezistencë. Në jetë ke pasur një motiv të madh, për të kaluar provat më të rëndësishme, por kush ka qenë ky motiv e nga ka ardhur. Deri sa të hapet kjo letër besoj se do të ngelë një enigmë.

**Bjorn Mato 9C**



I dashur Igli!

Të kujtohem unë? Jam ti i vogël. E di që ti ndoshta nuk ke për ta lexuar këtë letër, sepse do të jesh i zënë me punë dhe teknologjia atëherë do të jetë zhvilluar shumë. E mban mend atëherë kur ke qenë një fëmijë energjik, që doje të luaje gjithmonë, por që mësoje shumë në shkollë dhe ishe me nota të mira. Matematika!! Gjithmonë lënda jote e preferuar. E mban mend kur ishe i vogël, e kishe barkun sa një grusht, por me kalimin e viteve fillove të haje shumë. Gjithsesi besoj se tani je dobësuar shumë dhe je bërë muskuloz. Një gjë të rëndësishme do të të pyes dhe dua të tregohesh i sinqertë: A ka fituar Interi ndonjë trofe? Po tallem. Doja të të pyesja, nëse vazhdove universitetin për ekonomi dhe u martove me ndonjë vajzë të bukur? Shpresoj që të dyja pyetjet të kenë një përgjigje pozitive, shumë pozitive. Shpresoj që t'i kesh ruajtur ata miq që ke pasur që nga shkolla. Gjithsesi po i bie shkurt. Më dëgjo mua për këto fjalë që po të them, sepse do të të duhen. E para, mëso në shkollë, sepse shkolla është pasuri; E dyta, respektoje familjen, sepse ata janë pasuria jote. Dhe të lutem mos ji kurnac. Jepu të gjithëve. Kaq kisha unë. Shihemi në të ardhmen!

Me dashuri Igli.

**Igli Ulliri 9C**



Ç'kemi Ing!

Besoj se akoma të pëlqen kur të thërrasin kështu.

Sot, më 13.10.2016, dielli shkëlqen, ndonëse është ftohtë. Ti po shpreson që të ishte duke rënë borë. Motra ka tre javë që ka ikur dhe me zor po pret ta vizitosh në Hamburg. Megjithatë ti tashmë besoj se je në Gjermani, sikurse ajo. Vras mendjen a ia ke dalë të bëhesh kardiologe? Unë çdo ditë mundohem e lodhem që ti të kesh sukses, prandaj të lutem të ma shpërblesh. A je një kirurge e njohur? Nëse po, sa operacione ke bërë deri tani? A të kanë hyrë në punë videot e kirurgjive që shoh unë? Po gjermanisht a flet rrjedhshëm? A e ke atë theksin, që po më shqetëson kaq shumë? A ke një raft me medalje nga olimpiadat e matematikës? S'besoj se më kanë shkuar kot, të enjtet pas mësimit dhe orët e shumta të ekuacioneve, ndryshoreve a sistemeve çdo të shtunë. Mos u mërzit edhe nëse nuk ia ke dalë. Ti ke ende gjithë jetën përpara. Në shtëpinë tënde a dëgjohet muzikë që kur lind dielli e deri kur të zë gjumi? Ed Sheeran a ka ndonjë këngë të re? Ti me siguri i di përmendësh. Si është viti 2037? Çfarë gjërash kanë ndryshuar? Ndonjë shpikje e re?

Mbi të gjitha a je e lumtur? Shpresoj se po. Unë jam e lumtur me veten time, padyshim do të jem edhe me ty. Të dua shumë, ti nga 21 vjet më parë.

**Ingis Beliu 9C**



I dashur Jon!

Shpresoj që mbas 20 vitesh, të vazhdosh të jesh siç jam unë. Ndoshta unë të imagjinoj ty ndryshe, kurse ti mund të më kesh harruar fare mua. Do të doja të të pyesja se ç'punë bën, a je martuar, sa fëmijë ke etj, por e di që do të më duhet të pres 20 vite për të marrë përgjigje.

Megjithëse ti mund të më kesh harruar fare mua (dhe as nuk përpiqesh të më kujtosh), unë e ndiej si një lloj detyre të të tregoj si ishte jeta jote kur ishe 15 vjeç.

Ti ishe në klasën e 9C, në bankë me Iglin, mbrapa kishe Johnin dhe e gjithë klasa po dëgjonte ulërimat dhe të qeshurat e Pieros. Tani është ora e gjuhës. Zysha është ngritur dhe po e sheh gjithë klasën me vëmendje se mos bën ndonjëri zhurmë. Unë shpresoj që edhe në vitet në vazhdim të jesh fans i Milanit dhe gjithashtu që Milani të ketë fituar plot trofe. Mos harro (ose) fillo që të merresh me futboll, sepse ishte një dëshirë e madhe që të bëheshe një lojtar i zoti.

Do të të kërkoja të mos harroje faktin që ne jemi i njëjti person edhe pse unë mund të të dukem një person krejt tjetër (s' do të çuditësia. Janë 20 vite!), mos harro as të ruash të gjitha miqësitë e mëparshme.

Me dashuri për veten Joni.

**Joni Kraja 9C**



Përshëndetje Jetlira,

Sot jam 14 vjeçe dhe jam në klasën e nëntë. Mësuesja e gjuhës na tha që do të bëjmë një letër për veten tonë në moshën 35 vjeçare. Kjo letër më duket shumë interesante. Mendoj për të ardhmen. Sot jam akoma e vogël, këtu në klasë, me buzëqeshje duke e shkruar. Jam në shkollën "Turgut Özal" dhe, si shkolla më e mirë në Shqipëri me bindje them që do i plotësoj ëndrrat e mia. E them me bindje që do të jem e suksesshme. Gjithmonë kam dashur të bëhem aktore. Nuk e di pse, por ndoshta nga tipi i shkathët që jam. Më pëlqen shumë të aktroj dhe gjithmonë kam marrë pjesë nëpër konkurse duke marrë 3 çmimet e para gjithmonë. Kur të hap këtë letrën, do të jem në vilën time luksoze, duke shijuar jetën si aktore e madhe e Hollivudit. Ndoshta kjo është fantazia ime. Por me punë dhe kurajo do ia arrij qëllimit tim. Do të jem e gjatë siç kam qenë gjithmonë. Shpresoj mos të jem edhe shumë e gjatë, sepse nuk do dukem mirë. Do të jem grua e mbajtur, e bukur dhe e sjellshme. Tani është ai momenti, kur unë lavdëroj veten. Përveç shakave do jem një grua shumë e mirë dhe do t'i ndihmoj shumë njerëzit në nevojë. Kur të hap këtë letrën do të jem e lumtur, do të kem familjen, që gjithmonë kam dashur. Një burrë kuzhinier, që të më bëjë për të ngrënë, një burrë të bukur dhe të pasur. Të kem fëmijë të mrekullueshëm që t'i edukoj dhe t'i rris në mënyrën më të mirë, pa i munguar asgjë. Do t'i bëj të ndihen mirë dhe do i bëj të lumtur në çdo aspekt. Dëshiroj të kem shëndet dhe lumturi. Me ambicie do të jem gjithmonë duke u munduar të arrij majat. Por për të arrirë majat duhen kaluar pengesa, por shkolla dhe prindërit më kanë ndihmuar t'i kaloj pengesat, kështu që s'do kem vështirësi. Shpresoj t'i kem plotësuar të gjitha dëshirat e mia. Jam e sigurt që kur të hap letrën do të jem me lot në sy duke kujtuar fëmijërinë, duke kujtuar shkollën, duke kujtuar shokët dhe shoqet, dhe duke thënë me vete që ia arrite qëllimit, i plotësove të gjitha. Bravo Jetlira, jam krenare për ty! E mbyll letrën dhe them: Sa vite kanë kaluar!

**Jetlira Ibroja 9C**





Përshëndetje Kejsi!

Të kujtohem ndopak unë? Jam ti, njëzet vite më parë. Kisha dëshirë të të kujtoja disa gjëra që t'i kesh parasysh dhe mos t'i harrosh kurrë. Kujto gjithmonë se me sa pafajësi e shihnim botën ne fëmijët. Plot ngjyra e lumturi. Mos harro që të mos ndryshosh kurrë dhe të jesh po ajo e njëjta. Mos harro kurrë prejardhjen tënde dhe origjinën. Mos harro të gjithë ata persona që kontribuan për ty dhe bënë të mundur të arrije kjo që je tani. Gjithmonë ec me mendimin se do të arrish të bëhesh dikush në jetë pavarësisht të gjitha vështirësive që do të të shoqërojnë gjatë gjithë jetës. Kurrë mos u dorëzo, pasi është gjithmonë dikush që mendon e shqetësohet për ty. Vazhdo kështu dhe përpiqu të kujtohesh ndonjëherë dhe për mua.

Se për pak harrova, e mban mend që kam pasur gjithmonë ëndërr të bëhesha piktoresh? Shpresoj vërtet të kesh arritur ta plotësosh këtë dëshirë tënden dhe madje të kesh arritur akoma dhe më lart. Të uroj gjithë të mirat e botës, Kejsi Bici 15-vjeçare.

**Kejsi Bici 9C**



Përshëndetje vetja ime 35 vjeçare!

Sot që po të shkruaj jam rreth të katërbëdhjetave dhe jam në klasën e nëntë. Nuk ia kam idenë se si do të jesh. Apo si do të mendosh apo dukesh. Nuk e di, por gjëja që shpresoja që t'ia kem arritur në moshën tënde është që të mos ta shoh botën me ngjyra të zbehta si gjithë të rriturit. Jo, të shoh botën siç janë filmat e vjetër shqiptarë bardhë e zi, jo, dua ta shoh me ngjyrat e pranverës dhe me ngrohtësinë që ajo përcjell. Gjëja tjetër e rëndësishme që shpresoj, është të mos fiksohem pas punës dhe dëshirës për të fituar sa më shumë para. E di që ndoshta i mban mend mendimet e tua kur ishim të vegjël apo ëndrrat tona se si do të ndryshonim botën dhe si do të bëheshim të famshëm apo të pasur, por kur e mendoj thellë, shpresoj, që ti t'i kushtosh më shumë vëmendje familjes. Në fakt mendimi im për ty është i turbullt, nuk e di nëse do të jesh i suksesshëm apo jo, e shijon jetën apo je i mbërthyer pas karriges së mërzitshme në një punë të mërzitshme. Në fakt nuk ka edhe shumë rëndësi kjo gjë, për mendimin tim, rëndësi ka që ti të jesh një njeri i mirë dhe të kesh njerëz që të duan.

Këtë letër unë po e palos dhe po e vendos thellë në mendjen time, në një vend të errët në një sënduk me çelës. Shpresoj që ti ta gjesh atë çelës në kohën e duhur. Kjo veç të tjerave do të jetë trashëgimia ime për ty.

Me dashuri fëmijëria jote! E njëjta adresë dorëzimi pas 21 vitesh.

**Kejvin Hila 9C**



Hej Oldea,

Si je? A është vallë jeta jote aq e bukur dhe plot ngjyra siç e imagjinoje gjithmonë? Çfarë profesioni ke? Ti gjithnjë kur të pyesnin ishe e pasigurt. Ishe aq e frikësuar për të ardhmen që të priste, saqë i shmangeshe kësaj pyetjeje me çdo kusht. Jam e sigurt që ti e adhuron punën tënde, pasi ke një profesion që të bën të ndihesh e palodhur, një profesion, në të cilin çdo minutë, çdo sekond i jetës tënde ka vlerë. Të mbahet mend se sa e adhuroje biologjinë, shkencën e jetës? Madje, dikur dëshiroje të kishe një mikroskop, të vendosje në të e të studioje çdo gjë të panjohur dhe të mund t'u ktheje përgjigje gjithë atyre pyetjeve fëmijënore që të gumëzhinin në kokë. Çfarë dëshire! Sa keq që kurrë nuk pate guximin t'ua kërkoje prindërve! Gjithnjë i je shmangur mendimit se duhet të kesh një qëllim në jetë dhe e mbaj mend mirë se sa e refuzoje faktin që po rriteshe dhe se së shpejti do të duhej të merrje vendime të rëndësishme. "Unë nuk do të rritem. Le të rriten të tjerët, por unë gjithnjë do të mbetem kështu!", thojë gjithnjë. Shpresoj që tani t'i kesh mposhtur ato frikëra që dikur s'të linin të qetë, të ecësh ballëlartë përpara, e vendosur dhe e sigurt për vendin tënd në shoqëri. A ke shumë shoqe? Kur ishe sa unë kishe shumë, por nuk ndiheshe sikur e kishe gjetur shoqen që do të bënte të përjetoje ndjesinë e miqësisë së vërtetë. Shpresoj me gjithë zemër që ta kesh gjetur një person që të të dojë dhe të vlerësojë për atë që je, person, të cilit t'i tregosh ato ëndrrat e tua disi idiote, por të cilat përmbajnë gjithë çiltërsinë tënde. Pasi ti nuk do të rritesh kurrë, apo jo? Gjithnjë do të mbetesh me atë çiltërsinë e pafajshme, humorin dhe sinqeritetin, të cilin nuk mund ta shprehje me gjë tjetër veç syve gri dhe faqeve që hera-herës bëheshin të kuqe nga turpi. Kam imagjinuar shumë gjëra për ty; tre fëmijë (ose më pak), shumë shoqe, humor dhe për më tepër shumë dashuri, për të tjerët dhe veten. Mos më zhgënje!

Me dashuri, Oldea dymbëdhjetëvjeçare.

**Oldea Mamo 9C**







Përshëndetje Stavro,

Unë jam ti, por vetëm 21 vjet më parë. Kjo letër është për ty, me qëllim për të të kujtuar si ke qenë kur ishe 14 vjeç.

Sot është data 13.10.2016 dhe na dhanë detyrë të të shkruaja një letër ty. Dje mbasdite ia kalova shumë keq, pasi në shkollë u bë kontroll dhe më morën celularin, kështu që nuk dëgjova dot muzikë gjithë mbasditen. Shpresoj ta marr sot. Në fundjavë do të dal me shokët e mi më të mirë që shpresoj t'i kem edhe pas 21 vjetësh, kurse të dielën shpresoj të iki në Gjermani me babin. Këtë vit, ndryshe nga vitet më përpara jam më mirë me notat, sidomos në matematikë dhe kimi. Do mundohem të jap maksimumin për të mësuar, pasi kam provimet e liritimit e duhet të dal mirë patjetër. Nga ana tjetër nuk duhet të bëj mungesa në stërvitje, por të mundohem të programoj kohën e t'i bëj të dyja, edhe shkollën edhe futbollin, edhe pse është jashtëzakonisht shumë e lodhshme. Do doja shumë të dija si është të jesh I RRITUR , të kesh familjen tënde, shtëpinë tënde, biznesin tënd, makinën tënde... Kjo është pak a shumë jeta ime. Shpresoj që jeta jote të jetë më interesante dhe e bukur.

Me respekt, Stavro 14-vjeçar.

**Stavro Qendro 9C**



E dashur Elen,

Kanë kaluar 21 vjet nga shkrimi i kësaj letre. Një Elen 14 vjeçare, që i shkruan një të ardhmeje. Si po të trajton jeta? Uroj të jesh mirë. Të kesh një jetë të stabilizuar, ku të shijosh çdo moment që je mbi dhe. Nuk e di a do e mbash mend se si ke qenë 14 vjeç, kështu që po ta kujtoj. Një fëmijë kurioz e me ëndrra dhe shpresa të mëdha për të ardhmen.

Shpresoj që udhëtimi që ke zgjedhur në jetë, të jetë i duhuri për ne. Dhe uroj që të jesh një nënë e mirë dhe një grua e suksesshme në jetë.

Dua që të jesh e lumtur dhe të kesh çdo gjë që ke ëndërruar. Nuk do të zhgënjehem edhe nëse nuk do të kemi arritur gjë. Jeta është plot surpriza dhe të papritura. Mos u dorëzo kurrë!

Shihemi pas 21 vjetësh.

**Elen Kraja 9D**





E dashur ...!?

E dashur Znj. Shahini... e dashur vetja ime! Mendoj dhe besoj se tani përpara kësaj letre që vjen nga një kohë e hershme, qëndron një zonjë, një grua 35 vjeçare e arrirë dhe e realizuar në jetë. Një grua që vazhdon të bëjë karrierë. Një nënë e mrekullueshme, e përkushtuar, një shoqe shumë e mirë, para se të jesh një bashkëshorte e mirë. Me flokët e mbledhura, ku tek tuk shkëlqen ndonjë thinjë. Me fytyrën e qeshur dhe të qetë, e cila përkëdhelet lehtë nga një lot që bledh në bardhësinë e saj... me nostalgjinë e të qenit fëmijë.

A të kujtohet edhe sot klasë e nëntë? Klasa ku mori jetë kjo letër e shkruar. Të kujtohet kur hyre për herë të parë në atë klasë? Me trupin e imët dhe hapin jo fort të vendosur, me "frikën" e ambientit të ri. Por ky hap ishte vendimtar për ty. Këtu i përforcove bazat e tua dhe ece para.

A e mban mend uniformën e kolegjit? Hahaha, shumë e bukur, por nuk besoj të kesh harruar pantallonat e gjera. Sa e sa herë i luteshe mamit t'i çonte për modifikim. Po ti a i kupton fëmijët tu në këtë pikë? Kuptoji ata kur e duan dhomën rrëmujë, kuptoji edhe kur duan të dëgjojnë muzikë me zë të lartë, tek e fundit në shtëpinë e tyre janë.

E dashur vetja ime! Sa keq do të më vinte për ndonjë notë jo të këndshme që do të merrnin fëmijët e tu. Në fakt për fëmijët e tu do të më vinte keq, në qoftë se nuk do t'i kuptoje. Të gjitha notat për nxënësin janë ta hajë e mira! Vetja ime, ndoshta rrudhat e para kanë nisur të të vizitojnë, por sa të bukura duken. Ato do të tregojnë se ke jetuar, ke qeshur e je trishtuar. Jam shumë kureshtare të di si je. Je si mami im? I ngjan babit, apo të dyve nga pak? Do të doja që t'u ngjaje të dyve, por mbi të gjitha të jesh vetvetja.

**Denada Shahini 9D**



I dashur Bashkim,

Po të shkruaj këtë letër, që ti ta lexosh në të ardhmen. Unë ndonjëherë pyes veten se çfarë jete do të kem pas 20 vjetësh. E para, jeta do ketë ndryshuar shumë dhe mund të jetë e vështirë për të jetuar. Unë e imagjinoj veten në një shtëpi me dy fëmijë. Dua që të jem i suksesshëm në jetë. Tani që po lexon këtë letër, ndoshta kujtohesh për fëmijërinë tënde, për momentet më të bukura, por ti ke përgjigjësi për familjen, punën e shumë gjëra të tjera. Gjithsesi jeta po vazhdon dhe unë e di që ti do t'ia dalësh në shumë gjëra, sepse në fund të fundit ti, je unë. Shpresoj që të të jenë plotësuar të tëra dëshirat e tua dhe ëndrrat që ke dashur. Përherë kam dashur të jetoj në një vilë me familjen dhe me disa nga të afërmit e mi. Do dëshiroja të kisha një oborr të madh me lule, ku fëmijët e mi të luajnë e të kënaqen.

**Bashkim Burimi 9D**



Si je Anxh?

Si po ia kalon? Unë sot jam në klasë dhe po të shkruaj këtë letër. Tani do të të flas për jetën time. Jeta që kam kaluar deri tani, ka qenë jeta më e bukur në botë. Familja dhe shoqëria ma kanë zbukuruar më shumë. Me shoqërinë jam kënaqur pak më shumë duke bërë shumë çmendurira. Besoj se nuk i mban mend, sepse ka kaluar shumë kohë. Shpresoj që t'i kesh arritur ato çfarë ke dëshiruar. Të kesh një karrierë të famshme, një familje të përsosur, shoqërinë që ke pasur ta kesh akoma. Do të doja shumë që ti ta lexoje këtë letër, të cilën unë po të shkruaj në këto momente, në moshën 14 vjeçe që të kujtosh kohët që ke kaluar.

Me shumë dashuri.

**Anxhela Elezi 9D**



E dashur Amela,

Nëqoftëse të kujtohet, e ke shkruar këtë letër më datë 13.10.2016. Nuk e di a do të jepet ndonjëherë mundësia për ta lexuar këtë letër deri sa të bësh 35 vjeç. Nëse po, dua që kur ta lexosh të mendosh vetëm për momentet e çmuara e të paharrueshme të të gjitha viteve të shkuara. Dua që të kujtosh të gjitha ëndrrat që ke pasur, të gjitha dëshirat. Kujto zhurmën që po bënte klasa, ndërsa ti e shkruaje këtë letër. Çdo tingull zëri, çdo qortim të mësueses, çdo buzëqeshje. Dua që kur ta lexosh këtë letër, të kesh arritur gjithçka që do të të bënte të lumtur. A e mban mend që doje të studioje në Angli për stiliste, aktore dhe regjizore? Doje të shkruaje libra e të lije një shenjë në çdo zemër që prekje. Seç kam një përshtypje që ia ke arritur të gjithave. Dhe e di pse? Ishe dhe je personi më kokëfortë, më këmbëngulës dhe me ambicien më të madhe që kam njohur. Jam e sigurt se, nëqoftëse do ta lexosh ndonjëherë këtë letër mbas shumë vitesh, do të dridhen duart, ashtu siç t'u drodhën teksa e shkrove. Amel ke kaluar shumë sfida, ke patur shumë ulje-ngritje (megjithëse këto nuk para ia lejon vetes), dua ta dish se asgjë nuk arrihet vetëm. Ti gjithmonë ndryshe nga të tjerët, thoshe se jeta që do të bëje, do të ishte vetëm për karrierë dhe nuk do kishe kohë për familje. Dhe kur po e shkruaje letrën përsëri me këtë mendim qëndroje e vendosur, por dua, që kur të vijë momenti letrës ti të kesh një karrierë sa më të arrirë dhe të kesh krijuar një familje me njeriun që do. Duhet ta kujtosh se do të jesh e suksesshme vetëm nëse do të kesh dikë, me të cilin ta ndash suksesin e lumturinë. Dua që derisa kjo letër të të trokasë në derë, të kesh shijuar çdo moment të jetës në maksimum, dua të kesh krijuar kujtime që do t'i ruash përgjithnjë, ashtu si kjo letër, që do të presë me padurim që ta hapesh. Amel, thjesht jeto!

Me dashuri, E ardhmja jote.

**Amela Buzi 9D**



I dashur David,

Këtë letër po e shkruaj vetë unë për të të treguar se çfarë ka ndodhur deri tani. Ky është viti i fundit midis nesh, klasës së 9-të D dhe kjo gjë na trishton të gjithëve. Shpresoj që deri tani, t'i kesh arritur disa nga qëllimet e tua, disa nga ato, të cilat i ëndërroje gjithmonë në këtë moshë që po shkruhet kjo letër. Shpresoj që të kesh sukses të mëtejshëm në fushën e artit. Shpresoj që të jesh ai që ti ëndërrove të ishe. Kjo kohë do të kalojë shpejt, andaj të rikujtoj çdo moment të bukur të shoqërisë, çdo përqaftim, premtim, çdo gjë që do të t'i mbushi sytë me lot kur t'i kujtosh. Së pari këto shokët dhe shoqet e tua të ngushta, pa të cilët ti nuk qëndroje dot asnjë ditë. Ishit të pandashëm. Kujtoji me mall. Dua të falenderoj çdo njeri që të ndihmoi të qëndrosh këtu. Falendero prindërit që të rritën dhe të dhanë jetë me shumë mund e sakrificë. Ata s' do jenë gjithmonë pranë teje, prandaj kujdesu dhe bëja qejfin gjithmonë. Falendero çdo mësuese që të dha dije dhe të ndihmoi të kesh një këndvështrim për jetën. Falendero çdokënd. Falendero Zotin që të dha këtë fat, të ishe pjesë e një familjeje kaq të mirë, pjesë e kësaj klase, kontinenti, bote.

**David Prifti 9D**



E dashur Event!

Sot ke ditëlindjen e 35-të. Përgatitjet për festën që ke organizuar po shkojnë shumë mirë, edhe pse ti vazhdon të jesh e stresuar, pasi dhe pse je rritur tashmë, je po e njëjta. Po, je e njëjta Event, që ke qenë dhe në klasën e 9-të, kur po shkruaje këtë letër. Eventi që kërkon e dëshiron që çdo gjë të jetë perfekte, ambicioze (për mirë kuptohet) dhe shumë e organizuar. Le të kthehemi disa vite më parë dhe t'i hedhim një sy jetës tënde, arritjet e tua, uljet e ngritjet që ke kaluar. Ke arritur shumë gjëra dhe pse në një moshë relativisht të vogël. Ndihem krenare për ty, pasi me të vërtetë nuk u dorëzove, nuk ndalove së menduari e punuari për ëndrrat e tua, e për t'i bërë prindërit e tu krenarë. Mbarove shkollën e avokatisë dhe pse në rolin e një personi publik. Nuk u dorëzove: Ia dole të bëheshe pjesë e botës së aktrimit. U refuzove shumë herë, shumë dyer të mbyllura, shumë audicione e përsëritje skenaresh dhe pjesësh të ndryshme akoma "You are going Strong!" Ke ndërtuar një familje të mrekullueshme e të lumtur. Më bëhet shumë qejfi për këtë. Gjithmonë ke ëndërruar për një familje të madhe e plot hare. Shumë lot ke derdhur, gjatë rrugës. Lot, ndarje, mërzitje, por u ke dalë ballë, pasi kështu ke qenë gjithmonë, e fortë dhe besim në vetvete.

Nuk je perfekte, por je ajo që unë kam ëndërruar të jesh gjithmonë!

Faleminderit! Qetësohu, bëj një hap prapa, shijoj dhe Gëzuar Event!

**Event Sharku 9D**



Përshëndetje Omari 35 vite në të ardhmen,  
Shpresoj që deri tani t'ia kesh kaluar dhe të jesh në shëndet të mirë. Shpresoj të jesh bërë njeri i matur dhe i respektuar. Shpresoj se ke pasur një jetë të lumtur dhe të kesh krijuar familjen tënde, një grua të mirë dhe besoj se tani mund të keni edhe fëmijët tuaj. Duaji dhe mbroji ata mirë. Për punën nuk besoj se do kesh pasur ndonjë problem, por prapë të uroj fat të mbarë. Dhe mos harro se fëmijët janë kryesorët, kështu që krijoj kondita të mira, arsimim dhe edukim të mirë. Për tani vetëm kaq mund të them dhe paç fat në të ardhmen dhe mbajni parasysh këshillat e mia. Me shumë respekt

**Omar Vorpsi 9D**



E dashur vetja ime,  
Si po ia kalon? Koha kalon shpejt, aq shpejt sa që nuk merret vesh. E di që këto 20 vera dhe dimra do jenë shumë të rëndësishëm për ty, prandaj dua të sigurohem që çdo gjë të shkojë mirë. Sot është data 26 tetor e vitit të largët 2016. Jam shumë i sigurt, që nuk e mban mend këtë datë dhe besoj se gjërat, që tani i konsideroj të rëndësishme nuk do të kenë fare rëndësi për ty në të ardhmen. Uroj që gjatë kësaj kohe t'ia kesh plotësuar të gjitha dëshirat! Uroj që të jesh bërë një doktor i famshëm në gjithë Gjermaninë! Vetja ime, e vetmja gjë që të kërkoj është që të mos ta ndryshosh asnjëherë tipin që ke. Dua që të jesh po ai njeri besnik, që i ndihmon të tjerët edhe pse e di që të tjerët s'mund të më ndihmojnë, ai njeri që bën çdo gjë, edhe të pamundurën për njerëzit e zemrës, ai njeri që kundërshton për çdo gjë, edhe kur e ka gabim. Shpresoj që të arrish të bësh gjithçka që ke ëndërruar, por edhe në qoftë se nuk i ke arritur, asnjëherë mos u dorëzo. Kur të kesh kohë të lutem m'ia përqafo fort nënën me gjyshin!!!!

Vetja jote para 20 vitesh.

**Ergi Istrefi 9D**



Çkemi Olti,  
Unë doja të dija se si do të jem në moshën 35 vjeçare. Besoj se ti tani do të kesh mbaruar shkollën. Kur ti të hapësh këtë letër, do të kuptosh se sa keq ke qenë në krijimin e eseve. Besoj se do të kem një shtëpi normale në një fshat të bukur e të qetë. Qyteti nuk është se nuk më pëlqen, por fshati është më mirë. Ndoshta do të kem gjetur një punë të mirë. Punë të mirë, quaj një punë, e cila nuk është e lodhshme, por që ka të ardhura të mira.  
Mirupafshim!

**Olti Mazreku 9D**



Përsëndetje Melisa,

Je duke lexuar këtë letër apo jo? Nëse po atëherë, të lutem më dëgjo...

Jam ende vetëm 14 vjeç, e ti mund të jesh duke menduar se ç'vlerë ka mendimi i një katërbëdhjetëvjeçareje. Shpresoj të më kuptosh, por është mendimi yt. Ndoshta nuk do ta pranosh atë ç'ka do të them unë, atëherë të lutem vetëm më dëgjo. E di që ti tani je rritur, ndoshta ke krijuar edhe familje e besoj se ke një vizion tjetër për jetën. Vë bast se po kujton veten në fëmijëri, një fëmijë i çiltër, që vetëm qeshte. Besoj se po kthehesh mbrapsht në mendime, po kujton shokët e shoqet me të cilët kaloje aq shumë kohë, e qeshnit aq shumë, kur nuk kishte nevojë të vrisje mendjen për asgjë e kur njerëzit e zemrës i kishe pranë çdo kohë. Kohë të bukura ishin, vërtet, por tashmë kanë kaluar. Kanë kaluar si çdo kohë e jetës, që ikën e nuk kthehet më. Tashmë nuk je më një fëmijë, ke përgjegjësitë e tua. Kjo s'do të thotë se jeta ka kaluar, çdo kohë e jetës tënde është si një fushë e pafundme me lule pranvere, e nuk ia vlen ta humbasësh këtë kohë e mërzitur, sepse jeta është një udhëtim aq i shkurtër, sa udhëtimi i një zogu që kalon nga një degë te një tjetër e së njëjtës pemë.

**Melisa Vadenja 9D**



I dashur Drini,

Sot je 35 vjeç dhe ke vendosur që ta hapësh këtë letër. Me zor ke pritur, por më në fund dita erdhi. Sot je një burrë i madh dhe kur kujton shakatë e fëmijërisë qesh me të madhe. Edhe pse je bërë më serioz, nuk ke ndryshuar shumë nga më parë. Dëshira për të qeshur ende ekziston tek ty. Sot je i rritur dhe me anë të zgjuarsisë ke arritur shume lart. Je bërë shumë i pasur dhe falë zemrës së mirë që ke, i ndihmon njerëzit në nevojë. Shpesh ndihmon dhe shokët e tu. Ke një shoqëri të madhe dhe besnike, ku shokët nuk të tradhtojnë kurrë. Kujdesesh për prindërit e tu, që tashmë janë në moshë të thyer. Jeta të ka mësuar shumë gjëra. Edhe pse, përveç kujtimeve të gëzuara, ka pasur dhe të dëshpëruara, por ti i ke kaluar të gjitha provat me sukses. Uroj dhe që e ardhmja të jetë e tillë.

Me dashuri, Drini.

**Drini Hoxha 9D**





E dashur Bjorna,

Shpresoj që kjo letër të të gjejë të realizuar, ashtu siç ti ke dashur dhe ëndërruar gjithmonë. Besoj dhe uroj se i ke përmbushur të gjitha qëllimet që i ke vënë vetes dhe ke realizuar gjithë ëndrrat dhe dëshirat që ke pasur. Është moshë me e bukur, ku njeriu ka arritur diçka në jetë dhe po provon frytet e punës dhe sakrificave të bëra gjatë gjithë këtyre viteve. Por edhe në qoftë se nuk i ke realizuar akoma, mos ndalo së provuari. Kam dëgjuar që, kur rritesh nuk ëndërron më, nuk përpiqesh të realizosh atë që do, por thjesht jeton një jetë të zymtë, pa ngjyra dhe dëshira. Jam e sigurt që kjo gjë nuk do të ndodhë me ty. E di dhe jam e sigurt që çdo ditë do të luftosh për atë që dëshiron dhe kurrë nuk do ndalosh së ëndërruari. Shpresoj të mos kesh harruar, çfarë ti ke ëndërruar, kur ke qenë e vogël. Ndoshta tani mund të të duken si dëshira të kota dhe pa kuptim. Por jo, vazhdo, përpiqu t'i realizosh, qoftë edhe thjesht për të mbajtur premtimet që i ke bërë vetes, si atëherë, kur i the vetes që do vizitoje çdo vend të botës. Ose atëherë, kur i premtove që një ditë do të zhyteshe thellë në oqeanin blu dhe do të shikojë gjëra që kurrë si kishe parë dhe gjallesa plot ngjyra të botës aq magjepsëse nënujore. Ose atëherë kur pe atë filmin me eksplorues dhe vendose që do të eksploroje vende të botës që askush nuk i ka eksploruar më parë. Gjithashtu i the që do të bëje një shpikje, për të cilën të gjithë do të të mbajnë mend. Madje edhe dëshira të tilla si të bësh sërif, të mësosh të kalërosh dhe të hipësh në balonë. Po atë premtimin, ndoshta dhe më të vështirin që i ke bërë vetes, a e ke mbajtur? Ai, që të mposhtje frikën tënde më të madhe. Besoj se po, jam e sigurt për këtë. Një gjë tjetër që i premtove vetes, kur dole vendi i dytë në konkursin e matematikës, është që do të zije vendin e parë në një konkurs tjetër. Po gjithashtu i premtove vetes se kjo gjë nuk do të të bënte egoiste dhe do të fitojë vetëm në mënyrë të sinqertë, se pastaj nuk do të kishte asnjë kuptim.

Besoj se je bërë një arkitekto e famshme dhe ke hapur studion tënde, që gjithmonë e ke dashur. Për këtë jam e sigurt që e ke arritur, pasi e njoh këmbënguljen dhe vendosmërinë tënde për të realizuar atë që ëndërron. Kjo ka qenë gjithmonë dëshira jote më e madhe. Shpresoj të mos ngelesh me kaq. Kurrë mos mendo se është mjaftueshëm, ajo çfarë ti ke arritur. Mundohu për më shumë!

Gjithashtu e di që të qenit e pasur nuk ka shumë rëndësi për ty. Ti gjithmonë ke ndihmuar të tjerët, ke dhuruar edhe atëherë kur nuk kishe vetë mundësi. Gjithmonë u je lutur prindërve të tu të ndihmojnë fëmijët në nevojë, që dhe ata të ishin të lumtur, ashtu siç ti ke qenë ngaherë. Ndërsa tani këtë mundësi ti ia ke krijuar vetes. Gjithmonë je pranë njerëzve që kanë nevojë. Gjithashtu, shpresoj të kesh krijuar një familje të madhe dhe të lumtur. E di që këtë gjë e ke dashur gjithmonë. Gjithashtu ke dashur të kesh edhe një qen, të cilin prindërit nuk ta merrnin, se babi yt ishte alergjik ndaj tyre. Uroj që tani ta kesh një të tillë! Për fëmijët, jam e sigurt që do t'i rrisësh me aq dashuri dhe përkujdesje sa të rritën prindërit e tu dhe me po aq sakrifica. Por, mos harro, jepu këshilla



të vlefshme për jetën dhe gjithmonë gjendju pranë! Përpiqu t'i kuptosh dhe kurrë mos i kërko të jenë diçka që s'janë. Mos harro që dhe t'i ke qenë si ata. Përpiqu ta kujtosh prapë atë botë të mrekullueshme me gjithë bukuritë dhe vështirësitë e saj! Përpiqu të kujtosh si ishte "të jesh fëmijë" dhe vije veten në vendin e tyre. Mos u mundo të luash vetëm rolin e prindit, por edhe të shoqes së ngushtë, të cilës ata mund t'i thonë çdo gjë, të cilës i marrin mendim, të cilës i besojnë. Mos i qorto për gabimet që bëjnë, por bëji të dallojnë çfarë është e drejta dhe çfarë është e gabuara. Gjithashtu mos harro që asnjë nuk është perfekt. Mbi të gjitha shpresoj të jesh e lumtur dhe e gëzuar me zgjedhjet që ke bërë.

Me dashuri për ty.

**Bjorna Përmeti 9E**



E dashur Edea,

Kjo letër është për ty, që kur ti të jesh 35 vjeç dhe shumë gjëra t'i kesh harruar, kjo letër të t'i kujtojë. Të kujtohet si ishte të qënit fëmijë? Jo vetëm të pasurit me pak stres, por jeta në përgjithësi: të shkuarit në shkollë, rolin aq të madh që zinte shoqëria në jetën tënde, shtëpia plot me njerëzit më të dashur të familjes. Të kujtohen ndjenjat e hershme, kur merakoseshe për shkollën ose kur problemi yt më i madh ishte kur ziheshe me ndonjë shoqe, kur ndiheshe sikur askush nuk të kuptonte? Mos i harro kurrë këto gjëra. Ndoshta tani të duken të pakuptimta, kapriço fëmimore, por ato janë pjesë e jotja. Ato janë origjina e asaj çfarë je tani, dhe për të qenë një person sa më i mirë, duhet të kujtosh të kaluarën tënde, të mësosh nga gabimet dhe të rikujtosh vlerat dhe besimin që ke patur dikur. Ndoshta në këtë moment ndihesh keq. Ndoshta nuk ke arritur akoma atë që do. Dua të dish se nuk ka asgjë gabim këtu. Me kalimin e kohës çdo gjë do rregullohet. Por mos i humb shpresat dhe mos ndalo kurrë së përpjekuri! Kujto gjithë njerëzit që të duan e kanë besim te ty. Kujto gjithë herët që ke hasur një problem dhe ia ke dalë mbanë! Ndoshta gjërat të duken të zymta e të koplikuara, por duhet ta dish se çfarë mendoj unë që të bësh. Mendo si fëmijë. Thjeshtoji gjërat, jepi ngjyra jetës. Do e shohësh që gjithçka mund të rregullohet.

Ndoshta në këto moment je e lumtur, ke arritur gjithë çfarë ke dashur dhe po përparon gjithmonë e më shumë. Vazhdo kështu! Mos u step para vështirësive, ndjehu krenare për veten! Ndaje këtë lumturi me të tjerët! Jeta është e bukur, shijojë në maksimum!

Si përfundim, dua të të them që të jesh e lumtur, gjithmonë. Beso te vetja dhe mos u dorëzo kurrë! Në fund gjithçka do rregullohet. Dhe në qoftë se ndonjëherë dyshon ose ndihesh vetëm, dije se je e rrethuar nga njerëz që të duan, por mbi të gjitha, të duash veten.

Me dashuri, Edea 14 vjeçare Tiranë.

**Edea Zusi 9E**





Letër vetes sime...

Ç'kemi Aldez? Unë jam ti para 21 vitesh. Shpresoj të më mbash mend. Dhe shpresoj mos t'i kesh humbur vlerat që kam tani. Tani për tani kam shumë ëndrra, por unë mendoj se ti do kesh zgjedhur më të mirat për mua. Nuk ka rëndësi vetëm pasuria ose jeta që ti bën, por rëndësi ka zemërgjerësia dhe t'i shërbesh të tjerëve. Duhet t'i duash njerëzit që të rrethojnë si në ditë të mira, ashtu dhe në të këqija. Dua që të kesh lumturinë e dikurshme; ai djali i qeshur, i shkathët, zemërmirë dhe i shoqërueshëm me të tjerët, ai djali që nuk lëndonte njeri dhe që e donin të gjithë. Sigurisht që kam bërë dhe prapësira, nga të cilat njerëzit që më rrethojnë janë mërëzitur me mua. Ah more Aldez! Kjo jetë ka ndodhi të mira, por gjithashtu dhe të këqija. Por këto ndodhi do të ndërthuren në jetën tënde. Nuk duhet të hidhërohemi për ndodhitë e këqija, sepse kemi ende jetë për të jetuar. Shumë të mira do të na presin.

Mbetem në pritje të letrës tënde me shpresën e madhe të arritjeve në jetë.

Me respekt dhe shume dashuri.

**Aldez Muhametaj 9E**



E dashur Kida,

Sa kohë ka kaluar!? Plot 20 vjet, që atëhere kur ishe një 15-vjeçare. Kishe botën tënde fëminore e të padjallëzuar, ku e merrje çdo gjë për të mirëqenë e, kur akoma nuk e dije mirë kuptimin e fjalës vetmi ose gënjeshtër. Jetoje në një botë të lirë e pa paragjykime.

Çfarë ka ndryshuar në jetën tënde? Si i shikon gjërat një 35-vjeçare? Si ishte rruga deri tani? Patjetër e vështirë, sepse jeta të vë përballë shumë të papritura. Si janë mami me babin? Vazhdon të zihesh me motrën dhe vëllain? Duhet të kesh krijuar një familje të re, të bukur, tënden. Po binjakët si janë, sepse di që ti gjithmonë i ke dashur. Çfarë pune bën? A të bën të lumtur "kjo jetë e re"? Kur kthehesh në shtëpi, a ndihesh e lumtur, sepse do të shkosh në fole të tënde të ngrohtë? E ke më atë durimin e palodhur? E di që durimi ishte një nga virtytet e tua më të mira. E ke të vështirë të zësh miq të rinj? E mbaj mend se e ke pasur shumë të vështirë. Pyetja më e vështirë vjen tani: A je ti e lumtur, vërtet e lumtur? A je prap e njëjta ti? E di që ndoshta po të lodh me kaq shumë pyetje, por thjesht dua të di se çfarë ndodh gjatë këtyre viteve që kalojnë. Dua të di çdo gjë që ndodhi në jetën tënde. Dua të të them se gjithmonë ti më ke bërë krenare e përjetë do të jem krenare për ty. Ty do të të kem përkrah meje gjithë jetën se e di që te ty mund të kem besim e ti do të jesh me mua prandaj nuk do të mendoj kurrë se jam vetëm. Jo, sepse unë të kam ty.

Me zor pres të të takoj. Me dashuri Kida.

**Alkida Kepi 9E**



E dashur Era,

Çdo moment të bukur ne e kujtojmë dhe fillojmë të mendojmë. Nga çdo moment të "shëmtuar" ne mësojmë. Sigurisht që jeta i ka të dyja këto momente. Po një nga këto më të bukurat ka qenë kur unë fillova të mendoja për të ardhmen time. Të mendoja për të ardhmen time, ishte të mendoja se çdo të bëhesha në jetë. Lënda që më ka pëlqyer gjithmonë në shkollë ishte gjuha e huaj angleze. Do doja që të kisha qendrën time të përkthimit. Të udhëtoja nëpër botë duke ndihmuar njerëzit. Do doja të bëhesha një përkthyes aq e mirë, sa që të merrja pjesë në eventet më të rëndësishme. Do doja që të shkoja në vendet e varfëra, ku ka gjithashtu dhe fëmijë të varfër. Do doja që atyre fëmijëve t'i mësoja edhe gjuhë të huaja, që ata të kenë sa më shumë njohuri për to. Ndoshta në të ardhmen mund të bëhen përkthyes të zotë. Kurrë nuk i dihet! Unë do të ndihesha shumë e lumtur që kam mësuar ata fëmijë. Jam krenare për ty! Për qafime Era.

**Era Shkëmbi 9E**



Përsëndetje vetja ime e ardhshme Renis,

Jemi i njëjti person, po shpresoj që ti të mos kesh ndryshuar, të mos jesh futur në rrugën e gabuar. Shpresoj të jesh ai djali ambicioz që kërkon gjithmonë të jetë më i miri, gjë që gjithmonë kam menduar se do më ndihmoj atje jashtë, në botën e ashpër. Shpresoj që mënyra se si kjo botë funksionon të mos të ketë zhgënjyer, edhe nëse të ka zhgënjyer. Ti të jesh ai që e ndryshon këtë botë, sepse kjo është gjëja që ne bëjmë, kur diçka s'na pëlqen e rregullojmë. Gjithmonë pëpiqemi e kurrë s'do rrëzohemi, edhe nëse jeta na godet prap, të ringrihem. Shpresoj që të jesh bërë ai djali pa komplekse e t'i kesh mposhtur veset. Mbi të gjitha shpresoj të jesh i lumtur dhe të punosh e të jetosh ndershëm. Një jetë është e gjitha ajo që kemi, kështu që mos dysho në zgjedhjet e tua dhe merr përsipër rreziqe. Jeto çdo ditë si të ishte dita e fundit! Puno fort dhe zbavitu në të njëjtën kohë! Mos lerë asgjë të të konsumojë! Mos e vrit shpirtin e fëmijës që ke brenda vetes! Duket sikur po të këshilloj, por thjesht po të hap sytë që të mos harrosh kush ke qenë. Për sa i përket familjes nuk e di ç'do të thotë të jesh baba, po shpresoj që ti ta kesh kuptuar dhe të jesh si babai ynë, personi që kemi idhull. Së fundmi shpresoj që të gjitha ëndrrat dhe objektivat të jenë realizuar.

Pavarësisht çdo gjëje që ndodh qëndro i njëjti dhe duaje jetën akoma më shumë!

Me respekt

**Renis Sanxhaku 9E**



I dashur Kevin,

Unë jam ti në moshën 15-vjeçare dhe po të shkruaj për të të pyetur e kujtuar disa gjëra.

Vras mendjen se çfarë pune bën? Në moshën time ke dashur të bëhesh një biznesmen i zoti, por jetës nuk i dihet asnjëherë. Kështu që jam shumë kurioz të di për profesionin tënd. Shpresoj të bësh një punë që e pëlqen me gjithë zemër. Tani ti duhet të kesh krijuar një familje, me të cilën uroj të krijosh sa më shumë kujtime të bukura. Të këshilloj të mos bëhesh skllav i punës, por të kujtosh se koha e shpenzuar me familjen është gjithashtu shumë e çmuar. Shpresoj të takohesh shpesh me prindërit si dhe me motrën tënde. Besoj se duke patur kaq shumë njerëz të dashur afër teje do të ndihesh gjithmonë i lumtur.

Të përqafoj Kevin

**Kevin Kaloshi 9E**



E dashur Estel,

Po ta shkruaj këtë letër për të të rikujtuar disa nga gjërat më të bukura, kujtimet më të paharruara të kësaj bote femërore që po përjetoj tani.

Shpresoj që t'i kem realizuar ëndrrat dhe dëshirat që kam tani. Në qoftë se akoma nuk janë realizuar, mos harro se nuk është kurrë vonë për t'i bërë realitet. Gjithashtu shpresoj që puna që po bën të jetë ajo që ti do doje më shumë. Puno dhe lufto për profesionin tënd të preferuar. Dhe shpresoj me gjithë shpirt që të kesh një familje të shëndetshme dhe, kurrë mos harro sakrificat e mamit dhe të babit! Kujdesu për ta, siç u kujdesën ata për ty! Kurrë mos i lerë vetëm, derisa vdekja t'ju ndajë. Bëji ata njerëzit më të lumtur, siç ata të bën ty. Kurrë mos harro ta mbash trupin në formë, se gjithmonë i kam premtuar vetes se nuk do të heq dorë nga sportet.

Shpresoj që të jesh gjithmonë mirë dhe e lumtur. Me dashuri Estel.

**Estel Çausi 9E**





E dashur Dea 35-vjeçare,

Pak e çuditshme të mendoj bisedën me veten pas 21 vjetesh, por interesante dhe intriguese njëkohësisht! (Madje po përpiqem të të imagjinoj edhe si dukesh). E mban mend si ishte ajo kohë? Ta kujtoj unë... Qeshur shumë, lozur shumë, mërzitur, ndoshta në mënyrën tënde të të parit për gjëra të parëndësishme, por që për këtë moshë janë pjesë e botës së të menduarit tonë. Nga njëra anë është shkolla, është klasa e 9-të. Një pikë e rëndësishme kthese. Duhet të të kujtohet me sa ankth ke pritur provimet e saj. Mua për momentin më duken sa larg, aq dhe afër, por po punoj për to çdo ditë. Shpresoj dhe besoj se do të shkojë gjithçka mirë. Kjo është gjëja më e rëndësishme për mua për momentin! Të kujtohen shoqet dhe shokët? Një grup i dashur, ku bashkë rritemi përditë. S'ka më bukur se të rrethohesh nga kaq mirësi dhe të mësosh nga ato gabime të vogla që bëjmë secili.

Ndoshta je mama dhe këtë moshë e sheh me këtë sy, por mbase do të ma thuash dot një herë tjetër se si je ndjerë atëhere, domethënë tani. Ndërkohë mua më duhet të marr vendime që duken të vështira. Bukur dhe sfiduese të rritesh! Viti që vjen është gjimnazi dhe më pas studimet e Universitetit (duket sikur s'mbarojnë kurrë...), por do të jenë ato hapa që do t'më sjellin deri aty ku je ti sot. Për të qenë e singertë, ende nuk e di se cila do të jetë kjo rrugë. Ty me sytë e mendjes të shoh si grua të bukur dhe të realizuar, me një punë, e cila të pëlqen dhe të shpërblen. Shoh rreth e rrotull teje shoqet e mia që kam sot edhe ato të rritura po njësoj. Fëmijët tanë mbase duke lozur rreth e rrotull dhe ne duke kujtuar këto vite, si dhe duke folur për ditën dhe jo vetëm.

Shpresoj vërtet dhe duket interesante ideja, që pas aq vjetësh të sjell në mendje sërish letrën që po të shkruaj dhe ta gjej atë, po kaq të bukur sa më duket mua tani.

Të përqafoj fort, o Dea e madhe,  
Nga Dea e vogël.

**Dea Pëllumbi 9E**





I dashur Irfan,

Sot në moshën 15 vjeçare, përveç ngjyrave, lumturisë dhe sigurisht fantazisë së shfrenuar kam filluar që në atë mënyrën time disi naive, të mendoj për të ardhmen. Përpiqem të mendoj pak, pasi kjo periudhë në dukje të shkurtër, pasi është periudha më e bukur e jetës sime. Gjithashtu e di, që gjithçka nga kjo periudhë do të jetë zhdukur nga kujtesa ime, e di që bashkë me të do të ikin edhe ngjyrat që ne i japim jetës. Prandaj, dua të të shkruaj sot për të të kujtuar se kurrë nuk duhet humbur lumturia dhe dëshira për të jetuar. Siç e thashë dhe më sipër, kjo periudhë është më e bukura e jetës tënde, kështu që gjëja e fundit që duhet t'i lejosh vetes është që të harrosh kujtimet që ke nga kjo moshë. Nuk duhet harruar asnjë nga ato budallallëqet femijënore, çdo minutë dhe sekondë duke qeshur dhe duke bërë atë që të pëlqen. Duhet të të kujtohen të gjitha planet e çmendura që bëje për të ardhmen e largët apo të afërt me shoqërinë. Gjithmonë mendoja se do të isha i suksesshëm në mënyrën time dhe në moshën që ti je tani. Të isha duke bërë diçka që më pëlqente dhe që më kënaqte shpirtërisht. Besoj te ti. E di më mirë se unë, në ia kam mundur t'ia dal dot. Me gjithë shpirt shpresoj dhe besoj që çdo minutë e vështirë, e trishtueshme apo e lumtur, t'ia ketë vlejtur barra qiranë dhe të mos ketë shkuar dëm. Dua të të kujtoj që, nëse je në vështirësi nuk duhet të humbësh shpresën dhe ndjesitë e bukura që e rrethojnë atë, pasi nëse ke humbur shpresën, ke humbur çdo gjë. Mos harro që çdo njeri, sado i parëndësishëm në memorien tënde, ka qenë një faktor i madh në jetën dhe formimin e karakterit tënd. Dua të të kujtoj se çdo njeri që tani në moshën 35-vjeçare po të qëndron pranë dhe i konsideron të rëndësishëm në jetën tënde, mbaji pranë, duaji dhe kujdesu për ta. Duhet të mendosh e të bësh më të mirën për ata dhe për ty. Po i afrohem fundit të kësaj letre të shkurtër dhe shpresoj që me këtë letër të shkurtër të të kem dhënë një mesazh të rëndësishëm, pasi nuk duhen shumë fjalë të mëdha për të përcjellë një mesazh të fuqishëm.

Me respekt

**Irfan Stermollli 9E**



I dashur Ohri,

Ndoshta një ditë mbas 21 vitesh, duke pastruar një pjesë të sirtareve, nga njëri prej tyre do të bjerë kjo letër e rrudhosur, e grisur, që nuk do kesh asnjë ide se nga ka ardhur e se ç'është. Mbas 21 vitesh, kur t'i lexosh këto rreshta, do të të duken budallallëqe fëmijërie, por prapëseprapë, merre mundimin e lexoje deri në fund, e dije se janë fjalët e nxjerra prej shpirtit tënd... fëminor... ose ndoshta adoleshent. Shpresoj që, kur të jesh duke lexuar këtë letër, të jesh bërë një burrë i përgjegjshëm e i drejtë, i zoti i vetes në radhë të parë. Mbas 21 vitesh, do të të duket absurde gjendja e tmerrshme emocionale që ke kaluar në një moshë kaq të papjekur, e me siguri, pa më të voglin dyshim do t'i kesh harruar të gjitha gjërat e kota, të cilat të shqetësonin më parë, shumë vite më parë. Ama, dua të



shoh një njeri të suksesshëm, i cili e ka arritur suksesin me vendosmëri, lodhje e punë, shumë shumë punë. Dua të shoh te ti një njeri, që kurrë nuk i është dashur t'i rrijë mbrapa të tjerëve që të përfitoje e që tani shijon ato që i ka fituar vetë.

Gjatë leximit, e di që pavarësisht moshës, disa pika loti do të pikojnë mbi fletë, siç ndodhi 21 vjet më parë gjatë shkrimit të saj, por nuk ka problem, pasi diçka është e sigurtë: Në shpirt s'do të plakesh kurrë. Nuk ka nevojë të pres për ta ditur që akoma do jesh ai Ohri i dhembshur, ai Ohri që do të bënte maksimumin për të ndihmuar dikë që është në hall, edhe pse do të lëndojë qëndrimi i keq i tyre ndaj teje, por që sigurisht, tani nuk do t'i japësh aq rëndësi sa dikur.

Mos harro kurrë! Mos harro që çdo person që të ka vrarë në të shkuarën, të ka forcuar për të ardhmen! Mos harro pasionin që kishe i vogël për t'u bërë një person i madh në të ardhmen! Mos harro kurrë dëshirat e fundit të gjyshit, i cili të donte me gjithë shpirt. Dhe e fundit: Kujto që çdo fjalë e keqe, çdo ofendim, çdo përçmim, çdo nënvlerësim, çdo gjendje ankthi ose stresi, çdo gjendje ndoshta depresive që ke pasur e ke kaluar më përpara, tani janë bërë hi bashkë me erën! Kurse çdo herë që i jepje vetes forcë të vazhdoje përpara, kur shpresa kishte vdekur, çdo herë që ke marrë një këshillë të mirë, çdo herë që ke luftuar me veten për një qëllim më të mirë ... Këto janë! Këto janë momentet kur nuk je dorëzuar, nuk je gjunjësuar para të këqijave që jeta të ka sjellë e gjithmonë ke vazhduar përpara! Mos i ler të tjerët, të të ulin poshtë e të të ndryshojnë, por rri krenar për veten dhe mendo: "Ku janë tani ata të cilëve u dhashë shumë rëndësi dikur?"

Dil fitimtar mbi të gjitha e të gjithë! Kujtoje të shkuarën me mallëngjim e shih përpara, me krenari!

**Ohri Muca 9E**



E dashur Enejda,

Kur ta lexosh këtë letër, do të jetë vonë dhe nuk mendoj që do të kesh në mendjen tënde momentet që ti ke kaluar. Shpresoj të kesh përfunduar shkollën me sukses, pasi ti shqetësoheshe shumë për këtë. Shpresoj të kesh përmbushur dëshirat dhe ëndrrat e tua e të jesh e zonja e vetes e dikushi në jetë. Besoj që tani ke krijuar një familje dhe je e lumtur pranë tyre, por dhe ata pranë teje. Tani për ty jeta ka një kuptim tjetër dhe normale që do vendosësh familjen para vetes. Kujtohu për kohërat kur bëheshe xheloze për vëllain ose, kur mendoje që prindërit duan më shumë atë. Tani ti je prind vetë dhe e kupton shumë më mirë këtë. Mendo për dëshirat e tua të çmendura që kishe për të jetuar në Filipine ose budallallëqet që thojë dhe bëje në shkollë dhe llastimet e pafundme. Këto kohë kanë mbaruar tashmë dhe tani ndihesh e rritur, me përgjegjësi të tjera dhe më të mëdha.

Shpresoj të jesh e lumtur me jetën tënde!

**Enejda Islami 9E**



I dashur Olsi,

Shpresoj të gjesh paqe në këtë letër dhe akoma të kesh dikë special në jetën tënd, qoftë qen, shok, ose një njeri i dashur. Të tregohem i sinqertë, tani shumica e kohës së jetës sime është e çrregullt. Çfarë mund të presësh nga një 15 vjeçar? Rreth 70 përqind të kohës jeta ime është në kaos dhe shpesh herë harroj detyrat ose përgjegjësitë e mia. Shpresoj që ti të mos bësh të njëjtin gabim. Shpresoj që të kesh mësuar që ndonjëherë personi i gabuar duhet sjellë te ai i duhuri. Shpresoj që akoma ta vlerësosh shoqërinë e vërtetë dhe historitë që mund të nxjerrësh me to. Shpresoj që të kesh filluar së planifikuari familjen tënd të re ose ta kesh filluar atë, dhe të zgjedhësh që mos të harrosh familjen tënde të parë që të bëri këtë person që je tani.

Shpresoj që sa herë që gjërat nuk janë duke shkuar mirë të kesh dikë që të ndihmon në momente që jeta nuk është duke ecur ashtu siç do ti. Më e rëndësishmja është që të mos harrosh personin që ishte para 20 vitesh. Shpresoj dhe puno gjithmonë për më të mirën!

Me dashuri Olsi.

**Olsi Shehaj 9E**



I dashur Ramazan,

Si je? A i ke plotësuar dëshirat e tua që kishe kur ishe një fëmijë? A je bërë një mjek i famshëm, a ke hapur spitalin tënd? Në qoftë se nuk i ke arritur akoma nuk do të thotë se duhet të dorëzohesh. Vazhdo të jetosh me po të njëjtin ëndërr e dëshirë që ke pasur kur ke qenë një fëmijë! Kur ishe i vogël mendoje; kur do të rritem? Tani besoj se e ke kuptuar që fëmijëria është pjesa më e bukur e jetës. Vitet e shkollës, e gjimnazit, ku me shokë ke kaluar momentet më të bukura. Po atë ëndërrën për të jetuar jashtë shtetit në një shtëpi të madhe? Besoj se ke zgjedhur Norvegjinë, pasi ai ishte shteti që të ka lënë më shumë mbresa nga të gjithë. Besoj se jeta atje është më e mirë se në Shqipëri, por kurrë mos e lër' atdheun tënd! Kurrë mos u bërtit fëmijëve të tu! Mendo se çfarë ke bërë kur ke qenë ti një fëmijë dhe pastaj do të vepros në mënyrën e duhur. Edukoji dhe shkolloji sa më mirë të mundesh, siç u shkollove ti nga prindërit e tu! Shoqërinë që ke patur në fëmijëri mos e humb kurrë, sepse ata janë të vetmit persona që kanë qenë që në fillim me ty, që nga shkolla fillore e deri ku je ti tani me një familje të madhe e të dashur.

Mbi të gjitha mos harro kurrë se fëmijëria është dhe do të jetë gjithmonë periudha më e bukur në jetë!

Të përqafoj.

**Ramazan Tafa 9E**



I dashur Regli,

Unë, Regli 15-vjeçar, kam shumë ëndrra dhe pasione, të cilat shpresoj dhe uroj të më plotësohen. Mendoj artin si shpëtimin tim shpirtëror, ku mund të jem vetvetja dhe dikush tjetër në formën më të mirë të mundshme. Por është e vështirë duke marrë shkas sistemin, të mbijetoj vetëm me anë të artit që do bëj. Në planin e perspektivës jam i mbrojtur dhe me fat, pasi mendoj të vazhdoj biznesin e familjes. Duke marrë shembull babanë do jem një njeri i suksesshëm. Përkrah kësaj detyre do jem një familjar i devotshëm. Për familjen ku jam rritur dhe familjen e re që do krijoj. Moshë 35 vjeçare është moshë e plotësimit të ambicieve dhe një fillim i ri i një jete me shumë ngarkesa psikologjike. Njeriu gjatë të 30-ve kupton dhe njeh shumë gjëra, të cilat do e zhgënjëjnë dhe do e bëjnë pesimist për jetën. S'mund të mbetesh Peter Pan gjithmonë. Vjen një moment që t'i rritesh dhe duhet të marrësh përgjegjësi të mëdha, që kanë të bëjnë me jetën tënde dhe ndikimin e tyre në të.

Unë dua të jem i lumtur dhe i rrethuar me njerëz pozitiv që do më bëjnë të ndihem mirë dhe i rëndësishëm.

Mirutakofshim Regli!

**Regli Prençi 9E**



I dashur Rejgis,

Në këtë moment që po të shkruaj, jam në moshën 15-vjeçare, në kulmin e moshës rinore. Në kokë kam shumë mendime dhe shumë dëshira. Deri më tani kam jetuar me mendimin që jeta është veç një herë dhe duhet jetuar në maksimum. Tani, në këtë moshë, kam shumë dëshira që dua të të tregoj. Unë në jetë dua të arrij sa më shumë dhe dua që kur ti ta lexosh këtë letër, unë t'i kem arritur ato. Një dëshirë e imja është që në atë moshë, 35 vjeçare, të jem një njeri i formuar në karakter dhe me mendje të hapur në çdo aspekt. Një tjetër dëshirë e imja është që në atë moshë, të kem mbaruar një nga universitetet më të mira dhe të jetoj në një nga vendet më të zhvilluara dhe të bukura të botës. Një tjetër dëshirë është që deri në atë moshë, unë të çaj përpara në jetë, duke mos e vrarë mendjen për asgjë. Prandaj, në këtë moment që po të shkruaj, dua të të them që unë deri sa t'i përmbush dëshirat dhe qëllimet e mia në jetë, nuk kam për t'u dorëzuar kurrë.

Të përqafoj.

**Rejgis Muça 9E**







I dashur Rubin,

Ç'kemi? Shpresoj të jesh sa më mirë dhe të kesh një jetë të këndshme. Unë, jam ti, i 20 viteve më parë. Doja të të kujtoja disa gjëra që mund t'i kesh harruar. Tani, jam shumë ambicioz. Shpresoj mos ta kesh humbur gjithë atë zell dhe ego për të qenë më i miri. Është e vërtetë, dua që të jem shumë i suksesshëm, por kurrë, kurrë mos harro për njerëzit që të rrethojnë! Nëse je i fokusuar vetëm në punë, hiq dorë tani. Telefono njerëzit, me të cilët unë, 15 vjeç jam i afërt tani. Kushërinjtë dhe shokët, shpresoj t'ua kesh mbajtur numrat. Të kujtohet kur ishe sa unë? Cilat ishin pasionet e tua? Gjëja e parë në mendjen tënde janë lojrat kompjuterike, por s'po flas për këtë dhe shpresoj të mos jesh kaq i përkushtuar ndaj tyre, sa jam unë tani. Gjithsesi, doja të të flisja për punën që unë dua. Kimia dhe kompjuteri, janë pasion i madh i imi në këto momente. Shpresoj të jesh personi që ka të paktën pak lidhje me këto dy subjekte. Kaq kisha për të thënë për punën, pasi i besoj vetes sime 35 vjeçare dhe mendoj që do bëj zgjedhjen e duhur. Mos harro, dua të mësoj kinezçe dhe frengjisht! Mos harro ruishten! Pres që të paktën të di 6 gjuhë rrjedhshëm. Megjithëse tani di vetëm dy. Është punë në progres për katër të tjerat! Duhet patjetër ta vizitosh Francën. Shijojë jetën në çdo aspekt! Shpresoj të kesh gjetur një vajzë si ajo që ke pasur në mendje, një vajzë inteligjente e të bukur. Kujdesu për veten dhe, siç dua në këto momente të jesh. Shko në palestër! Përveç njerëzve në familje dua të kesh një qen. Një "German Shpeherd" ose "Husky". Këto janë më të lezetshmit dhe më të bukurit. Udhëto nëpër botë! Mëso kulturat e vendeve ku shkon. Siç ta thashë edhe më parë: Shijojë jetën dhe mos harro ata, me të cilët kalove fëmijërinë. Kjo është ideja ime e lumturisë.

Të përqafoj Rubini.

**Rubin Aga 9E**



Ç'do t'i thojë vetes në moshën 35-vjeçare?

E dashur Bianka,

Jam ulur buzë detit. Kam mbyllur sytë dhe ëndërroj. Ëndërrimi është i bukur siç është dhe vetë jeta. Eci rrugëve të jetës, me tallaze, vështirësi, gëzime dhe hidhërimë. Sa shpejt ikën vitet? Si fletët e një romani. Dhe ja, ku gjendem sot e rritur, e realizuar si një mjeke e zonja dhe me një familje të konsoliduar.

Kthej kokën pas në vite. Sa mund dhe sa djersë për të arritur deri këtu. Sa lot, netë pa gjumë, por edhe ditë të bukura rinore të kaluara këndshëm nën shoqërinë e miqve të mi. Ditë me diell me shi, por dhe ditë me tallazë e furtunë.

Ç'do t'i thojë sot vetes në moshën 35-vjeçare? Eh! Në fakt pyetjet dhe dilemat do të ishin të ndyshme. A zgjodha profesionin e duhur? A ishte vendim i drejtë që e ndërtova të ardhmen në Shqipëri e jo në Europë? A i bëra të lumtur prindërit e mi?



Një sirenë anije më shkund nga kjo përgjumje. Oh sa bukur isha tretur në fantazi! Por papritur kuptova e nënqesha. Nuk ka rëndesi, nëse bëhem mjeke, mësuese, apo diçka tjetër. Nuk ka rëndësi ku e ndërtoj të ardhmen. E rëndësishme është të bëj krenarë prindërit e mi. E rëndësishme është të bëhem njeri i mirë. E rëndësishme është të bëhem dikush në jetë, që ta bëj me pasion dhe dëshirë punën që më kërkohet. Dhe për këtë duhet shumë, shumë punë dhe forcë. Një valë lozonjare deti më ledhaton këmbët. Unë mendoj "Eh! Duhet të kthehem te librat, se e ardhmja më pret..."

Përqaftime, Bianka

**Bianka Shaba 9E**



Përschendetje Silvia 35-vjeçare,

Unë që po të shkruaj jam Silvia 14-vjeçare. E di që mbase, kur të jesh 35 vjeçe nuk do ta kujtosh fare këtë letër, madje as nuk do të guxosh ta lexosh. Por ja ku po e filloj.

E shikoj botën me ngjyra, me ngjyra nga ato më të ndezurat dhe më të bukurat deri te ato më gri e më të errta. Kam shpresë. Ndonjëherë e humb, por ajo rikthehet prap te unë. E di se po ta humbësh, ajo nuk do të rikthehet prap te ty, sepse ti dhe gjithë të tjerët si ti nuk besojnë në mrekulli, nuk besojnë në dëshira ekstreme, të cilat mund të bëhen realitet. Ata nuk besojnë te e pamundura. Shumë si puna ime dëshirojnë të rriten, duke menduar se do të kenë më pak probleme, por është e kundërta. Shumë të rritur harrojnë që edhe ata kanë qenë dikur fëmijë, që kanë pasur ëndrra dhe dëshira, që tani u duken më se absurde. Por unë besoj, unë besoj se brenda çdo të rrituri ekziston një fëmijë, një fëmijë që mezi pret të dalë dhe t'i bëjë të rriturit të ndjejnë përsëri ndjenjën e të qenit fëmijë. Unë dua që ky fëmijë t'u kthejë të rriturve çiltërsinë dhe gëzimin femënor.

Ajo që unë kërkoh nga ty është që ti të mos më harrosh kurrë. Të mos harrosh se unë jam me ty kudo që ti je.

Mirupafshim Silvia!

**Silvia Gogu 9E**





E dashur Aleksandra,

Koha ka kaluar. Tashmë je një femër me përgjegjësi, me detyrime ndaj personave që të rrethojnë. Ëndrrat e fëmijërisë kanë mbaruar. Tashmë je një 35 vjeçare. Ke kaluar momente hidhëruese, mbresëlënëse, emocionuese dhe të gjitha këto e kanë bërë jetën tënde të veçantë. Ke krijuar një familje dhe mbase ke dhe fëmijë dhe kjo do të thotë se jeta jote e përditshme do jetë shumë e zënë.

Mbase pamja e jashtme nuk është e njëjtë si ajo para 20 viteve, por karakteri është i njëjtë. Ëndërron akoma sikurse fëmijë?! Ekzistojnë akoma ato ëndrra të fëmijërisë së dikurshme?! E shikon botën me ngjyra si atëherë apo atë shikim e kanë mbuluar retë e zeza të përgjegjësive që ke para dëshirave?! Mbizotëron akoma ajo mirësjellje e dikurshme, ku ti ishe një vajzë e edukuar me këndvështrimet e tua të çdo situatë?! Je ti njësoj si para 20 viteve?

Shumë pyetje, shumë probleme, shumë përgjegjësi janë shtuar në këtë 20 vjeçar. Dëshirat që ke pasur dikur në fëmijëri shpresoj të të jenë plotësuar, sepse ato dikur ishin pëllumba, pëllumba që fluturonin të lirë në shpirtin tënd. Po, po pëllumba, sepse ato janë të pafajshme, me një bukuri magjepsëse dhe quhen "qenie të pafajshme", por me një guxim që u buron nga thellësia e shpirtit, ashtu si ti.

Dikur ke qenë e guximshme, guxoje të ktheje të pamundurën në të mundur. Ekziston akoma ai guxim?! Guximi që t'ua përplasje të tjerëve në fytyrë atë që të shqetësonte.

Dikur i premtroje vetes se do sundoje botën, por jo me lek, por me zemër dhe dashuri. Do t'i bëje njerëzit të kishin respekt për ty dhe jo frikë. Ia ke mbajtur këto premtime vetes? Ndoshta këto ishin ëndrrat e një 15 vjeçareje dhe tani je bërë si gjithë të tjerët, ku e vetmja gjë që u intereson është fjala "lek".

Çdo ditë mendoj se si do të jem 35 vjeçe. Çfarë njeriu do jem? Do kem këto mendime që kam tani?

E di që unë ndodhem brenda teje. S'e di kush do jem në këtë moshë. Shpresoj që ëndrrat, dëshirat dhe zemrën e bardhë. Jeta mos të m'i rrëmbejë në mënyrën më harbute. Një ditë do shihemi dhe shpresoj t'i kem plotësuar vendet bosh të jetës sime, që më vonë të mos pendohem. Një ditë do futem në pozitën tënde, por deri atëherë do provoj dhe do shijoj jetën, sikur të jetë dita e fundit në këtë botë.

Me dashuri

**Aleksandra Harxhi 9E**





Letër vetes pas 20 vitesh

Ah, Rei!... Rei! Shpresoj të kesh realizuar të gjithë ëndrrat e tua fëminore. Shpresoj shumë në të ardhmen time si Rei i rritur. Për momentin nuk kam ndonjë plan të madh. Shpresoj të mbaroj klasën e nëntë me nota të kënaqeshme që të ndihet krenare mami për djalin e saj. Me thënë të vërtetën mezi po pres gjimnazin, do jetë gallatë, shokë të rinj, mësues të rinj, ambient i ri. Nuk e imagjinoj dot veten me patentën e shoferit. Sa shumë gjëra do ndryshojnë. Shpresoj të shkoj në një universitet të mirë dhe të mbaroj shkollën me nota të shkëlqyeshme. E dëgjoj mamin shpesh që më thotë të shkollohem në Amerikë, tek gjyshi dhe gjyshja. Do doja të bëhesha një arkitekt i kompletuar. Mbas 20 vitesh e shoh veten të stabilizuar, që do të thotë, një arkitekt i suksesshëm me studion time private, me një familje të shkëlqyer dhe kryesorja të jesh i pavarur ekonomikisht. Do jetë pak e vështirë të përballem me veten pas kaq shume vitesh. Shpresoj që jeta të mos më përplasë aq fort, sa mos të ngrihem më. Rei i madh, kur ta lexosh këtë letër mbas 20 vitesh, shpresoj të të kem prekur sado pak dhe ti të kesh arritur aty ku duhet të jesh.

Të uth Rei i vogël.

**Rey Calvin Bushi 9E**



E dashur Stela

Shumë vite kanë kaluar. U bë kohë e gjatë pa u parë. Koha fluturoi kaq shpejt. Jam shumë kurioze të di për jetën që po bën tani. Shpresoj të të jenë realizuar të gjitha dëshirat dhe ëndrrat e fëmijërisë. Gjithashtu shpresoj të jesh e kënaqur me profesionin tënd. Mbi të gjitha shpresoj të jesh e lumtur. Shpresoj të kesh krijuar një rreth shoqëror të ri. Mos harro t'i falenderosh ata për mbështetjen që të kanë dhënë vitet që keni kaluar bashkë. Falenderoji që kanë qenë me ty, në ditë të mira dhe të këqija. Falenderoji që të kanë treguar gjithmonë të vërtetën. Mbi të gjitha falenderoji që kanë qenë vetvetja kur kanë qëndruar me ty.

Edhe pse tani je e rritur dhe kupton shumë gjëra, dua të të them një gjë shumë të rëndësishme që të mos e harrosh kurrë. Duaji ata që të kanë rritur me shumë sakrificë, ata që t'i plotësuan të gjitha dëshirat që t'i kishe, ata që të sollën në jetë, ata që bënë të pamundurën që ti të edukoheshe dhe të shkolloheshe në mënyrën më të mirë të mundshme dhe të bëheshe dikush në jetë. Duaje familjen tënde, sepse nuk të do askush më shumë se ata! Kujdesu për ta, siç janë kujdesur ata për ty që kur linde.

Përveç familjes, që është më kryesorja, mos harro asnjëherë të kujdesesh për veten. Duaje veten, ashtu siç je. Unë kam besim tek ty dhe mendoj se mund të arrish çdo gjë, por duke mos u dorëzuar asnjëherë. Je shumë e rëndësishme për mua dhe jam shumë krenare për ty dhe për të gjitha arritjet e tua. E di që mund të të duken të çuditshme këto gjëra që po të përmend, por besomë, pa këto nuk arrin asgjë në jetë.

Me shumë dashuri.

**Stela Lika 9E**



E dashur Ibadete,

Jeta ndërthuret me momente të bukura dhe të shëmtuara. Por ëndrrat vazhdojnë....

Lëndët që më pëlqejnë më shumë janë kimia dhe biologjia. Këto janë baza e mjeksisë. Pra, unë mund të bëhem një doktoreshë. Më pëlqen shumë pediatria. Dua të shëroj dhe të kujdesem për fëmijët.

Dua të jetoj në apartamentin tim, dhe të kem profesion tim.

Dua që me shoqen time, të shëtis në Venecia, në qytetin e ujit.

Dëshiroj që çdo fëmijë të jetë i lumtur në këtë botë, por ka shumë fëmijë, të cilët nuk mund të jenë të lumtur.

Dua të ndihmoj të gjithë fëmijët që kanë nevojë. Dua t'u fal atyre të gjithë dashurinë time, t'i përkrah pavarësisht mangësive.

Dua t'ua shpërblej dhe prindërve të mi, mundimet që kanë bërë ato për mua. Do të përpiqem t'i bëj të lumtur ata, ashtu siç më bëjnë dhe mua.

Dua që të gjitha ngjyrat e fëmijërisë, ëndrrat, dëshirat të më ndjekin kudo.

Shpresoj që gjithmonë të kem përkrahje, dashuri dhe sukses në jetë!

Me dashuri, Ibadetja.

**Ibadete Daku 9E**



Përshëndetje Alessio,

Këtë letër do ta lexosh kur të mbushësh 35 vjeç.

Gjatë kësaj kohe do të ndodhin shumë ngjarje. Do të rritemi e do të kalojmë çaste e momente tepër argëtuese dhe të paharrueshme që do të kemi në bankat e shkollës. Shoqëritë dhe miqësitë që do lidhim vit pas viti, të cilat do të na shoqërojnë gjithë jetën. Janë pikërisht këto vite, që për çdo fëmijë mbeten momente tepër të bukura të skalitura në memorjen tonë si: shakatë, humorin, çapkënlleqet tona të moshës, por sigurisht ku nuk mungojnë as kritikën e mësuesve për të na edukuar e arsimuar në të vetmen mënyrë që ata dinë më mirë, me dashurinë dhe durimin e tyre. Ditët e fundit, kur ne të dalim nga dyert e universiteteve, mirënjohja dhe vlerësimi për këta mësues do të jetë tepër i madh. Ndërkohë, që ne i falenderojmë këta mësues, në sytë e tyre shihet kënaqësia të cilën ata arritën të nxjerrin edhe një brez tjetër të përgatitur për jetën e vështirë që i pret. Një ngjarje tepër e dhimbshme do të na ndodhë gjatë kësaj kohe. Gjyshërit dhe gjyshet tona do të largohen nga kjo botë. Ditë shumë të vështira për ne. Ditë, ku sigurisht humbja nuk është vetëm largimi i tyre nga kjo botë, por edhe ne, bashkë me largimin e tyre, humbasim një pjesë nga vetja jonë. Një zbrazëti, e cila do të mbushet vetëm me kujtimet e tyre. Zemërgjerësinë e tyre nuk do ta harrojmë asnjëherë. Ata do të mbeten këshilluesit më të mirë për ne. Pavarësisht situatave ata kanë qenë gjithmonë aty. Fjalët më të ëmbla, më të mira, më të dashura do të dilnin



vetëm nga buzët e tyre. Edhe kur ne gabonim, ata ishin gjithmonë aty. Për ata isha nipi i parë, gëzimi i parë, gëzimi i tyre i shumëpritur, pra, siç thoshin ata "mjalti i mjaltit".

E megjithatë çdo ngjarje, çdo gëzim, çdo trishtim, çdo arritje, çdo moment e sekondë, ne nuk do të ishim pa ata. Të vetmit, të veçantët, të paarritshmit, tifozët tanë më të mëdhenj, prindërit tanë. Ata nuk janë vetëm prindër, ata janë heronj. Na kanë shoqëruar në çdo hap tonin, që në momentin që kemi ardhur në jetë. Ata kanë qenë aty gati për ne duke sakrifikuar edhe veten e tyre. Na kanë ndihmuar që në hapat e para e deri tani. Shpeshherë ne i kemi mërzhitur, shqetësuar qoftë edhe pa dashje, por ata nuk janë dorëzuar asnjëherë. E pavarësisht viteve që kalojnë, ne pranë tyre do të mbetemi të vegjël. Prandaj, kur të lexosh këtë letër, asnjëherë nuk duhet të harrosh dashurinë që ata kanë pasur e na kanë falur.

Tashmë je 35 vjeç, i arsimuar, me profesion mjek, në kërkim për të krijuar familjen tënde. Asnjëherë nuk duhet të harrosh rrugën e gjatë e të vështirë që ke kaluar.

Me dashuri, Alessio.

**Alessio Goga 9F**



Përsëndetje Arjan,

Si je? Ku jeton? A ke një shtëpi tënden? A del me shokët apo qëndron tërë ditën i mbyllur në shtëpi duke luajtur kompjuter? A ke krijuar një familje dhe nëse jo, mendoje, pasi është tërë ajo jetë që do të të duhet ta kalosh i vetëm. Në fakt këto janë thjesht disa nga pyetjet që kam pasi do të duhen më shumë se kjo faqe për t'i shkruar. E di, gjithmonë kam dashur të bëhesha arkitekt dhe nuk e di nëse ia kam dalë për të ardhmen, por unë e di që ti je bërë ai që ti mendon se është më e mira për ty, pasi ti gjithmonë ke bërë zgjedhjen e duhur.

Të kalojmë pak tek familja. Si janë mami dhe babi? Po motra me vëllanë si janë dhe a kanë arritur diçka në jetë? Motra a është e dashur dhe e afrueshme, pasi në këtë kohë që po të shkruaj unë, ajo mendon vetëm për vete. Kanë kaluar 20 vjet, që janë plot 2 dekada, pra shumë. Me kohë gjithashtu besoj që ka ndryshuar edhe mentaliteti dhe opinioni i njerëzve në krahasim me njerëzit e kësaj periudhe. Por nuk ka rëndësi koha dhe vendi, pasi ti gjithmonë do të kesh mendimet më të mira të kohës. Kjo, sa për motivim. Gjithësesi unë po e mbyll këtë letër duke të kërkuar të kujdesesh për veten dhe familjen, por gjithmonë lufto për më të mirën.

Shkruar me dashurinë më të madhe.

**Arjan Kurti 9F**



E dashur Alisa 35-vjeçare,

Si je? Shpresoj që të jesh mirë! Shpresoj që të gjitha dëshirat dhe objektivat e tua t'i kesh plotësuar. Po të shkruaj për të të kujtuar fëmijërinë tënde. Po të shkruaj për të të kujtuar ëndrrat e tua, kur ke qenë e vogël dhe se sa shumë besojë tek vetja. Të kujtohet se sa shpesh ëndërroje për të ardhmen? Sa e sa ëndrra kishe! Të kujtohet se sa të vështirë e kishe se çfarë profesioni do bëje kur të rriteshe, duke menduar se ke shumë aftësi, të cilat duhet t'i përdorësh për të krijuar një jetë më të mirë! Epo ja ku je sot! A ke përmbushur ndonjë nga dëshirat që ke pasur? Mos harro se ti doje ta bëje botën një vend më të mirë! Doje që t'i ndihmoje njerëzit në nevojë! Kishe dëshirë të bëheshe e famshme, por jo për ndihmën që i ke dhënë botës dhe duke treguar anën humane, pasi ajo është diçka që duhet ta ketë gjithkush, por doje të bëheshe e njohur për arritjet e tua! Doje që bota të dinte se çfarë je në gjendje të bësh dhe të të dojë për atë që je! Mos harro se sa ke punuar për t'i përmbushur ëndrrat e tua!

Sa shumë doje të krijoje një jetë më të mirë për vete dhe familjen tënde! Sa doje që familja jote të krenohet me ty në sy të të gjithëve! Doje që të ishe e zonja e vetes dhe t'i ndihmosh njerëzit pranë teje! Kujtohu që gjithmonë pas një sfide të vështirë, vjen diçka për të të gëzuar, sepse ti ia dole! Kujtohu se jo gjithçka është aq e vështirë sa duket!

Unë dua që shkollën ta mbaroj në Gjermani me rezultate të shkëlqyera. Dua të vazhdoj për kimi. Dhe kur të rritem, të kem të ardhura të mira. Por fëmijët e mi do të rriten duke njohur vlerën e gjërave dhe jo çmimin e tyre! Dua që të kem një familje të bashkuar dhe të gëzuar. Dua që të jem një njeri punëtor dhe jo të ankojem. Por së fundmi dua që të jem e lumtur!

Shpresoj që kjo letër të të ketë ndihmuar! Jo gjithmonë do fitosh në jetë, por gjithmonë duhet që të ndihesh fitimtare! Gjithmonë sillu vetvetja, pavarësisht se ç'thonë të tjerët!

Me dashuri Alisa Shehaj.

**Alisa Shehaj 9F**



E dashur Anja,

Sot që po e shkruaj këtë letër jam katërmbëdhjetë vjeç, ndërsa ti, shumë më e rritur se unë. Ke kaluar ngjarje, të cilat unë thjesht i kam imagjinuar, ose krejt të kundërtën e tyre.

Ndoshta ke ndjekur lëndën e arkitekturës ose i je kthyer ëndrrës sonë të fëmijërisë, të bëheshim stiliste me famë botërore. Ose ndoshta mendimet që kam pasur këto kohë, për të punuar në mbrojtje të të drejtave të njeriut, ose për të punuar fort drejt arritjes së barazisë gjinore, u bënë më shumë se thjesht mendime. Ndoshta kam vazhduar për një degë, të cilën unë nuk do ta mendoja kurrë si timen, ose librat që kam shkruar, janë publikuar dhe tani po



i kaloj ditët si një e rritur duke shkruar përsëri. Gjatë viteve që kanë kaluar, shpresoj që ti të jesh bërë një njeri më i mirë se unë. Shpresoj që të kesh gjetur veten, pasi tani nuk jam shumë e sigurt se kush jam në të vërtetë. Ndoshta, përveç ëndrrave të tanishme, ti mund të kesh ndjekur ëndrrat që kemi pasur kohë më parë, të cilat tani i mendoj si të perealizueshme.

Por gjëja që dëshiroj më shumë, është që të mos jesh bërë si gjithë të tjerët. Dua që ti të vazhdosh duke bërë çdo gjë që të jep kënaqësi, të mos e kalosh pjesën tjetër të jetës mbrapa një kompjuteri, duke bërë diçka që e urren. Mos e lejo rutinën të të kthejë në diçka që s'je! Gjithë të mirat. Anja!

P.s: Vazhdo të ruash lidhjet e tua me familjen, sepse do të pendohesh më vonë!

**Anja Marika 9F**



E dashur Darli,

Shpresoj që të gjitha dëshirat e tua të jenë plotësuar. Shpresoj që t'i kesh arritur synimet e tua në jetë duke mos ndalur së dëshiruari lumturinë në një botë më të mirë! Ndoshta tashmë në jetën tënde kanë ndryshuar shumë gjëra në krahasim me të kaluarën, ndoshta në mënyrën se si ti e shikojë jetën, kur ishe një fëmijë, apo në personin që ti ishe dikur dhe në synimet që donte të arrinte ajo, edhe pse dëshiroj që ti të kesh vazhduar ta shikosh botën nga syri i një fëmije, pasi është më e çiltër dhe paqësore, shpresoj të mos i kesh vënë vetes asnjë kufi duke e parë botën me të gjitha ngjyrat e saj!

Ndoshta në moshën 35 vjeçare ti mund të kesh krijuar familjen tënde, mund të kesh provuar ndjenjën e mrekullueshme të të qenit mama, apo mund të kesh kapërcyer vështirësi të ndryshme në jetë, gjithsesi pyetja ime e vetme është: "A vazhdon të besosh në të pamundurën apo bota të ka përthithur aq fort dhe tashmë ke harruar fuqinë e imagjinatës së një fëmije?" Mund vallë të ketë ndodhur të jesh zhytur aq thellë në hallet e jetës së një të rrituri dhe ke harruar të ëndërrosh për të ardhmen?! Shpresoj se kjo nuk ka ndodhur dhe s'do të ndodhë ndonjëherë! Këtë letër nisa t'ia shkruaj Darlit 35 vjeçare duke synuar veç një gjë, të të kujtoj se sa e bukur dhe shumëngjyrëshe është jeta, kur ti nuk rresht së ëndërruari dhe nuk dorëzohesh ndaj dallgëve të jetës! Mos harro çfarë i ke premtuar vetes në fëmijëri! Ki besim në vetvete dhe do t'ia dalësh gjithmonë mbanë!

Pranë meje përjetësisht, Darli.

**Darli Kosta 9F**





I dashur Dejv,

Sot mbushe 35 vjeç ..... Të gjithë ishin aty me ty, për të festuar këtë përvjetor; familjarë, miq dhe shokë. Për një moment m'u desh të fryja qirinjtë dhe para syve të mi më kaloi një fragment i jetës si në ekran kinemaje. Jeta ime ka qenë sa e bukur, aq edhe e paparashikueshme, plot aventura dhe sfida. Nuk kam pritur asgjë nga askush, por kam jetuar bukur, kam dashur pa kushte dhe kam falur shumë. Rrugëtimi im ka qenë i vështirë si i çdo njeriu, i cili kërkon të arrijë gjithçka në jetë. A ia kam dalë?

Kam pasur momente, për të cilat jam penduar, por mund të them me siguri që jam aty, ku duhet të jem. Kam qeshur, luajtur, mësuar, por kurrë nuk e kam gënjyer veten dhe as kam bërë kompromis me veten time. Kam ecur këmbëzbathur dhe e kam shijuar momentin, kam fituar dhe humbur, por sërish i buzëqesh jetës me optimizëm. Si një 35-vjeçar, sot menaxhoj lokalet më me emër të kryeqytetit dhe sigurisht që jam edhe pronar i ligjshëm i tyre. Më pëlqen shoqëria që kam, sepse janë ata njerëz, tek të cilët unë mund të mbështetem fort. Çdo ditë falenderoj Zotin për gjithçka kam .....; babin tim, i cili më ka dhënë një shembull të përkryer për t'u ndjekur, nënën time, e cila ka sakrifikuar pa fund dhe ç'është më e rëndësishmja familjen time, pa të cilën nuk do të isha ky që jam sot.

E pra, e dashurove jetën dhe jeto çdo moment të saj në vitet që do të vijnë!

Mirutakofshim Dejv!

**Dejv Shulku 9F**



Përshëndetje Denis,

Si je? Si ia ke kaluar? Unë po pyesja veten nëse i ke arritur dëshirat e tua, nëse po bën jetën që ke dëshiruar? Atëherë unë kam vepruar si duhet dhe, nëse jo, unë duhet të mësoja e të jetoja jetën. Unë rrezikova duke mos mësuar, por e kuptoj që çdo këshillë e ka të mirën dhe çdo e keqe e ka prapë një të mirë. Guximi im, që më çonte deri aty ku nuk duhej dhe unë sakrifikoja shumë, më dilte gjithmonë siç unë thoja. Mendoja se jeta do ishte e thjeshtë, por me kalimin e kohës e kuptova që edhe jeta kishte pengesat e saj. Mua më pëlqente që gjithë kohën ta kaloja kot e të luaja kompjuter, por prej tij nuk mësova ndonjë gjë. Unë do të doja që ti të mos i kishe harruar dëshirat që ke pasur. Po mendoja që ti, të mos i përdorje gjërat e këqija si: alkoolin dhe cigaren. Nëse e lexon këtë letër do të doja që të ma plotësoje edhe këtë dëshirë të fundit.

Me dashuri Denisi.

**Denis Sheshori 9F**



Përschendetje Elvi,

Si po ia kalon? Shpresoj t'ia kalosh mirë dhe të jesh sa më mirë me shëndet, ti dhe familja jote. Mendoj se mund të kesh krijuar një famlje të mirë në keëtë moshë që je.

Unë po të shkruaj tani në vitin 2016. Jam 14 vjeç. Tani mendoj se ti po thua "Pse po ma shkruan ky këtë letër?" Unë po e shkruaj këtë letër, që do të mbërrijë ty mbas 20 vjetësh dhe për të ditur cilat janë arritjet e tua në këtë moshë 35 vjeçare.

Me shume gjasa ti mund ta kesh mbaruar shkollën jashtë shtetit dhe pse jo, dhe të jetosh atje. Nëse po jeton atje, mendoj se ke gjetur një punë të mirë për shembull, menaxher i një kompanie të madhe. Me siguri do të kesh gjetur edhe shumë shokë dhe shoqe. Nëqoftëse ti nuk mund të jetoje jashtë shtetit, nuk është ndonjë problem i madh. Ti punën e ke të siguar domethënë do të vazhdosh ta ngrësh sa më lart kompanine e babit. Do të kesh shoqëri të madhe. Shpresoj mos ta lesh palestrën. Cigaren as mos ta mendosh. Nuk është se po të jap urdhra, por këto po i them për të mirën tënde. Jeta vetëm 1 herë jetohet dhe duhet ta shijosh deri në fund atë. Nëse diçka e keqe ndodh, ti asnjëherë mos u dorëzo ose të kthesh kokën mbrapa. Unë me kaq po e mbyll këtë letër dhe të uroj jetë të mbarë!

Me respekt Elvi i vogël.

**Elvi Çaushaj 9F**



Përschendetje Marvin,

Sot jam 15 vjeç. A ka ndryshuar bota? Tani që jam i ri kam lirinë time, por nuk e di nëse ti në këtë moshë ke më pak liri se, kur ishe i ri. Mos harro ta shikosh botën me ngjyra dhe jo bardhë e zi. Mos harro për ëndrrat që kishe kur ishe i ri. A i mban mend dhe, në qoftë se jo, po t'i kujtoj unë. Kur ke qenë i ri, doje që në të ardhmen të bëheshe futbollist dhe të luaje me ekipe me emër. Ke qenë ai djalë që doje të të respektonin dhe t'i respektoje të tjerët. Të kishe një familje të bashkuar, ku të mbizotëronte dashuria dhe mirësia. Të uroj gjithë të mirat dhe mos harro se një herë e një kohë ke qenë një fëmijë i lumtur. Mos më thuaj që i ke harruar këto ëndrra! P.S: Ndiqi ëndrrat e tua dhe kurrë mos u dorëzo! Të përqafoj Marvini.

**Marvin Kodra 9F**





E dashur Enva,

Me shumë mundësi po pyet veten se përse të erdhi në dorë kjo letër tani. Epo një ditë po mendoja për të shkuarën dhe se sa shumë ka ndikuar ajo te vendimet që kam marrë sot. Do doja që ti të mos ndikohesh nga vendimet e marra më parë dhe të ndiqje rrugën që ke dashur gjithmonë. Për këtë arsye po mendoja të të shkruaja. Do doja të të rikujtoja të gjitha dëshirat dhe ambiciet që ke pasur. Besoj se gjimnazin e bërë në Gjermani, ashtu siç vendosëm bashkë. Duhet të jesh njohur me shumë njerëz të rinj. Shpresoj të kesh mbajtur lidhje me gjithë njerëzit, që kanë patur ndikim dhe që kanë qenë të rëndësishëm për ty. Unë profesionin nuk e kam vendosur akoma, por besoj se ti ke zgjedhur të mbarosh studimet për një degë që ty t'u duk e denjë, dhe kam besim që je e suksesshme në atë që po bën. Mendoj se u tregova shumë formale deri tani. Ti e di shumë mirë që nuk jam e tillë. Isha kurioze të të pyesja për jetën personale. A je e martuar (me Leonardo Di Caprion)?? Hahaha...! Ke fëmijë? Fëmijët a na ngjajnë neve? Besoj se je një nënë e devotshme, e cila nuk ia heq sytë fëmijëve për asnjë çast. Do të të kerkoja të mos jesh shumë e rreptë me ta dhe të sillesh siç janë sjellë mami dhe babi me ne dhe motrën time.

Po mami dhe babi si janë? Si është Amanda (motra)? Besoj se mamit dhe babit i mungoni shumë që të dyja. Në sytë e tyre qoftë 15, qoftë 35 vjeç, do mbetemi gjithmonë të vogla. Kur të shohësh këtë letër, kam dëshirë që ti të ndjesh atë që po ndiej unë tani: Mall dhe dashuri. Mall dhe dashuri për familjen, për çdo çast që ke kaluar qoftë i mirë, qoftë i keq.

Përqafoji të gjithë, sidomos mamin, babin dhe Amandën.

Me dashuri, Enva.

**Enva Shima 9F**



Përshëndetje Era,

Nuk e di si je ose çfarë bën në këtë moshë, por realisht kam dëshirë që ta di. Si po vijon e ardhmja jote? A i ke plotësuar dëshirat e fëmijërisë, sepse e di që ke pasur me shumicë. A i mban mend ato netët e gjata, ku përfytyroje të ardhmen tënde plot me ngjyra dhe shpresë? Deri në fund të botës shkoje dhe më beso e di se botën plot me gjallëri do e mbushje. Më ke folur për disa nga ëndrrat e tua. Me sa më kujtohet ëndrra jote e parë ishte të bëheshe mësuese. A e mban mend? E adhuroje këtë profesion. Vitet kalojnë, ëndrrat ndryshojnë. Rreth klasës së pestë dëshiroje të bëheshe si mami, ekonomiste. Sa herë e mendoje të bëheshe ekonomiste! Ëndrrat e tua shpërthenin, kur mendoje gjithë ato numra, veshjet e bukura dhe gjithçka. Por si çdo fëmijë, në zemrën tënde nuk ekzistonte vetëm një ëndërr, aty kishe pafundësisht. Kur do ta lexosh, ndoshta do të qeshësh. Por më beso ti dhe vëllai yt i vogël, çdo natë mendonit se si të krijonit ilaçin e pavdekësisë. Vitet kalojnë sa hap e mbyll sytë. Arrite në moshën e pubertetit. U bërë adoleshente. Në këtë moshë ëndërroje të bëheshe daktreshë profesioniste. Të mbaroje Universitetin me nota maksimale, të



mbaroje dhe Doktoraturën. Më pas të filloje një punë, ku ti të ishe mjekja më e mirë. A të kujtohet? Dëshiroje të shkoje në Gjermani, të bëje një spital në mes të Berlinit, që do të ishte i njohur në te gjithë botën dhe njerëzit do të prisnin rradhë të gjata që të kuroheshin tek ti. Shpresoj që të kesh mbajtur premtimin që i bëre vetes. Ditën kur të diplomohesh do ia kushtosh dhe motrës tënde, për shkak se ajo nuk pati mundësi të shkonte në ceremoninë e diplomimit. Uroj t'i kesh arritur objektivat që i kishe vendosur vetes. Të uroj të gjitha të mirat e botës, me lumturi, paqe dhe shëndet pranë njerëzve që do dhe të duan. Ndoshta nuk jam personi i duhur për të të dhënë këshillë, por mendoj se dhe një njeri i rritur duhet ta dëgjojë idenë e një minoreneje. Ndoshta ajo këshillë mund të ketë më shumë vlerë se disa të tjera. Gjithsesi të këshilloj që kurrë mos të dorëzohesh para situatave të ndryshme dhe mos harro: sado që të rritesh, sado ngjarje të të ndodhin në jetë dhe sado ëndrra të thurësh mbaje mend, unë jam brenda teje, ajo fëmija e ëmbël, moskokëçarëse, naive, agresive, e dashur, zemërgur dhe gjithmonë kështu do të mbetem.

Me dashuri Era Kasmî.

**Era Kasmî 9F**



E dashur Merita,

Së pari uroj që ti dhe njerëzit e tu të dashur të jenë mirë. Kanë kaluar 21 vjet që nga letra jonë e fundit. Tani duhet të jesh 35 vjeç. Shumë gjëra duhet të kenë ndryshuar edhe ti duhet të kesh ndryshuar. Shpresoj që ëndrra jote, aktrimi, të jetë bërë realitet dhe, në qoftë se jo, do të thotë se nuk ia dole dot të bindje babin për audicionin e "Disney Channel". Në qoftë se nuk ia ke dalë mbanë për aktrimin, një gjë është e sigurt se ke plotësuar dëshirën e prindërve për të filluar universitetin për politika të jashtme. Dhe jam e sigurt se do të bësh të pamundurën për të shfaqur imazhin pozitiv të Shqipërisë në botë. Me shumë mundësi tani nuk je e vetme, duhet të kesh gjetur shokun e jetës dhe fjala shtëpi duhet të ketë një kuptim të veçantë për ty. Duhet të ketë marrë kuptimin e atij vendi që jo shumë njerëz arrijnë ta krijojnë, vendi ku e di që pas një dite të gjatë, do të gjeshe qetësi dhe dashuri të pakufishme. Duhet të jesh bërë mama. Dhe tani ke arritur të kuptosh fjalët e mamit: "Vetëm kur të bëhesh nënë do të më kuptosh". Ke kuptuar se ç'do të thotë të marrësh titullin "Nënë". Me këtë gjë të janë shtuar ndjenja të bukura, të panjohura më parë, por dhe më shumë përgjegjësi. Kurrë mos harro: "Jeta është një lojë e vështirë dhe të bie shpesh të humbasësh, por duhet të jesh një lojtare e zonja". Uroj që të mos kesh ndryshuar për një gjë, të mos kesh harruar të shohësh botën me ngjyra. Lutem që rritja të mos ketë arritur ta largojë këtë gjë nga ty. Të uroj gjithë të mirat dhe më të bukurat gjëra në jetë!

Mbështetja jote më e madhe,

**Merita Hima 9F**



E dashur Kea e madhe,

Si për fillim të kësaj letre shpresoj të jesh mirë dhe të jesh e lumtur. Sido që të jetë e di që do të ketë qenë e vështirë për të arritur aty ku ndodhesh ti tani dhe se ke dhënë maksimumin tënd. Sa do doja të ishe këtu me mua që të mund të flisnim me njëra tjetrën për çdo gjë. Mos harro të kesh ngjyra në jetën tënde dhe tregohu sa më e ëmbël! Në fakt dëshirat e mia, të cilat do të më pëlqente të plotësoheshin janë të panumërueshme edhe pse jam Kea e vogël 14-vjeçare. Të gjithë ëndërrojnë në çdo moshë, por duke u rritur, nuk kemi më kohë për të ëndërruar. Prandaj po të shkruaj që të të tregoj disa nga ëndërrat tona për të ardhmen, duke të të lënë ty të kuptosh se sa prej tyre janë realizuar...

Pak a shumë si çdo fëmijë i vogël edhe unë kam dashur të bëhem një balerinë. Pse jo? Në fakt, do të ishte diçka shumë e magjishme të jepje shfaqje në sallat më të mira të botës. Pas balerinës zënë radhën profesionet e çuditshme si: astronaute, modele, aktore dhe Barbi (nuk e mbaj mend pse doja të bëhesha një Barbi). Po që të dyja ne e dimë mirë që në radhë të parë është shkolla (siç thonë gjithmonë mami dhe babi). Më ka pëlqyer gjithnjë arkitektura, por kohët e fundit po më pëlqen mjekësia, pasi do mund të shpëtoja jetët e njerëzve duke i ndihmuar ata dhe familjet e tyre. Gjithsesi do e marr vesh më vonë përgjigjen. Keushe, mami dhe babi si janë? Po Gersushi? Mbase nuk jeni që të katërt bashkë, por thuaju shpesh që i do shumë se koha do kalojë dhe do fluturojë shpejt siç mendon ti. Mbase s'do jemi kurrë të afta që t'i falenderojmë ata të tre aq sa duhet, por bëj çmos për t'i ndihmuar. Gersushin do e kem idhull (mos e harro ASNJËHERË). Mamin e kam jetë, e dua më shumë se çdo njeri. Ndërsa babin e dua pafund. Tek e fundit goca e babit jam tani dhe do jem gjithmonë. Mos e harro që për 14 vitet e para të jetës tënde këta persona dhanë gjithçka për ty.

JI MIRENJOHËSE!

Shpresoj t'i kesh bërë njerëzit krenar për ty, sidomos nënën që të ka parë në çdo moment nga lart... Jam dhe unë krenare për ty Keushe. Ki besim në vetvete! Familja është gjithmonë me ty. Të puth fort, fort, fort, Keushi i vogël!

**Kea Legisi 9F**





E dashur Sindy,

Besoj se ke kaluar disa faza të jetës. Shpresoj me gjithë shpirt t'i kesh arritur ato që ke dashur... Kushedi se çfarë do të jesh duke bërë tani?! Unë po ia lë së ardhmes në pritje që ta marr vesh. Do isha jashtë mase krenare nëse i ke arritur të gjitha çfarë ke dashur, edhe pse në fakt më duket pak e paarritshme. Gjithsesi jam e sigurt që ke provuar. Ia kam premtuar vetes këtë gjë. Kur kam qenë më e vogël thoja një shprehje: "Mos rresht së provuari! Po dështove, të paktën e provove. Nuk ka gjë. Me shpresë mos t'i kesh lënë mundësitë të të ikin pa provuar. Kjo letër mund të ketë dy emra: Krenari ose pendesë. Jeta në kohën e shkuar të bën ta kthesh kokën mbrapa dhe veç të pendohesh për mundësitë e pashfrytëzuara. Por ama nuk ia vlen të kthesh kokën mbrapa e të qash për të shkuarën. Do të mendoj që nuk ia vlen më. Por mos harro që jetës asnjëherë nuk i dihet! Jeta vjen shpejt tek ty. Shumë gjëra pozitive të presin. Pse i vendos limite vetes? Veç një herë jeton... Jetoje jetën me mundësitë e një fëmije, por me pjekurinë që ke tani. Mos i harro ngjyrat e bukura që të ofron jeta Sind! Jam vetëm 14 vjeç tani. E di, por thjesht dua të të përcjell një mesazh: asnjëherë mos rresht së ëndërruari. Kurrë nuk është vonë për asgjë. Dua të iki jashtë shtetit, në një vend jo kaq të zymtë mundësisht. Jo gri... Këtu s'më mungon drita e diellit, nuk po them, por thjesht nuk dua të qëndroj më... Me këto plane besoj se më pret aventura e ardhshme. Hapa të mëdha sikur po më thërrasin, nuk e di. Nuk dua të jesh bërë si ata njerëzit që shkojnë 50 ose 60 vjeç dhe thonë: "Më iku jeta!", "Kaq e kisha". Përçmim kam ndaj këtyre njerëzve. Për mua aventurat nuk mbarojnë. Më duken të humbur ata njerëz të tillë. E them tani kështu që s'kam shumë eksperiencë nga jeta, por çdo gjë sa vjen e po bëhet më e vështirë... Gjithsesi pres shumë nga ty. Më shumë seç mund të më duket. E di që je person që kërkon shumë ndaj vetes, por këtë gjë do t'ia le kohës. Shpresoj të kesh gjetur paqe në shpirt dhe të jesh pajtuar me gabimet e së kaluarës. Jo rrallë përplasem me ndërgjegjen, e cila bie ndesh me veprimet e tua. Të mirëkuptoj për çdo zgjedhje që bën, e cila veç rastësore që nuk është. Kuptoj çdo nevojë tënden qoftë dhe kundrejt parimeve të tua, kundra moralit të keqpërfolur, kur kalon netë pa gjumë duke shpresuar në askund. Kam besim tek ty. Mos më zhgënj!

Me dashuri Sindy.

**Sindy Huta 9F**





E dashur Vivien!

Gjithmonë kam menduar se në jetë duhet të arrish gjëra të mëdha. Për t'i arritur ato duhet të bësh shumë përpjekje e sakrifica. Të gjithë, kur kemi qenë fëmijë, kemi pasur shumë synime dhe pikëpamje të ndryshme për të ardhmen. Që në këtë moshë i dija mirë gjërat që dëshiroja të arrija: të bëhesha dikushi në jetë, të mos trembesha nga të papriturat që mund të më dilnin përpara. Pastaj arritjet vijnë nga ëndrrat dhe dëshirat tona. Kam dashur që një ditë të jetoj jashtë, të mbaroj shkollën që dëshiroj dhe të kem punën që dëshiroj. Tani veç ëndërroj për të ardhmen, por dua që kur të vijë ajo ditë çdo gjë ta kem arritur me forcat e mia. Çdo gjë ka qenë e lehtë atëherë, jeta më dukej si fushë me lule, por jam e sigurtë që për t'u bërë ajo që je sot ke kaluar shumë vështirësi. Në jetë nuk mund thjesht të mbyllim sytë dhe për një moment të ecim pa frikë, të sigurtë për hapat që do të hedhim më pas. Deri tani s' jam ndjerë asnjëherë e vetmuar. E kam ditur që gjithmonë kam pasur pranë njerëz që më duan e më kanë mbështetur në momentet më të vështira. Por për ty është ndryshe. Tashmë je rritur e nuk mund të kesh më ëndrrat fëmijënore si dikur. Në jetën tënde nuk ka më vend për fantazi të kota. Çdo gjë është reale, prezente dhe jetohet në atë moment. E di, asgjë nuk ka qenë e lehtë. Jeta të ka vënë përpara provave të ndryshme, por jam e sigurtë se i ke kaluar me më shumë guxim e forcë. Ka raste kur je ndjerë vetëm, sikur s' mundeshe më, e lodhur nga misteri i së ardhmes. Tani po ta lë ty në dorë të mendosh se si do të vazhdojë jeta jote më tej. Unë e di që ti nuk do të dorëzohesh kurrë. Jam e sigurtë, që gabimet nuk kanë qenë të pakta gjatë rrugës tënde deri më tani, por kurrë mos e kthe kokën pas e të mendosh se si mund t'i bëje gjërat ndryshe. Dua që, kur të lexosh këtë letër, të mos mendosh për dikur se si mund t'i evitohet gabimet, pasi çdo veprim ka pastojat e tij dhe janë ato gabime, nga të cilat ti ke mësuar dhe të kanë bërë ajo që je sot. Mos rresht kurrë së ëndërruari për vazhdimin dhe mos i lë kurrë mendimet e të tjerëve të të ndalojnë! Jam e sigurtë që ti i ke bërë këto gjëra deri më sot. Pasi ëndrra kanë të gjithë, por e di që ti i ke bërë ëndrrat e tua realitet...

Me dashuri Vivieni.

**Vivieni Mishel Prifti 9F**



Përshëndetje e dashur Laura,

Kanë kaluar vite dhe tani ti mund të jesh bërë zonjë e suksesshme në punë e në jetë, ndoshta ke krijuar familjen tënde, vatrën e ngrohtë ku gjen paqe e qetësi. Mund të jenë shumë ndoshta për jetën tënde, por përveç gjithë këtyre pikëpyetjeve që kam, shpresoj që ti dhe njerëzit e tu të dashur të jeni mirë. Nuk e di se çfarë ke arritur në jetë, por di që gjithmonë ke ëndërruar për të



ardhmen, ashtu si unë. Edhe unë kam shumë ëndrra. Shkollën e mesme dua ta mbaroj me mesatare të lartë. Më pas do t'i drejtohem vorbullës së jetës me gjithë forcat që kam. E di shumë mirë që jo çdo gjë që kam ëndërruar do të realizohet, por gjithmonë shpresoj. Dua që vitet më të bukura të jetës, ato të universitetit t'i kaloj jo shumë larg familjes. Dua ta shijoj sa më shumë atë eksperiencë duke filluar nga stresi i provimeve e deri në daljet me shoqërinë. Pas disa viteve mësim, vjen edhe diplomimi. Edhe pse jeta është e gjitha një mësim, diplomimi tregon fundin e jetës studentore e fillimin e marrjes së përgjegjësi. Dhe pas shkollës ti e di më mirë se do të vijë puna. Por, përveç kësaj ëndërroj të takoj gjysmën tjetër timen, personin, me të cilin do të kaloj edhe jetën. Por jo çdo gjë do të jetë fushë më lule. Ashtu si për çdo njeri e di, e di se jeta do të ketë rezervuar diçka për mua, për të na vënë në provë. Shpresoj t'i kalojmë së bashku. Përjetimi i këtyre gjërave do të na tregojë nëse jemi të duhur për njëri-tjetrin dhe nëse po, hapi tjetër është familja. Për këtë sot për sot nuk di shumë. Ç'të të them? Jam e sigurtë se ti ke shumë për të treguar. Nga ty kërkoj veç diçka: "Të mos harrosh, ta shikosh botën me ngjyra dhe të mos rreshtësh kurrë së kërkuari lumturinë!" Dua t'ia dalësh mbanë, ta jetosh jetën me çdo gjë të sajën si atëherë edhe tani! Si unë edhe ti!

Me shumë dashuri,

**Laura Alliaj 9F**



Përshëndetje Stiven,

Si je? Sot që po të shkruaj jam 14 vjeç. Po mendoj se si kanë avancuar gjërat deri atëhere ose me saktë se si ka ndryshuar bota. Tani jam adoleshent, kam lirinë time dhe mund të bëj çfarë të dua, pothuajse. Mos harro se brenda shpirtit tënd ka ngelur një pjesë nga fëmijëria që e kujton me mall. Mos harro ta shikosh botën me ngjyra dhe jo bardhë e zi, siç bën shumica. Besoj që e mban mend kush isha i vogël dhe që doja të bëhesha shef IT-je dhe luaja shumë lojra te kompjuteri, që bëra me duart e mia. Mos hiq dorë nga dëshirat e pafundme. Unë po mundohem me shpirt e me zemër që t'i realizoj. Tani që je i rritur mendoj se je shumë i zënë me punë dhe i ke harruar fare, por përpiku t'i kujtosh. Në qoftë se ke kohë përpiku një herë ta hapësh kompjuterin dhe të luash lojra që do të duken shumë të vjetra. Tani mund të jesh duke jetuar në një shtet tjetër, mbase edhe në një planet tjetër. Asnjëherë mos u dorëzo dhe gjithmonë mos harro që edhe ti ke qenë një fëmijë! Prano gjithmonë këshillat nga të tjerët dhe mos harro të ëndërrosh!

Mirutakofshim!

**Stiven Janku 9F**





E dashur Mariza,

Je fëmijë dhe botën me sytë e një fëmije e sheh. Sheh çdo gjë me pozitivitet. Thur ëndrra pa e ditur nëse ato do të realizohen apo jo në të ardhmen. Je fëmijë i guximshëm. Nuk e di nëse këtë guxim të madh që ke mund ta kesh edhe në të ardhmen. Çdo ëndërr që thur ka një fantazi të palimituar. Ëndërro pa fund. Ëndërro edhe për të ardhmen tënde. Si mund të jesh ti në të ardhmen? A do të kesh një jetë të bukur, ashtu si e ke ëndërruar? A do të kesh profesionin që do? A do të kesh mundur t'i realizosh këto ëndrra që po thur në fëmijëri? Besoj se përgjigjet e këtyre pyetjeve do të mund t'i kthesh shumë vite më vonë. Jeta jote ndoshta mund të jetë e trishtë në të ardhmen, një botë pa ngjyra, një botë, nga e cila është shumë ndryshe nga ajo që ti ke ëndërruar në këtë moshë të vogël që ke. Ndoshta s'do mund të realizosh asnjë nga ëndrrat që ke thurur deri tani. Oh, sa pyetje që ke dhe nuk mund t'i kthesh përgjigje tani! Ndoshta mund të ushtrosh profesionin e mjekes, ashtu siç ke ëndërruar që në vogëli. Ndoshta, kur të jesh një grua 35 vjeçare do të mund saktësisht t'i përgjigjesh. Të ëndërosh Marizën 35 vjeçe. Eh! Një grua ndoshta me fëmijë ose jo, ndoshta një mjeke, ndoshta do të ushtrosh një profesion tjetër, ndoshta një grua që do të bëjë një jetë të zakonshme, ndoshta jetën që ajo vetë ka ëndërruar. Por, kjo mbetet veçse për t'u parë. Ah! Sa ëndrra thur një fëmijë për të ardhmen e tij pa e ditur që jeta nuk është një fushë me lule, por një luftë e ashpër, e cila duhet mbajtur me forca deri në fund.

Ëndrrat e mia do t'i realizoj dhe nuk do të dorëzohem kurrë, derisa t'i bëj realitet.

**Mariza Alla 9F**



E dashur Aleksia,

Si je? Si po të shkon jeta si 35 vjeçare? Shpresoj se po jeton jetën që ëndërroje që ditën që shkruajte këtë letër. Besoj se ke arritur të kesh bizneset e tua të shumta, gjithashtu duhet të jesh diplomuar në një nga Universitetet më të mira të Los Angeles apo New Yorkut. A je martuar? Besoj se ke dy fëmijë apo jo? Je marrë me aktrim dhe modeling? Me shumë mundësi je e suksesshme ose e famshme në atë që bën. Ndërkohë që po shkruaj këtë letër, pikërisht kështu e ëndërroj jetën tënde pas 20 vitesh. Po të shkruaj, sepse dua që ditën që do të marrësh këtë letër të kujtohesh për mua. Në moshë e pjekuri mund të kesh ndryshuar, por shpresoj të vazhdosh të jesh po ajo Aleksia që ke qenë kur po formuloje këtë fjalë. Të lutem mos më harro! Edhe pas 20 vitesh, kur të jesh duke lexuar këto fjalë, unë do të jem ende brenda teje. Po, po. Unë dhe shpirti im prej 15 vjeçareje do të jetojmë akoma brenda teje, edhe pse ti mund të mos e kesh zbuluar. Prandaj dua të mos më braktisësh. Mos hiq dorë nga unë vetëm sepse po rritesh. Mos më lejo të shuhem, vetëm sepse po jeton në stuhi.



Mos vallë i ke harruar të gjitha dëshirat që ke pasur 20 vjet më parë? Mos vallë ke hequr dorë nga ëndrrat prej pengesave që ke hasur? Mos vallë i ke lejuar këto pengesa të bëhen një gardh midis teje dhe ëndrrave të tua e tani nuk e kapërcen dot më?

Në qoftë se i ke bërë këto, atëherë unë jam zhdukur. Atëherë kam kuptuar se nuk kam më vend në mendjen dhe shpirtin tënd e jam larguar. Prandaj po të shkuaj. Që të më rizgjosh. Kërko thellë, shumë thellë brenda vetes dhe mund të më gjesh!

Unë nuk dua të më humbasësh, sepse jam një pjesë e rëndësishme e jotja. Unë jam imagjinata, harmonia dhe shpresa jote. Pa mua ti nuk je Aleksia e plotë. Nëse më humbet mua, ti humbet vetveten dhe kjo është gjëja e fundit që do të dëshiroja për ty. Prandaj, nëse ende ke të njëjtat dëshira si tani që po shkruan këtë letër, mos hiq dorë prej tyre. Çfarëdo pengese të të dali para, mos e humb shpresën. Përpigu! Dështove? S'ka gjë. Përpigu përsëri! Mos u dorëzo! Mos u tremb nga rrethanat. Me durim e përpeke mund të arrish gjithçka dhe ti e di këtë. Guxo! Mos u mposht nga frika! Mos u ndiko nga askush dhe nga asgjë. Këtë i ke thënë vazhdimisht vetes edhe 20 vjet më parë, apo jo? Nuk pres të më kuptosh. Të paktën jo menjëherë. Por dua të mendohesh për këto që po të them. Dua të mbyllësh sytë e të kujtosh gjithë ëndrrat që ke pasur kur po shkruaje këtë letër. Dua të kujtosh çfarë ndieje kur po shkruaje këtë letër! Me dashuri,

**Aleksia Peleshi 9F**



Përsëndetje Gerald,

Pyetja e parë që do të doja të të bëja është se si je me shëndet, pasi shëndeti është kryesor në jetë. Pa shëndet, nuk mund të gëzosh asgjë. Jeta si ka kaluar ndër vite? A janë realizuar ëndrrat e tua fëmijore? Epo në qoftë se i ke harruar, atëhere po të jap një dorë ndihmë.

Kur ke qënë fëmijë, ti ke qënë i apasionuar mbas makinave dhe teknologjisë. Shpresoj se në këtë moshë që je tani të kesh mundësi financiare dhe kohore për t'u marrë me to, të krijosh koleksione nga më klasiket te këto më modernet.

Kur ti ke qënë në moshë të re, ke pasur gjithmonë dëshirë të kishe një jetë të lumtur e të shëndetshme. Ke pasur dëshirë që të çaje në jetë. Nga ana arsimore, të mbaroje ciklin e ulët me rezultate të shkëlqyeshme, po ashtue dhe ciklin e mesëm. Pas këtyre dy cikleve shumë të rëndësishme për jetën tënde, ke pasur dëshirë që të vazhdoje ciklin e lartë në degë shkencore. Mbase të mbaroje dhe këtë cikël shumë të rëndësishëm dhe kuptimplot të jetës tënde, të gjeje një punë të mirë, jo monotone dhe fitimprurëse për ty, që të krijoje një ekonomi të mirë për të filluar jetën familjare. Pas pak vitesh si beqar, ti ke dëshiruar që të gjeje vajzën me të cilën të martoheshe dhe të krijoje familje.



Unë gjithmonë kam pasur dëshirë që të arsimoja fëmijët e mi në shkollat më të mira në botë, që ata të bëhen po ashtu si unë në të ardhmen: dikush në jetë. Shpresoj që fëmijët e mi mos të bëjnë një jetë të shpërfillur dhe të kenë një respekt të konsiderueshëm për mua, po ashtu dhe ndaj gruas sime.

Pasi ata të marrin një drejtim të mirë në jetë, shpresoj që unë dhe gruaja ime të bëjmë një jetë të lumtur dhe të shëndetshme.

PS: Kurrë mos u dorëzo në jetë! Kurrë mos u dëshpëro! Shiko gjithmonë përpara!

Tëpërqafoj

**Gerald Zekaj 9F**



I dashur Ergys,

ERGYS si je? S'besoj të kesh ndryshuar shumë nga ai që ke qenë. Besoj se tani je rritur e je bërë një individ i rëndësishëm për jetën tënde.

A ke arritur të marrësh çfarë gjithmonë ke dashur? Besoj dhe shpresoj se po, pasi nuk dorëzohesh para dëshirave dhe qëllimeve që i vendosje vetes. Ishe i zgjuar dhe shumë dinak për të arritur ato dhe aty ku doje. Shpresoj që të jesh bërë ai Ergys që gjithmonë dëshiroje, ai që nuk i linte shokët në baltë. I doje dhe i respektoje ato që të donin. Prandaj vendosa të ta shkruaj këtë letër, për të të falenderuar që u bërë ai që unë doja, pa u vendosur në vështirësitë që ndoshta dhe mosha mund të të vinte në provë. Qëndroju pranë prindërve, motrës, vëllait dhe të afërmve të tu!

Me dashuri ERGYSI

**Ergys Çaushaj 9G**



I dashur Frenkli,

Jam unë, ose ti më saktë, por 20 vite më përpara. Të shkruajta, pasi kam shumë pyetje për ty.

Si je? A kanë shkuar gjërat siç i ke planifikuar? Apo jeta të ka çuar në rrugë që as e dije që ekzistonin. Më e rëndësishmja, a je i lumtur? A fokusohesh akoma tek gjërat negative që të rrethojnë, në vend që të vlerësosh ato pozitivet? Shpresoj të jesh mirë! Po përpiqem që të jesh një version më i mirë i personit që jam tani. Po filloj të seleksionoj personat që lejoj në jetën time, që ti të mos rrethohesh nga negativiteti, të cilin e urren aq shumë. Të premtoj se do i kujtosh këto vite dhe do ndihesh krenar. S'dua të të zhgënej.

Me mall Frenkli

**Frenkli Muça 9G**



E dashur...Artela,

Jam në dilemë; ndoshta duhet ta nisja: "E nderuar gjykatëse", por nuk e di a ia ke dalë mbanë?! A e ke bërë ëndrrën tonë, ëndrrën time realitet? Po, nejtse, si je? A je e lumtur? A po buzëqesh me fjalët e mia, të hedhura në këtë copë të thjeshtë letre, të bardhë si pafundësia, të panjohur si e ardhmja? A je ulur në zyrën tënde me shkresa të pafundme përbri, por të organizuar jashtë mase? Apo mos ndoshta ke marrë një shprehje jo fort të këndshme fytyre dhe po mundohesh të fshehësh pendimin dhe trishtimin? Dhe nëse po, nëse e ke vrarë ose i ke dhënë jetë ëndrrës sonë, a e gjete atë që kërkoje në të dy rastet? Por më e rëndësishmja: A je ende aty? Duke marrë parasysht dhe të mirëqenë ekzistencën tënde, duke të patur ty si modelin më të mirë të mundshëm për veten time të tashme, duke besuar dhe shpresuar që je vërtetë akoma unë dhe jo dikush tjetër, duke menduar që ia ke dalë, të shkruaj këtë letër me atë hyrje aq të ngarkuar me pyetje. Pyetje pafund, për ty, për mua. Do ta pres me durim përgjigjen tënde, për plot njëzet vjet. Do të shoh nga dritarja dhe do të buzëqesh për ditën që po agon. Do të eci në po të njëjtët hapa me ty e di. E di, unë do të bëhem ti, sepse ti ishe unë dhe ne jemi një, të pandashme, por gjithsesi larg me njëra-tjetrën. Dhe kur të vijë ajo përgjigje, qoftë ajo një buzëqeshje, një lot apo dhe një letër tjetër, e pra, kur të vijë ajo ditë ndoshta, por dhe ndoshta jo, do të jem ajo që dua të bëhem, por gjithsesi unë do të jem ti. Mbyll sytë dhe e shpreh dëshirën; duke fryrë qirinjtë, kur shoh natën që bie, kur ora shënon mesnatën dhe jam ende zgjuar, kur dielli perëndon me premtimin që do të agojë përsëri, kur fryj lule-qumështoren apo lule "Babagyshin", kur e shoh të ardhmen pas pikës së shiut që rrëshket mbi xham; shpreh dëshirën që të jem ti, por ashtu si dua unë. Dua të kem një familje të vogël, por të ngrohtë, një karrierë brilante, jo e bazuar në egoizëm etik, por në dëshirën për të mbrojtur të vërtetën, për të ndihmuar të drejtën të gjejë rrugën e saj, për t'i dhënë fund konflikteve pavlerë, për të lënë gurin tim në mozaikun e njerëzimit, për të kuptuar dhe ndihmuar me forcën time botën, për të qenë pjesë e reales dhe së ardhmes.

Ti e di, unë dua të bëhem gjyqtare, dua të ndihmoj në krijimin e shtetit të së drejtës, jo atij ligjor, në të cilin edhe nëse diçka është e gabuar dhe shkon ndesh me moralin, është e gabuar dhe e padrejtë, nëse e mbështet shumica bëhet legjitime.

Jo! Unë dua të ndihmoj për krijimin e atij shteti, në të cilin individ i jeton i lirë, me shpresë për të ardhmen, sepse e drejta e tij është e sigurt.

Ti e di. Unë dua të arrij aty ku e di që e meritoj, ku e di që i përkas. Është e vërtetë, unë dua të bëhem politikane e suksesshme, të ngre zërin për popullin tim, për njerëzit e mi, t'u jap atyre të ardhmen, por gjithçka fillon kur do t'ia dal të krijoj timen. Dhe për këtë shpresat i kam te ti dhe te çasti, te momenti. Tani do ta mbyll. Do të të uroj të jesh ajo që do të jesh, do të uroj të bëhesh ëndrra ime, unë, por të jesh ti në të ardhmen. Do të të jap një përqaftim të

ngrohtë mbushur me kujtimet e së shkuarës dhe do të të shoh me admirim, sepse gjithësesi ti je unë, je e ardhmja ime, je jeta ime.

Të përqafoj nga larg,

Merr: Një person interesant që mban emrin tim, vetja ime, Artela Roshi

Dërgon: Një fëmijë me ëndrra, që përsëri mbart emrin tim, sepse jam unë.

**Artela Roshi 9G**



E dashur Ailin,

Uroj që kjo letër të të gjejë mirë dhe që t'ia kesh kaluar mirë këto 20 vite. Shpresoj ta kesh mbaruar me sukses shkollën dhe të jesh duke bërë punën që ëndërron. Mendoj që i ke falenderuar prindërit, të cilët të kanë ndihmuar të arrish aty ku je dhe jam e sigurt që i ke bërë krenarë. Besoj që tashmë e ke gjetur personin, me të cilin do të ndash pjesën e mbetur të jetës. Shpresoj që ta duash dhe të të dojë, ta respektosh dhe të të respektojë. Uroj të kesh fëmijë të mirë dhe të bukur, të cilët janë të lumtur dhe mirënjohës për ato që kanë. Shpresoj që ta kesh blerë atë makinën e bukur dhe atë shtëpinë e madhe që ke dashur gjithnjë. Mendoj që tani je duke jetuar në një qytet, ku i ke të gjitha kushtet për të bërë ato që ke dëshirë, në një vend ku nuk ke frikë për të jetuar, në një vend, ku je e sigurt. Besoj që ke udhëtuar nëpër vende të ndryshme dhe besoj që ke mësuar gjëra të reja dhe që ke kaluar momente të paharrueshme. Shpresoj të jesh duke i ofruar vetes kënaqësitë e vogla të jetës.

Së fundmi, uroj të jesh e lumtur me jetën që bën. Shpresoj të mos jesh duke pritur gjithë javën për ditën e premtë dhe fundjavën, apo gjithë vitin për pushimet verore. Shpresoj të jesh e lumtur edhe ditët kur nuk je pushim. Uroj që të jesh diku në jetën tënde, ku stresi nuk ekziston dhe të jesh duke përçarur vetëm pozitivitet. Shpresoj të jesh personi që ke dashur gjithnjë të jesh. Të jesh e njëjta vajzë që ke qenë para 20 vitesh, vetëm të jesh "version i përmirësuar". Gjithë të mirat, Ailin 2016 (14 vjeç).

**Ailin Haxhialushi 9G**



E dashur Esi!

Shpresoj të jesh mirë, të jem mirë më saktë. Kjo është pak e sikletshme. Shkruaj tani e pyes veten se ku mund të kesh përfunduar..

Pyes veten se çfarë profesioni kam marrë... ose më saktë nëse kam marrë një profesion, sepse nuk i dihet si kanë ardhur gjërat këtu e 21 vjet, apo jo? A ke ndonjë ngjashmëri me mua të tanishmen? Ndonjë ves ose virtyt që më karakterizon, ke ruajtur vallë? Me siguri nuk i je ndarë kurrë muzikës. Shpresoj të mos ia kemi mohuar vetes atë kënaqësi, të paktën atë. Nuk më hiqet nga



mendja një pyetje sado që përpiqem ta largoj: Në fund të fundit, çfarë mund të kem bërë me jetën time vallë? Në këto momente, ajo është dilema ime më e madhe, zgjedhja e një shkolle, universiteti, masteri, puna...

Teksa shkruaj kam një ëndërr që e quajmë "të marrë", por kam një besim të çuditshëm te ti, te vetja ime, se mund të kem realizuar të famshmen ëndërr dhe të jem duke e jetuar atë teksa lexoj këtë letër. Uroj që po. Uroj të mos kem hequr dorë së qëni fëmijë, edhe pse je aq e madhe. Është e pakuptimtë të kërkoj diçka të tillë, e di. Të gjithë duhet të rriten, por unë nuk kam qëllim të të them, të jesh e papërgjegjshme, thjesht dua të mos ndalosh së fantazuari. Unë nuk dua të ndaloj. Dua të vazhdoj të mendoj për të ardhmen deri sa ta gjej veten të dergjuar në ndonjë shtrat nga ku nuk lëviz dot më.

Kam besim se ti nuk e ke zhgënjyer këtë katërmbëdhjetëvjeçaren e marrë që të kërkon të fantazosh të ardhmen në çdo moment. Kjo detyrë, është një shkallë më lart se ajo që unë bëj zakonisht. Nëse deri tani më është dashur të mendoj se si do të zgjidh problemet dhe do ta jetoj çdo moment në një kohë që zgjat deri në dy ditë..., papritur e gjej veten 21 vjet në të ardhmen. Them se kam të drejtë të shoh gjithë anët e medaljes, të ardhmen alternative. Nuk e di ende në këtë moshë se çfarë ekzaktësisht kërkoj nga jeta ime në të ardhmen, por e di se çfarë nuk dua të ndryshojë tek unë. Nuk mendoj se duhet të përmend ndonjë gjë, sepse unë dhe ti, unë, dua të them. E di shumë mirë se cilat janë ato tipare që duhet të vdesin bashkë me mua. E kam përmendur disa herë vdekjen, por mos ma merr për keq. Unë e di si jam. Vdekja do jetë fundi i gjithçkaje dhe ajo që do të ngelet prej meje do të jetë kujtimi i njerëzve pas saj. Pra nuk dua që të mendohet se unë ndryshoja sipas kohës, sipas trendit, si ndonjë njeri pa personalitet. .... Kush e di sa e papjekur tingëllon kjo! Më vjen keq nëse ngjaj shumë fëmijore ose e mërzhitur, nuk është ai qëllimi im i kësaj here. Kësaj here dua të shkruaj për mirë, thjesht kam një frikë, një karakteristikë tjetër, se nëse unë nuk të them atë që kam në mendje, në një mënyrë ose një tjetër, e ardhmja ime do të zhgënjë të shkuarën time.

Uroj që kjo letër të mos duket si ndonjë fragment i dalë nga kodi i Da Vinçit ... sa kopetencia i dhashë vetes! Këtë mburrjen pa të keq mirë është ta heq në të ardhmen. Nuk e di në ia vlen të shkruaj më apo jo. Kam aq shumë për të thënë në të njëjtën kohe, por nuk i vendos dot të gjitha në vijë. Kur mendoj për diçka që nuk ka ndodhur, ka gjithmonë të tjerë që i kundërvihen dhe, nëse i marr të gjitha parasysh, i bie të mos e mbyll letrën kurrë. E thënë ndryshe, do ta mbyll me kaq. Shpresoj të jesh e lumtur me zgjedhjet e mia dhe të jesh ende unë në të njëjtën kohë!

Me dashuri, Ester

**Ester Çalliku 9G**



E dashur Arlina,

Sot që po e shkruaj këtë letër jam akoma fëmijë.

Jam akoma në atë lumturinë që e ka çdo njeri në moshën time. Ëndrrat e mia janë të pafundme, për një të ardhme të suksesshme, për një dashuri të pashterueshme dhe që lumturia që kam tani mos të mbarojë kurrë. Më kanë thënë që jeta mbasi të rritesh, është shumë e vështirë. S'më duket ashtu nga këndvështrimi im. Mua më duket normale. Pa dyshim çdo njeri ka probleme të ndryshme, por jo aq sa të zhytesh në ato probleme. Ato duhen kaluar me pozitivitet dhe me kokën lart. Lumturia të vjen përsëri, edhe pse të ikën për një çast, ajo nuk të braktis kurrë. Kujtohu për dëshirat që kishim kur ishim fëmijë! Mos i harro asnjëherë! Mos harro guximin që kishim! Çdo gjë e bëje pa patur problemin e një frike, që mund të vinte më pas. Nuk dua asnjë gjë tjetër, përveç lumturisë tënde dhe njerëzve të tu të dashur. Shpresoj që këto fjalë që po të them tani, t'i ndiej dhe kur të rritem. Mirupafshim!

Me dashuri Arlina.

**Arlina Duxha 9G**



I dashur Elio!

Po të shkruaj, pasi nuk jemi parë prej kohësh. Ti i ngarkuar me punë dhe obligime të tjera, unë po ashtu. Fillove shkollën në Nju Jork direkt, pasi mbarove gjimnazin këtu në Shqipëri? Kishe vajtur për një jetë më të mirë, afër me disa familjarë, që përpara i shihje rrallë, kurse këto kohë mund të shkosh dhe t'i takosh për 5 orë rrugë. Nuk kishe më pse të shkoje për një ditë të tërë nga një cep në një tjetër të botës. Po të pyes si shkon tema shkencore? Ti mbarove studimet, bërë dhe specializimin në kirurgjinë stomatologjike. E di që puna të ecën mirë, ke bërë emër. U takuam në Nju Jork, ku ishe për trajnim. U mburra me aftësitë e tua.

Ti tani ke filluar studimin shkencor për ta çuar përpara kirurgjinë. E di që studion shumë, por lerë vend dhe për ne. Kur do t'i kthehesh familjes tënde, atë kryesoren?? Dua që dhe ti të krijosh një familje për së mbari, t'i edukosh po aq mirë si të edukuan ty, sepse përherë familja dhe shëndeti vijnë të parat. U gëzova shumë, kur mora vesh se së shpejti mund të krijosh familjen tënde. Pres të më sqarosh. Dua të jem në gëzimet e tua, ashtu siç gëzon ti me ne. Të uroj gjith të mirat!

Miku yt më i mirë,

**Elio Zhilla 9G**



E dashur Beha,

E di që gjithmonë ke dashur të jetosh në një banesë të vogël, të ngrohtë dhe të jesh vetëm jashtë shtetit duke punuar. Kështu që shpresoj që dëshira jote të jetë plotësuar tashmë, se sido që të jetë, tani ti je një e rritur.

Je tridhjetë e pesë vjeç dhe mund të bësh çfarë të duash dhe jo si atëherë që doje që prindërit të të kuptonin dhe të të linin të bëje gjëra të palejuara që ti do i bëje pa dijenin e tyre dhe pastaj do pendohesh. Shumë herë dëshiroje të mos ekzistonin.

Tani mund të bësh çfarë të duash, por tashmë nuk ke dëshirë t'i bësh, sepse mendoj që tashmë nuk je më ajo që ke qenë në atë moshë. E di që tani pendohesh që ke bërë gjëra të tilla në moshën e adoleshencës, por ato do të mbeten pjesë e jetës tënde, që nuk i ndryshon dot. Thjesht shpresoj mos t'i bësh më. E di që ti gjithmonë do doje të jetoje vetë dhe në atë shtëpinë e vogël që e përmenda dhe në fillim, por tani besoj që ke krijuar familjen tënde të lumtur, me kushtet më të mira. Shpresoj që tani ke atë makinën që doje gjithmonë që askush përveç teje mos ta përdorte. Gjithashtu dhe garderobën me rrobat më të reja të kohës, ta kesh dhe prapë mos të dish se çfarë të veshësh, siç bëje gjithmonë. Të gjitha këto që i ke pasur "dëshira të paplotësuara", si një adoleshente, shpresoj t'i kesh tani dhe të jetosh siç ti dëshiroje.

Me dashuri Beha 14-vjeçare.

**Beha Koçishte 9G**



E dashur vetja ime ... në të ardhmen e largët!

Nuk jam e sigurt se çfarë duhet të mendoj për ty. Nuk e di se si ndihesh në këto momente, se me kë je e rrethuar, se sa e gëzuar je me arritjet e tua, me punën e palodhur, me sakrificat që ke bërë, dhe tani je 35 vjeç?

Tani kur të mendoj, e ardhmja më duket një botë që është kaq larg dhe kaq pranë meje, një botë e mbushur me ngjyra të zbehta dhe të zymta, një botë e frikshme, ku të përplasim gjithmonë vërshtirësitë e jetës, "dallgët e detit". Por ndonjëherë më duket kaq magjike dhe e mistershme, sa mezi pres të zgjas duart e ta përkëdhel, ta afrojë drejt meje, të jetoj çdo çast gëzimi të saj, me pasion dhe entuziazëm, të ndiej lumturinë dhe mrekullitë e saj, por dhe lotët e saj. Çdo ditë zgjohem me një ëndër të re. Çdo mëngjes një ylber tjetër dua të kapërcej. Çdo frikë timen dua ta mposht, çdo gjë që më del përpara dua ta kaloj. Kurrë nuk dua të ndalem, kurrë nuk dua të pushoj, se për mua gjërat janë kaq të bukura dhe magjike, kaq të frikshme e mizore. Por koha ecën shpejt, momentet zgjasin kaq pak, sa më duket sikur lumturia më rrëshket nga duart, pa e kuptuar fare se në ç'kohë ndodhem. E ardhmja më troket gjithmonë në derë, më tërheq drejt saj. Ajo kapet pas krahëve fort dhe merr fluturimin e largët, për të më çuar në horizonte të panjohura që nuk i kam parë ndonjëherë. Bota ime plot ngjyra dhe e bukur, e mbushur plot lule shumëngjyrëshe, pak e nga pak çdo gjë fillon të zhduket. E di që fola shumë





për të ardhmen, por gjithmonë mendoj për të. Gjithmonë mendoj për ty, se sa e suksesshme je, se sa e talentuar dhe magjepsëse je. Se sa e lodhur dhe e rraskapitur je. Por pavarësisht të gjithave shpresoj se ti je shëndoshë e mirë dhe mbi të gjitha e kënaqur me veten tënde!

Me dashuri Silvia, vetja jote 14 vjeçare

**Silvia Jashari 9G**



E dashur vetja ime ... në një të ardhme të largët, Kur ta lexosh këtë letër, do të jesh 20 vjet më i madh e mbase do të kesh krijuar familje tashmë. Ndoshta do të kesh punën e ëndërrave, ndoshta do që të jetosh mirë, pasi i thirre mendjes që s' do të kishe të ardhme pa mësuar. Ndoshta do të jetosh në mënyrë jo të denjë, pasi e kishe mendjen të mos mësoje, por të luaje lojëra kompjuterike që s' të vlejnjë për asgjë.

Gjithsesi ato gabime janë bërë tashmë e s' ke çfarë të bësh. Ama, kurrë mos rresht së besuari dhe punuari. Mundohu të jesh gjithmonë në anën e ndriçuar të globit! Përpiqu që të bësh gjithmonë zgjedhjen e duhur. Puno gjithmonë e më shumë e mos u kënaq kurrë me pak. Gjithmonë pyet, kur nuk kupton diçka, merr këshilla nga më të diturit. Kur je i pasigurtë, dëgjoji njerëzit që ke pranë se ata të duan të mirën! Në qoftë se ke fëmijë, edukoji ata siç të kanë edukuar prindërit ty! Duaji ata, siç të kanë dashur prindërit ty! Respektoji dëshirat e tyre siç t' i kanë respektuar prindërit ty. Ndihamoji njerëzit që të kanë ndihmuar, respektoji njerëzit që të kanë respektuar dhe besoj atyre që të kanë besuar! Shiko gjithmonë përpara, por hidhi sytë edhe mbrapa! Ji i gatshëm për gjithçka e gjithkënd!

Kurrë mos e harro fëmijërinë, momentet e bukura dhe të këqija dhe gjithmonë falenderoji prindërit që të rritën me të gjithë të mirat e falë tyre je këtu sot!

Me mall

**Elio Kreka 9G**



I dashur Rey,

Shpresoj të jesh mirë, pasi nuk e di çfarë mund të ketë ndodhur deri atëherë. Unë jam munduar disa herë të të shkruaj, por nuk kam ditur se si të të drejtohem. Sot unë jetoj në një botë të bukur, por me sfidat e jetës, të cilat e zbehin këtë bukuri. Gjithsesi unë mendoj se ende këto sfida nuk janë edhe aq të vështira dhe të rëndësishme sa në moshën 35 vjeçare. Unë mendoj se edhe ti duhet t' i kalosh këto sfida lehtësisht dhe pa të lënë shenja negative. Unë e di se bota në të ardhmen do të ketë ndryshuar shumë, por nuk e di se si: për mirë apo për keq. Mendoj se në të ardhmen do të ketë ndryshuar për mirë, por gjithsesi nuk jam i sigurt për këtë gjë. Do përpiqem të të shkruaj më shpesh gjatë viteve dhe në çdo përvjetor dhe ditëlindje timen. Me dashuri, Rey

**Rey Karapici 9G**



I dashur Alessio,

Shpresoj të jesh mirë. Kam menduar të të shkruaj shumë herë. Në mendje kam shumë ide dhe dëshira, që shpresoj t'i kem realizuar. Për tani çdo gjë është në rregull, por e mendoj shpesh si do të jetë e ardhmja, si do të ketë evoluar teknologjia, e cila gjithmonë më ka tërhequr dhe vazhdon të më tërheqë. Shumë njerëz më thonë që gjërat do të vështirësohen, por unë mendoj se mund t'i kaloj ato pa shumë problem, me vullnet, durim dhe këmbëngulje. Sigurisht do të ketë dhe shumë situata të vështira, por unë s'do dorëzohem kurrë, derisa të arrij qëllimet e mia. Do të vazhdoj të studjoj dhe asnjëherë nuk do t'i lëshoj librat nga duart. Unë jam shumë optimist për të ardhmen dhe do të vazhdoj të ec drejt saj, sepse siç thotë edhe një fjalë e urtë: "Asnjëherë mos mendoni se i dini të gjitha, edhe në qoftë se i dini, kini burrërinë t'i thoni vetes që unë nuk di".

Do të të shkruaj përsëri, sa më shpejt që të jetë e mundur. Kalofsh sa më mirë dhe shpresoj mos t'i harrosh kurrë këto fjalë që shkruajta këtu!

Gjithë të mirat, Alessio!

**Alesio Tela 9G**



E dashur Heidi,

Si ke qenë? Si ia ke kaluar gjatë gjithë këtyre viteve? Kjo është një letër që e kam shkruar unë, vetja jote 15-vjeçare, para 20 vitesh. Në këtë letër dua të të përcjell fjalë që kalojnë kufijtë e kohës dhe të moshës. Unë dhe ti vërtetë mund të kemi emër dhe përbërje gjenetike të përbashkët, pra identitet të njëjtë, por prapësëprapë nuk jemi i njëjti person. Gjatë këtyre njëzet viteve, ti ke ndryshuar, ke kaluar eksperiencat të ndryshme, je bërë me përvoja të shumta. Unë dhe ti nuk shikojmë të njëjtën botë. Ashtu si unë, edhe bota ka ndryshuar, që nga zhvillimet teknologjike e deri te njerëzit e famshëm. Edhe mënyra si ne e shohim botën nuk është e njëjtë. Sot, unë kam me mijëra, me miliona ide dhe ëndrra, të cilat dua t'i provoj apo t'i arrij në të ardhmen. A i ke mbajtur në mendje këto, pavarësisht nga sa ke ndryshuar? Apo i je nënshtruar jetës së përditshme, pa asnjë mendim jashtë saj?

Jeta është si një lum. Fillon të burojë në momentin kur lind dhe derdhet, përfundon së rrjedhuri kur vdes. Sigurisht, uji që rrjedh në këtë lum, nuk është i njëjtë nga fillimi deri në fund. Ndryshon, duke u turbulluar, duke marrë me vete papastërtira të ndryshme. Kështu, ndryshon dhe këndvështrimi ynë teksa rritemi. Kur jemi fëmijë të vegjël, mendojmë se mund të bëjmë gjithçka që mund të bëhet. Duke u rritur, këto ëndrra turbullohen, njerëzit bëhen gjithnjë e më shumë pesimistë, kalojnë nga idealet e tyre, nga bota e ëndrrave



të fëmijërisë, në botën e vërtetë mizore, derisa përfundojnë thjesht si një pjesë e turmës. Por, shpresoj të kesh mbajtur parasysh këtë fakt: gjithmonë mund të shikosh prapa. Nuk është e thënë, që edhe pas 10, 20, 30 apo më shumë vitesh, të harrosh të shkuarën, apo veten tënde në të shkuarën. Vërtet duhet të jetosh për të tashmen e të ardhmen, por me përvojat dhe ëndrrat e së shkuarës.

Pra, a më kujton ndonjëherë mua? A kujton ëndrrat që ke pasur në moshën time, apo dhe më parë? Ndoshta e ke mbajtur mend këtë letër e je përpjekur t'i arrish këto ëndrra! Ose ndoshta, nga ana tjetër, je bërë pjesë e rrjedhës së lumit, duke mos ndryshuar asgjë.

Shpresoj që të jetë ajo e para!

Gjithë të mirat!

**Heidi Durrësi 9G**



I dashur Enio,

Unë që po të shkruaj jam fëmija brenda teje. Ai fëmijë që kishte botën në duart e tij, ai Enio që kishte ëndrra të mëdha dhe nuk do të dorëzohej, derisa t'i bënte realitet. Por më dukesh pak i humbur e dëshiroja të ta kujtoja veten tënde fëmijë. Ti ishe vetëm një fëmijë i vogël në një botë të madhe dhe me ëndrra e qëllime të mëdha. Ishe një fëmijë, që i doje e i respektoje njerëzit e nuk i harroje të mirat që ata bënë për të të ndihmuar. Ti kishe dëshirë të ishe mbreti i gjithçkaje dhe nuk kishe aspak frikë ose dyshim që do t'i arrije ato që doje. Ai fëmijë guximtar që nuk kishte frikë të ndërthurte imagjinatën me botën reale, të ndërthurte guximin me inteligjencën për ta përdorur në interes të vetes. Shpresoj që sot t'ia kesh dalë mbanë e t'i kesh arritur synimet e tua, për të cilat aq shumë ëndërroje. Por shpresoj që dhe munda t'ia kete vlejtur dhe të ndihesh i plotësuar me veten tënde. Mendoj se, përderisa unë nisa ta shkruaja këtë letër ti ishe zhytur në një botë ku ndihesh i huaj e jo i barabartë. Aty ku çdo gjë vërtitet rreth interesit dhe gënjeshtërisë. Por thellë brenda vetes ti e kupton që ti nuk i përket kësaj bote. Ti e kupton dhe e mban mend dëshirën tënde për t'u bërë dikush në jetë. Pra, nuk do të vazhdoj të të shkruaj më shumë, sepse besoj se e ke kuptuar mesazhin e kësaj letre të sinqertë, e cila po të ishte lexuar më përpara mund të ishte keqkuptuar nga ndryshimet vit pas viti të mentalitetit tënd. Por tani je i rritur, aq i rritur, sa ta kuptosh letrën që ti i ke shkruar ndërgjegjes tënde. Tani që ti u kujtove se kush je, shpresoj që dhe dëshirat e tua të vërteta të jenë kthyer në realitet dhe jo në një gënjeshtëri të madhe për ty dhe një zhgënjim edhe më i madh për njerëzit që besuan tek ti.

Me dashuri

**Enio Bajraktari 9G**



E dashur Era Qendro,

Po lexon një letër që e ka shkruar 15-vjeçarja Era. Asaj që i pëlqejnë ecjet e gjata dhe filmat, që do të realizojë, kur të rritet. Shpresoj ta kesh arritur këtë. Mbase duke u rritur ke ndryshuar mendje se çfarë do të bëje. Ndoshta je bërë juriste ose doktoreshë. Çfarëdo që të kesh bërë shpresoj që këto vite që kanë kaluar të kenë qenë më të mirat. Shpresoj që je duke e lexuar këtë letër në kolltukun tënd të preferuar, në shtëpine e bukur pranë me bashkëshortin tënd dhe vajzën tënde të vogël. Shpresoj që i ke shijuar vitet e gjimnazit dhe të universitetit. Shpresoj që ke mësuar nga gabimet në jetë. Shpresoj që ke ndjekur atë që ke dashur dhe që s'ke hequr dorë, që je bërë femra që unë imagjinoj të jesh. Dua që kjo letër të jetë një udhëtim në fëmijërinë që të ka pëlqyer shumë. Dua të kujtosh çdo hap të rëndësishëm që ke hedhur. Gjithmonë ke dashur të udhëtosh botën, shpresoj që e ke bërë dhe këtë, që ke bërë me miliona foto, sepse e di që i adhuron. Shpresoj që e ke ruajtur shoqërinë që ke tani dhe që ke bërë akoma më shumë shok e shoqe gjatë jetës. Shpresoj që tani je e qetë dhe e lumtur me jetën që bën dhe që rreth teje ke njerëz që të mbështesin. Të uroj të kesh një jetë sa më të bukur!

Me dashuri Era.

**Era Qendro 9G**



E dashur Jona,

S'e kam menduar kurrë që do t'i shkruaja një letër vetes sime 35 vjeçare. Një mijë pyetje më shkojnë në mendje. Si po ndihem në ato momente? A kam ndryshuar shumë? A ia kam arritur qëllimit për të qenë një arkitekte? A kam krijuar një familje? Po prindërit e mi, vëllai im si janë?

Së pari do të të tregoj se çfarë gjërash po ndodhin sot, 20 vite përpara se të kesh marrë këtë letër. Unë jam në klasë të nëntë dhe po jap maksimumin tim në mësim, sepse ky është një vit i rëndësishëm. Unë kam për të dhënë provimet e lirimt. Do të të duket qesharake kur ta lexosh këtë letër e të mendosh sa e stresuar kam qenë këtë vit, por ky është realiteti, unë stresohem shumë për çdo gjë. Vras mendjen, nëse, dhe kur të jem në atë moshë që je ti, do të jem po aq e stresuar sa ç'jam tani. Po më vret kureshtja për të ditur se çfarë ndodh në të ardhmen. Si është bota, njerëzit? Dua të të them këtë, edhe nëqoftëse s'e keni arritur të qenit ajo që unë do të doja të isha, nuk ka problem. E vetmja gjë, që unë dua të jem, është e lumtur. Edhe nëse s'jam arkitekte nuk ka rëndësi, rëndësi ka që unë të bëj atë që më bën mua të lumtur.

Dua të të kërkoj diçka, nuk është një kërkesë shumë e madhe, por për mua ka shumë vlerë. Dua që ti, vetja ime 35 vjeçare, të mos ndalosh kurrë së lexuari, së pari filma vizatimorë, që e di që i ke pikë të dobët, së shkruari e së vizatuari. Tregoj njerëzve për jetën tënde, lëre shenjën tënde në këtë botë. Tani, dua të



të pyes. A e mban mend atë listë që ke krijuar, atë listë për gjërat, të cilat do të bëje para se të ishte tepër vonë? Në qoftë se po, atëherë më thuaj a e keni përmbushur? A i ke lexuar ato mijëra libra, vizituar vendet e botës e shpëtuar dhe adoptuar ato kafshë që ëndërroje? Tani që kujtohem, sa kafshë ke dhe a i do aq shumë sa e doje qenin tënd të parë?

E di që po zgjatem shumë, por po përpiqem të të rikujtoj sa më shumë gjëra. Shpresoj të jesh sa më mirë dhe që do të të mbushen sytë me lotë për gjithë këto kujtime. Shpresoj ta ruash këtë letër e të jesh disi krenare për veten tënde 15 vjeçare.

Të uroj fat, Jona

**Jona Karçini 9G**



I dashur Erald,

Kam pasur shumë dëshirë për të folur me ju. Sa shumë gjëra dua t'ju them! Ju kërkoj shumë ndjesë që nuk ju kam shkruar, se kam qenë pak i ngarkuar duke u marrë me shkollën. Megjithatë e di se shkolla është shumë e rëndësishme, sepse kam marrë shembull nga ju, që keni bërë gjithë këto arritje fal saj. Ndaj unë i kam vënë qëllim vetes të bëhem si ju me një perspektivë për të ardhmen time. Kam dëshirë edhe unë të bëhem një biznesmen aq i fuqishëm sa ju. Ju uroj shumë mbarësi me fabrikat dhe dyqanet tuaja të reja, por dhe për bizneset e trashëguara! Ju dhe vëllezërit tuaj jeni trashëguesit e denjë për traditën e bukës së veçantë "Nela". Diçka që admiroj te ju, është ecja juaj në "hapa të sigurt". Që pas përfundimit të universitetit për ekonomi deri te fuqizimi i biznesit tuaj, shoh zbatimin e shprehjes: "Mendo dy herë, para se të veprosh". Imagjinoj se zemërgjerësia dhe zgjuarsia s'ju kanë lënë në baltë. Gjithmonë ju nuk harroni nga keni filluar dhe jeni i gatshëm dhe i pranishëm në shumë momente, kur njerëzit kanë nevojë për ndihmë. Ju përcillni një mesazh shumë të rëndësishëm për shoqërinë tonë, i cili është që sado lart që mund të ngrihemi asnjëherë nuk duhet të harrojmë, ku i kemi nisur hapat e parë dhe duhet të jemi sa më human me të tjerët dhe t'i ndihmojmë të ngrihen në jetë. Ndonjëherë mendoj për pamjen tuaj. Ju përfytyroj me pamjen e një kreshniku të vërtetë, ku dallohet trupi i madh, flokët e zinj dhe shpatullat e gjera. Në mendje ju shoh përkrah një bashkëshorteje shumë të hijshme dhe dy fëmijëve të mrekullueshëm. Po e mbyll letrën time me një urim të përzemërt, që të keni vetëm momente të gëzuara e të lumtura. Me respekt

**Eraldi Nela 9G**



I dashur Gerald,

Është e vërtetë që gjërat vështirësohen kur rritesh dhe koha më argëtuese është fëmijëria. Por çfarë kuptoj ndërkohë që rritem? Ti mund të arrish gjëra madhështore. Arsyeja që jetoj është që një ditë ta shoh botën nga sytë e tu të lumtur dhe të kem gjithë ato arritjet fantastike që ke ti. Tashme ti e di kuptimin e dashurisë, e miqësisë dhe jetës tënde. Edhe në qoftë se gjithë bota është kundër teje, unë do të mbaj krahun tënd dhe jam i sigurt, që nuk do të jem i vetmi.

Ende nuk e kam ndarë mendjen për shumë gjëra. E ardhmja është një mister për mua. Jam kurioz për çfarë ke vendosur të bësh dhe mënyrën se si do të jetosh.

Arsyeja që kam dashur të jem i famshëm ka qënë që të gjithë të më kenë pranë, njerëz nga e gjithë bota. Giithmonë kam dashur t'i tregoj botës se ç'mund të bëj dhe jam i sigurt që do vazhdoj të dua. Me këtë letër po tregohem shumë pozitiv, megjithëse e di që mund të ndodhin dhe fatkeqësi. Kam besimin më të madh te ti. Jam i sigurt që nuk ke lënë askënd të të pengojë në rrugën tënde, sepse në qoftë se nuk besoj te vetja ime, kujt do t'i besoj? Gjithmonë kam ndryshuar dhe do vazhdoj të ndryshoj, sepse dua të bëhem më i mirë se ç'jam. Të di më shumë dhe të arrij shumë herë më shumë se ç'mundem. Gjëja më e rëndësishme për ty është familja jote. Ti jeton për ta dhe veten tënde. Nuk mund të dështosh, në qoftë se gjithçka e bën për njerëz kaq të rëndësishëm për ty, thjesht nuk mundesh. Do kisha shumë dëshirë që të më shkruaje ti njëherë, pasi e ardhmja për mua është e panjohur, unë nuk mund të të këshilloj, ashtu si ti mua, por thjesht mund të shpreh ndjenjat e mia. Me siguri është bukur të dëgjoj nga vetja ime. Duke shprehur ndjenjat e mia, shpresoj me gjithë zemër të të kujtohet se si ke qënë dhe se si je ndërë dikur. Do sigurohem të të dërgoj edhe ndonjë video, ndoshta disa video, sepse e adhuroj mënyrën sesi mbushem me pyetje dhe gjithë ai kuriozitet që më pushton, kur mendoj për të ardhmen.

Me dashuri

**Gerald Qato 9G**



E dashur Lucy,

Nuk e ke idenë sa shumë jam menduar për këtë letër. As nuk jam e sigurt se si ta filloj. Besoj se po e nis me një pyetje paksa retorike: Si je? Të tregohem shumë e sinqertë, do të thoja se e kam të vështirë ta shkruaj këtë. Siç e mban mend, që e vogël kam menduar gjithmonë për të ardhmen time, dhe kam pasur mendime nga më të ndryshmet. Po të flas pak për veten time tani, në mënyrë që të të qartësoj ose ndoshta dhe të të kujtoj.

Jam 15 vjeçe. Më pëlqen muzika deri në pikën sa nuk imagjinoj dot jetën pa të. Luaj kitarë prej pothuajse një viti. Mësoj gjermanisht. Synoj të shkoj jashtë për



studime të larta me shpresën se do t'ia dal. Kjo ishte një nga arsyet pse doja të gjeja një mënyrë për të mos ta shkruar këtë letër, sepse me shpresën time të madhe vjen dhe frika. Frika nga zhgënjimi. Frika të di mos kam dështuar. Kam arritur në atë fazë, ku më në fund vetëbesimi im po rritet dhe çdo gjë e marr më lehtë (përveç provimeve të shkollës), aty po që më kap ankthi. Do të isha e gëzuar, në qoftë se do të isha kështu dhe pas njëzet viteve, por nëse tregohem realiste, shanset janë të pakta, duke marrë parasysh faktin se jam në zhvillim e sipër dhe jam pothuajse 100% e ndryshme nga ajo që isha tri vite më parë. Prandaj nuk po të pyes se çfarë zgjedhesh ke bërë, sepse unë kam besim tek ty. E di që nuk bën zgjedhje të pamenduara. Kjo nuk ka për të ndryshuar kurrë. Jam e sigurt që ke bërë dhe gabime, shmangia e tyre është e pamundur, por jam e sigurt se ke mësuar prej tyre. Besoj se ajo ç'ka doja të të shkruaja, nuk kishte qëllim të të pyeste se ku je në jetë, apo sa ke ndryshuar, por për të të pyetur, pikërisht, për mua.

Unë akoma nuk e njoh veten time. Çdo ditë mësoj gjëra të reja, çdo ditë ndryshoj. Por s'dua të të pyes për këtë. Mendoj se dua të të pyes se çfarë mendon për mua. Nëse ndihesh sado pak krenare për mua, versionin tënd 15 vjeçar, ëndërrimtaren e gatshme për të bërë gjithçka për të fituar. Nëse mendon pozitivisht për mua, apo thua se isha nga ato të çuditshmet. Dhe kurrë mos harro, se unë të dua ashtu si je, pavarësisht çdo gjëje. Po e mbyll këtë letër të çuditshme. Me dashuri, Lucy 15-vjeçare.

**Lucy Skifteri 9G**



I dashur Kristi,

Shpresoj që kjo letër të të gjejë mirë. E ardhmja është diçka aq e panjohur, por dhe mjaft interesante. Gjithmonë të kam përfytyruar si një njeri intelektual, i mirarsimuar dhe një model frymëzues për t'u ndjekur. Fëmijëria jote ka qenë e bukur dhe plot ngjyra. Besoj se nuk i ke harruar ditët kur luaje futboll dhe njëkohësisht i përkushtohesh mësimëve. Shkollën duhet ta kesh mbaruar në një universitet prestigjioz jashtë vendit, me rezultate të shkëlqyera. Të kam ndjekur me kujdes dhe jam i lumtur që ia ke dalë të realizosh edhe ëndërrën tënde, duke u bërë një futbollist i njohur, i cili përfaqëson në mënyrë të denjë familjen dhe vendin e tij. Nuk e di se çfarë ke ndërmend të bësh pas futbollit. Unë do të sugjeroja që t'i përkushtohesh ekonomisë, për të cilën edhe ke studiuar. Nuk duhet të lësh mënjane edhe familjen, e cila është pjesë e rëndësishme e jotja. Të kesh familje të lumtur dhe të jetosh i rrethuar me dashuri, të ndihmon të jesh edhe një profesionist i zoti. Mbaje mend këtë nga unë! Mos i lerë pas dore fëmijët! Rriti ata me përkushtim dhe dashuri, ashtu sikurse kanë bërë prindërit me ty!

Pres të më shkruash! Me plot mall e dashuri! I yti, Kristi

**Kristi Dushku 9G**



E dashur Nola,

Kam menduar të të shkruaj disa herë, por nuk e kam marrë guximin, sepse disa gjëra të vogla, kur rritesh, ndryshojnë, por këto gjëra të vogla, sado të vogla të jenë, ndryshojnë një pjesë tënden. Edhe pse tani jam akoma e vogël, mendoj pothuaj se dita-ditës për ty. A do të jesh mirë? Si po jeton? Në çfarë ambienti? Të të them të drejtën pyetja "si je?" më mundon më shumë... Nuk e di a je akoma në jetë, sepse gjithë këtë kohë... ne nuk kemi folur, nuk kam marrë asnjë lajm nga ti, asnjë shenjë të vetme.

Por unë ..., por unë do të luftoj për ty. Do të luftoj sa jam e vogël, në fakt nuk e di akoma, pse po e quaj veten të vogël, sepse unë e di që thellë brenda meje unë nuk jam një fëmijë, ashtu siç di sa mendojnë. Gjithsesi në krahasim me ty, mund të quhem ende e tillë. Do të luftoj tani, sepse dhe siç thotë një shprehje... "Fillimi i mbarë gjysma e punës".

Ti e di, unë kam shumë dëshira. Njëra prej tyre është që të ndihmoj njerëzit në nevojë, të pastrehët... Dua që të bëj një ndryshim, një ndryshim sado të vogël në botë. Dua që të gjithë të ndihen mirë me veten e tyre. Paqja dhe barazia të mbizotërojnë tek të gjithë ne. Por, që kjo gjë të arrihet, duhet të jem një person i njohur. E di, kjo gjë nuk është e lehtë, madje kjo është shumë e vështirë. Por unë e njoh veten time, të njoh ty shumë mirë... E di që në një mënyrë ose tjetër ti do ta arrish dëshirën tënde më të madhe. Mos u dorëzo!

Edhe pse unë tani kam shumë dëshira... edhe ti më kupton. Por jeta është e tillë, që njeriu lind, jeton edhe vdes... Ne, një ditë, nuk do të jemi në jetë, kështu që, edhe nëse ne nuk e arrijmë dëshirën tonë më të madhe... nuk më duket ndonjë problem i madh, sepse në fund asnjë nuk do të jetë më ..., por gjurmët në jetë do të mbeten gjithmonë.

**Nola Pashaj 9G**



I dashur Serxho,

Unë jam ti, dhe pse mund të të duket e çuditshme, dua të më dëgjosh deri në fund. Ti ke qenë një fëmijë shumë i dashur, i kujdeshëm dhe gjithmonë shumë inteligjent.

Shpresoj se e njeh veten tënde fëmijë dhe sërish shpresoj të mos kesh ndryshuar. A je ai që ke dashur? A ndihesh i arrirë brenda vetes? Besoj se po, sepse ishe shumë i vendosur dhe një djalosh me vullnet të madh. Je aq i kujdeshëm dhe i dashur ndaj atyre personave që të deshën e i deshe? Besoj se po, sepse ishe një fëmijë me zemër të madhe e të pastër. Sot që ti po e lexon këtë shkrim ke arritur të çash ne jetë e të arrish aty ku doje.

Kjo letër që ka udhëtuar në kohë që të lexohej nga ty, është jo më shumë se një falenderim për ty. Dua të vazhdosh i vendosur rrugën tënde e të mos harrosh kurrë se askush nuk mund të të ndalojë, këtë mos e harro kurrë. Me dashuri, Serxho i vogël.

**Serxho Orhani 9G**





I dashur Gledjon,

Kurrë nuk e kisha menduar se do t'i shkruaja vetes sime. Por me sa duket e bëra. Kam shumë pyetje në mendjen time dhe jam kurioz të di gjithçka që ka ndodhur 20 vitet e fundit.

Me shumë mundësi i ke arritur të gjitha qëllimet dhe ëndrrat e tua, por edhe nëse jo, mjafton të jesh i lumtur dhe ta kalosh jetën sa më mirë. Jam kurioz të di, nëse ke arritur të bëhesh aktor i njohur apo jo? Jam kurioz të di, nëse akoma e dëgjon muzikën që dëgjoje këto ditë apo jo? Mendoj se i ke hequr syzet dhe je gëzuar shumë për këtë gjë. 20 vjet janë shumë dhe them se ke ndryshuar shumë. Mos harro të vizitosh prindërit herë pas here, sepse ata mërzhiten shumë vetëm. Mos u ndiko nga fjalët negative të njerëzve të tjerë. Kurrë mos hiq dorë nga ëndrrat e tua! Mbaje gjithmonë kokën lart dhe do ta shohësh që gjithçka do shkojë për mrekulli. Me pak fjalë, shpresoj të kalosh sa më mirë dhe të jesh i lumtur në jetë. Mundohu të zgjedhësh gjithnjë alternativat më të arsyeshme dhe ki besim në vetvete!

Të uroj gjithë të mirat, Gledjoni Tiranë, Shqipëri.

**Gledjon Haldeda 9G**

*Klasat e 8-ta*



I dashur unë

Shpresoj që kjo letër të të gjejë mirë. Kam shumë dëshira, që do doja t'i realizoja. Ka shumë gjëra që nuk i kuptoj dhe do doja që të isha sa ti, që t'i kuptoja. Kam shumë dëshira që kur të jem në moshën tënde, do doja t'i kem realizuar. Kryesorja është që t'i përfundosh të gjitha studimet me rezultate më të mira, të mbarosh universitetin dhe masterin që të jesh sa më i përgatitur për jetën. Dua që pritshmëritë që kanë njerëzit për mua, t'i kesh realizuar dhe t'i kesh bërë prindërit krenarë për ty.

Shpresoj që kur të jesh duke lexuar këtë letër, të kesh realizuar dëshirën që me babain dhe vëllain të keni kompaninë tuaj dhe të jesh duke dërguar përpara atë. Tani që po të shkruaj dua të them, që mua më pëlqejnë sportet dhe artet marciale dhe dëshirën për të marrë pjesë në kampionatet e ndryshme të këtij sporti nuk e di a do ta realizoj dot këtë gjë në këtë kohë.

E di që duhen shumë vjet që të bëhem 35 vjeç dhe e di që atëherë do kem dëshira të tjera dhe do jem i zënë me punë dhe impenjime të tjera, por ashtu siç thotë edhe babai mendoj që do më marrë malli për fëmijërinë edhe për shkollën. Shpresoj të kem një vilë të bukur dhe një makinë të mirë. Shpresoj që tani që po lexon këtë letër, je i rrethuar nga njerëz shumë të mirë dhe që të duan dhe bëjnë gjëra shumë të mira për ty.

Me dashuri ti.

**Erik Peshkëpia 8A**



I dashur Afrim,

Kur isha 13 vjeç, unë bëja shëtitje në vende të ndryshme të Shqipërisë, por jo vetëm, si për shembull Berat, Shkodër, Llogara, Sarandë, Dibër, Vlorë, etj.

Kam shkuar shumë shpesh në Amerikë, pasi atje është dhe shtëpia ime e dytë. Atje vizitoja Shtëpinë e Bardhë, një nga ndërtesat më të bukura në botë. Më pas, isha te Statuja e Lirisë, e cila ka një histori të bukur që ka lidhje me popullin francez. Franca i dhuroi Amerikës një statujë shumë të bukur në shenjë mirësjelljeje. Një nga pushimet më të bukura që mbaj mend, është edhe pushimi në Turqi, atje ku kam provuar sportet ujore për herë të parë. Një nga eksperiencat më të bukura, është padiskutim shëtitja me balonë, ku mund të shihje mjaft bukur çdo lëvizje që kryenin njerëzit, pavarësisht se i shihja shumë të vegjël. Kur mbusha 9 vjeç, gjyshi më mësoi se si t'i jepja makinës. Ajo ditë ishte shumë e bukur dhe qesharake, sepse vëllai im përplasi makinën. Gjithashtu, mbaj mend një episod që ka ndodhur në Amerikë. Një ditë, vendosëm të iknim në një ndeshje bejsbolli. Atmosfera e krijuar ishte mjaft entuziaste, pasi të dyja skuadrat luajtën shumë mirë, aq sa fituesi u nda me vetëm një pikë, por fatkeqësisht, skuadra fitimtare nuk ishte ajo që unë mbështetja. Mund të them që kam kaluar një fëmijëri të bukur dhe me plot eksperiencë.

**Afrim Hima 8A**



I dashur Klejdi i vitit 2051,

Jam unë i vitit 2016. Po të shkruaj për atë detyrën që kishim në gjuhë.

Pra si i ke gruan dhe fëmijët, mirë? Pra, duke njohur veten, besoj se je, ose avokat, ose rreper. Nëse je avokat, sa njerëz ke nxjerrë nga burgu, ose nëse je rreper sa albume ke nxjerrë? Besoj se ke fituar ndonjë çmim Nobel, ose të paktën një Gremi. Kaq po të them tani bye.

Shihena mbas 35 vitesh.

**Klejdi Kaziu 8A**



E dashur Ola,

Tashmë je 35 vjeç. Po ta dërgoj ty këtë letër që pas 22 vitesh shpresoj të kesh mbetur e njëjta. Me çiltërsinë e dliresinë tënde. Shpresoj që horizonti të jetë i hapur për çfarëdo që ti ke dëshirë. Unë 13 vjeçarja shpresoj që ty të të jetë realizuar çdo dëshirë që pate përzemër. Të përfytyroj gjithmonë në shtëpinë që ke dashur, me punën e ëndrrave e me familjen sa më afër perfekte. E mbi të gjitha dua që jeta jote të jetë ashtu siç ti e ke dashur përherë, e qetë, e lumtur dhe e mbushur tërë dashuri, por natyra jote fëmijërore, mos të zhduket kurrë nga ty si dhe dëshira për aventura, për të parë botën, e për të zbuluar vende të tjera. Ama uroj që frika jote nga qentë të zhduket. Unë teksa po shkruaj këtë letër po përjetoj shumë ndjenja të ndryshme dhe kam një dëshirë të zjarrtë që ti, unë 35 vjeçarja, t'i kujtosh këto ndjenja. Dhe me emocionin më të flaktë të uroj që jeta jote të jetë siç e ke dashur. Me shumë dashuri, Unë 13 vjeçarja.

**Arjola Nuredini 8 A**



E dashur Adela,

Po të të shkruaj këtë letër, që kur të arrish në moshën 35 vjeç, të shikosh realizimin e ëndrrave dhe dëshirave që ke dëshiruar. Dua të arsimohem në shkollat më të mira dhe me rezultate sa më të mira. Pasi të mbaroj shkollën e mesme, dua të ndjek studimet e larta në degën e interior design. Kjo degë është e preferuara ime, sepse dëshiroj t'i bëj ambientet e njerëzve sa më të këndëshme dhe të rehatshme.

Mbas mbarimit të shkollës së lartë, dua të mbaroj masterin në këtë degë që të arrish aftësitë e mia profesionale. Kam dëshirë të krijoj një aktivitet timin privat me emrin tim, logon time dhe me dizenjot personale të miat. Dëshiroj që bashkë me këtë të kem përmbushur edhe jetën time familjare.

Adela, kur ta lexosh këtë letër, shpresoj dhe dëshiroj të ndihesh e lumtur dhe e plotësuar me arritjet e tua.

**Adela Xihani 8A**



E dashur Isli!

Si je? Besoj se ke ndryshur. Por ti mbetesh prapë ajo Isli vogël trazovaçe, nazelie dhe pak ledhatare e me ato prapësirat e tua. Nejse kane kaluar 23 vjet dhe ti je më e pjekur. Por ke lënë shumë kujtime pas. Sidomos kur ti haje çokollatat dhe patatinat fshehurazi mamit, e letrat i hidhje pas krevatit. Ty të pëlqente shumë të bëheshe mësuese. Shpresoj që tani, ti je duke punuar në zyrat e shtetit si avokate për të vendosur drejtësi në vend siç e kishe qejf dhe atëherë. Hahaha më kujtohet dhe kur i lodhje aq shumë zyshat me veprimet e tua prandaj hoqe dorë nga profesioni i mësueses. Të pëlqente t'i kishe të gjitha per vete. Bobo... ishe shumë kërnace. Por hëm edhe pak e "e keqe". I ktheje shumë fjalën prindërve. I mërzijsje ata çdo ditë sidomos mamin, se babin e kishe shumë frikë. Kur ai vinte në shtëpi i lodhur ti fshiheshe mbas mamit, por mami nuk i thoshte gjë, sepse të donte shumë. Aty kuptova fjalën NËNË. Sepse nëna ishte e gatshme të sakrifikonte dëshirat e saj për të siguruar nevojat e fëmijës. Çdo ditë më ofronte dashuri, butësi, e dhembshuri. E mërzijsja shumë, saqë një ditë fillova e mora me të mirë duke iu shprehur: "Nënë je gjëja më e shtrenjtë në botë për mua që deri në frymën e fundit nuk të braktis kurrë". Ajo që të gjitha i bën, të gjitha i përjeton. Dashuria e nënës është dashuria më e sinqertë në të gjithë rruzullin tokësor. Të dua Nënë! Në këtë botë do doja që të mos ndryshonte kurrë FAMILJA. Por jo të gjitha na realizohen dhe janë disa gjëra që ne nuk i ndryshojmë dot. Tani shkoi vonë, po e mbyll. Edhe pse ne jemi të vegjël mendoj se duhet të kemi ëndrra për të ardhmen dhe të besojmë në to sikur do të plotësohen nesër. Mendoj se me rëndësi është që të mendosh për të ardhmen, sepse e ardhmja të pret, por e kaluara shkon dhe nuk mund ta kthesh!! Me dashuri ti.

**Isli Zeneli 8A**



I dashur Klaudio 35-vjeçari,

Sot që po të shkruaj, jam në moshën 14-vjeçare dhe jam në klasën e tetë. Jetoj në Tiranë. Vazhdoj shkollën 9-vjeçare në kolegjin "Turgut Özal". Lënda ime e preferuar është gjeografia dhe kimia. Më pëlqen shumë të luaj futboll. Deri në moshën 35 vjeçare, do të jem një lojtar i një ekipi të huaj. Kam dëshirë të jetoj në kryeqytetin e Gjermanisë, Berlinin. Dua të kem profesionin e avokatit dhe të drejtoj kompaninë time në Gjermani. Dua të kem një familje të lumtur, ku të marrë atje edhe prindërit e mi. Dua të jem i stabilizuar, me dokumente e me shtëpi në Gjermani. Dua që jeta ime të jetë me të ardhurat e mia, siç jetoj unë sot me të ardhurat e prindërve. Në moshën 35 vjeçare, kam shumë dëshirë të drejtoj një shoqatë bamirësie për fëmijët me aftësi të kufizuara. Po ashtu kam edhe plot dëshira të tjera. Shpresoj që të gjitha të realizohen. Mirupafshim në moshën 35 vjeçare.

I njëjti,

**Klaudio Tozaj 8A**



Ç' kemi Gledis,

Kjo letër ka qenë një detyrë e klasës së tetë. Shkruaji një letër vetes tënde 35 vjeçare. Shpresoj të bëj një punë të mirë...

Po mendoj për gjërat që dua të kem arritur me 35 vjeç. Dua të kem punën dhe familjen e ëndrrave të mia. Të jem e rrethuar nga njerëz që më duan. Dëshiroj të ndjehem e rëndësishme, të dallohem nga masat e njerëzve, të jem e veçantë. Dua të ndiej që kam bërë një ndryshim, dua të di që do mbahem mend. Dua që jeta jote të ketë pasion, dashuri, por edhe pak aventurë dhe rrezik.

Nga kjo kohë që po të shkruaj, dua që të mbash mend gjërat që ke kaluar, mësimet që ke marrë nga gabimet që ke bërë. Dua të mbash mend gjërat që ke fituar e të dish t'i vlerësosh ato. Dua të bësh gabime dhe të dalësh më e zgjuar, të humbësh, por të bëhesh më konfidente në vetvete, të trembesh një herë nga e panjohura, por mos të jesh më e frikësuar nga ajo. Dua të mbash mend kohërat e vështira dhe personat që të ndihmuan t'i kalosh ato, por edhe të harrosh ato persona që i krijuan ato kohëra për ty.

Shpresoj që një ditë të hapësh sytë e të gjesh veten në një përrallë. Do kuptosh se do të jetë pak më ndryshe se ato që lexoj unë tani. Kështjella nuk do të jetë tamam kështjellë, dhe nuk është e rëndësishme a do jetë "e gëzuar përgjithmonë"; rëndësi ka të jetë e gëzuar në ato momente. Nuk duhet të ketë patjetër zogj që këndojnë, ose petale lulësh që bien nga qielli, dhe do ketë ditë kur lumturia s'do jetë aq e panishme sa në momentet më parë, sepse jeta nuk është një përrallë. Në atë moment që e realizon këtë gjë, dua që të ndalosh për një moment, të shohësh rreth e qark, të marrësh frymë thellë, të shijosh momentin, të ndjesh magjinë dhe të vlerësosh gjërat e mira që ke në jetë.

Nëse mund të të jap një këshillë, do ishte, se nëse e do një gjë me të vërtetë, atëherë lufto për të, dhe kurrë mos u dorëzo, sado e paarrtshme të duket. Nuk dua që të mendosh pas 10 vitesh, "Po sikur t'i kishe dhënë dhe një shans të fundit, të ishe munduar dhe një herë." Nuk dua të jesh spektatore e jetës, dua të jesh lojtarja më e fortë. Luaj, ndrysho rregullat, mashtro pak dhe ndalo vetëm për të kuruar plagët. Por luaj sikur mos të ketë të nesërme. Dua, që kur gjërat të ndryshojnë dhe të jesh përballë me të panjohurën, mos të trembesh e të mendosh më të keqen, por të futesh në mes të saj dhe të mendosh se do jetë brilante. Nuk do ketë zgjidhje të gatshme, as përgjigje të thjeshta, çdo gjë do duhet ta menaxhosh vetë, ta gjesh vetë zgjidhjen dhe përgjigjet, të luftosh rrugën tënde për të kaluar çdo gjë. "Sekreti i suksesit është që të mos lësh punën e sotme për nesër." Kjo është një nga shumë proverbat që ke dëgjuar. Nuk mund të thuash që s'na kanë paralajmëruar. Kemi dëgjuar prindërit të na thonë mos ta humbim kohën kot, gjyshërit që na këshillojnë të ndajmë ditën e punët që do bëjmë, dhe poetat e shumta. Por unë dua që ti t'i shohësh gjërat në këndvështrimin tënd. Të bësh gabimet e tua, të nxjerrësh mësimet



e tua dhe të kuptosh, se të dish, është shumë herë më mirë, se të pyesësh, të bësh, është shumë herë më mirë se të pendohesh, dhe se humbjen më të madhe është gjithmonë më mirë mos ta provosh kurrë. Shpresoj që 22 vjet më vonë, ti të kesh arritur të gjitha këto gjëra, ta gjesh veten në një përrallë, të mos jesh më e trembur nga e panjohura, të kuptosh gjërat për të cilat ia vlen të jetosh, të pranosh jetën si të të vijë dhe të luftosh për ta bërë siç e do ti, të mos dorëzohesh kurrë, të luash sikur luan për jetën tënde, të gjesh lumturinë tënde, t'i lësh gjërat të ndryshojnë e personat të ikin, të marrësh shanset e tua të dyta, të menaxhosh e luftosh dhimbjen tënde në mënyrë që në fund të përfundosh saktësisht ku ti do. Kam besim tek ty. Shkruar nga ti 22 vjet më parë...

**Gledis Rusmali 8A**



Përshëndetje Ervini 35 vjeçar,

Shpresoj që të jesh mirë. Unë tani po ia kaloj shumë mirë. Tani jam në klasë të 8-të dhe kam shumë shokë dhe shoqe. Ne bëjmë shumë gallata bashkë dhe dalim bashkë. Shkolla jonë, është një nga më të mirat në Shqipëri. Ne mësojmë shumë gjëra atje. Shkolla jonë gjithashtu na bën shumë ekskursione si psh; në Shkodër, në Llogara, etj. Këtë verë unë isha në Amerikë dhe ishte shumë qejf, edhe pse nuk ishte hera e parë që shkoja. Një ditë mbaj mend që shkova në një ndeshje bejsbolli. Shkova me vëllain, babin dhe disa miq të babit tim. Na kontrolluan biletat dhe u futëm brenda. U ulëm në karrige, por pas disa sekondash na erdhi roja dhe na tha që ai nuk ishte vendi ynë dhe ne kaluam tek tribuna tjetër. Porositëm naços dhe hot dogs. Po luante Philadelphia kundër New York. Ishte shumë qejf, sepse ishte hera e parë që shkoja në një ndeshje bejsbolli. Në gjysmë të ndeshjes njëri lojtar e gjuajti topin dhe topi shkoi tek tribuna ngjitur nesh. Ajo ishte tribuna, ku ne ishim ulur në fillim të ndeshjes dhe topi ra po tek ato karrige, ku ishim ulur më parë, por fatkeqësisht nuk ishim ne atje dhe nuk e morëm dot topin. Fatkeqësisht në fund Philadelphia humbi. Pra ajo ishte një ditë shumë e bukur. Dhe tani ne jemi në shkollë. Ky është një vit i vështirë, por ne në klasë e bëjmë zbatimë shkollën me shakatë që bëjmë. Këtu po e mbyll këtë letër. Edhe një herë shpresoj që të jesh mirë.

**Ervin Hima 8A**





E dashur Jioana,

Nuk e di nëse do arrish ta lexosh këtë letër, por shpresoj shumë që po. Nuk e di, nuk jam e sigurt se çdo të ndodhë nesër, pas një ore, e jo më pas 23 vitesh. Sepse, ne jemi njerëz të thjeshtë, disa krijesa, që kanë një libër të rëndomtë, ku në faqen e parë është lindja e dënuar, në të fundit është vdekja e shumëpritur, por, e dyta është bosh, dhe pikërisht, ti, duhet ta mbushësh atë boshllëk, por ki kujdes. Mos lejo të ta shkruajnë të tjerët. Je ti dhe vetem ti, ajo që vizaton jetën tënde të pacaktuar. Nuk e di nëse, pas 23 vitesh, do të kesh të njëjtin stiolaps, tavolinë, të njëjtën gjatësi të gishtit të pafajshëm, apo të trupit, në do kesh të njëjtën shtëpi, rreth shoqëror, mendje, mendime, apo dhe zemër. Të gjitha këto, mund të ndryshojnë, por vetëm për diçka jam e sigurt, që dashuria dhe ngrohtësia që ti ndjen kur mbështet kokën tek gjoksi i nënës, nuk do të ndyshojë. Jioana, ki kujdes nga gjithçka, nga vendet, sendet, por kryesisht, nga njerëzit, mendohu dy herë para se t'i besosh. Kam dhe një dëshirë të fundit <<Mos harro>> se kur ke qenë 13 vjeç, je lodhur së bëri diçka, dhe shpresa për të ardhmen të ka ngritur përsëri e ke thënë: "Jepi Jioana, mendo për të ardhmen, ëndrrat dhe mos i harro ato!" Shpresa, ndjenja dhe guximi, janë ato, të cilat na motivojnë për një të nesërme më të mirë.

Të lutem, mos më zhgënje, mos bëj të më shkojnë shpresat dëm. Kurrë mos resht së shpresuari, së qeni optimiste, pozitive dhe t'i kalosh të gjitha problemet me buzëqeshje.

JIOANA KUR ISHTE 13 VJEÇ♥

**Jiona Zhgaba 8A**



E dashur vetja ime në moshën 35-vjeçare,

Ç'kemi unë? Unë e di që ti do pyesësh çdo kjo vajzë që më ngacmon pas 23 vitesh. Ajo që unë dua të them është a ka ndryshuar shumë bota pas 23 vitesh? Është më e pastër apo është bërë më keq? Pyetja më kritike është: A ka më internet? Apo jetoni pa internet? Tani për tani e harrojmë të ardhmen dhe fillojmë me mua. Mos ki merak, nuk do filloj me fantazmat poshtë krevatit. Unë jam për këto gjëra tani. Kjo nuk do të thotë që s'kam fare imagjinatë. A ke dëgjuar ndonjëherë për familjen e fantazmave në bodrum? Poshtë apartamentit tonë. Po mirë mirë, po pushoj. Tani jam gati të të dëgjoj ty. Çfarë po thoshe? Aaah, po të pyesja unë. Mirë atëherë, çfarë universiteti kishe mbaruar? Çfarë pune kam? A jam e lumtur? Po me macen time çfarë ndodhi? Mos më thuaj që nuk jeton më? Besoj që ti do të shpikësh makinën e kohës dhe gjithashtu do kohë që t'i përgjigjesh gjithë pyetjeve që të bëra. Shihemi kur ti mund ta shpikësh makinën e kohës.

Unë para 23 vitesh...

**Meryeme Sevda Tok 8A**





E dashur Ines,

Mendime nga më të shumtat po kalojnë në kokën tënde për momentin, kureshtja për të nesërmen, përfytyrimi i një të panjohure jo krejt ndryshe nga ti.

Shpresoj mos të kesh ndryshuar shumë, të vazhdosh të jesh ai fëmija e çiltër, të cilit, krejt rastësisht, i lexohet gëzimi në sy, me atë pafajësinë fëminore, me atë kujdesin e tepërt dhe me ambicie për veten. Uroj që zemra jote, të jetë akoma e mbushur me atë mirësinë e pashpjegueshme dhe dashurinë e pamasë për jetën, që të mos kesh hequr dorë nga gjithë ato ëndrra dhe të vazhdosh të besosh në veten tënde. Uroj që as imagjinata jote e shfrenuar, të mos ketë ndryshuar, sepse janë këto pak cilësi që na bëjnë secilin prej nesh të veçantë. Në sytë e një 13 vjeçareje, gjithcka duket ndryshe. Jeta ndonjëherë mund edhe të krahasohet me një rrugicë të ngushtë, pa fund, në terr të pashpjegueshëm, ku ti asnjëherë nuk e di destinacionin, por mos u merakos. Gabimet dhe mësimet do të të udhëheqin për atje. Uroj, që jeta të mos jetë treguar e ashpër me ty dhe mos të kesh filluar të shohësh bardh e zi, sepse jeta është një shumëllojshmëri ngjyrash dhe ia vlen ta jetosh. Ti thjesht duhet të vazhdosh t'i krijosh vetes mundësi për horizonte të reja. Shpresoj të mos jesh bërë një njeri i mbyllur në vetvete, krejt i padëshiruar, sepse ndonjëherë, të rriturit ngrysen dhe e groposin fëmijën që kanë qenë dikur, thellë në humnerat më të panjohura e të pakonceptueshme brenda tyre. Shpresoj që ti ta mbash atë fëmijë të pafajshëm gjithnjë brenda zemrës tënde. Me dashuri, Ti, para 22 vitesh.

**Ines Bega 8 A**



I dashur Klevis,

Si po ja kalon? Shpresoj mirë, se ti je unë pas 21 vitesh. Pyes veten se çfarë do jem në të ardhmen. Unë dua që të bëhem inxhinier mekanik si babai im, por më parë e shoh veten si një nxënës që i arrin të gjitha ato që i kërkohen. E shoh veten si një nxënës që pavarësisht vështirësive del i pari. E mendoj veten 35 vjeç si një njeri të gjatë e të hollë, me flokë kafe, jo shumë të shkurtra. E mendoj jetën time të plotësuar nga të gjitha anët. Makina ime do të jetë më e fundit ndërsa telefonin tim e mendoj nga më të fundit të kohës. (Telefoni më duhet që të kontaktoj me të gjithë njerëzit që duhet për arsye pune).

**Klevis Mera 8A**





Përsëndetje Ti,

Shpresoj kur të arrish në një moshë si 35 vjeç të jesh një grua e pjekur dhe të vërtetosh se jeta që kalove nuk ishte e lehtë, por as e vështirë. Jeta do të ketë shumë zbritje e ngjitje, por ti thjesht duhet ta jetosh atë. Nuk duhet të jetosh për të kaluarën, por nuk duhet të jetosh as për të ardhmen. Më beso nuk ia vlen. Duhet të jetosh për çfarë je sot për çfarë ke arritur deri këtu si një vajzë kryelartë. Pavarësisht se jeta do të të vendosë në shumë sprova, ti duhet të mësosh të jetosh midis dy zjarrëve, të jetosh dhe të sillesh si një grua e rritur. Deri atëherë do të kesh kuptuar se kujt duhet t'i besosh e kujt jo. Duhet të mendohesh mirë dhe të mos lëndohesh me personin e parë që të njohësh. Të shoh tek sa po arrin majat e larta me përpjekje dhe me vështirësi. Më beso, do të jesh një grua, të cilën do ta duash jetën do ta duash dhe ta jetosh. Nuk duhet të jesh spektatore e saj, por lojtare. Por luaj sikur nuk ke të nesërme, vërtetoi botës se ti ia vlen, ia vlen për çdo gjë. Kurrë mos e le punën e sotme për nesër, kurrë mos mendo se të gjithë njerëzit janë të mirë. Mëso dhe do të fitosh...

Shoh që qenke rritur, je bërë një grua e suksesshme në jetë. Sërish dalloj disa tipare prej fëmije si: Ajo buzëqeshja lozonjare që të është gdhendur në fytyrë, atë krenarinë që e dallon me kilometra larg. Kjo krenari është fituar pas shumë viteve vështirësi, pas shumë rënieve, por shoh që ke mësuar nga gabimet dhe që je ngritur edhe më e fuqishme se më parë, je ngritur me një vizion tjetër për jetën. Ke mësuar që të dallosh se kujt t'i besosh e kujt jo, por gjithsesi sërish dallohet lehtë bujaria që ke pasur që e vogël. Pavarsisht se jeta të ka vendosur përpara sprovave të ndryshme, ti ke ngelur po e njëjta, sigurisht më e pjekur. Je bërë një grua që nuk varet nga askush, një grua e fortë, e cila mund të përballojë edhe një stuhi në qoftë se është nevoja. Sërish në një pjesë tënden, gjendet ajo ndjeshmëria e "burgosur" diku thellë, ajo ndjeshmëria prej një fëmijë të pafajshëm. Shoh që me thjeshtësinë më të madhe injoron çdo fjalë të pahijshme që thonë për ty dhe vazhdon rrugën kryelartë, sikur asgjë të mos kishte ndodhur. A e di se çfarë ka ndryshuar vërtetë nga ti? Ahh, janë ato të qarat shpeshherë pa kuptim, tani shoh që e ke kuptuar rëndësinë e atyre kristaleve të vegjël, ke kuptuar se nuk ke nevojë që t'i derdhësh për njerëz që shkojnë e vijnë, ke kuptuar se jo gjithkush do të qëndrojë pranë teje. Me pak fjalë, ke kuptuar se jeta është e vështirë, por mjafton vetëm një shkëndijë që ta kthejë atë në një përrallë magjike, në një vend ku ia vlen të jetohet.

**Klara Morinaj 8A**





Përshëndetje Klevis,

Unë tani jam fëmijë dhe si çdo fëmijë, kam shumë ëndrra për të ardhmen time.

Unë po ndjek një shkollë shumë serioze, ku mësimi bëhet shumë seriozisht dhe rregullisht, kështu që kam të drejtë për një profesion shumë të mirë dhe të nderuar. Nëse do të shohim anketat e shumta që bëhen te fëmijët e grupmoshave të ndryshme, apo te prindërit në krye të listës së profesioneve të preferuara, ndodhet profesioni i mjekut. Unë kam fatin e madh, që të dy prindërit i kam mjekë, kështu që dëshira ime, është të bëhem kardiokirurg. Unë kam shumë dëshirë t'iu shërbej njerëzve, t'i ndihmoj ata, t'iu shpëtoj jetën atyre. Unë e di që është një profesion shumë i vështirë, që kërkon shumë mund dhe sakrifica, por shpresa për një botë pa sëmundje, më bën shumë për vete. Pas mbarimit të gjimnazit, unë do të shkoj në fakultetin e mjekësisë në Tiranë. Është një fakultet shumë i bukur, por edhe shumë i vështirë. Studentët më të mirë nga i gjithë vendi shkojnë aty. Konkurenca është shumë e madhe, dhe për studentët e mjekësisë nuk vlen nocioni i "kohës së lirë". Për çdo student tjetër, kjo mund të vlejë. Fakulteti i mjekësisë ka materialet më të fundit shkencore, ka eksperiencat më të çuditshme, ka raste nga më të paimagjinueshment, aplikohen arritjet më të fundit të shkencës dhe të teknologjisë. Më pas, dua të specializohem për kardiokirurgji në një spital të njohur në Gjermani. Është degë shumë e bukur dhe shumë e vështirë. Do të isha shumë i lumtur, që pasi ta mbaroja specializimin, të filloja punë në këto qendra spitalore, të operoja paciente të rëndë, dhe t'iu shpëtoja jetën atyre. Do të dëshiroja të isha pjesë e stafeve mjekësore të kualifikuar, pjesë e debatit shkencor dhe profesional, me profesorë dhe doktorë shkencash të shquar të këtyre spitaleve. Krahas punës profesionale, do të doja të kisha përfunduar dhe pjesën akademike. Të kisha marrë gradën shkencore të doktorit të shkencave mjekësore. E di që është një gradë shumë e vështirë për t'u marrë në vendet e zhvilluara, por puna dhe vetëmohimi im nuk do të mungojë. E di që kam zgjedhur një profesion shumë të vështirë. Puna në një spital të tillë, është një sfidë dhe provim i përditshëm, dhe unë besoj se do ta meritoj një pozicion të tillë.

**Klevis Hoxha 8A**





Përshëndetje Pamela,

Jam një vajzë që ti e njeh dhe di çdo gjë për të dhe çdo gjë që ajo apo më mirë unë kam kaluar. Siç edhe mund ta kuptosh, jam ti, para 21 vitesh. Teksa po e shoh veten në një pasqyrë të vogël, që kam në dorë mendoj të ardhmen time, mendoj për ty. Do të jetë aq mirë sa mendoj? Do të jem një vajzë ose më saktë, një grua e fortë e me një karrierë të madhe? Do të jenë arritur kërkesat e mia??? Mendoj e mendoj gjatë, por përgjigjet i ke vetëm ti. Sot po jetoj një jetë të lumtur, me një familje të dashur, me shumë shokë e shoqe e me një shkollë të mirë, që më formon për të nesërmen. Sot jam e mbushur me ëndrra e dëshira të panumërta. Si fillim dëshiroj të kem një karrierë të suksesshme, cilado të jetë ajo. Këto kohë jam pak e pavendosur për karrierën time. Ëndërroj të gjej atë personin ideal për mua, që do më bëjë të lumtur në cdo kohë. Dëshiroj të arrij në jetë shumë gjëra si nga çmimet e vogla shkollore po ashtu edhe ato më të mëdha. Dëshiroj ... Dëshiroj... eh, sa shumë dëshiroj. Një pjesë e madhe e imja mendon se gjithçka do të realizohet, por jeta ka të papritura plot. E ndërsa shkruaj nën dritën e hënës dalloj tek unë një person të fortë e plot shpresa. Besoj se këto cilësi nuk ndryshojnë. Kështu kam qenë që e vogël, e kështu do të mbetem. Nuk kam ndërmend të ndryshoj në këtë aspekt. Si një 14 vjeçare, i kuptoj mirë problemet e shoqërisë sonë. Tashmë jam rritur aq sa për ta kuptuar. E kuptoj se janë sa vetë qielli. Do të mundohem t'i kapërcej që në të ardhmen të jetoj sa më mirë. Hm... që ti të jetosh mirë. Me besim porsa deti them se unë jam dhe do jem mirë. Me një fëmijëri të lumtur, Pamela Mera 14 vjeç.

**Pamela Mera 8 A**



Përshëndetje Megi,

Po të shkruan vetja jote 22 vjet me parë ...

22 vite me parë kam qenë e lumtur duke njohur botën e ëmbël sa puthja e babit dhe e thjesht sa emri yt. Tani e di që gjërat për ty kanë ndryshuar, duhet të qëndrosh vetë në jetë dhe të gesh rrugët e tua, por prapë e di që je e lumtur duke luajtur lojën e jetës tënde... jetës së ëmbël sa emri yt. 22 vjet më parë doje të arrije sa më shpejt të 20-at, të rritesh me nxitim deri 25. Tani që je 35 e di që do rendësh për të kapur çdo mundësi, pa kthyer kokën pas, duke gjetur e lënë miqtë rrugës, duke mësuar nga gabimet e tua, duke u përballur shpeshherë me të panjohurën madje duke u munduar ta ngadalësosh kohën dhe e di që do ndalosh vetëm kur të kesh arritur gjithçka që ke dashur 22 vjet më përpara. Por dua që ta dish që edhe në moshën 35 vjeçare edhe kur të jesh nënë në ditët e vështira, në problemet që do të duken të pamundura dhe për t'i zgjidhur mund të vraposh drejt kujtimeve të fëmijërisë dhe mund të vraposh drejt kujtimeve tona të përbashkëta dhe do të ndihesh më e qetë, e sigurt dhe e paqetë. Këto janë urimet që i bëj vetes 22 vjet më vonë.

**Megi Gjyli 8A**



I dashur Marlis,

Për mua kjo nuk është një letër e thjeshtë që po të shkruaj, por kujtesa e dëshirave dhe ambicieve të tua për të aritur tek ëndrra. Ti Marlis do të kesh ndryshuar. Nuk e di se sa, këtë do ta kuptosh kur të lexosh këtë letër të shkruar nga një djalë 13 vjeçar. Sidoqoftë, je ende në vitet ku ëndrrat s'kanë mbaruar. Kalove nëpër faza që të formuan, të përgatitën të futën në rrugën e madhe të jetës. Të kujtohet? Pasioni për pianon dhe muzikën të ndiqte vazhdimisht. Kohë të tëra kaloje në tastierën e pianos dhe humbisje në botën e tingujve, të ritmit dhe e shijoje. Pianoja jote e vjetër duhet të jetë patjetër në dhomën tënde, e cila do të ketë ndryshuar. Do të kesh krijuar edhe këndin tënd të udhëtimeve, për të cilat gjithmonë ke qenë i apasionuar. E ke nisur që i vogël me Romën, Koloseun, Venecian, Firencen. Je mahnitur me muzeun e Leonardo da Vincit, i cili u bë idhulli yt. Objektivi yt ishte të shikojë të gjithë qytetet e bukura të botës. Besoj se do të kesh parë edhe Egjiptin dhe Indinë kulturat e bukura dhe mistike që i lexoje me aq ëndje në histori. Ëndërroje të bëheshe një kimist dhe të studioje në Amerikë, ku do të zhvilloje studimet e tua dhe kërkimet shkencore. Dëshirat e tua ishin të shumta, por objektivat i kishe të qarta. "Do të krijoj markën time të vajrave sintetikë për makinat. Do të krijoj kompaninë time internacionale.", kështu thojë.

Për ty, përpjekjet dhe puna ishin ritëm, si në muzikë dhe ti i ndiqje si duhet. Kjo të ndihmonte që idetë t'i ktheje në vepra.

Ti do jesh në kulmin e krijmtarisë tënde kur të lexosh këtë letër dhe do të habitesh se sa shumë energji dhe pasion ke patur brenda shpirtit tënd. Mos ndalo! Nëse ke nevojë të shplohesh, kujto me dashuri çdo gjë që ke kaluar. E shkuara është gjithmonë një forcë për të ecur përpara. Ti ece i rrethuar me dashurinë prindërore dhe miqësineë e shokëve të tu. Nëse kur të lexosh këtë letër ndjehesh vetëm, kujto shoqërinë. Mos harro që jetën tënde ta mbushësh plot dashuri dhe miqësi, sepse ato janë forca jote. Edhe nëse i ke harruar jam i sigurt që do të gesh forcën të rigjesh përsëri dashurinë e miqve, mësuesve që të kanë mbështetur. Mirënjohja është virtyt të cilën duhet ta përqafosh fort. Kur të marrësh këtë letër jam i sigurt se do ta kuptosh që jam unë që ta kam shkruar. Jam muzika brenda vetes tënde edhe pse nuk ka dërgues në fund të saj.

**Marlis Sejdiaj 8A**





Përshëndetje unë,

Tani që po të shkruaj, jam 13 vjeç. Kam shumë ngjarje dhe dilema, që dua të t'i shpreh. Kaloj kohë të qeta dhe mendoj për gjërat që do të më nevojiten gjatë kohëve në vazhdim, gjithmonë më ndryshojnë këndvështrimet sipas humorit që kam, por do të vazhdoj të mendoj, derisa të bie dakord me veten për vendimet e duhura. Midis orëve të vona që studioj për mësimet, kam problemet e shoqërisë. Ndoshta ty nuk të duken këto si probleme të vërteta, por ka raste, që më lënë kohë për t'u menduar si duhet të jenë lëvizjet e mia të tjera. Gjithmonë përpiqem për të treguar veten sa më mirë, megjithëse, askush nuk është perfekt. Më duket sikur krijoj përshtypje të mira tek ata që takoj në vendet që vizitoj, duke dashur të përjetoj eksperiencat e reja, për aq kohë sa më mbetet para se të rritem. Kur ndihem i frustruar nga mendimet e tepërta dhe nga presioni i mësimëve, kaloj në një ndjesi çlirimi, kur marr topin dhe luaj, tek ndiej djersitjen, që në një mënyrë të shqetësuar, më rrëshket në faqe, krejt pa dashur, duke nxjerrë të gjithë energjitë e mbledhura, gjatë një kohe të tensionuar, ku më pas, kërkoj të shtrihem, të pushoj dhe të vazhdoj ditët si normalisht. Shpresoj të kuptosh mendimet e mia, Sinqerisht nga ti.

**Keith Mici 8 A**



I dashur Samuel,

Si je vetja ime 35 vjeç? Ça bone?

Pa më thuaj si je? Si të shkojnë gjërat? Po puna? Po familja?

Më fal për gjithë këto pyetje, po dua të di se si e ke jetën tani që je 35 vjeç, sepse e di që do e kesh patur të vështirë largimin nga Shqipëria. Po të erdhi kjo letër, dua që të kujtosh të gjitha gjërat që ke patur i vogël si përshembull: ps2, X-box 360 apo Nintendo Ds. Mos të harrosh miqtë e tu më të mirë si Enriku, Eriku, Joni, Ralfi, Harvi apo Matiasi. Në fund, po jo më e parëndësishmja mos të më harrosh Barcelonën se të vrava pastaj. Shpresoj të më shkruash sa më shpejt... Me dashuri

**Samueli Gjençaj 8A**



Përshëndetje Marin,

Si ndihesh tani që ke mbaruar shkollën dhe ke ndërtuar jetën tënde personale? A ndihesh mirë që ke realizuar ëndrrat e tua, megjithëse nuk dyshoj, sepse e di që ke marrë një profesion që ke pas dashur që në fëmijëri. Je bërë një doktor i suksesshëm dhe mbi të gjitha ke një familje që të do shumë dhe ke disa fëmijë të mrekullueshëm. Tani ti jeton në Londër me familjen tënde. Cilat janë gjërat për të cilat je penduar me shumë dhe gjërat më të mira që ke



bërë në jetë? Tani bën një jetë shumë të lumtur dhe fëmijët i shkollon në disa shkolla shumë të mira që dhe ata të arrijnë rezultat që ke arritur ti deri më sot. Je shumë zemërmirë dhe bujar me të tjerët dhe çdo pacient që del nga klinika jote del i kënaqur dhe me dhëmbë të rregulluar. Më shkruaj sa më shpejt!

**Marin Baloshi 8A**



E dashur vetja ime!

Si do të jem në të ardhmen? A do i kem shoqet që kam tani? A do të jem e lumtur? Çfarë shkolle do të mbaroj? A do të zgjatem? Si përfundim, a do ndryshoj shumë apo do jem njëlloj. Dua ta lexoj këtë letër kur të rritem. Dhe të më kujtojë kujtimet.

Me dashuri Busra Kaya 13 vjeçe.

**Büşra Kaya 8B**



E dashur vetja ime,

Pasi të kesh lexuar këtë letër do të thotë që sapo ke mbushur 35 vjeç, 2038. Tingëllon kaq larg, por jam e sigurt se ti do të pyesësh veten se si kaluan vitet kaq shpejt.

Si do të jetë vallë jeta jote? A ke ndryshuar ndopak apo je e njëjta, gjithmonë e qeshur? A janë bërë ëndrrat e tua realitet? Çfarë profesioni ke? Unë për momentin dua të bëhem menaxhere biznesi. Nuk e di nëse ke ndryshuar mendim. Ku jeton? A ke marrë një shtëpi dhe e ke arretuar si ta doje? Çfarë filmash të pëlqejnë të shikosh. Po për muzikën, a ka ndryshuar ndopak në 2038 apo janë të njëjtat? Jazz, pop, rock. Besoj se do të jesh duke dëgjuar të njëjtën muzikë si dikur. Çfarë librash lexon në 2038? Libra me aventura, fantastiko-shkencorë, romane, novela? Sa qesharake po të pyes për kaq shumë gjëra, por jam shumë kurioze të di çfarë po mendon në këto momente që po lexon këtë letër. A të sjell ndopak nostalgji? Dua të di çmendon për jetën, tani që ke mbushur 35 vjeç? Në çfarë këndvështrimi e sheh? E di që po mendon se jeta është si një ëndërr dhe se vitet kaluan shpejt. Po shpresoj ta kesh kaluar e jetuar atë ashtu siç ke dashur e të kesh bërë gjërat që i ke ëndërruar gjithmonë. Më shkruaj edhe ti një letër, ku të më shkruash për aventurat që ke kaluar deri tani. Jam shumë kurioze t'i lexoj dhe të di që ti nuk më ke harruar, por gjithmonë më ke kujtuar dhe që unë kam zënë një vend të rëndësishëm në zemrën dhe në shpirtin tënd. E di që e zgjata pak, por shpresoj që ta lexosh këtë letër me kënaqësi.

Me dashuri nga Ester.

**Ester Albrahimi 8B**



Për veten time 35 vjeçe

Rruga jote do të ketë probleme e pengesa dhe do të ketë momente që nuk do të dish çfarë të bësh e ku të ndodhesh. Por gjithmonë do të ketë një derë të hapur, një derë e hapur nga familja jote dhe shoqet që ke. Ajo derë do të tregojë të keqen dhe të mirën për ty, siç ndodh edhe sot, dhe pse je rritur dhe je berë 35 vjeçe. A i ke arritur qëllimet? E di që nuk do të dorëzohesh. A bëhesh e lumtur nga gjërat e vogla edhe në këtë ditë dhe kupton vlerën e tyre? Mendoj që duhet të falenderosh prindërit e tu, që të ndihmuan të jesh ky njeri që je tashmë. Nuk dua ta zgjas shumë, por diçka dua të them; që kur të kujtosh të tashmen bëhu e lumtur, sepse ajo është gjithçka që ke. Nga vetja jote 22 vjet më parë.

**Ayşe Feyza Köksal 8B**



E dashur vetja ime,

Si sot mbas 35 vitesh unë nuk e di nëse ti do të jesh pak a shumë i njëjti person që je sot. Jeta do të bëjë të veten. Ajo do të ndryshojë në varësi të çdo problemi ose gëzimi që do të rastisë gjatë viteve. Ndoshta tani që po të shkruaj, ti nuk do të kesh më të njëjtat mendime siç kam unë tani, por besoj që një pjesë të mirë të gjërave që ëndërroj në këto momente do t'i kesh plotësuar, sepse njeriu bazën më të madhe e merr nga edukata familjare që në fëmijëri dhe shumica e ëndrrave të shumëpritura nuk zhduken. Gjithsesi mënyrat, se si neve na vë në provë jeta janë të ndryshme. E mban kur thjesht rrije e qetë pa i folur askujt dhe mbylleshe në botën tënde nga vetmia që ti nuk e përballoje dot, sepse të dukej sikur asnjëri nuk të kuptonte, kur doje të qaje brenda vetes për padrejtësitë që të bënin të tjerët. Ose vetë padrejtësia e jetës ishte akoma më e dhimbshme dhe e pamenaxhueshme. Ndiheh ai njeriu që ka vetëm një prind që e do më shumë se gjithçka, por, do, s' do i vijnë shpresat e humbura në mendje për të patur diçka si të tjerët. Nuk të kupton kush, kur nuk e ke problemin tek çfarë thonë ata për gjendjen tënde. Ka raste fajëson veten, ka raste fajëson të tjerët, sepse nuk di çfarë bën nga vuajtja për ta patur një familje të bashkuar. Çoroditesh, fillon e qan e s'të kupton njeri se si një fëmijë trajtoheshe si një mjet komunikimi i fjalëve të panumërta e të dhimbshme të prindërve të saj ndaj njëri-tjetrit. Mbylleshe dhe flije dhe shpresojë të mos zgjohesh dhe të shihje realitetin. E mban mend, kur të dukej vetja një në një milion dhe kujtoje se s' do të gjeje asnjëri, i cili të kuptonte çfarë mendoje, çfarë ndieje ose çfarë doje në të vërtetë, kur shprehesh tek shoqëria ndihesh e çliruar, por përsëri s' do të thoshte se ata do të zgjidhnin gjë. Ajo frika kur fillon të mendosh përse duhet ta vazhdosh jetën, kur nuk përshtatesh dot me botën, saqë çdo gjë të duket, akoma më keq, kur njerëzit e tu më të afërt nuk arrijnë të kuptojnë se çfarë kërkon ti nga ata, e jo më ta kërkojë prej të tjerëve. Njerëzit tanë duan





më të mirën për ne, por çdokush ka tipin dhe personalitetin e vet dhe e krijon atë sa nga prindi, aq edhe vetë. Personaliteti nuk krijohet krejtësisht nga prindi. Mendoj se prindi është ai që duhet t'i mbështesë edhe disa vendime të miat, jo vetëm në lidhje me arsimimin. Pretendoj se në moshën 35 vjeçare, ti do të kesh mbërritur çdo synim, por meritë e kësaj do të jetë edhe mamaja, e cila pavarësisht keqkuptimeve, të ka bërë një njeri plot vullnet dhe të fortë, por edhe ajo kokëderrësia jote për disa gjëra që ti i kishe të nevojshme, jo prej të tjerëve, por kryesisht për veten tënde. Ti do kesh arritur të kesh një shoqëri të qëndrueshme, nëse fati ta ka dhënë këtë gjë dhe do kesh filluar një pjesë të vështirë të jetës duke përfshirë çdo problem familjar. E ku të njeh njeri tjetër më mirë sesa ti veten tënde?! E di shumë mirë që je ai tip që do paqe midis të gjithëve dhe, edhe pse je rritur, do akoma që e mira dhe e keqja midis kujt do të jetë e balancuar. Ai çasti kur do, që çdo gjë të shkojë perfekt, por e di që edhe në këtë moshë je akoma personi që ia ka frikën së ardhmes dhe mendon shumë dhe e lodh veten për gjëra që nuk duhet ta bësh. Do që të kesh mendimin tënd duke marrë parasysh konsideratat e të tjerëve, por jo të bësh sic thonë të tjerët gjithmonë. Jam shumë e sigurt, jashtëzakonisht për ç'ka po them, sepse këto janë karakteristikat e veçanta të Arielit prej kohësh. Ehh, si përfundim po karriera? Ajo imagjinata jote e pafund që do të jetë zhvilluar në këtë moshë për shkak të njohurive që në vogëli, të cilat janë bërë prej atij pasioni të madh për arkitekturën që ti i çmendje të gjithë me pyetje për të marrë eksperiencë sa më herët dhe besoj se do kesh arritur majat tani prej asaj dashurie të madhe për këtë degë, ku nxirrje në dukje një pjesë se si e ëndërron ti botën e jashtme dhe e bën realitet me çfarë të mundesh. Tani me këto që po them, ti do kesh fituar përvojë të shumtë nga jeta dhe këto që po flas, nuk janë as gjysma, por e di që Arieli nëse ka një mendje dhe goxha synime, por që i do me të vërtetë, e di që i bën realitet pavarësisht gjithçkaje. Me shumë dashuri për Ty.

**Ariel Kabashi 8B**



I dashur Erjon

Shpresoj të jesh mirë me shëndet. Dua t'i kesh arritur të gjitha gjërat që ti ëndërron si; për shembull të kesh mbaruar universitetin dhe të gjesh një punë të mirë. Besoj që do të kesh ndryshuar shumë, jo vetëm nga pamja, por edhe nga karakteri, komunikimi etj. Dua të bëhesh më i miri, por edhe në qoftë se nuk e arrin dot, jep më të mirën tënde. Duhet të kërkosh sa më shumë nga vetja, që të arrish më të mirën. Me këto fjalë po e mbyll letrën time. Shpresoj që ta lexosh në të ardhmen.

**Erjon Çela 8B**



E dashur Sara 35 vjeçe

Të flas nga e shkuara. Nga ajo e shkuar, të cilën me siguri e kujton me shumë kënaqësi. Të marr nga koha, në të cilën bota për ty nuk ishte veçse një sferë e mbushur me kënaqësi. Të shkruaj, pasi jam shumë kurioze për çdo gjë rreth teje. Dua t'i di të gjitha. Por fillimisht si je? Shpresoj të jesh mirë. Dhe tani më lër të vazhdoj me pyetjet e mia. A je zgjatur? A je më e dobët? A jeton jashtë? Për çfarë ke mbaruar? Ke filluar punë? Besoj se po. Shpresoj që ti i kujton të gjitha nga fëmijëria jote. Tani më je mjaft e rritur prandaj dhe i kupton më mirë se vetë unë, veprimet dhe sjelljet e mia në këto kohë prandaj po të kërkoj të mos mërzhitesh shumë me mua, pasi ajo që ka ikur nuk kthehet më. Dua të të kërkoj edhe disa gjëra të tjera. Fillimisht do të doja që ti këtë letër ta lexoje ndoshta katër, ose më pak ditë përpara se të bëhesh 35 vjeçe, pasi dua që në drekën e 35 vjetorit tënd, të ishin të pranishëm të gjithë, sepse besoj se jeta të ka treguar se nuk duhet t'i harrojmë asnjëherë njerëzit më të vyer e më të dashur për ne prandaj kjo është ndër dëshirat e mia më të mëdha, të shikoja si dhe për pak çaste të gjithë së bashku. Besoj se do të kaloni shumë bukur ndaj dhe unë dua ta mbyll këtë letër duke të uruar edhe 100 vite të tjera të bukura dhe duke të të bërë dhe kërkesën time të fundit: Jetoje jetën!

Me shumë dashuri, E shkuara.

**Sara Osmani 8B**



I dashur Kevin 35 vjeçar,

Tani që po të shkruaj jam vetëm 14 vjeç. Unë kam vendosur disa qëllime në jetën time dhe shpresoj që në të ardhmen ti do t'i kesh plotësuar ato. Do të përmend vetëm qëllimet më të rëndësishme. Një nga qëllimet e mia është që të krijoj një familje me një bashkëshorte të mirë dhe fëmijë të dashur. Dua që t'i kem ata përkrah çdo mëngjes të jetës sime e të kaloj jetën me ta. Një qëllim tjetër që kam është që të kem një punë të mirë dhe me një pagë të lartë. Mundësisht do të doja të isha biznesmen i fuqishëm, pasi më pëlqen ta shoh veten serioz dhe me kostum. Një nga qëllimet e tjera është të vazhdoj të kem përkrahë prindërit, motrën dhe vëllain tim. Të mblidhemi çdo javë e të hamë një drekë së bashku, të diskutojmë për problemet dhe ngjarjet e javës dhe të rikthehemi në kujtimet e fëmijërisë. Një qëllim parësor është të jemi të gjithë shumë mirë me shëndet. Më pas kam shumë qëllime të tjera, por ndiej se kam përmendur ato në kryesoret. Shpresoj që kur të takohemi t'i kesh përmendur këto qëllime. Në atë kohë ti duhet të jesh bërë një burrë i matur e i kompletuar. Kam shumë besim tek ti dhe jam i sigurt që nuk do të më zhgënjesh. Shihemi pas 21 vitesh. Nga Kevin 14 vjeç.

**Kevin Hoxha 8B**



E dashur vetja ime,

Sot që ti po lexon këtë letër je 22 vite më e rritur se ditën që e ke shkruar. Tani që je 35 vjeç, dua të të kujtoj se në shpirt të mbetesh gjithmonë fëmijë. Mos harro të ecësh dhe të dëgjosh tingujt e gjetheve të vjeshtës, kur shkelen nga këmba jote. Mos harro kurrë kënaqësinë e lisharësës dhe numërimit të yjeve në ballkon natën vonë. Dua të të kujtoj të respektosh dhe të duash prindërit, njerëzit, që të qëndruan gjithmonë pranë. Tani që jam 13 vjeç, ende nuk i kuptoj vërejtjet e prindërve, por kur të lexosh këtë letër me siguri do të kesh fëmijë dhe i kupton më së miri. Mos kërko të jesh nëna perfekte, por kujto të gjitha herët që nëna jote të ka toleruar ty. Ndoshta atë ditë që do të lexosh këtë letër do të kesh realizuar të gjitha ëndërrat e tua. E nëse ka ndodhur kështu, atëherë duhet të jesh krenare për familjen, karrirën dhe të gjitha arrijtet. Nëse edhe pse je 35 vjeç, nuk i ke realizuar të gjitha ëndërrat, atëherë kujtohu që s'ka asgjë të pamundur, kujtohu që s'është vonë për të vrapuar pas ëndrrave. Duaje veten tënde dhe mos harro të nxjerrësh ditarët e vjetër nga kutia e groposur në pemën e fundit të oborrit. Rregullo kaçurrelen e pabindur të anës së djathtë para se të dalësh.

Ti!

**Ledja Allaraj 8B**



Ç' kemi,

Shpresoj që kur ta jesh duke lexuar këtë letër, të jesh bërë një njeri studioz, i nderuar, dhe një kirurg i mirë. Të pëlqen më të vishesh si më parë? A të pëlqen të luash Go-Kart ose Paintball, po bilardoja vazhdon të të pëlqejë? Tedin e ke më shok ose Eljon? I mban mend kohët e bukura që ke kaluar me ata? A je martuar? Tani jeton në Tiranë apo ke lëvizur? A të pëlqen të udhëtosh më si më parë? Shpresoj që sushi të jetë ushqimi i preferuar. Mendoj se makinën e preferuar dhe shtëpitë e mëdha t'i kesh blerë. Shpresoj mos të të ketë rënë shpejtësia e rutinës së ditës. Po tani a e vazhdon notin intesivisht si atëherë? Mendoj se me fëmijët luan shumë, aktivitete, not, futboll. Mos harro t'ia mësosh dhe makinën kur të kenë vajtur 13 vjeç. Po tani çfarë zhanri muzikor dëgjon? Në qoftëse je bërë kirurg ku ke studiuar?

Me dashuri.

**Eno Koliçi 8B**





I dashur Patrick 35 vjeç,

Unë jam Patrick Kola dhe jam 13 vjeç. Jam në klasën e 8B. Unë po studioj shumë në shkollën time. Po ti a po punon shumë në punën tënde? A je një biznesmen i madh? Nëse po, unë do të ndihem shumë i lumtur? Unë kam shkuar në shumë vende të botës, mund të kemi shkuar në më shumë se 10 shtete. A ke shkuar në më shumë se 20? Unë pas disa ditësh do të iki në Barcelonë. Unë po ia kaloj shumë mirë, por si gjithë njerëzit me problemet e mia. Po ti, a po ia kalon mirë? A ke një bashkëshorte të mirë? Sa fëmijë ke? Më shkruaj.

Të përqafoj,

**Patrick Kola 8B**



E dashur Fiona 35-vjeçare,

Çfarë pune po bën? Gjinnazin tek "Turgut Ozal" e bërë? Po universitetin, ku e vazhdove? Shpresoj që të jesh bërë një arkitekte e zonja, e cila jeton në një shtëpi të madhe, të bukur e luksoze. Ke bërë shoqeri të re? Po me shoqet e klasës ke folur më? Gledisi, a është bërë avokate? Po Ledja a e kafituar çmimin "Notarja më e mirë në botë"? Në çfarë vendi të botës po jeton apo ke ngelur në Shqipëri?! Sa gjuhë të huaja ke mësuar? Po fëmijët e vëllezërve të tua janë çapkënë, sepse edhe nëse ata janë, nuk do të habitësia. Çfarë lloj ndjesie ke kur ata të quajnë hallë? Më fal që po të bezdis me kaq shumë pyetje, sepse ti ndoshta ndërpreve punën tënde vetëm për të lexuar këtë letër. Unë thjesht dua të di sa më shumë të jetë e mundur për të ardhmen time. Vetja ime 35 vjeçare, shpresoj që ti ta kesh ruajtur këtë letër për 22 vite dhe gjithashtu shpresoj që të jesh e lumtur me jetën tënde edhe t'i kesh arritur qëllimet e tua në jetë. Kur të mbarosh së lexuari letrën, dua që të kujtosh kohët e vjetra dhe t'i thuash vetes se je një njeri me fat, sepse ke një familje dhe shoqëri të mrekullueshme.

Nga Fiona, 13 vjeçare.

**Fiona Rramilli 8B**



I dashur Frenki 35 vjeç,

Tani që po të shkruaj jam vetëm 13 vjeç dhe e kam mendjen të mbushur plot me ëndrra. Besoj se tani që po e lexon këtë letër duhet të jesh bërë dikushi në jetë. Duhet t'i kesh plotësuar parimet kryesore të tuat. Ti gjatë gjithë këtyre viteve ke kaluar shumë eksperiencë si të mira, por edhe të këqija dhe besoj se të kanë bërë punë për ta vazhduar më tej jetën. Me vullnetin tënd unë besoj se i ke realizuar të gjitha ëndrrat e tua. Në jetë asgjë nuk është e pamundur. Ti mund të kesh krijuar familjen tënde dhe tani mendon për të ardhmen e fëmijëve të tu. Familja është një nga gjërat më themelore të jetës, kështu që



duaje dhe ruaje atë, por kurrë mos harro ata që të kanë bërë ky që je sot. Kurrë mos e zhgënje familjen tënde, por bëji ata të lumtur me të gjitha mënyrat. Asnjëherë mos ndysho karakter, gjithmonë qëndro ai që ke qenë. Ti tashmë duhet të kesh punën e ëndrrave të tua. Duhet të kesh një pozicion të mirë dhe një pagë të lartë. Ajo punë duhet të jetë si shpërblimi yt i gjithë kësaj lodhjeje që ke harxhuar ndër vite për të arritur këtë që je duke bërë sot. Vazhdo kështu! Me dashuri Ti.

**Frenki Koduzi 8B**



E dashur Gledis 35-vjeçare,

Pyes veten si po ia kalon? Shumë gjëra duhet të kenë ndodhur deri atëherë. Gjimnazin ku e mbarove? Shpresoj se ke vazhduar të studiosh shumë dhe t'i kesh bërë prindërit krenarë. Gjithashtu, dua vërtet shumë të besoj se ke arritur të pranohesh në "Harvard", universitetin ku ke ëndërruar të shkosh gjithmonë. Pa më thuaj a je bërë një avokate e zonja? Në cilin qytet po jeton? Shpresoj të jetë një vend i qetë, por gjithashtu shumë interesant, ku mund të jetosh e lumtur me familjen tënde. Pyes veten, nëse je akoma duke komunikuar me miqtë e vjetër të nëntëvjeçares. Shpresoj se ti dhe Fiona jeni akoma shoqe të ngushta dhe se ajo tashmë është bërë një arkitekthe. Por mbi të gjitha, shpresoj se në të ardhmen time, unë jam e lumtur po ashtu dhe të gjithë miqtë e të afërmit e mi. Nëse pas 21 vitesh unë do ta kem ruajtur këtë letër dhe një ditë të ulem e ta lexoj, dua që të kujtoj të gjitha kohët e bukura që kam kaluar gjatë fëmijërisë sime dhe shpresoj se të gjitha ëndrrat që kam pasur dhe dëshirat që kam shprehur t'i kem bërë realitet. Me dashuri Gledis 14-vjeçare.

**Gledis Kondi 8B**



Përshëndetje, Grenti 35 vjeç

Nuk ia ke idenë se sa pyetje dua të të bëj. Dy janë pyetjet që më interesojnë më shumë; e para është me çfarë pune po merresh dhe e dyta është; a ke fëmijë? Në qoftë se ke, shpresoj të jetë djalë. Sa shumë të ka ndryshuar pamja? Vazhdon të të pëlqejë muzika Hip - Hop. Në fakt këtë duhet të kisha thënë qënë fillim, por isha shumë i interesuar për përgjigjen e atyre pyetjeve, çfarë duhet të të kisha thënë, është që uroj të jesh mirë me shëndet, sepse mendoj që shëndeti duhet të jetë para çdo gjëje. Babi duhet të jetë 73 vjeç dhe mami 63 vjeç. Nuk mund t'i imagjinoj dot aq të vjetër. Po vëllai ç'thotë? Shpresoj që dhe ai të jetë mirë me shëndet. Besoj se kaq kisha për të thënë. Të uroj sukses në çdo fushë të jetës. Për pak harrova që të thoja, që di vetëm diçka dhe ajo është që të mungojnë këto kohë kur po të shkruaj tani.

**Grenti Rajta 8B**



E dashur Kaltra,

Si ke qenë e nga ke qenë? Të shkruaj, sepse kam dëshirë të di gjithçka rreth teje. Doja të të pyesja; nëse e ke arritur qëllimin tënd që të kishe një të ardhme të ndritur si make-up artist? Të kujtohen kohët kur ti punoje me gjithë dëshirë në kursin e pikturës dhe me pas kënaqeshe gjithmonë me punën që bëjë ose kur ti krijoje personazhe të frikshme e më pas i vizatoje e i punoje në fytyrën tënde. Personalitetet e njerëzve të ndryshëm binin prehë e krijimit tënd. Mistika që kish' brenda çdo personazh i arrirë, krijesa me aq fshehtësi të mbartur, ishte krijim i një imagjinate feminare e të shfrenuar.

Të kujtohet 9-vjeçarja? Çdo gjë e bukur që kemi kaluar, çdo galletë që kemi bërë e çdo mësim që kemi mësuar qoftë edhe nga gabimet janë të paharrueshme. Shokët e shoqet e klasës që kemi pasur, i ke takuar më? Sa kemi qeshur, kemi luajtur e jemi gëzuar me ta...?! Beson se të mungon kjo kohë. Por gjithsesi ti tani je duke përjetuar ëndrrat e fëmijërisë. A nuk ka më bukur se kaq...?! Ëndërr që bëhet realitet...

Teksa mbyll letrën jam duke imagjinuar labirinthin e së ardhmes. Po shoh yllin tim që ndricon...

Me dashuri "Një mike e vjetër.."

**Kaltra Mezini 8B**



E dashur Kora,

Çfarë të rejash kemi nga ty gjatë viteve të fundit? Po të shkruaj, sepse jam shumë kurioze për jetën tënde. Shpresoj t'ia kesh kaluar sa më mirë me familjen dhe miqtë e tu të rinj. Ehh, sa pyetje të ndryshme më vijnë në këto momente në mendje! Çfarë ke bërë njëzet e dy vitet e fundit? Ke udhëtuar ndopak? Mbaj mend që kur ishe e vogël, ke pasur shumë dëshirë të realizoje një udhëtim rreth e qark Europës. E ke realizuar këtë dëshirë? Po studimet e larta, ku i ke bërë? A arrite të shkoje në Gjermani për të studiuar? Po shoqërinë e vjetër e ke ruajtur ndopak? Cilët prej tyre vazhdojnë të jenë akoma miqtë e tu më të mirë? Preferencat e tua letrare a kanë ndryshuar ndopak? Edukimi yt gjuhësor a është zgjeruar? Kur ishe e vogël të pëlqente shumë muzika rrep e pop. Po tani, cilat janë preferencat e tua nga ana muzikore? Cili është profesioni yt? E ke krijuar familjen tënde ideale? Ku jeton në këto momente? Shpresoj të kesh një shtëpi sa më të madhe e komode. Shpresoj shumë që t'ia kesh kaluar sa më mirë dhe të kesh realizuar qëllimet dhe ëndrrat e tua të shumta.

Me dashuri nga Kora.

**Kora Sulo 8B**



I dashur Lainus,

Para disa ditësh të kujtova dhe mendova të të shkruaj një letër, në të cilën ti do të kujtosh çdo gjë dhe do të gjesh të gjitha pjesët e humbura.

A e mban mend veten përpara njëzet e dy viteve? Epo nëse jo, do ta kujtosh në këtë letër. Gjithmonë ti ke qenë ai që u thojë njerëzve të gjitha pakënaqësitë ndaj tyre, pa e vrarë mendjen nëse i dëgjonin apo jo, dhe kënaqësitë i mbaje për vete, sepse nuk doje që të tjerët të vetëkënaqeshin më shumë se ç' duhet. Ti kishe vullnetin që t'i bëje gjërat shkëlqyeshëm deri në gjysmë, por jo deri në fund. Një gjë që duhet ta mbash mend është, që të mos kesh frikë të pyesësh, sepse asgjë nuk humb, por vetëm do të ndjesh mundësitë për të bërë atë që do. Po ashtu dua të të jap disa këshilla, që do të të vlejné gjatë jetës tënde. Rri pranë së mirës, sado e bukur e tunduese të të duket e gabuara, sepse ajo gjithmonë të çon në rrugë pa drejtim. Duaje veten dhe mendo se ti mund të bësh gjithçka që dhe të tjerët bëjnë. Ki vullnetin që të nisësh e të përfundosh diçka shkëlqyeshëm, dhe e fundit, gënje sa më pak të jetë e mundur, sepse të qenit i vërtetë, është një virtyt që të dallon nga të tjerët.

Shpresoj se leximin e kësaj letre do ta mbyllësh me një buzëqeshje nga mendimi se jeta jote ka qenë reflektimi pozitiv i gjithçkaje ti lexove. Paç fat!

**Lainus Hyska 8C**



E dashur Ajkana 35 vjeçe,

Jam Ajkana 13 vjeçe, e cila po të shkruaj pas një kohe shumë të gjatë. Uroj që të kesh arritur të gjitha qëllimet e tua në jetë dhe të kesh zgjedhur profesionin e dëshiruar.

Shpresoj që të jetë plotësuar një ndër dëshirat e tua më të veçanta, ajo e fillimit të një jete të re diku tjetër. Mbase je bërë nënë dhe ke krijuar familjen tënde të ngrohtë dhe të dashur. Uroj që të kesh arritur t'i shpërblesh dhe t'i kesh bërë krenar prindërit dhe të mos i kesh shpenzuar kot sakrificat e tyre. E di që ke kaluar shumë vështirësi dhe ke njohur shumë njerëz nga më të ndryshëm, ku të cilët bëjnë pjesë dhe ata që të kanë ndihmuar dhe ata që nuk kanë dashur të shohin sukseset e tua, por kanë dashur të të ulin poshtë e më poshtë, por ti je e fortë dhe ke arritur t'i kapërcesh të gjitha vështirësitë dhe pengesat e jetës. E di, që kur të lexosh këtë letër, do jesh e përhumbur në kujtimet e fëmijërisë dhe adoleshencës dhe uroj që të mos të kesh harruar eksperiencat e shumta që kemi kaluar.

Shpresoj, që kur të lexosh këtë letër, të të kujtohen të gjitha ëndrrat e fëmijërisë. Të uroj të gjitha të mirat e kësaj bote, gjithashtu dhe realizimin e plotësimit e çdo qëllimi që ke në jetë.

Të përqafoj fort Ajkana 13 vjeç.

**Ajkana Hima 8C**



I dashur 35 vjeçari Firdeos!

Jam 13 vjeçar. A më mban mend? Doja të të shkruaja një letër. Kam shumë pyetje. Tani besoj se je bërë baba. Shpresoj të jesh një njeri i mirë dhe shpresoj që të kesh një jetë të mirë dhe t' i kesh të afërmit dhe njerëzit që do më shumë pranë. Besoj se të mungon shumë adoleshenca. A do doje ti, të përsërisje edhe njëherë këtë periudhë të jetës si adoleshenca? Po shokët dhe shoqet të mungojnë? A i ke ti akoma shokët e vjetër afër teje? Dua që të mos kesh harruar se si ngriheshe në mëngjes dhe shkoje në shkollë pa dëshirë të madhe, kur të rritesh do e kuptosh që është diçka me vlerë, është e ardhmja jote. Besoj se dashurinë që ke marrë dhe ke dhënë nuk e ke harruar apo jo? Në qoftëse je bërë baba shpresoj, që je një baba i mirë dhe kujdesshëm për fëmijët e tu të dashur. Dëshira ime e madhe është që të zgjohem nga gjumi dhe të shoh se si fëmijët e mi rriten me një të ardhme të suksesshme si unë tani. Besoj se do të kesh arritur sukses dhe mbase ke bërë gjënë që ke dëshiruar të bëje. Më e rëndësishmja është të jesh mirë me shëndet, ti dhe të afërmit e tu. Besoj se këtyre pyetjeve një ditë do t' u jepet përgjigjja. Firdeus, asnjëherë mos harro se adoleshenca deri tani ka qënë periudha më e bukur, më e dhimbshme, por më e mrekullueshmja dhe marramëndëse e jetës tënde...

Me dashurinë më të madhe ti...

**Firdeos Demiraj 8C**



E dashur Mishel,

A është jeta në moshën 35 vjeçare ndopak ndryshe nga e shkuara jote? Shpresoj të kesh arritur qëllimet e tua në jetë dhe ëndrrat që kishe që fëmijë. Sigurisht një nga ato ëndrra ishte dhe të jetoje në Manhattan, qytetin që ke pëlqyer më shumë që fëmijë. Unë Misheli 14 vjeç jam tepër e kënaqur nga zgjedhjet e mia deri më tani e besoj se dhe ti ke bërë ato të duhurat për të arritur aty ku je. Dikur ishe një fëmijë i vetëm, deri sa në jetë erdhi motra jote Alis. Uroj që dhe fëmijët e tu të kenë atë lidhje të fortë e dashuri midis njëri-tjetrit, si ti dhe ajo. Shpresa ime për ty ishte që të shkoje diku jashtë shtetit për të mbaruar një shkollë të mirë e të gjeje një profesion që të pëlqente e ushtroje me pasion. Nuk e di në qoftë se jeta të ka ofruar këtë mundësi, por në qoftëse këtu e mbas 21 vitesh ndodhesh diku larg vendit tënd, si ndihesh ta kesh arritur këtë qëllim? A të merr malli për vendin, ku kalove fëmijërinë, apo ndodhet në një cep të largët të mendjes tënde? A kujton kohët kur flisje për të ardhmen me shoqet e tua apo kur e merrnit gjithë Tiranën më këmbë? Mbas dy dekadash je bërë një nënë, bashkëshorte e grua e suksesshme në profesionin e saj. Mendoj, që je ajo mama perfekte, që ke dëshiruar gjithmonë që kur ke qënë e vogël. Sigurisht për një 14 vjeçare si unë të 35-at, duken si një moshë tepër e largët, ku njeriu





ka plotësuar çdo ambicie të vetën, e më në fund ia ka dalë mbanë, por a është kjo e vërteta? A është mosha 35 vjeçare me të vërtetë një moshë ku "ia ke dale mbanë", ku çdo ambicie është plotësuar? Uroj që këto 21 vite me të vërtetë të të kenë mësuar diçka dhe të kenë ndikuar në personin që je. Gjithashtu shpresoj të kesh vetëm lumturi, dashuri, suksese e shëndet ne jetë; ti dhe familja jote. Të uth, Misheli 14 vjeç.

**Mishel Fevzi 8C**



E dashur Aurora,

Vitet ikin si gjethet e pemës në vjeshtë, dhe papritur e do të shohësh veten 35 vjeç. Çdo gjethë vjeshtë përfaqëson një dëshirë të realizuar. Studion letrare, që aq shumë dëshiroja, shpresoj që të jetë bërë realitet. Librat që aq shumë i doje në jetën tënde, besoj i kanë mbuluar raftet e bizhuterive. Udhëtimi yt rreth e qark botës shpresoj të ketë mbaruar me sukses. Por megjithëse ti do jesh 35 vjeç, një zonjë e hijshme, në mendjen time do ngelesh ajo Lola e vogël, me flokët e verdha dhe me buzët me shkëlqyes, ku në sytë e tu kishte gjithmonë shpresë e lumturi.

**Aurora Elezaj 8C**



E dashur Emi 35 vjeçare,

Tani që po të shkruaj jam ulur në oborrin e shtëpisë, vendin tënd të preferuar, ku rrije përherë e mendoje. Mendoje për të ardhmen, jetën tënde e si do të ishte ajo pas disa vitesh. Gjithmonë ke dashur të jetosh në New York dhe të kesh një jetë të mirë, me një familje të madhe e të dashur dhe një punë që të pëlqen dhe e bën me pasion. Shpresoj që ëndrra jotë për t'u bërë një mama e përkushuar dhe një biznesmene e suksesshme të jetë realizuar.

Që e vogël ke qenë shumë ambicioze, gjë që ka bërë të mundur të arrije qëllimet e tua. Ndoshta nuk ke vazhduar profesionin që ke dashur të ndjekësh, por besoj se sinqeriteti dhe karakteri yt i fortë, të kanë ndihmuar të jesh e suksesshme në çfarëdolloj rruge të kesh zgjedhur për veten tënde.

A e mban mend kohën kur dilje çdo fundjavë me shoqet e tua më të ngushta dhe bridhnit nëpër bllok deri në orët e vona? Shpresoj që akoma të kesh ruajtur kontakte me to, vajzat me të cilat ke kaluar çdo moment, qoftë të bukur apo të mërzitshëm. Gjithashtu shpresoj të keni kohë që të takoheni shpesh, edhe pse jetoni në shtete të ndryshme, e të kujtoni gjërat që bënit kur ishit të vogla. Për t'u mos u zgjatur shumë, të uroj një jetë të mbushur me lumturi e fat, e qofsh gjithmonë ajo Emi të cilën e karakterizonte e qeshura.

Me shumë dashuri, Emi 13 vjeçare.

**Emi Frangaj 8C**



Përshëndetje

Si po ia kalon?

Teksa po shkruaj këtë letër qëndroj e vetmuar në dhomën time. Gjithçka më duket e zymtë. Botës perreth i ka rënë një hije e rëndë, e cila ka ndrydhur buzëqeshjen dhe lumturinë e njerëzve. Ajri i ndotur i fabrikave dëmton çdo ditë e me shumë frymëmarrjen e fëmijëve të vegjël e të pafajshëm. Po bota jote si duket? A ka parqe të gjelbëruara? Po rrugët a janë të zymta? A janë ndërgjegjësuar njerëzit? Pasi këtu po bëjnë dëme të mëdha. Po fëmijët a janë të qeshur? A i bën të lumtur, bota juaj ata? Po zogjtë cicërojnë kaq e bukur si këtu?

Do të doja që njerëzit të kenë ndryshuar e të mos e dëmtojnë kaq rëndë natyrën e bukur plot ngjyra. Janë krijuar organizata për mbrojtjen e kafshëve të pafajshme?

Po varfëria është më një problem, i cili vret shumë njerëz? Do të doja që gjithë këtyre pyetjeve t'i përgjigjeshe tani, por nuk është e mundur pasi ti je e ardhmja ime.

**Fjona Muça 8C**



I dashur, Flavio i vitit 2037.

Kam dashur të të shkruaj dhe më parë, por kam qenë shumë i ngarkuar. Kam shumë pyetje për të të bërë, sepse jam shumë kurioz. Së pari dua të di se sa anëtarë jeni në familje dhe nëse je larguar nga Shqipëria ose jo? Meqë ra fjala te familja, sa vjeç janë fëmijët për momentin dhe si i kanë emrat? Jam shumë kurioz të di për profesionin tënd gjithashtu. Po përsa i përket prindërve tanë? Si janë ata dhe ku po jetojnë? Shpresoj të jenë mirë. Mbase nuk ke shumë kohë prandaj jam duke të të bërë vetëm disa pyetje të rëndësishme gjithashtu nuk dua të të bezdis shumë. Mos më lërë të pres për letrën tënde, sepse nuk duroj dot.

Me dashuri, Flavio i vitit 2016

P.S Më dërgo një foto tënden, për të parë se sa kam ndryshuar...

**Flavio Vila 8C**



Përshëndetje Gledia,

Jam kurioze nëse e ardhmja është ashtu si mendoj. Shpresoj të kesh akoma kontakt me shoqërinë dhe me familjen. Duhet ta dish që sado larg të jenë, ata do jenë gjithmonë në zemrën time. Do të doja në njëfarë mënyrë një përgjigje, por është e pamundur. Kam akoma shumë pyetje në mendje dhe jam shumë kurioze të të takoj, por duhet të pres. Dua që të mos më harrosh kurrë. Bëju të fala të gjithëve dhe mbroji fort. Shpresoj të kesh sukses dhe ëndrrat të të realizohen.

Puthje nga kujtimet e vjetra Gledia 2016

**Gledia Ferko 8C**



I dashur Geri,

Ta mendosh që ti, tani që po e lexon këtë letër, nuk je më siç ke qenë, por unë dua që ti të kujtosh veten për një moment. Shpresoj që kjo letër të jetë e butë, e brishtë siç është tani në këto çaste. Madje madje shpresoj që këto gishtat, që po mbajnë këtë letër, të jenë ende po aq të gjatë, topolakë dhe të butë, mos të kenë ndryshuar fare. Dua që ti të kesh arritur të bëhesh doktor dhe të kesh krijuar një familje, por dua që ti të kujtosh tani për shokët që ke pasur dhe momentet që ke kaluar atëherë. Kujto që ti ke pasur shokë që të ngrinin humorin kur ishe i trishtuar, kujto kur bëje gallata me ata derisa shkriheshe gazit. Tani desha të të kërkjoja diç ka të rëndësishme! Dua që familjen tënde ende ta duash dhe të mos ta lëndosh ose ta fyesh, sepse ata gjithmonë të kanë ndihmuar dhe të kanë ndenjur pranë në momentet më të vështira.

Të uroj që të kesh një jetë sa më të lumtur!

**Gerard Marku 8C**



E dashur Odri,

Unë tani jam 13 vjeçe dhe po e shkruaj këtë letër që ta lexoj kur të jem në moshën 35 vjeçe. Tani në këtë moshë që unë jam nuk kam asnjë detyrim tjetër, përveç se të mësoj dhe të ndihmoj prindërit, kur u nevojitem. Bota këtu ka shumë ngjyra dhe fëmijët luajnë me lojra të ndryshme. Po kur të rritem, a do jetë bota si tani? Po fëmijët do luajnë përsëri në ajrin e pastër? Po bari do të rritet më kaq shumë, lulet do të jenë kaq shumëngjyrëshe do të ekzistojë më gjelbërim ngado si tani? Unë shpresoj që edhe kafshët të ndihen të sigurta dhe ne mos t'i vrasim ato. Do të ketë pyje të dendur që të jenë ambiente të përshtatshme për kafshët, sepse ne duhet të mendojmë dhe për to. Unë mendoj kur ta lexosh ti këtë letër, ti do të jesh bërë e suksesshme në punë, pasi ti punove dhe do të punosh gjithmonë, me forcë dhe sakrificë. Do të vazhdosh të mendosh për mua se si kam qenë e çfarë pëlqeja? Shpresoj t'i kesh bërë prindërit krenarë. Do të doja të më shkruaje edhe ti një letër, por unë e di që është e pamundur, pasi unë e kam shkruar këtë letër vite më parë. Përsa i përket teknologjisë a ka avancuar shumë? Po shoqëria jote si është? Do të doja të dija si janë shoqet e tua, gjithashtu doja të dija për pamjen tënde fizike nëse ke ndryshuar. Do të më pëlqente të dija se si e kalon kohën e lirë. A shfrytëzon kohë të mjaftueshme me familjen tënde, pasi ata janë kryesorët në jetën tënde. Kam kaq pyetje që do të doja të m'i ktheje përgjigje, por duhet të pres pak për t'i marrë ato përgjigje. Mezi po pres të të njoh më mirë ty, pasi do të më marrë malli, sepse nuk besoj të të shkruaj shpesh.

Me dashuri Odri e se shkuarës!

**Odri Bregu 8C**



E dashur Sara 35 vjeçare,  
 Po të shkruaj nga shtëpia ime, atje ku do të kalosh vitet e fëmijërisë. Jam ulur në oborrin me lule, ku ti vrapoje e mendoje për të ardhmen. Edhe në këtë moment jam duke menduar për të ardhmen dhe ndryshimet që do të ndodhin. Shumë mendime më vijnë pranë. Nuk mund ta parashikoj si është jeta jote, por uroj që të kesh arritur gjithçka që ke ëndërruar. Mendoj se ndërkohë që jam duke të shkruar këtë letër, ti duhet të jesh duke bërë atë që ke dashur gjithmonë. Tani duhet të kesh arritur të bësh gjithçka ke kërkuar e dëshiruar dhe të përgëzoh për këtë gjë. Tani jeta jote është ndryshe. Edhe pse teknologjia ka përparuar, mendoj si do të jetë pas 22 vitesh. Do të kalojë shumë kohë dhe gjëja e parë, që do të dish në këtë moment është të dish të ardhmen tënde pas kësaj periudhe të gjatë. Ndoshta nuk ke arritur të bësh profesionin që ke dashur, por gjatë këtij rrugëtimi do të kuptosh se shkolla dhe notat nuk janë gjithçka. Ndoshta do të përfundosh duke bërë atë që do dhe të jetosh më mirë se ç'mendoje. Mbase mund të ndodhë diçka në jetën tënde, që mund të ndryshojë krejt rrjedhën e saj. Sara e ardhme, do të kalosh nga vështirësitë më të ndryshme, por di diçka: çdo gjë në fund do të përfundojë siç duhet. Vështirësitë që do të kalosh gjatë kësaj moshe do të jenë të pafundme, por unë e di që do t'i kalosh, sepse ato do të formojnë personin që do të jesh pas 22 vitesh. Sara 35 vjeçare, ndiq ëndrrat e tua dhe mos mendo për opinionin e të tjerëve. Mendo për lumturinë tënde. Jam shumë krenare që do të bëhem një person si ti. Do të më gjesh në çdo kujtim.  
 Me dashuri, Sara 13 vjeçare.

**Sara Kondi 8C**



E dashur Sibora e së Ardhmes,  
 Nuk e di pse po ënderroja veten kur të bëhem 35 vjeç dhe vendosa të të shkruaj. Sa shumë vite janë, dhe ti mbase nuk i mban mend shumë gjëra nga fëmijëria, por ajo është një kujtim shumë i vlefshëm për jetën tënde. Shpresoj që përsëri t'i kesh ato kaçurrelat e tua, që asnjëherë nuk i pëlqeje shumë. Ato kaçurrela që gjithmonë doje t'i drejtoje. A je bërë ajo biznesmenea që dëshiroje? Në fëmijëri, ti vdisje të bëheshe biznesmene, sepse gjithmonë ke dashur të merrje në duart e tua të vogla kompanitë e prindërve të tu. A e ke vazhduar ëndrrën tënde për të shkuar në 'Harvard Business School'? Ti gjithmonë ke dashur të ndjekësh shkollën, ku babai yt ka mësuar. A e ke krijuar familjen tënde? A përbëhet familja jote prej shumë pjesëtarësh? Ti ke shkruar në një letër se doje të kishe një familje të madhe dhe prej 5 pjesëtarësh, ti, burri yt, dy fëmijë e tu binjakë, edhe një djalë te vetëm. A e ke përsëri qejf të pikturosh? Në moshën që je ti, me siguri që ngjyrat kanë evoluar edhe pikturat mund të jenë shumë më të bukura. A është sofistikuar shumë teknologjia? Besoj që me gjithë ato vite, do të jetë një botë me teknologji

të reja. Ti besoj, që nuk më mban shumë mend dhe je rritur shumë, por kurrë nuk duhet të harrosh që unë kam qenë një pjesë shumë e rëndësishme e jetës tënde. Shpresoj që kjo letër të ngelet përgjithmonë në kujtimet e tua. Me dashuri, Sibora e fëmijërisë tënde.

**Sibora Haxhia 8C**



E dashur Xhoi,

Hej! Nëse je duke e lexuar këtë, tani ti je diku rreth 35 vjeçe, që do të thotë se 22 vite kanë kaluar që kur isha 13-të dhe shkrova këtë letër.

Kur ti të jesh duke lexuar këtë letër, ka shumë mundësi që ti të jesh bërë mjeke-ligjore, në qoftë se ke pasur guxim të ndjekësh ëndrrën tënde. Po ashtu shpresoj të kesh pasur një jetë të mirë, të jesh e lumtur dhe të kesh një jetë pa stres dhe të lutem, të lutem, të lutem kujdesu për veten. Gjithmonë kam qenë e mendimit se kur rritesh njerëzit do ndalojnë së thëni se si duhet të jesh dhe kjo do të bëjë të mendosh se si duhet të kishe vepruar ndryshe me jetën tënde, por mos mendo për çfarë thonë të tjerët. Ji vetvetja, sepse ajo është personi më i mirë që mund të jesh.

Gjatë kohës që po shkruaja këtë letër po mendoj se çfarë mund të të ketë ndodhur ty në jetën tënde deri tani. Gjithmonë kam pasur synime të ndryshme për të ardhmen duke filluar nga gjërat më spontane si përshembull; të takoj ndonjë person të famshëm, të kem të njëjtën shoqe të ngushtë ose të ndjek të gjithë rregullat që mësove në #GIRLBOSS etj, por kam pasur dhe qëllime të rëndësishme për jetën time si:

Mbarimi i universitetit, ku kam dashur të shkoj, të bëhem një person i suksesshëm ose një person që ka ndikim sado të vogël në jetën e një njeriu. Qëllimet që i kam vendosur vetes shpresoj që ti t'i kesh përmbushur.

Me dashuri, Xhoi e së kaluarës.

**Xhosela Rraboshta 8C**



Përshëndetje!

Si po kalon? Kam shumë kohë pa të parë. Dukesh i zënë me punë. Nuk më ke shkruar për një kohë të gjatë. Unë kam shumë punë me mësimet, që sa vijnë e vështirësohen, por prapë kam kohë që të argëtohem. A luan e vrapon më si më parë? A ke kohë të argëtohesh apo je i dhënë pas punës? A ke menduar më për fëmijërinë? Unë ndjej se jo. Nuk me ke shkruar për kaq shumë kohë. Çdo ditë shpresoja që ti të shkruaje. Ti kurrë nuk më shkruajte. Pasi më ke lënë vetëm kaq kohë, mendoj se ti nuk do të më flasësh më. Ti ke harruar gjërat e rëndësishme dhe je zhdukur në një botë tjetër. Ti ke harruar familjen, fëmijërinë dhe mendon se jeta është punë. Puna është një pjesë e shkurtër e jetës. Të lutem, më dëgjo dhe ndrysho! Me dashuri Harvi.

**Harvi Seitaj 8C**



Përshëndetje.

Unë jam ti në 2016. Nuk e di nëse e kujton këtë letër, që duhet të shkruanim për orën e gjuhës. Shpresoj që gjithshka të jetë mirë. Shpresoj që të kem arritur të gjitha që kam dëshiruar. Shpresoj që jo gjithçka ka ndryshuar. Ndoshta tani mund të jem një person komplet ndryshe. Ndoshta mund të jem po i njëjti person, si ky në këto momente. Ndoshta jam akoma ajo vajza e llastuar që i kishte të gjitha. Ndoshta jam akoma ai person që ka dëshirë të qeshë dhe të bëjë të tjerët të qeshin në momente të vështira. Ose ndoshta jam një person me më pak humor. Një person që nuk i pëlqen të qeshë apo ndoshta pak e trishtuar. E ardhmja është plot me surpriza. E ardhmja është e vetmja kohë, të cilën ne nuk mund ta parashikojmë dot. E ardhmja do të mbetet gjithnjë mister. Prandaj tani nuk do të të shkruaj më me disa "Ndoshta" ose "Shpresoj". Tani do të të them mendimet e mia kur përfytyroj veten mbas 21 viteve. Unë e përfytyroj veten në Shqipëri. Pranë familjes sime. Pranë shoqërisë sime. E imagjinoj veten, për të mos gënjyer, një grua me karrierë. E imagjinoj veten një grua, e cila i ka bërë krenarë prindërit e saj. Këto ishin fjalët, të cilat më vijnë ndër mend. Këto ishin fjalitë e realizuara nga unë me "shpresoj", "ndoshta" dhe "dua".

**Sidora Tyli 8C**



I dashur Stivi,

Përshëndetje! Si je? Si po ia kalon? Shpresoj të kesh qenë mirë me shëndet. Kur ta lexosh këtë letër dua që ti të qeshësh dhe të të kujtohen të gjitha momentet, që ke kaluar në të shkuarën. Kur po e shkruaja këtë letër po mendoja se si do të isha në moshën 35 vjeçare. A do kem ndryshuar ndopak? Çfarë profesioni do të kem dhe sa fëmijë do të kem? Shpresoj që të të jenë plotësuar të gjitha ëndrrat që ke pasur në fëmijëri. Besoj se nuk i ke harruar prindërit kur të jepnin gjithë ato këshilla për të mësuar që të dilje dikushi në jetë. Shpresoj që t'i takosh shpesh ata dhe të mos i lësh kurrë pas dore, sepse ata janë kujdesur shumë për ty. Pas gjithë këtyre që sapo thashë, unë shpresoj që të të plotësohen të gjitha dëshirat.

Me dashuri, Stivi trembëdhjetë vjeçar.

**Stivi Balla 8D**



E dashur Uendi,

Jam unë, jam ti, por 30 vjet më parë.

Kam shkruar shumë letra më parë, por t'i shkruash vetes qenka shumë e vështirë. Faktikisht nuk di çfarë të të shkruaj, thjesht uroj që të jesh mirë. Uroj që të jesh e rrethuar me persona që i do e të duan dhe t'i kesh plotësuar të gjitha ëndrrat e tua. Uroj që të jesh ulur në zyrën tënde duke lexuar këtë letër nga një 13 vjeçare. Shpresoj që të jesh po ai, i njëjti person që nuk ndalet nëse



nuk e arrin atë që do. Gjithmonë më ka pëlqyer kjo gjë tek ty!

Pasi të kesh mbaruar së lexuari këtë letër, dua të mbyllësh sytë e të kujtosh fëmijërinë tënde, të kujtosh të gjitha të mirat dhe të këqijat, të kujtosh shokët e shoqet që të janë gjendur pranë, të kujtosh edhe personat që të kanë ulur poshtë. Të kujtosh disa pjesë të bukura të jetës tënde. HAPI SYTË! Dil para pasqyrës dhe shiko personin para vetes. Një grua, e cila është rritur, që ka filluar jetën e saj. Një grua e suksesshme që ka arritur çdo gjë që ka dashur dhe thellë brenda saj jam unë ajo vajza 13 vjeçare që po shkruan letrën...

**Uendi Tuda 8D**



E dashur Evi,

Shpresoj që kurrë nuk do të harrosh ta hapësh këtë letër kur të jesh 35 vjeç. Nuk e di sesi kjo letër do të gjejë ty. Një grua me karrierë? Një grua e martuar dhe me një familje? Apo mbase thjesht një grua me një dëshirë të madhe për ta jetuar këtë jetë?

E di, që ti do të çuditësh në fillim, kur të mësosh që kjo letër që po lexon është shkruar nga vetja jote para 21 vitesh, pra kur ti ishe vetëm 14 vjeç. Por e di që ti kur të vazhdosh ta lexosh, do të kujtohesh dhe do të qeshësh me veten tënde (ose mbase edhe do të trishtohesh edhe do të nisësh të qash), kur të kujtosh të gjitha çudirat apo prapësitat që ke bërë kur ishe thjesht një fëmijë.

Shpresoj që nuk i ke harruar dëshirat kur ke qenë në këtë moshë, që unë po të shkruaj.

1. Të udhëtosh në vende të ndryshme të botës.
2. Të kesh një jetë sa më të mirë.
3. Të kesh punën që ti ke dashur gjithmonë.
4. Të jetosh jashtë shtetit ose mbase të jetosh në një Shqipëri tjetër nga kjo që ke para. Në një Shqipëri tjetër nga kjo që ke parë. Në një Shqipëri të re dhe në një vend sa më të mirë.
5. Dhe e fundit të krijosh një familje.

E di, që ti nuk do të shikosh botën me këto ngjyra që po e shikoj unë tani. Por do ta shikosh me këndvështrim tjetër. Por mos u shqetëso, mbase kur të bëhesh me fëmijë, do të mundesh të rikthehesh sado pak në këtë botë tërë ngjyra. Nga të gjitha këto që të thashë, dua të sigurohem që nuk do të harrosh kurrë, atë premtim që ti i ke dhënë prindërve të tu. Nuk dua që të harrosh, ti bësh ata të ndihen krenarë dhe t'i falenderosh për të gjitha sakrificat, që ata kanë bërë për ty. Si dhe nuk dua që ti të harrosh për ta dhe t'i lësh pas dore, pasi po të mos ishin ata që të lindën, të rritën, të edukuan dhe u kujdesën për ty, mbase as ti vetë nuk do ta dije jetën që do të kishe dhe që do të vazhdosh të kesh.

Me dashuri, Vetja jote 14 vjeç.

**Evi Tafaj 8D**



I dashur Even,

Kam shumë pyetje për të të bërë. Nuk di se nga t'ia nis. A i mban mend shokët e vjetër? Po notin a e vazhdon më? Besoj se ke krijuar familje. Sa shumë qenke rritur dhe qenke zgjatur. Po Aldin, Enisin dhe Luisin, me të cilët rrije përherë a i mban mend? Po fëmijet e tu si quhen? Po shkollën për çfarë dege e ke mbaruar? Mendoj se ke dalë me nota të mira. Gjithsesi shumë gjëra kanë ndryshuar. Je bërë më i pjekur, ke punën tënde private. Me siguri ti tani ke forcë, lekë, por nuk ke më kohë, siç ke pasur kur ishe i vogël. Shpresoj t'i kesh arritur disa nga qëllimet që ke dashur në jetë dhe të vazhdosh të plotësosh ato që kanë ngelur. Me dashuri Even.

**Even Qarri 8D**



I dashur Aldi,

Si po ia kalon? Pyetjet e mia janë shumë dhe s'di nga t'ia nis. A je martuar? A ke ndryshuar? A e mban mend fëmijërinë tënde që të ka bërë të lumtur dhe të mërzitur? Deri sa të bëhem 35 vjeç do të kem kaluar shumë vështirësi dhe sfida të ndryshme, por gjithmonë do t'ia dal. Nuk mendoj se e mban mend kur luanim futboll, hapa dollapa dhe shumë lojëra të tjera, ku ne argëtoheshim dhe mësonim shumë nga ato. E mban mend kur nuk shkonim në shkollë dhe e gënjenim mamin. Shpresoj që ëndrra ime për t'u bërë futbollist të jetë realizuar. A je një futbollist i zoti në skuadra të mëdha? Po me shokët e tu të vjetër takohesh më? Të kujtohet Luisi, Enisi dhe Eveni që rrije dikur? Besoj se po, megjithëse dhe ata kanë krijuar familjet e tyre. Shpresoj që të jesh po ai Aldi energjik që kam qenë më përpara. Me dashuri, vetja.

**Aldi Gjumsi 8D**



E dashur Gea,

Unë që po të shkruaj jam ajo Gea, që po e nis pak me frikë këtë udhëtim nëpër vitet që do të jetoj, jam ajo Gea që akoma fshihet brenda teje, ajo pjesë e jotja feminare. Ti tashmë do të kesh fituar atë guxim dhe trimëri që sot mua më mungojnë nga gjithë kjo pasiguri që nuk po më largohet. Shpresoj shumë që ti tashmë ta kesh fituar e ta kesh ndërtuar atë vetëbesim që unë shumë po mundohem të formoj.

Kur ti ta lexosh këtë letër, me shumë mundësi do të kesh kaluar shumë situata e përjetuar shumë ndjenja që unë kam akoma kohë për t'i zbuluar mirë. Shpresa dhe dëshira që kam unë sot për ty është që ti të kesh studiuar fort e të kesh arritur të ndërtohet një karrierë të cilën e ke zgjedhur me shumë dashuri, dua që ti të kesh një punë që e adhuron dhe e kryen me një dëshirë të madhe. Gjithashtu dëshiroj që të kesh ndërtuar një jetë të lumtur e të qëndrueshme mundësisht në një shtet tjetër e më të zhvilluar se ç'është sot Shqipëria, të kesh





një familjë që ti e do dhe të do me gjithë shpirt. Unë dua që ti të kesh arritur e të kesh marrë gjithçka që ke dashur nga jeta. Por nuk dua që ti të më harrosh mua, atë pjesë të vetes tënde që është akoma një fëmijë dhe që i shikon gjërat me një pozitivitet aq të madh sa të bën të mendosh se nuk I bëhet vonë për asgjë tjetër përveç lumturisë e gëzimit. Jeta mund të të vendosë përballë shumë vështirësish, por unë nuk dua kurrësi që ti të dorëzohesh, nuk dëshiroj që të mendosh se nuk je mjaftueshëm e fortë sepse je, përderisa ke arritur deri aty. Shpresoj shumë që të gjitha këto dëshira që kam për ty sot, të jenë realizuar. Me shumë dashuri, Fëmijëria jote.

**Gea Ivanaj 8D**



E dashur Esti,

Shpresoj që të gëzohesh kur ta hapësh këtë letër dhe të lexosh mbi të shkuarën tënde. Do të kalojnë vite dhe jam e sigurt që kurrë nuk do të harrosh aventurat që ke kaluar në fëmijëri apo kukullat me të cilat ke kaluar kohën. Po momentet që të kanë bërë për të qarë apo ato, të cilat të kanë gëzuar pa masë. Shumë herë jam konfuze se si do të jetë rrugëtimi im në jetë. Po karriera ime? Më pëlqen të ndihmoj njerëzit, të cilët janë në vështirësi. Apo fëmijëve, të cilëve u mungon dashuria. Por jam e sigurt se do të jetë një rrugëtim i gjatë dhe ndoshta jo i lehtë. Do të ketë pengesa, të cilat do të më bëjnë të rrëzohem, por me forcën brenda vetes do të arrij t'i mposht ato. Shpresoj nuk i ke harruar dëshirat kur ke qenë në këtë moshë, pra 13 vjeç. Të vizitosh qytetet e humbura. Të kesh punën, që ke ëndërruar gjithmonë. Por, më e rëndësishmja të kesh një familje të mbushur me dashuri. Nga të gjitha këto dua të them se nuk duhet të harrosh për premtimet që i ke bërë prindërve të tu. T'i bësh ata prindërit më të lumtur e më krenarë në të gjithë botën. Duhet t'i respektosh për atë ç'kanë bërë për ty. Do të isha e lumtur nëse një ditë do të këmbëngulje ta lexoje këtë letër. Me shumë dashuri Esti 13 vjeç.

**Esti Dautaj 8D**



I dashur Kevin,

Ç'kemi? Si ke qenë? Ç'ke bërë? Je lodhur shumë? Sidoqoftë, shpresoj të jesh duke jetuar mirë. Mos harro se kur ishe fëmijë nuk doje t'ia dije shumë se çfarë bëje, sepse nuk kishe përgjegjësi. Ulu pak, çlodhu dhe mendohu. Mendo për planet që kishe kur ishe i vogël. Shiko, unë mendoj, se duhet të kthjellohesh pak dhe të dëgjosh. Unë jam në klasë të 8-të dhe akoma di shumë pak, por vetëm me atë fare pak unë besoj se mund të arrij dëshirat e mia. E mban mend vëllain tënd Andin? Po besoj se po, sepse unë asnjëherë nuk do të rrija pa folur me të. Ai është në vit të 2-të dhe do shkojë në Austri, të paktën kështu shpresoj. Po Christianin e mban mend? Ai është akoma në klasë të tretë. Ti ke marrë ndonjë punë? Besoj se do e marr vesh pas 20 vitesh. Unë jam i vogël dhe do të kujtoj për disa gjëra të vogla. Kur ishim të vegjël dhe kur ishe sa unë, ti



gjithmonë mendoje se kur të rriteshe doje të kishe këto gjëra ose të kishe këtë punë. Unë dua të bëhem doktor, Andi do shkojë në Austri, edhe unë dua po ashtu, por gjithmonë gjërat ndryshojnë dhe me punë mund të fitosh. Mua do me marrë malli, sepse Andi do iki dhe do të më mungojë shumë. Kur mendoj se do jetë larg më vjen për të qarë. Shpresoj se ky moment të të ketë larguar nga punët dhe stresi që ke. Shihemi pas 13 viteve.

**Kevin Çela 8D**



E dashur Sui,

Unë që po të shkruaj jam një vajzë 13 vjeçare, nxënëse në kolegjin "Turgut Özal".

Kam shkruar shumë letra, drejtuar prindërve të mi dhe gjyshërve me raste ditëlindjesh apo gëzime të tjera familjare. Por t'i shkruash vetes aq më tepër në moshën 35 vjeçare qenka shumë e vështirë. Në moshën 35-vjeçare besoj do e kem realizuar ëndrrën time për t'u bërë arkitekte. Kur ta lexosh këtë letër që sot po të shkruaj besoj se do jesh duke punuar për projektin e rradhës. Kam dëgjuar për ty si arkitekte e njohur në ndërtimin e shumë veprave të bukura në mbarë vendin. Prandaj dhe unë do të përpiqem shumë që të kem rezultate shumë të mira si ty. Me shumë dashuri, Vetja.

**Adile Su Girengir 8D**



Përshëndetje Aron,

Gjërat tani e tutje kanë ndryshuar. Unë nuk jam më i vogël, por jam rritur jam bërë 13 vjeç. Kjo gjë tregon se unë nuk jam më i vogël që të luaj me lodra ose me gjëra fëmijësh. Kur të rritem dua të bëhem një njeri i mirë dhe me dinjitet. Tani jam i rritur dhe i kuptoj gjërat më mirë. Unë duhet të mësoj dhe të eci përpara në jetë, sepse kjo gjë është e rëndësishme për mua. Se për të arritur majat e suksesit nuk ka ashensor, por duhet të ngjitësh shkallët. Kur të rritem do të krijoj një familje, do të punoj me forcë dhe me djersë e me lodhje.

**Aron Alushani 8D**



E dashur Erjana,

Po të shkruaj nga dhoma ime në Tiranë. Unë mendova që ne të flisnim për të ardhmen tonë. Çfarë mendoj që do të jem në të ardhmen? Si do të donim të kishim të ardhmen tone mbas 22 vitesh. Unë sot jam 13 vjeçe dhe doja të ndaja me ty se si e imagjinoj të ardhmen time kur të jem 35 vjeçe. Unë do të doja, që në të ardhmen time të jem shumë e suksesshme. Shpresoj që të mbaroj në një nga shkollat më të mira që unë kam mundësi dhe që të kem rezultate të mira. Unë dëshiroj që të kem një punë me të ardhura sa më të mira dhe mos të jetë e lodhshme që të më krijojë stres në jetën time të përditshme. Do të doja një familje të lumtur dhe të bashkuar dhe që prindërit dhe vëllai të jenë të shëndetshëm dhe të lumtur me jetën e tyre.



Po ti si e dëshiron të ardhmen tënde? Çfarë pune do të kesh? Si do që të jetë familja jote? Kujdesu për veten dhe familjen tënde. Puno që të arrish gjithçka që ke mundësi.

Me dashuri Erjana.

**Erjana Çejku 8D**



E dashur Klea,

Edhe 100 vjeç! Unë që po të shkruaj, jam thjesht ti në moshën 13 vjeçare. Këtë letër po e shkruaj me shumë dashuri. E di sa është data sot? Sot është data 19 tetor 2016. Shpresoj që kur ta lexosh këtë letër të mos qeshësh shumë. Sot dita ime nisi ndryshe. U çova herët vetëm për të filluar detyrat. Më pas dola me nënën, dajën, vëllain dhe mamin dhe u kënaqëm shumë. Pastaj u ktheva në shtëpi, sepse kishte ardhur orari i drekës dhe kur mbërrita atje fillova të shkruaj këtë letër. Gjatë shkrimit të kësaj letre po mendoja: "Kur të bëhem 35 vjeçe si do të jem, si do të dukem, a do të ndryshoj apo do të mbetem prapë unë...". Shumë pikëpyetje më erdhën në mendje, por asnjë përgjigje. Fillova të mendoja se ç'do të bëhesha kur të rritesha, por e vetmja përgjigje që më vinte ndërmend ishte kërcimtare. Vetën si një kërcimtare e mendoj me flokë të gjata kaçurrela, ngjyrë kafe dhe shume te bukura. Sytë i mendoj siç i kam tani. E mendoj veten të famshme dhe të njohur në të gjithë botën. Kështu që edhe ndjenjat apo karakteristikat nuk dua të më ndryshojnë. Dua të jem prapë ajo Klea gazmore dhe që ka shumë miq e mikeshë.

Pra, kur të jem 35 vjeç, dua që ëndrrat e mia të më jenë bërë realitet.

Shpresoj të mos kesh qeshur shumë, Klea e vogël.

**Klea Nela 8D**



I dashur Enis,

Si po ia kalon? Pyetjet e mia janë të shumta dhe s'di nga t'ia nis. A ke ndryshuar ndopak? A je martuar? A e mban mend shoqërinë dhe shokët e klasës? Besoj se e ke humbur fare imagjinatën, sepse ke qenë duke u trajnuar dhe ke qenë i zënë me familjen, por besoj se duke lexuar këtë letër që kam shkruar do të kujtohen shumë gjëra. Po shokët e tu janë ende ata që ke pasur në shkollë? Besoj se nuk do t'i kesh harruar dhe do të kesh zënë akoma edhe më shumë miq dhe shokë në universitet. Me siguri do të jesh futbollist në një skuadër të mirë dhe me shumë siguri i ke nderuar prindërit, sepse ata kanë bërë të pamundurën për të të shkolluar dhe për të të edukuar. A të kujtohet kur mami të thoshte "Mëso që të bëhesh dikushi." Ose kur babi të thoshte "Duhet të stërvitesh mire në qoftë se do të bëhesh futbollist i zoti." Dhe prandaj them se ti duhet të jesh stërvitur mirë dhe të kesh mësuar në të njëjtën kohë. Pas gjithë këtyre gjërave që të thash më sipër unë shpresoj që të kesh një jetë ideale me familjen tënde dhe të jesh bërë një futbollist i zoti dhe me famë.

Me shumë dashuri.

**Enis Dollapaj 8**



Përsëndetje Deborah!

Si je? Ti tani duhet të jesh 35 vjeç. Përfytyroj se ti je një vajzë në karrierë dhe e shkolluar. Shumë gjëra mund të kenë ndryshuar në jetën tënde, por nuk mendoj se ti e ke harruar fëmijërinë. Unë tani akoma jetoj me mamin, babin dhe motrën. Mendoj se ti duhet të kesh krijuar familjen tënde. Këtë letër po ta shkruaj për të të rikujtuar se edhe ti dikur ke qënë fëmijë. Kur ti jetoje me prindërit dhe ishe shumë e lumtur. Në këtë letër do të flas edhe për disa nga ëndrrat e tua të dikurshme. Kur ti t'i lexosh, mendoj se do të vijë për të qeshur dhe do të mendosh se të gjitha këto kanë qenë vetëm ëndrra fëminore. Do të mendosh kështu, pasi bota jote momentale prej të rrituri, është shumë ndryshe. Ajo është e mbushur me ftohtësi dhe nuk mund t'i konceptojë këto ëndrra. Shpresoj që letra të të rikujtojë sado pak të shkuarën. Vite më parë ti dëshiroje të bëheshe një arkitekthe. E përfytyroje veten në mesin e një grupi njerëzish duke prezantuar projektet e tua. Ti do të ishe një arkitekthe me famë dhe zotësia jote do të njihej deri në vendet e largëta të botës. Por, përveç kësaj ti dëshiroje të praktikojë edhe artin. Në kohën e lirë ti do të pikturoje dhe do të krijoje një ekspozitë, e cila do të vizitohej nga mijëra njerëz në vit. Përveç këtyre, një pasion tjetër ishte dhe muzika. Ti do të kompozojë këngë në kohën e lirë dhe do të bashkëpunojë me artistë me famë botërore. Siç e shikon këto kanë qenë ëndrrat e tua për të ardhmen. Mbase disa nga këto ëndrra mund të jenë realizuar. Këtë gjë do ta mësoj kur të bëhem 35 vjeç. Deri atëherë kam një rrugë të gjatë përpara për të përshtuar. Shpresoj se kjo letër të të ketë kujtuar sado pak botën tënde të dikurshme fëmijore. Bashkë do të shihemi pas disa viteve. Deri atëherë mirupafshim.

Të uth me mall.

**Deborah Hasanaga 8D**



E dashur Erta,

Si je? Mendoj se je e zënë me punë dhe nuk ke pasur kohë të qetësohesh. Ulu për një çast dhe kujto fëmijërinë tënde. Kujto çastet e bukura dhe të gëzuara të jetës. Ato momente që të kanë bërë të buzëqeshësh, qeshësh dhe ndonjëherë ke qarë. Tani të tregoj pak për jetën time. Unë jetoj me mamin, babin dhe 2 vëllezërit e mi, Kleidi dhe Ennio. Kleidi për momentin jeton në Amerikë dhe mund të them se më ka marrë malli edhe pse kanë kaluar vetëm 2 muaj. Unë dëshiroj të bëhem aktore ose avokate. Më shumë jam prirur drejt profesionit si aktore. Gjithashtu kam filluar një kurs aktrimi, ku mendoj se do të mësoj shumë. Lëndët e mia të preferuara janë: fizika, biologjia dhe matematika. Klasa e 8-të është e lodhshme dhe deri tani pak e vështirë.

Shpresoj të jesh sa më mirë. Jam në pritje të më shkruash.

Me dashuri, Erta në moshën 13 vjeç.

**Erta Hoxha 8D**



I dashur Luis,

Përshëndetje, si të kam? Shpresoj të jesh mirë me shëndet dhe gjendje financiare. Kur ta lexosh këtë leter dua që ta lexosh deri në fund të lutem. Unë jam akoma 14 vjeç dhe jeta më duket shumë e lehtë. Unë kam shumë pyetje për ty: A ke ndryshuar ndopak? Çfarë profesioni ke? A shkove në Amerikë për të mbaruar studimet? Gruan e gjete ndonjë çikë të mirë?... etj. Besoj se s'do kesh ndryshar shumë. Uroj që shkollën ta kesh mbaruar me rezultate të mira dhe të jesh bërë dikushi në jetë edhe pse je shumë përtac. Shpresoj të kesh krijuar një familje dhe një karrierë, të kesh krijuar kompaninë, që doje të kishe që në fëmijëri. Shpresoj se kur të jesh duke e lexuar këtë letër të jesh ulur në zyrën tënde në kat të fundit si shef që je. Besoj se nuk i ke harruar njerëzit, me të cilët je rritur dhe takohesh me ta ndonjëherë. Gjithashtu besoj se i ke arritur qëllimet që i ke vënë gjithmone vetes, të kesh arritur çdo virtyt dhe përmbushje humane sikurse të jesh bërë një njeri dinjitoz dhe i respektuar, i cili i del për zot vetes në çdo gjë, që i vihet përpara. Ëndërroj që ti, të jesh krenaria ime që imagjinoj sot, dhe mbas 21 vitesh të qëndrojë krenar për veten time.

Me shumë besim që do kesh arritur gjithçka, Luisi 15 vjeçar.

**Luis Hysi 8D**



Ç'kemi vetja ime 35 vjeç,

Besoj se këtë çast do të kujtohet dita kur shkruajte këtë letër para 22 vitesh. Do të kujtohet e gjithë fëmijëria, filmat vizatimorë të preferuar, kur mezi prisje verën që të thahej fusha dhe të luaje me shokët futboll gjithë pasditen. Ose kur shkoje në plazh me motrën dhe me kushërinjtë. Gjithashtu dhe kur shkonim në fshat tek shtëpia e vjetër, kur ishe më i vogël dhe dilnim në darkë me xhaxhain. Kur luaje videolojra me kushërinjtë më të mëdhenj dhe gjithmonë nevrikosesh se ata ishin më të mirë. Dhe dita që na tha mësuese Imelda, e gjuhës, që të shkruanim këtë letër. Shpresoj që t'i mbash mend të gjitha këto. Po hë, e fitove punën që ëndërroje? Ndoshta ti je i zënë me punë dhe ndoshta s'ke kohë ta lexosh këtë letër, sepse doktori ka shumë punë. Besoj se i je i martuar tani dhe ndoshta ke fëmijë. Duhet ta bej këtë letër, sepse do të botohet një libër, të cilin unë do e mbaj dhe shpresoj ta ruaj deri në kohën kur të jem 35 vjeç dhe ta lexoj e të më kujtohen të gjitha gjërat që kam shkruar më lart. Nga vetja jote.

**Henri Hoxha 8D**



E dashur Sara,

21 vjet më pas, nuk e di ç'ndodhi.

Diçka e madhe, një shpërthim, një rrapëllimë, zhurmëmadhja Jetë ndërhyri në rritjen time dhe rendi... rendi... derisa ti u bëre unë, e unë... një klon i yti; origjinali i një libri të humbur mes pluhurit të viteve. Ose ndoshta, diçka tjetër ndodhi; ndonjë ngjarje e grumbulluar mes qetësisë dhe heshtjes, psherëtimës dhe pëshpërimës dhe ti u shndërrove në një metamorfozë vërtetë e frikshme, aq e frikshme sa kaloi pa u kuptuar - në një version timin që unë, me siguri s'do ta njoh pak vite më pas.

Si ndodhi? Të kujtohet? A qe e dhimbshme të shndërrohesh në Sarën 35 - vjeçare nga Sara 14- vjeçare?

Unë mbetem e njëjta, ti e di. S'besoj të jesh kurioze mbi mua, apo je? Të kujtohem unë? Të kujtohet... gjithçka?

Më pështjellon sot e ndoshta s'di në do të më përkëdhelë sedrën vite më pas. Besomë, do të doja të merrja përgjigje që tani mbi këto pyetje, mirë po... s'ndalem dot. S'i ndal dot pyetjet.

Ku je? Si je? A po më ndjek? E ndjek rrjedhën e mendimit tim? Apo jam ngatërruar aq shumë me fjalët e mia sa as ti s'di të më kuptosh më?

Sara, më dëgjon? Po bërtas. Po thërras me të madhe emrin tim, që në errësirën e humbnajës së viteve, të gjesh rrugën mbrapsht tek unë.

Mbetem kurioze, kështu përballoje me mua këtë fletë me pak fjalë mbi ç'ka ëndërroj të kesh ti.

Ëndërroj... ëndërroj që ...

-Sara?!- tejqyra e vitrinës shkëlqen, ndërsa shëmbëllimi i asaj që shoh më tulat. Jam... ajo jam unë.

-Faleminderit, - buzëqeshi. Nga ana tjetër e vitrinës, buzëqesha edhe unë. Një grua e suksesshme, ka ndërtuar një familje, shqetësohet për të shoqin dhe fëmijën. Më pas ajo del nga zyra dhe, si pa më vënë re, kalon përtej meje; hedh hapat përmes siluetës sime si të mos e njihje, si të mos kisha as masë dhe as vëllim. S'kisha as formë.

- A duhet të shkoj në kompani para se të ...

- Mos duhet të telefonoj mësuesen kujdestare të tim biri...

-Sara?!

- Mendoj se do të qe më mirë po të shkoja në shtëpi dhe të mund të ...

- Jam lodhur goxha këto kohë, ndoshta pak pushim do të më ...

-Sara! - thërras, ndërsa ajo nuk e kthen kokën, as ndalon.

Ajo s'më kujton gjatë ditës së saj, madje s'jam as pjesë e mendimeve të saj më të thjeshta. Marr të largohem nga aty, kokulur dhe shpatullkërrusur.

"Më kujtohet vetja ime... Edhe unë atëherë, sa herë lodhesha, i thoja sime mëje se më dhembte koka; me siguri edhe ime më kështu shqetësohej..."

Tërheq telefonin celular nga xhepi i xhakëtës dhe formon një numër.

-Mami? Të kujtohet 21 vjet më parë ...?



Pra, Sara. Shpresoj të më kujtosh 21 vjet më vonë. Shpresoj që, ndonëse jeta jote do të mbushet me emocione dhe ngjarje, ndonjëherë të të kujtohem unë dhe kjo letër që të dërgoj unë, kloni yt i fshirë nga hapat e rëndë të erës që merr me vete kujtimet e pakomplikuara.

Të tilla ëndërrime na mbajnë mes etiketimeve të ëndërrimtarëve, ndërsa ti e di, mendoj se e kujton ende, sa i dua unë ëndërrimtarët. Të tilla ëndërrime më mbajnë mua të gjallë në kujtimet e tua të vogla.

Me të tilla ëndërrime... do të më kujtosh mua, adoleshenten e pamësuar me monotoninë e pyetje – përgjigjeve. Sarën 14- vjeçare.

**Sara Xholi 8D**



E dashur Denisa,

Nisa të të shkruaj dhe nuk po dija se çfarë. Por vendosa që të shkruaj çdo gjë që më vjen në mendje tani. Kështu do të jetë më e thjeshtë për mua, mendoj edhe për ty. Uroj që kur ta lexosh këtë letër (nëse do ta lexosh ndonjëherë), uroj për këtë; të qeshësh, të qash, të mallëngjehesh pse jo edhe të më shash. Unë jam 13 vjeç dhe çdo gjë më duket e lehtë, ndoshta më pëlqejnë shumë gjërat që bëj, apo ambienti që më rrethon. Të them të vërtetën nuk e di ç' mund të jetë. Ndoshta shoqet e mia, që më bëjnë të qesh çdo ditë, por edhe familja ime. Tani që po e hedh në letër, nuk po më duket edhe aq e lehtë të shprehem, përkundrazi, po më duket shumë e vështirë. Kam kaq shumë pyetje, por ato do t'i lë për në fund. Ti e di që këto kohët e fundit unë kam qenë e fiksuar pas një gjëje, që vetëm ti mund ta kuptosh. Pra, nuk po ta them. Tani që po të shkruaj, po vras mendjen nëse ti e mban mend jetën dhe mendimet e mia të kësaj kohe. Unë jam tepër e çuditshme si person, jam një njeri krejt tjetër kur jam me shoqet dhe jam shumë ndryshe kur jam me familjen. Mund të pyesësh shoqet e mia nëqoftëse nuk më beson. Tani që ra fjala tek shoqet e mia, a flet akoma me to? Shpresoj që po. Të sfidoj t'i gjesh se kush janë (nëse i ke harruar sigurisht). Po djemtë i ke harruar? Po si mund t'i harrosh ata me kalamanllëqet që bëjnë? Le të flasim pak për ty. Çfarë profesioni ke? Ku e mbarove universitetin? Si është jeta jote? Epo besoj se kur ta marr këtë letër do t'i kem përgjigjet. Shpresoj që mos të të kem mërëzitur me pyetjet e mia të pafundme. Epo unë kurioze kam qenë gjithmonë. Tani i erdhi fundi letrës sime. Shpresoj që kjo letër të ka sjellë disa kujtime e nostalgji. Paçim! Do të të shoh në të ardhmen.

Të puth, Denisa

**Denisa Spahija 8D**



E dashur Megisa,  
Përshëndetje, si po ja kalon? Shpresoj të kesh qenë mirë me shëndet. Kur ta lexosh këtë letër dua që të mallëngjehesh dhe të qeshësh. Unë jam akoma 13 vjeç dhe gjërat më duken të lehta. Pyetjet e mia për ty janë të pafundme: A ke ndryshuar ndopak? çfarë profesioni ke? A shkove në Londër për të mbaruar studimet?... etj. Besoj se do të kesh ndryshuar pak. Uroj që shkollën ta kesh mbaruar me rezultate të mira dhe të jesh bërë dikushi në jetë. Shpresoj që kur ta lexosh këtë letër të jesh ulur në zyrën tënde duke pirë një kafe. Besoj se nuk i ke harruar prindërit dhe i viziton çdo fundjavë. Gjithashtu shpresoj të të jenë plotësuar të gjitha dëshirat.  
Mirupafshim pas 22 vitesh.

**Megisa Muça 8D**



I dashur Sidrit,  
Si je? Si po ia kalon? Në këto momente, që po e shkruaj këtë letër jam 13 vjeç dhe për 2 muaj do të mbush 14 vjeç. Flokët i kam të zinj e sytë kafe të errët. Jam kurioz të di; a do të jenë po të njëjta kur të jem 35 vjeç. Apo do të ndryshojnë? Këtë s'e di. Pak rëndësi ka pamja e jashtme, por ajo që ka rëndësi, është të bëhem një inxhinier, një njeri i mirë e i suksesshëm. Gjithashtu do të doja të bëhesha i pasur. Pse jo? Më e rëndësishmja është të kem një familje të madhe e të shëndetshme si kokrra e mollës. Motoja ime është: "Të ecësh para duke mos parë pas." Shpresoj me gjithë zemër që të gjitha dëshirat e mia të realizohen pavarësisht zhgënjimeve e disfatave. Me dashuri, Sidriti 13-vjeçar.

**Sidrit Demiraj 8D**



I dashur Henri,  
Unë që po të shkruaj ty jam thjesht ti në moshën trembëdhjetë vjeç. Shpresoj të mos qeshësh shumë.  
Kur po e shkruaja këtë letër po mendoja: "Si do të jem kur të bëhem tridhjetë e pesë vjeç, si do të dukem" .... Po mendoja se çfarë do të bëhem kur të rritem, por e vetmja gjë në mendje ishte që të bëhem doktor i zoti që do t'i ndihmoj njerëzit e sëmurë. E mendoj veten një djalë të ndjeshëm dhe simpatik. Të kem shumë miq të mirë dhe gazmor. Dhe dua të jem akoma një djalë gazmor. Të kem një familje të madhe me dy kalamaj simpatik dhe të lezetshëm.  
Kur të jem tridhjetë e pesë vjeç dua që të gjitha ëndrrat e mia të më realizohen.

**Henri Vishka 8D**





Përshëndetje Xhei,

Unë jam Xhei dhe në këtë moment që po të shkruaj jam 13 vjeçe, por po të shkruaj për të ardhmen time në moshën tridhjetë e pesë vjeçare, për jetën që mendoj të kem. Unë jetoj në një familje të bukur dhe të madhe, e cila ndërtohet nga unë, vëllezërit e mi dhe prindërit. Unë akoma nuk e kam vendosur se çfarë profesioni do të kem kur të jem 35 vjeçe, por ëndërroj të kem nje familje të bukur, një punë të mirë për fëmijët e mi. Dua të ndjek hapat e prindërve të mi, ndoshta mund të bëhem si mami im doktoreshë. Unë tani jam 13 vjeçe dhe po thur shumë ëndrra për të ardhmen. Unë dua të jem një nënë shembullore për fëmijët e mi, ashtu si mamaja ime për katër fëmijët e saj. Dua të jem një femër e denjë për familjen time, për shoqërinë time, për rrethin që më rrethon. Unë dua që të kem një të ardhme të ndritur. Tani për tani prokupimi im më i madh është shkolla, por kur të jem 35 vjeç preokupimi im më i madh do të jetë familja. Dua të jem një motër e denjë për vëllezërit e mi dhe dua të jem një fëmijë i mirë për prindërit e mi. Me dashuri Xhei 13 vjeçe.

**Xhiko Llanaj 8D**



E dashur Megi si po të shkon jeta?

Jeta vazhdon të jetë e bukur edhe pse kanë kaluar 35 vite. Tashmë besoj se ke nje familje. Dëshiroja shumë që kur te ishe 35 vjeç të kishe një vajzë të bukur si hëna dhe një djalë të bukur si dielli. Familja është gjëja më e rëndësishme që do të doja të kishe. Familja për mua është ilaçi i jetës së një njeriu.

Shpresoj që të kesh krijuar karrierën tënde. Të kesh miq, kolegë që të mbështesin dhe plot dashuri, të sjellin vetëm lumturi dhe adhurim për jetën. Besoj se do të kesh vazhduar ëndrrën tënde për t'u bërë arkitekthe. Edhe në qoftëse jo, kurrë nuk është vonë për të përfunduar atë që dëshiron.

E mban mend kur luaje poshtë pallatit me shokët edhe shoqet? Tani, je ulur në një stol duke parë fëmijët e tu duke luajtur së bashku. I shikon me kënaqësi dhe kujton se sa e bukur ishte fëmijëria jote. Kujton gëzimet dhe hidhërimet që ke kaluar çastet më të bukura që ke përjetuar. Tashmë ti je rritur dhe kupton rëndësinë e jetës dhe bukurinë e saj.

Do të doja të shikoja fytyrën tënde në këto momente. Do të dëshiroja të shihja në qoftëse je duke qeshur apo duke qarë. Do të doja të shikoja emocionet e tua, në momentin që po lexon këtë letër. Do të dëshiroja të fshija lotët e tu ose të ndanim të njëjtin gëzim. Por disa gjëra ngelen të pamundura...

Si përfundim dua të të them vetëm dy fjalë. Pas çdo momenti të keq ka një shpresë për lumturi. Jetoje jetën ashtu siç dëshiron ti.

Me dashuri Vetja.

**Megi Lamçe 8E**



Përsëndetje Alvi,

U rrite tani, u poqe, je bërë burrë. E mban mend veten të vogël? Epo kjo letër do të të rikujtojë pak fëmijërinë tënde....

Ti ishe një djalë i urtë, i dobët, i cili studionte në kolegjin "Turgut Ozal". Kishe shumë shokë e shoqe nga klasa si dhe nga paraleli, por shokët e tu më të mirë ishin Klevi, Metjoni, Tedi, Mateo, Eriku, Ergi dhe Paolo, me të cilët kaloje pjesën më të madhe të pushimit, por edhe me pjesën tjetër kishe marrëdhënie shumë të mira.

Ty të pëlqente shumë të luaje futboll çdo fundjavë, si dhe të luaje me PlayStation. Klubi yt i preferuar ishte Fc Barcelona dhe idhulli yt ishte legjenda Leo Messi. Kur të rriteshe, ti kishe dy dëshira të bëheshe futbollist ose biznesmen.

Pak a shumë ky ishe ti. Me këtë letër që e ke shkruar vetë, ke përshkruar fëmijërinë tënde, të cilën me shumë mundësi ti do të doje të kthehej përsëri.

Me shumë respekt dhe dashuri, Alvi 13-vjeçar.

**Alvi Kalia 8E**



E dashur Megan në të ardhmen,

Kjo është pak e çuditshme, t'i shkruash një letër vetes tënde, por ja ku është! Si je? Nuk mund ta imagjinoj dot jetën time në të ardhmen. Prapëseprapë jam e sigurt, që nuk kam ndryshuar shumë. Tani unë jam në klasë të tetë dhe ti tani duhet të kesh mbaruar shkollën e universitetin, shpresoj të mos jesh lodhur shumë! Kam një parandjenjë që ti je duke qeshur në këto momente me këtë letër dhe mënyrën se si ajo është shkruar, si edhe me mendimet e një 13-vjeçareje. Në fillim dua të të pyes për prindërit, si janë dhe si po ia kalojnë? Përsëndete vëllain për mua, si është ai? Të kujtohet shkolla, se si stresoheshe për provimet kaq të thjeshta, kushedi se sa i vështirë do të ketë qenë universiteti. Po shoqet a i mban mend? Duke të njohur ty akoma i ke për zemër. Kam disa pyetje për ty:

1. Çfarë shkolle zgjodhe përfundimisht? Në çfarë universiteti shkove?
2. A je e lumtur?
3. Ke ndonjë gabim ose diçka që do të doje të mos e kishe bërë?
4. Çfarë është gjëja më e bukur në të qenit e madhe?
5. A e mban mend Naruton? A shikon akoma anime?

Kam edhe disa këshilla që dua të t'i jap. Ji e fortë dhe beso në veten tënde! Shpresoj që kjo rrugë që ke zgjedhur është ajo që ti vetë dëshiron që të mos mërzhitesh asnjëherë. Vazhdo të jesh ai fëmija optimist që ke qenë dhe gjeje anën pozitive në çdo gjë. Por gjëja më e rëndësishme është se dua të jesh e lumtur, unë do të jem gjithmonë aty me ty.

E vetmja dhe e jotja, Megan.

P. S. Mos e harro këtë letër!

**Megan Duraj 8E**



Ç'kemi Ergo? Si je? Si të shkojnë bizneset? Familja mirë? Të kujtohet kur i kishe flokët e verdha dhe me ato sytë blu rrezatues që të gjithë t'i pëlqenin. Studioje në shkollën "Turgut Ozal Collage". Po në klasën e 8-të, kur nuk ishe mirë me mësimet të kujtohet? E di që u mërzite shumë, po gjithçka kaloi shumë mirë, po ato gallatat që bëje me shokët. Të kujtohet kur dilje me shokët, por ti shumicën e rasteve nuk ishe, sepse shkoje tek nona. Po kur kishe orën e Turqishtes, që ishte lënda që ti nuk preferoje. Mban mend që në klasën e 8-të, kishe zysh kujdestare mësuese Imeldën, që gjithmonë thoje që është një nga zyshat më të mira. Gjëja që preferoje gjithmonë ishte të shtyje testet, gjithashtu dhe kur zyshat të lavdëronin. Gjithmonë synimi yt ka qenë të mbroje të tjerët. Ajo, për të cilën mërziteshe më shumë, ishte kur ndonjë zysh mund të të merrte inat dhe ajo, që ti nuk pëlqeje nga shkolla, ishte mbingarkesa e tepërt në mësimet. Gjithmonë thoje që në shkollë edukata është parësore, sepse shkolla është një institucion arsimor dhe nëse një nxënës bëhet njeri i mirë, mund të bëhet dhe i zoti. Siç thoshte dhe mësuesja jote kujdestare, e rëndësishme është të edukojmë njerëz dhe qytetarë të mirë, se mësimet aty janë. Po e mbyll këtu letrën. Të uroj suksese në punë dhe të fala familjes.

**Ergi Kupi 8E**



Ç'kemi Flori.

Çfarë ke bërë kohët e fundit. Si po të duket jeta jashtë kufijve të "Turgut Ozal". A ke vazhduar të shikosh më video me BOX? Cilat janë pasionet që ke zhvilluar gjatë këtyre viteve? Çfarë universiteti zgjodhe? Shpresoj të kesh arritur atë që do dhe siç e thoje dhe vetë; kurrë mos u dorëzo në jetë. A ke vazhduar të luash më basketboll siç luaje dhe më parë? Po me futbollin si ke vazhduar. Shpresoj mos t'i jesh ndarë portës asnjëherë. A i ke vazhduar studimet jashtë vendit apo ke vazhduar në Shqipëri. A je takuar me kushërinjtë shpesh, siç bëje i kur ishe i vogël? Shpresoj mos t'i kesh prishur marrëdhëniet me Vinin, sepse me të ke kaluar të gjithë fëmijërinë duke luajtur me biçikleta, telefona dhe me grushta ndonjëherë. Po me vëllain je takuar shpesh apo ka ikur me punë jashtë vendit, siç ka ëndërruar gjithmonë. Po me motrën e vogël dhe prindërit si je. Çfarë na thua ndonjë gjë nga shoqëria në Burrel. I ke takuar më xhaxhallarët si gjithmonë? Po dajat? Mos i harro kurrë personat e tu më të dashur, por as shoqërinë mos e harro, sepse ata do të të duhen gjithmonë. Shpresoj t'i kesh lënë budallallëqet dhe të kesh ulur kokën. Po me familjen tënde tani si e ke? Besoj se je martuar dhe ke bërë fëmijë. Shpresoj shumë t'i kesh ruajtur gjërat kryesore që ke pasur në fëmijërinë tënde. Gjithashtu do të të thoja që mos të fokusohesh tek diçka që të pëlqen deri në momentin kur ta marrësh.

Nga vetja jote 13 vjeçare!

**Florjan Çollaku 8E**



E dashur Amela,

Tani ti je një vajzë e madhe dhe e pjekur, por besoj se të kujtohen çastet e fëmijërisë. Të kujtohen ato momentet e bukura dhe besoj se i kujton me mall. Besoj se i mban mend pjesëmarrjen në ato konkurse e festivale të mrekullueshme. Mendoj që ke mbaruar shkollën e lartë për financë dhe shpresoj se po vazhdon edhe rrugën e bukur të këngës. Tani që je rritur je edhe më e pjekur, por ëndrrat që ke patur në sirtar, kur ke qenë e vogël t'i realizosh. Edhe pse je rritur, mendoj që në zemrën tënde, je po ajo vajza e vogël me mikrofon në dorë.

Shpresoj të jesh e lumtur gjithmonë.

Me dashuri, Vetja jote.

**Amela Agastra 8E**



E dashur Amina,

Nëse po e lexon këtë letër, uroj të të ketë gjetur shëndoshë e mirë dhe me çdo qëllim që i kishe vendosur vetes të përmbushur.

Uroj të kesh arritur nivelet akademike që gjithmone dëshiroje, si ashtu të kesh krijuar karrierën e jetën perfekte, që gjithmonë doje të arrije. Kam shumë pyetje: Ke arritur deri në këtë ditë?

U diplomove nga univeristetet më të mira? U bërë kirurge? Të pëlqen puna jote?

A je e suksesshme? A je rrethuar me persona pozitivë dhe të përkushtuar?

Apo mos vallë çdo gjë ka marrë ndonjë kthesë të papritur. . .

Kam shumë pyetje për ty, e mund të vazhdoj me orë me radhë, por gjëja kryesore që dua të di është: A je e lumtur?

Përqafime nga Amina!

**Amina Haka 8E**



Ç'kemi Anxhela,

Këtë letër po ta shkruaj që ta lexosh kur të arrish 35 vjeç. E di se na ndajnë shumë vite, por do më pëlqente ta lexoje. Tani që po të shkruaj jam 13 vjeç, studioj në kolegjin "Turgut Özal" dhe jam në klasë të 8-të. Në këtë letër do shkruaj disa këshilla që dua t'i zbatosh. Si fillim nuk dua që t'i besosh të gjithëve, por vetëm atyre personave që të kanë ndenjtur gjithmonë pranë. Gjithashtu dua të kesh vetëbesim. Në moshën 35 vjeç, gjithçka do të jetë më e vështirë prandaj dua të jesh e fortë dhe të punosh shumë për të ardhmen tënde dhe të familjes tënde. Unë kam besim tek ty dhe e di se mund t'ia dalësh mbanë. Me dashuri,

**Anxhela Reçi 8E**



E dashur Çeljeta,

Ç'kemi, si je? Besoj se më mban mend mua, dmth, veten në moshën 14 vjeçare. Doja të të bëja disa pyetje si kurioze që jam. Dua të di si do të jetë e ardhmja ime. A do të jetë ashtu si dua dhe imagjinoj unë? S'besoj se të vjen keq të filloj tani.

Çfarë profesioni ke? Punon në zyrë besoj, se s'para të pëlqen të lodhesh, flas për veten në këtë moshë. Shpresoj që të kesh dalë mirë dhe në shkollë, se në klasë të 8-të, nuk të pëlqente shumë të mësoje. Po tani, ku jeton? Seriozisht, shpresoj të më thuash që jeton diku në Amerikë apo Gjermani, pasi e ke pasur ëndërr që e vogël këtë. Mami dhe babi si janë me shëndet? Po Fatjoni? A kanë ndryshuar nga pamja? Për sa i përket Fatjonit, jam kurioze të di a i kanë vlejtur aq shumë mësimet, se nuk para merrej me gjë tjetër kur ishte i vogël (akoma nuk merret jam e sigurt). Se harrova fare, po Sara si është? Ma puth fort.

Tani të kalojmë te pjesa tjetër: Familja. A ke krijuar një të tillë? Nëse po, cilët janë anëtarët e saj? M'i përshkruaj pak. Jam shumë kurioze t'i njoh.

Po nga pamja fizike a ke ndryshuar shumë? Shpresoj që je bërë siç ke dashur. Duhet të iki tani, pasi sapo kam ardhur nga stërviçja dhe jam e lodhur.

Të përqafoj, vetja jote 14 vjeçare.

**Çeljeta Hodo 8E**



Përshëndetje Edor,

Tani që po e lexon këtë letër duhet të jesh një djalë 35 vjeçar. Kur ti ishe një fëmijë i vogël, ishe i urtë e fjalëpak e duheshe shumë me motrën tënde të vogël. Por shpeshherë, ti krijoje dhe situata humoristike dhe prindërit qeshnin me shakatë e tua. Tani ti me siguri duhet të kesh krijuar një familje, ku të kesh një vajzë të vogël dhe një djalë pak më të madh. Familja jote ty të do shumë, sepse ti je një njeri i dashur e nuk zemërohesh kurrë. Ti je një prind që mesazhet i jep me vepra e jo me fjalë e je shumë i përkushtuar ndaj punës. Ti duhet të jesh bërë një doktor i famshëm që shëron njerëz nga të katërta anët e botës. Me siguri ke hapur spitalin tënd, të cilin e ke ëndërruar që i vogël. Shpresoj që të ndjekësh dëshirat dhe pasionet e tua gjatë gjithë jetës, pavarësisht se çfarë thonë njerëzit e tjerë. Shpresoj të ngjitesh lart e më lart nga sukseset e tua.

Me dashuri Edori 13 vjeçar.

**Edor Shehu 8E**



Përsëndetje Eni!

E mban mend?

Kështu të thërrisnin të gjithë kur ishe e vogël.

Kjo letër shpresoj të të sjellë kujtime të bukura...

Dikur ke qenë një vajzë e urtë dhe e qetë. E mban mend sa shumë që grindeshe me vëllain? Pyes veten si është marrëdhënia jonë tani. I mban mend shokët dhe shoqet, shakatë, të qeshurat, zënkat? Shpresoj të kesh shoqëri akoma me ta. Po mësueset? I mban mend? Mësuesja e fizikulturës të thoshte sa herë që të shihte "kapi flokët". Ha ha ha. E mban mend mësuese Adelajdën? Ajo ishte mësuesja jote e parë kujdestare në kolegjin "Turgut Ozal". Tani që po të shkruaj je në klasë të tetë dhe mësuesja jote kujdestare, është mësuese Imelda. Edhe mësuese Irisin nuk besoj se e harruar.

Ty të pëlqente të shihje filma nga mëngjesi deri në darkë. Të pëlqente të lexoje libra e të dilje me shoqet në fundjavë, por më shumë nga të gjitha të pëlqente të ngacmoje vëllain tënd. Nuk na gjeje asnjëherë si duhej. Nuk e di si do të jetë kur të rritet, por për mua, ai do të ngelet gjithmonë vëllai i vogël e ngacaman. A gatuan akoma aq shumë si kur ishe e vogël? Ty të pëlqente shumë të bëje ëmbëlsira nga më të ndryshmet e të eksperimentoje me ushqimet dhe me shijet. Ambienti i preferuar në shtëpi ishte gjithmonë kuzhina. Parapëlqej të silllesh si shef në kuzhinë, duke përdorur aparatura e jo gjëra të thjeshta. Gjithmonë mami të bërtiste kur ti gatujesh dhe më pas nuk e pastroje rrëmujën që kishe bërë.

Jam shumë kurioze të di se çfarë po mendon tani? Ndoshta po qan nga mallëngjimi e ndoshta po qesh nga marrëzite e tua. Nuk i dihet.

Me pak fjalë kjo ishte fëmijëria jote... shpresoj t'i mbash mend, sepse këto janë edhe momentet më të bukura të jetës dhe duke të njohur mendoj se do të doje t'i përjetoje përsëri.

Me shumë shumë dashuri, Eni e vogël.

**Enisa Dalipi 8E**



Përsëndetje,

Unë jam Klevis Meçaj dhe jam 13 vjeç. Unë i pëlqej shumë videolojrat sidomos Fifa 17 dhe Gta V. Me pak fjalë, unë jam ti para 22 vitesh. Me mësim jam mirë dhe pëlqej të dal me shokët javë për javë. Ne bëjmë shumë gallata kur dalim, gjithashtu edhe mërzhitemi ndonjëherë, sepse disa nga shokët nuk vijnë shumicën e kohës. Tipi im është që jam i sinqertë, por edhe bëj humor. Disa nga shokët e mi të ngushtë janë: Mateo, Tedi, Eriku, Ergi, Alvi, Metjoni, Paolo etj. Si përfundim desha t'ju pyesja se si jam unë në të ardhmen? A kam punë të mirë? A vazhdoj të shoqërohem me shokët e klasës?

Me dashuri Klevisi (Ti i vogël).

**Klevis Meçaj 8E**



I dashur Fatjon,

Si jeni? Ku jetoni tashmë? Si është vendi? A ka shumë trafik? A ka destinacione turistike apo pamje tërheqëse? Ku banoni? Në apartament apo në vilë? Po prindërit me shëndet si janë? Po pyes, sepse shëndeti është gjëja parësore në jetën e njeriut. Jeni diplomuar gjithashtu? Keni tashmë një punë tuajën? Punoni me kohë të plotë, me kohë të pjesshme apo me turne?

Të mungojnë shokët e tu të dikurshëm? Të merr malli ndopak për vendin tënd, për atdheun tënd të shtrenjtë? E ke ruajtur apo humbur natyrën tënde fëmijërore? Po motra jote si është? I thuaj se e dua shumë si gjithmonë edhe pse nuk para ia them shpesh këtë gjë.

Shpresoj që t'i përgjigjeni këtij deti pyetjeje, të jeni mirë dhe sidomos ti.

Me dashuri, Vetja jote, Fatjoni.

**Fatjon Hodo 8E**



I dashur Kristi,

Unë jam Kristi 13 vjeçar. Unë jetoj në Tiranë. Jam nxënës në klasën e 8E, studioj në Kolegjin "Turgut Ozal". Lënda ime e preferuar është matematika dhe jam zgjedhur për të marrë pjesë në olimpiadën e matematikës. Gjithashtu më pëlqen të dal të flas me shokët dhe të luaj sporte të ndryshme.

Tani ti je 35 vjeç, je më i rritur dhe i pjekur. Ndoshta ti nuk ke një profesion, i cili lidhet me matematikën. Mund të jesh i martuar dhe të kesh fëmijë. Ajo, për të cilën po të shkruaj është këshilla më e mirë e dhënë nga një fëmijë: Mos i harro ëndrrat e fëmijërisë dhe fëmijërinë tënde, sepse janë dy gjëra shumë të rëndësishme në jetë.

Me dashuri,

**Kristi Civici 8E**



Po të shkruaj unë ose ndryshe ti në moshën 13-vjeçare, klasa e 8E. Desha të shikoja nëse ti i ke harruar ëndrrat e fëmijërisë. Pa më thuaj e ke harruar dëshirën për të luajtur me top? Po anime a shikon më apo të duken gjëra fëmijërore tani që je rritur? A ke mësuar si të ngasësh makinën? Çfarë makine ke? Po avionët a mësove t'i pilotosh? Çfarë profesioni ke zgjedhur? U, se për pak harrova; botën tani që je rritur e shikon përsëri me ngjyra si në moshën time? Po mos ndoshta duke qenë se u rrite nuk ka më aq shumë ngjyra bota për ty? Po ndonjë gjë interesante që ke bërë midis këtyre viteve, çfarë është? Kush është presidenti i Amerikës në kohën tënde, se ne, në 2016 jemi mërzhitur shumë që fitoi Trump-i. Po në provime lirim si dole? Çfarë gjimnazi ndoqe më vonë? Po universitetin ku e bërë? Nëse ka ndonjë pyetje që s'e kam shkruar, kujtoje vetë se unë tashi u lodha duke të shkruar.

Mirupafshim vete 35-vjeçare, nga kalamani që ke qenë ti.

**Livia Bezati 8E**



Përshëndetje Mateo....

Unë jam Mateo dhe jam 13 vjeç. Studioj në shkollën "Turgut Ozal". Po e shkruaj këtë letër, që kur të shkoj 35 vjeç ta lexoj dhe mos të bëj më gabimet që bëj tani. Disa këshilla për veten time si për shembull; të kem vetëbesim, të kem shokë të vërtetë dhe jo mosmirënjohës, etj. Sportet e mia të preferuara janë futbollin, basketbollin dhe ping pongu. Shpresoj që deri atëherë të kem të njëjtat mendime edhe dëshira për këto sporte. Dua që të punoj shumë, në mënyrë që të kem një të ardhme shumë të mirë. Duhet që për këtë të mësoj shumë dhe t'i vë vetes forca, gjithashtu edhe qëllime të caktuara. Shpresoj që ti, ta lexosh këtë letër në kujtimin e fëmijërisë tënde edhe të filllosh të qeshësh e gëzohesh. Me shumë dashuri për ty.

**Mateo Mane 8E**



Përshëndetje Metjon,

Tani je bërë burrë, je bërë 35 vjeç. Ke hapur biznese. Tani je pjekur. E mban mend veten kur ishe i vogël? Ishe një fëmijë i vogël bjond, që skuqeshe shpejt. Mësoje, por në klasë të 8-të re nga mësimet. U dembelose pak. Studjoja në shkollën "Turgut Ozal". Kisha shumë shokë si Alvin, Mateon, Tedin, Klevisin, Erikun, Ergin. Ata ishin shumë shokë të mirë. Gjithmonë rrija me ata, madje edhe dilnim çdo të shtunë. Bënim gallata, ndanim gëzimet, shqetësimet bashkë dhe ndihmonim njërin tjetrin për çdo gjë. Tani jam akoma shok me Endin, s'më besohet, 35 vjet shok. Ah, sikur të ekzistonte edhe një mundësi që jeta të kthehej mbrapsht dhe të shijoj dhe njëherë fëmijërinë. Me dashuri, Vetja jote.

**Metjon Agastra 8E**



E dashur Greis,

Kur të jesh duke lexuar këtë letër, do të thotë se tashmë je 35 vjeç dhe do jesh rritur.

Kurrë s'kam dashur të rritem, besoj se ti tani ndihesh ndryshe, pasi pikëpamja jote mbi jetën ka ndryshuar. Brenda vetes gjithmonë kam qenë pak fëmijë, jam përpjekur të ruaj gjithmonë dhe besoj se do ta ruaj dhe tek ti. Tani do të të shpreh dëshirat e mia si adoleshente. Vendosi shenjë nëse i kam plotësuar: Krijimi i një familjeje të madhe.

Fëmija i parë/djali (shpresoj) ta ketë emrin Hektor.

Mbarimi i shkollës dhe të qenurit një avokate.

Të kem gjithmonë pranë prindërit.

Ikja në vend tjetër për jetë më të mirë.

Më së shumti se çdo gjë, shpresoj që kjo letër të të gjejë shëndoshë e mirë dhe të lumtur.

Me dashuri, Vetja jote më e vogël.

**Greis Alla 8E**





E dashur vetja ime pas 21 vitesh!

Unë që po të shkruaj jam pikërisht ti, por në moshën 14 vjeçare. Si ia ke kaluar këto 21 vite? A ka ndryshuar ndonjë gjë? Vazhdon të jesh e apasionuar pas telefonit? A je zgjatur ndopak? A je shëndoshur apo dobësuar? Po rrudhat a të kanë dalë? Po prindërit që të thonë akoma sa herë të shohin, "ulu e mëso"? Jam tepër kurioze të të shoh, në mënyrë që të di se ç'më pret në të ardhmen. Shkollën për çfarë e mbarove? Mesa duket e vendose se ç'degë të marrësh. Po fëmijët si i ke? A është ndonjëri në fazën e adoleshencës? Të këshilloj të bëhesh prind i mirë, mos të ndjekësh shembullin e disave. Ehhh. . . sikur të mund të dija si është bota në ato vite!

Me respekt, Vetja jote në të shkuarën.

**Nadia Kola 8E**



E dashur, Livia,

Kur ti ta lexosh këtë letër, do jesh mjaftueshme e rritur për të kuptuar se çfarë do në jetë dhe çdo të arrish. Jam e sigurt se kur ta marrësh këtë letër do jesh duke qeshur se çfarë ka shkruar Livia 13-vjeçare.

Kur të jesh duke lexuar këtë letër, besoj se do jesh në një vend që ke gjetur lumturi, qetësi e rehati. Dhe pse tani je plot tridhjetë e pesë vjeç, je prapë e re, pasi ke të gjithë jetën para të gëzosh atë që mbolle. Besoj se tani duhet të kesh dhe fëmijë dhe jam e sigurt se i do me gjithë shpirt. Mos harro të takosh dhe mamën dhe pse tani është mbi të gjashtëdhjetat, jam e sigurt që dashuria juaj për njëra-tjetrën s'ka ndryshuar fare. Shpresoj që t'i kesh përmbushur të gjitha pikësynimet, të jesh një gazetare e suksesshme, të vizitosh vende të bukura dhe më e rëndësishmja të kesh gjithmonë familjen përkrah.

Me kaq po e mbyll! Shpresoj kur ta gësh këtë letër të jesh krenare për gjithçka që ke arritur, sepse jam e bindur që ti do t'i arrish të gjitha. Gjithashtu mendoj se kjo letër është dhe për të voglën Livia. Ndoshta si një rikujtim.

Do takohemi shpejt! Me dashuri Vetja jote.

**Livia Vokshi 8E**





Ç'kemi Arba,

Vendosa të të shkruaj një letër. Jam, unë, domethënë ti vetëm se 13 vjeç. Si je? Pyes veten se çfarë je duke bërë në këto momente, ndoshta po punon ose je me pushime. Çfarë pune po bën? Mos vallë je bërë një biznesmene ose një arkitekthe? Nuk i dihet se çfarë profesioni ke zgjedhur. Besoj se deri tani e ke mbaruar shkollën, lum si ti. Unë akoma nuk kam mbaruar 9-vjeçaren. Jam kurioze të di si dukesh, si vishesh, etj. Deri tani ndoshta ti ke krijuar edhe familjen tënde. A ke fëmijë dhe nëse po, djalë apo vajzë? Sa vjeç janë? A të ngjajnë? Jam kurioze të di, çfarë po mendon tani që po lexon këtë letër. Mos vallë kanë gjetur kurën e kancerit apo është zbuluar një planet i ri? Asnjëherë nuk i dihet se çdo të ndodhë në të ardhmen, mund të ketë filluar lufta e tretë botërore ose janë zbuluar alienët. Të uroj më të mirat dhe shpresoj që të gjitha dëshirat e tua të jenë plotësuar.

**Arbeas Luar Braha 8F**



E dashur unë,

Po të shkruaj ulur në karrigen e bardhë, mbështetur mbi tavolinën ngjyrë blu të dhomës tënde (asaj më të madhes në shtëpi domethënë). Nuk e di a do t'i mbaje mend, kështu që t'i rikujtova pak. Shpresoj të kesh arritur diçka në jetë, por edhe nëse jo, nuk të gjykoj dot, sepse fundja fundit unë jam ti. Nejse... Nuk e di a e mban mend bankën e parë, rreshti nga dritarja dhe ke 3 vjet që historikisht aty ulesh. Nuk e di a e mban mend Çobon, shokun tënd të ngushtë apo Debon, që tani nuk kalon dot një minutë pa i folur apo qoftë edhe pa e parë në sy. Nuk e di çfarë ka ndryshuar tek ti, por shpresoj që karakteri këmbëngulës, i pavarur, moskokëçarës dhe guximtar mos të kenë ndryshuar. Ejji, mbaj mend '8E 2015-2016' mos guxo ta harrosh. Mos harro fjalën 'nuse'... Këto mos i harro, të tjerat do ndryshojnë dhe do harrohen me kalimin e kohës. E di që duhet të kalosh plot 22 vjet, që të marrësh vesh çfarë do jetë bërë me ty. E di që do kem 22 vjet përpara të mbushura me rrugë të llojeve të ndryshme, kështu që po ia lejoj kohës të më tregojë çfarë do ndodhë me mua. Mos më harro mua, Darlin feminare, TI.

**Darlin Muka 8F**



I dashur Grei,

Kanë kaluar plot 22 vite dhe kjo letër tani ka mbërritur tek ty. Në fund të fundit, dihej që një ditë do ta merrje, sepse koha vazhdon të ecë, çdo gjë e ka një fillim dhe një fund. Koha ka ndryshuar, të përbashkëtat midis nesh po ndalojnë së ekzistuari.



Ne jemi ndryshe: Unë jam një 13-vjeçar, i cili thur çdo ditë ëndrra dhe është i mbushur plot objektiva që dua të arrij në të ardhmen. Objektiva, të cilat, po i arrin e po i përjeton ti tani.

Për mendimin tim, ti po jeton një jetë pothuajse përfekte në këto momente. Ti ke një familje të lumtur e të mahnitshme, një punë ideale. Ti je i rrethuar nga lëvdatat, nga miqtë e mirë. Ti je i suksesshëm në jetën tënde, por mos harro se dhe ti je krijimi i një ëndërrimtari.

**Grei Lamçe 8F**



Përshëndetje Henri,

Si po ia kalon? Si je me shëndet? Po fëmijët dhe gruaja si janë? Në shkollë mirë? Në të njëjtën shtëpi jetoni? Po në punë si po ia kalon? Je shef departamenti ashtu siç ke pasur ëndërr? Ke botuar botimet e tua shkencore siç ke pasur dëshirë? A ke arritur aty ku ke dashur në fushën e neurokirurgjisë? Unë asgjë interesante, por vazhdoj të studioj që ti të arrish ato që ke dashur gjithmonë, që të bësh prindërit krenarë për ty.

Po me sporte a vazhdon të merresh? Më kujtohet të pëlqenin artet marciale, uroj që të vazhdosh akoma të të pëlqejnë. Henri, jeta jote është një shembull i një njeriu të kompletuar në familje dhe karrierë. Uroj që dhe fëmijët e tu të ndjekin hapat e babait të tyre, ashtu siç dua dhe unë. Uroj që djali yt të bëhet neurokirurg si babai dhe gjyshi i tij.

Uroj të shihemi së shpejti, TI.

**Henri Olldashi 8F**



Përshëndetje Leonard,

Ka kaluar shumë kohë, nga koha që e kam shkruar këtë letër. Me siguri ti je rritur, je bërë djalë i matur dhe i suksesshëm. Rruga për të ardhur deri këtu, do të ketë qenë e gjatë dhe e vështirë. Por dua të të kujtoj disa gjëra nga e shkuara.

Mos harro fëmijërinë tënde, ajo ka qenë e lumtur. Gjithmonë ke qenë i rrethuar nga njerëzit që të falnin dashuri, shumë shokë të mirë, por ndonjëherë edhe vështirësi të vogla. Të qenit i rrethuar nga këta njerëz, për ty ka qenë një lumturi. Këtë mirësi u mundove t'ua japësh edhe njerëzve të tjerë. Doja të të pyesja, a vazhdon të jesh ende djali i dikurshëm? Besoj se po, por më i rritur dhe më i pjekur në mendime.

**Leonard Kollçaku 8F**



E dashur Dea,

Nuk dua të zgjatem dhe të them gjëra pa kuptim. Të vetmet gjëra që dua të të them janë: dua që ta shijosh jetën sikur të ishte dita e fundit e jotja (siç e bëj gjithmonë) dhe dua që të mos të të intersojë mendimi i të tjerëve, siç më intereson tani. Mendoj se tani e ke kuptuar mentalitetin e vendit tënd dhe shpresoj që të jesh duke jetuar në vendin ideal për ty. Nuk e di çfarë ke vendosur për shkollën dhe jetën, po në moshën 13 vjeçare, ke dashur të vazhdosh për shkenca politike dhe të (jetosh) domethënë që të "bredhësh" gjithë botën.

Edhe pse duhet të jesh larg familjes, mamit dhe babit, e di që i do më shumë se çdo gjë, edhe pse nuk e shpreh. Uroj që Danielin ta kesh patur gjithmonë afër dhe mos të bëni më ato "luftërat" që dilnit të dy me të nxira. Jam shumë e sigurtë që shoqëria jote me Loren vazhdon edhe sot. Dhe shpresoj ta keni bërë atë udhëtimin në Amerikën Latine, se e keni patur fiksim.

Në qoftëse ke krijuar një familje tënden, do isha shumë krenare, sepse e di që ti je njeri shumë i ftohtë dhe i ke super inat kalamajt e vegjël. Besoj se do kesh gjetur ndonjë punë që të përshtatet dhe të jesh duke e jetuar jetën kështu siç e mendoj unë ta jetoj.

Shpresoj që të kesh ngelur ai "robi" që është gjithmonë rehat, që vishet gjithmonë si djalë, (përveçse kur del ose ke ndonjë rast). Do të të thoja dhe për ca njerëz që të mos i harroje, po këtë letrën kanë për ta lexuar shumë veta :P. Dea 13 vjeç.

**Dea Gjermani 8F**



E dashur e Liel,

Më duket pak e çuditshme që po të drejtohem kështu, por kam shumë dilema dhe kërrshëri për jetën time. Më ndodh shpesh të mendoj veten 20, 25 apo 35 vjeç. Pikërisht ty po të shkruaj. Ty, Lielit 35 vjeç. Me çfarë merresh në jetë? Besoj se shkollën e ke mbaruar shumë kohë më parë. Shpresoj ke zgjedhur profesionin që ke dashur, për të çuar përpara punën e sakrificat e familjes. A ke miq e shokë rreth vetes, që të duan dhe i do? Sigurisht tani do të kesh krijuar familjen tënde të re.

Po në ato vendet që endërroj unë tani, por edhe në të tjera a ke shkuar?

Mbi të gjitha të uroj me gjithë zemër që të jesh mirë me shëndet ti dhe të gjithë njerëzit që të rrethojnë. Duke uruar që vështirësitë mos të ndalin, duke shpresuar se hapat e jetës do t'i hedh të sigurt. Po e mbyll letrën time me kaq sot, herë tjetër do të shkruaj shumë më shumë....

Të përqafoj.

**Liel Dojaka 8F**



E dashur Deborah,

E di që e ke inat kur të thërrasin me emër, por vendosa të tentoj të të shkruaj, pasi të them të drejtën, nuk ia kam idenë se çfarë do të të them. Nuk e di se ku je apo a do të arrish ta marrësh këtë letër, por thjesht shpresoj të jesh mirë. Shpresoj të kesh punën që të bën ty të lumtur, pasi tani unë as ia kam idenë se çfarë dua të bëj. Shpresoj të kesh vizituar shumë vende, sidomos Kinën dhe Indinë. Shpresoj që të kesh fëmijë, edhe pse tani me duken shumë të mërzitshëm, shpresoj të kujdesesh dhe t'i duash ata, gjithashtu shpresoj të kesh gjetur një njeri, që të do pafundësisht dhe të respekton. Shpresoj të mos ta harrosh familjen dhe të shkosh në shtëpi për Krishtlindje. Shpresoj të kesh shuar kureshtjen për gjërat më të vogla që tani dua t'i shoh e t'i provoj. Shpresoj që të jesh akoma ajo Deborah, që nuk do të shkojë në shtëpi para orës tetë dhe që i pëlqen deti me dallgë. Shpresoj që të kesh provuar akulloren me mente, të cilën e urrej. Mbi të gjitha këto, shpresoj të mos ndihesh bosh, shpresoj të ndihesh e plotë dhe e lumtur. Shpresoj t'ia dish vlerat vetes dhe ta duash atë. Shpresoj t'i kesh arritur ato që do. Shpresoj që të gjitha këto t'i kesh bërë për veten dhe jo për të tjerët. Besoj se kaq kisha çfarë të të thoja. Disa të tjerë do të shkruanin letra të gjata për veten e tyre, duke pyetur për të ardhmen, por unë kaq kisha. Nuk dua t'ia di se çfarë do ndodhë më vonë. Tani për tani jam kjo që jam dhe kam shumë për të jetuar në të tashmen prandaj s' duhet të mendoj për të ardhmen. Më pëlqen kur të shkruaj, është e lehtë dhe një ndjenjë e ngrohtë. Më duket sikur të njoh, por as ia kam idenë se kush je. Me shumë dashuri, ti.

**Deborah Drenofci 8F**



Përshëndetje Geri,

Do të dua të kem një shtëpi të madhe dykatëshe, me dhoma të gjera, me mobilje të këndshme. Ngjyrat e dhomave të jenë të kombinuara me mobiljet dhe të ketë piktura të bukura. Pamja jashtë e shtëpisë të jetë me ngjyrë jeshile. Oborri i shtëpisë të jetë i madh, me pemë, lule dhe me hapësire të bollshme. Do dua ta kem edhe nje qen, sepse i dua shumë kafshët. Do të dua të luaj më shumë me lojra elektronike, por prindërit më lejojnë vetëm nga një orë në fundjavë. Do të dua të dal vetëm në lagjen afër shtëpisë, por prindërit kanë merak, pasi trafiku i makinave është i rënduar dhe ndodhin mjaft aksidente në rrugë. Nëpër lagje të ketë më shumë parqe për fëmijë, ku ne mund të luajmë dhe të shëtisim me biçikleta. Rrugët të jenë më të pastra dhe në rrugët kryesore të ketë më shumë kosha të vegjël, që njerëzit të mos i flakin në tokë mbeturinat. Mirutakofshim!

**Geri Lufi 8F**



I dashur Ervis,

Këtë letër, ti do ta marësh kur të kesh mbushur 35 vjeç. Ti tani po e lexon këtë letër me vëmendje e me kureshtje. A e mban mend kur ke qenë 3 vjeç, kur vrave syrin dhe fillove të qaje, ose kur mbushe 4 vjeç dhe mësove t'i jepje biçikletës. Mami dhe Babi ishin krenarë për ty, po ashtu do të jenë tani që je 35 vjeç. Thoshe se do të bëheshe një biznesmen i madh. Shpresoj të kesh arritur dhe të jesh krenar. Kur ke qenë i vogël, doje të lindje një vajzë dhe një djalë, e po shpresoj të jetë plotësuar dëshira. Të uroj të kesh një grua fisnike dhe besnike siç ke dëshiruar këtë gjë që i vogël. A e mban mend kur luaje hapa dollapa i vogël, sa gëzoheshe, ose kur luaje futboll ose kur fshiheshe tek "Shtëpia e Bardhë", me shokët e lagjes. Shpresoj që t'i mbash mend këto kujtime fantastike që ke kaluar. Tani ti duhet të jesh i zënë me punë e duke menaxhuar biznesin tënd të madh edhe duke zgjidhur problemet familjare ose duke shpenzuar kohë me gruan dhe fëmijët. Fëmijët do të kenë falur shumë gëzim në jetë dhe ju do të jeni prindër shumë të mrekullueshëm për fëmijët e tu, siç ishin prindërit tanë për ne. Mami e Babi kujdesen për fëmijët, kur ju jeni në punë dhe fëmijët duhet t'i duan shumë gjyshërit e tyre. Vëllai yt si gjithmonë kujdesej për ty edhe besoj se edhe tani është shumë i dashur me ty, familjen dhe nipërit. SHPRESOJ QË TË JENI TË GJITHË MIRË ME SHËNDET!!!!

**Elvis Morina 8F**



Përsëndetje Eneo,

Si të duket vetja i rritur? Unë akoma nuk e mendoj dot se si do të shijoj jetën pa çastet e fëmijërisë dhe jo që të mendoj aq larg sikur jam 35 vjeç. Tani që po e lexon këtë letër, besoj se po të mungojnë shumë bankat e shkollës, shokët gjithashtu dhe mësuesit shumë të përkushtuar që na kanë ndihmuar në çdo çast.

Kur na e dha mësuesja si detyrë nuk e mora me seriozitet, sepse nuk më pëlqeu si ide prandaj mendova që të mos e bëja, por më vonë ndryshova mendje duke e bërë, sepse do ishte një kujtim shumë i bukur dhe shumë interesant. Ti ndoshta mund të qeshësh, por unë i vogël kam qenë pak përtac. Ndoshta mund të kem ndryshuar tani që ti po e lexon.

Unë që i vogël, thjesht doja që kur të rritesha, të bëja një jetë të thjeshtë dhe një punë të mirë, ku mund t'i siguroja të ardhmen familjes sime. Shpresoj shumë që këtë dëshirë të ma kesh plotësuar. Ti ke ndryshuar dhe tani mendon si një i rritur dhe jo si mendja e një 14 vjeçari. Jam shumë kurioz se ku je ti tani ose ku po jeton, por këto do i marr vesh më vonë. Jam shumë kurioz se çfarë do të ndodhë me mua.

Me shumë respekt :) Eneo i vogël

**Eneo Imeraj 8F**



E dashur vetja ime 35 vjeçare,  
Po të drejtoj këtë letër, të shkruar shumë kohë më parë, rreth njëzet vjet...  
Madje mendoj se pas njëzet vjetësh ti mund të mos e kujtosh fare këtë letër të shkruar, kur ke qenë veçse një çunak në klasën e tetë, që të pëlqente të diskutoje për problemet e gjithë botës dhe kur mendoje gjithashtu se qytetit tënd të vogël i mungonin shumë gjëra. Nëse do ta lexosh këtë letër në të ardhmen mendoj se mund të të vijë për të qarë për gjithë ato grimca lumturie që ke kaluar, por ndoshta edhe për çastet e hidhura, por mbase edhe për të qeshur për këndvështrimin që e ke parë botën.

Jam tepër i sigurt se kur të kujtohesh për këtë moshë, do të kesh ndryshuar objektivat si dhe interesat dhe nuk do të kesh kohë për të menduar për teoritë ndryshme konspirative apo për të zbuluar formula të reja fizike. Gjithashtu mund të kesh ndryshuar shumë nga pamja e jashtme dhe nga mënyra e të sjellurit. Kur të jesh në atë moshë shpresoj t'i harrosh shqetësimet e tua qoftë edhe për një ditë, mbase është edhe e pamundur, por kështu dëshiroj dhe kështu u bëftë!

Por, mbi të gjitha shpresoj të kesh arritur sukses në një mënyrë të ndershme dhe gjithashtu të kem bërë prindërit dhe gjyshërit e mi krenarë. Kujto gjithmonë, që çdo gjë duhet ta bësh me një qëllim dhe arsye dhe kurrë të mos dekurajohesh! (E kuptoj që këto këshilla mund të të duken qesharake dhe tepër fëmijërore.)

Pra, shpresoj të kesh përparuar dhe mezi pres të të shoh.

Me dashuri, Vetja jote 14 vjeçare.

P.S. Më kujto dhe më bëj të ndihem krenar.

**Erik Kaçani 8F**



I dashur Samuel,

A je mirë me shëndet? Do zoti je doktor për punë dhe aktor për lekë!

A ka fituar Juvja NDONJË CHAMPIONS LEAGUE tjetër?

A është shkatërruar bota?

A ka arritur Trump ta shkatërrojë Kinën?

A të pëlqen akoma pica?

A i ke kaluar 1:90 cm?

Këto jane pyetjet kryesore që kam, por ka dhe shumë të tjera. Tani ti ke një detyrë. Përgjigju pyetjeve dhe bëji vetes ca pyetje kur të jesh 70 vjeç. Kot për qejf.

Kaloja mirë, qesh gjatë gjithë kohës dhe bëj gallata, se vetëm mirë bën. Po e shkruaj këtë, që të vendos në pozitë zyshën por s'ka vënë 10, do e lexosh këtë dhe hidhu nga ballkoni, po ke marr 9 (ose më poshtë), ke shumë përgjegjësi në duar ZYSH!!!!!!!!!!!!!!!!!!!!!!!!!!!!!!

**Samuel Vargu 8F**



E nderuara vetja ime 35 vjeçe, vetëm prit!

Do të shohësh se jeta është diçka e papritur dhe e papërshtueshme. Andaj është më mirë mos të presësh, por të jetosh. Ti je kompetente të definosh se çfarë është e mjaftueshme për ty. Jeta nuk është lineare. Rrugëtimi yt, do të jetë plot udhëkryqe, probleme, prerje, ndërprerje, pengesa dhe shpesh do të kesh rrugë të hapur. Do të ketë kohë, që nuk do e dish se ku ndodhesh, mirëpo unë të them se je m'u aty ku duhet të jesh. Nuk dua të ligjëroj mbi atë se çfarë mund të bësh ndryshe, kjo është rruga jote dhe mund të bësh çfarë të duash me të pasi që je i përgatitur. Je i fortë sa duhet, i mençur, i guximshëm, andaj duaje veten dhe të tjerët përreth. Ajo që dua të të them janë disa fjalë urtësie që dua t'i mbash mend, ja ku janë...

1. Fillo çdo ditë duke falenderuar. Ti e zgjedh ushqimin për zemrën dhe shpirtin tënd andaj ushqehu me fjalë dhe ndjenja të mira.
2. Kujdesu për shëndetin, trupin dhe mendjen tënde. Qeshu, lëviz, luaj, kërce, këndo, stërvitu, medito, dëgjo, flej, lexo, mëso, shkruaj dhe ndaj momentet me të dashurit e tu.
3. Gjeje fisin tënd. Gjeji ata njerëz që të kuptojnë dhe të ndihmojnë që të rritesh. Me dashuri Ervisi.

**Ervis Alushi 8F**



Përschendetje Geri,

Kanë kaluar kaq vite dhe kjo letër tani ka mbërritur tek ty. Koha ka ndryshuar, të përbashkëtat midis nesh po ndalojnë së ekzistuari e ndryshimet po rriten gjithnjë e më tepër.

Ne jemi ndryshe; Unë jam një 14-vjeçar, i cili thur çdo ditë ëndrra e është i mbushur plot ambicie e synime. Ty ambicia nuk të mungon, por ajo nuk është në të njëjtat nivele me timen, sepse ti tani ke një punë, një familje të re, një grua, fëmijët e tu, një makinë, një shtëpitë re, një llogari bankare etj. Ti je duke jetuar në planet dhe ambiciet, që unë jam duke i krijuar!

Ndoshta ti mendon se je duke kaluar një jetë të qetë, pa stres dhe shqetësime, por e ke gabim! Jam unë ai që po e jeton këtë jetë të qetë. Mua nuk më shqetëson buxheti familjar, të paktën jo aq sa ti. Unë nuk kam për se të punoj për të tjerët, madje as për veten time. Unë dal me shoqërinë pa pasur nevojë për t'i studiuar mirë ata persona që mbaj afër vetes, bëj qejf, bëj gabime pa u përballur me pasojat, unë bëj gjithçka që dua, edhe pse disa nga shokët e klasës s'më konsiderojnë si mik. Megjithatë jeta jote është e bukur, ndoshta edhe më e bukur se e imja. Por unë të uroj që ti të kesh një jetë që të plotësoh të gjitha dëshirat e tua. Të uroj gjithë të mirat....

**Gerti Tarka 8F**





I dashur Klei, Vetja ime,

Sot kam vendosur të të shkruaj ty edhe pse më duket disi e çuditshme, gati qesharake. Kam dashur edhe më parë të të shkruaj për të shprehur dëshirat dhe ëndrrat e mia. Të të shkruaj ty e shoh si një terapi që më bën të ndihem mire, më relakson.

Që kur isha femijë i vogël, më pëlqente shumë të ëndërroja, ëndrra këto që në fillim nxiteshin nga përrallat që më tregonte mami para se të flija, më pas nga filmat që shikoja apo nga librat që lexoja. Duke u rritur kuptoja se ëndrrat ndryshonin, pasi dhe unë ndryshoja, bëhesha më i ditur, më i pjekur. Ëndrrat e mia të dikurshme, që të bëhesha një superhero, apo të mund të fluturoja si një zog dhe të shëtisja gjithë botën, tashmë më duken fëmijore. Tani kam filluar të mendoj për të ardhmen, të ëndërroj për atë që unë dëshiroj të bëhem. Dëshira e madhe për të bërë realitet gjithë ëndrrat e mia, më shtyn të lexoj dhe të studioj më shumë, sepse e di që rruga drejt suksesit nuk është një rrugë e lehtë, pa pengesa, pa ndalesa, por me forcë, vullnet dhe vendosmëri, mendoj se do arrij t'i kapërcej të gjitha barrierat që mund të më dalin para.

Sot, vetja ime, të premtoj se do të bëj të pamundurën të jem i denjë për veten, familjen dhe shoqërinë. Dua të jem busulla dhe mbështetja për familjen time, për t'ia shpërblyer gjithë investimin e tyre për mua. Dua të jem profesionist i vërtetë dhe jo vetëm kaq, dua të shkëlqej, të bëhem një personalitet i spikatur në profesionin tim. Dua të jem një koleg i mirë, një shok i mirë, dhe një qytetar i mirë. Dua të jem një partner dhe një baba i mirë, ashtu si im atë. Rrugëtimin tim për të arritur ëndrrat nuk mund ta quaj të realizuar nëse nuk i arrij ato, në mënyrë të denjë dhe të ndershme.

Vetja ime, sot të premtoj se kur ta lexosh këtë letër do të qeshësh e do të thuash sa pak paskam kërkuar e sa shumë kam arritur. Mirutakofshim!

**Klei Hysaj 8F**





E dashur Lora,

Si është jeta për ty në këtë moment? Unë, Lora 13 vjeç, jam tepër e lumtur për çdo gjë që kam bërë dhe uroj të njëjtën gjë edhe për ty. Tani po përjetoj një jetë të thjeshtë, pa probleme.

E di që në këto momente je në Zvicër, ku ke krijuar një jetë të re dhe je duke shijuar çdo moment. Ndihi krenare për veten që përpos gjithçkaje, ia dole, pasi e ke pasur dëshirë të madhe të jetoje aty. Të ka pëlqyer që e vogël. Ia dole prej faktit se je ai lloj njeriu, që nuk dorëzohesh kurrë për të realizuar ëndrrat e veta. Je e përkushtuar në gjërat që do.

E di që shpesh të merr malli për prindërit e tu këtu në Shqipëri. Për Jurin, i cili të ka pikë të dobët, por fundja fundit prej meritave të tyre arrite në vendin ku ndodhesh sot. E di që të mungon kushërira dhe shoqet me të cilat shpenzoje çdo fundjavë. Familja dhe shoqet janë mbështetja jote më e madhe dhe dashuria e tyre nuk do të të mungojë asnjëherë. Dhe pse ndodhen në cepa të ndryshëm të botës, ju ju lidhin kujtimet, ato të bukurat dhe të këqijat, të cilat i keni kaluar lehtësisht. Gjatë këtyre 21 viteve mund të kesh bërë të mira, por dhe shumë gabime. Sido që të ketë ndodhur mos e harro të shkuarën tënde, frymëzohu nga ajo dhe krenohu me të sotmen.

Të puth.

**Lora Lika 8F**



I dashur Marin,

Mund ta lexosh këtë letër ose jo, por gjithsesi doja të të përshëndesja. Ne kohën që do ta lexosh këtë letër, jam i sigurt që do jesh rritur shumë dhe do jesh pjekur mjaftueshëm për të kuptuar thelbin dhe rëndësinë e jetës.

Besoj se ndodhesh diku nëpër botë, në një vend që ke gjetur lumturinë, në një vend që të ka pasuruar dhe të ka zhvilluar shumë intelektualisht. Nëqoftëse ke qenë me fat, besoj se ke gjetur dhe personin, me të cilin ke vendosur të kalosh jetën.

Shpresoj që të jesh dikush me influencë në botë, qofsh një lider botëror apo një investues shumë i suksesshëm, nuk e di, nuk mund të jem i sigurt, por dua që kjo influencë e jotja ta ketë bërë botën një vend më paqësor, më të lumtur e më të sigurtë.

Shpresoj që të mos kesh humbur pozitivitetin që të karakterizonte. Pozitivitet, që së bashku me guximin, bënë çdo gjë të mundur në fëmijërinë tënde 'të rritur'.

Shpresoj që asgjë mos të të ketë ndalur, as dështimet që në hapat e parë dhe lotët që vinin pas tyre, as personat keqdashës e as ata që të udhëheqin në rrugë të gabuara. Mbi të gjitha shpresoj që të kesh arritur gjithçka ke ëndërruar dhe puna e lodhshme, netët pa gjumë, kohët e vështira dhe gjithë lodhja e mundi,



të kenë qenë me vend. Jo, nuk dua që të përlolesh kur ta lexosh këtë, pasi mundi ia ka vlejtur, ti arrite gjithçka. Gjithçka që doje dhe ëndërroje gjatë ditëve të gjata pakuptim, e netëve pa gjumë. Gjithë këto të kanë formuar në personin që je sot. Vetja jote perfekte...

**Marin Shpata 8F**



I dashur Samuel,

Rri i ulur në kolltukun tim të preferuar në shtëpinë e prindërve të mi. Qëkur kam qenë i vogël ka qenë vendi im i preferuar dhe gjithmonë do të jetë. Mbi komodinë qëndron mbyllur një zarf i bardhë. Zgjas dorën dhe e hap, e nxjerr nga ai letrën që ndodhet brenda.

Samuel!

Kjo letër është për ty! Mendoj që në këto momente të kesh realizuar të gjithë ëndrrat që ke pasur. Jeta është e gjatë, e bukur, e plot të papritura dhe nuk duhet kurrë të tërhiqesh në momente të vështira, në çaste delikate, por duhet të luftosh me mish e me shpirt që të arrish aty ku ti meriton të jesh, lart e më lart. Shpresoj shumë të kesh arritur aty ku ti dëshiron, por edhe nëse jo, beso që nuk është kurrë vonë për ta bërë.

Vazhdo! Përpiku! Mëso! Puno! Jeto! Kurrë mos thuaj është vonë! Kurrë mos u dorëzo! Jeta është e bukur e ti gjithmonë, gjithmonë gjej forcën t'i buzëqeshësh asaj.

Mos u thyej nga asgjë! Dhe kurrë mos harro se pavarësisht gjithçkaje, JE TI AI QE VLEN!!

**Samuel Rakipi 8F**



Ç'kemi Loren,

Ndoshta ti këtë letër s'e lexon se të duket budallallëk ose thjesht e ke humbur, megjithatë kur mësuesja na e dha këtë detyrë, pas shumë dyshimesh, kuptova që ishte një ide shumë interesante. Të tilla projekte i kam parë me mijëra herë nëpër filma, por asnjëherë s'e mendoja se do ta bëja një gjë të tillë. Shpresoj që gjatë këtyre 21 vjetëve gjithçka të ketë shkuar sa më mirë. Nuk e kam menduar shumë se ç'dua në të ardhmen, por shpresoj të jesh e lumtur.

A jeton vallë në Munih, Berlin, Endhoven, Paris, Moske, San Pjetërburg, Romë apo Tiranë? Tirana nuk është keq, por kam menduar gjithmonë se do iki nga ky vend, por ndoshta dhe gabohem. Gjithmonë kam ëndërruar se jeta ime tani, me atë që po jeton ti, do të jenë shumë të ndryshme, pasi unë tani stresohem dhe për gjëra të kota. A ke frikë kur udhëton? Nëse përgjigjesh me jo, ndoshta këto pyetje të bëjnë për të qeshur. A vazhdon të shohësh shumë



seriale? Si quhen? Unë tani shoh "Teen wolf", "The vampire diaries", "The originals", "Lucifer dhe Pretty Little Liars".

Po Fjordin si e thërret? Tani jam në fazën që e thërras ose Lucifer, Lusi ose nocholaus.

Shpresoj të të kenë ardhur kujtimet më të bukura të kësaj kohe dhe të kesh arritur gjithçka ke dashur në jetë.

Nga Loreni 14 vjeç për atë 35.

Adios.

**Loren Llagami 8F**



E dashur e Panjohur,

Ndonëse padituria ime e skajshme e ekzistencës tënde kalon kufijtë e injorancës, vendosa të të shkruaj një letër, rreth 22 vjet më parë, me shpresën se, bashkë me kohën, nuk do të kenë fluturuar krahëhapur kujtimet "e përgjakshme".

Një qetësi përbuzëse luhet në sfond. Dielli, ai lëmsh gjigand e vdekjeprurës; portreti më i madh në oqeanin e paanë, i ndjekur nga ato autoportrete të vogla, të pambukta, aq delikate; ndriçon gjysmëterrën e letrës, në të cilën të shkruaj, të krijuar nga flokët e zinj, ndonëse të shkurtër. Këmbët, nga të cilat një erë kutërbuese mbizotëron flladin e lehtë e kalimtar, i kam të kallura. Këpucët, e dorëzuara kohë më parë, i kam disi të çara, gojëhapur, në përgjërime të vuajtur të shpresës për të pushuar. Ndërsa unë, unë jam dergjur mbi qilimin erëmirë të luleve të shtypura nën mua, duke ëndërruar për ty, krejt në tym, me shpresën e paqenë, se do të ngjasojmë sadopak. Endërroj për atë dashuri të një lloji tjetër, që do të na mbajë bashkë, pasi, në fund të fundit, dashuria është gravitet. Sado e vogël, e papërfillshme të jetë, të tërheq pranë vetes deri në pafundësi, si një viktimitë të sajën. Shpresoj që qielli abstrakt të mbetet po i njëjti, që, sa herë madhështia e tij të bie mbi sytë e shkretuar, të të kujtojë këto momente të pakthyeshme nga asgjë. Vërtet dua që bari i njomë të jetë po i njëjti, po kaq jeshil e melankolik, që kur gishtërinjtë e mi moskokëçarës t'i japin fund jetës së disave prej tyre, të mbeten po ata gishtërinj të pavdekshëm e të pazëvendësueshëm. Uroj që dielli të ndriçojë po kaq mahnitshëm, që si edhe sot, të verbojë edhe të verbrit. Mbi të gjitha, shpresoj që shpirti yt, të jetë kaq i lirë e mospërfillës sa imi; shpresoj që sytë e tu monoton, të pasqyrojnë këtë çiltërsi që gjendet brenda meje. Dua që ti të duash te jetosh, jo të mbijetosh.

Me dashuri, Ti.

**Rebeka Sharko 8F**



Ç'kemi vete,

Këtë letër po e shkruaj për ty, tani që jam 13 vjeç dhe e fiksuar pas gjërave të parëndësishme, tmerrësisht e stresuar e shumë e përhumbur. Shumë pyetje më rrotullohen në mendje, por asnjërës nuk di si t'i jap përgjigje. Shpresoj shumë që ti mos të jesh kaq e përhumbur sa jam unë tani, sepse është me të vërtetë e lodhshme. Ndoshta, nuk e ke patur mundësinë të martoheshe me Michael Clifford ose Luke Hemmings, por a të kujtohet sa shumë e doje këtë gjë? Jam e sigurt që je duke qeshur në këto momente me mua, por mos harro se kjo ishte ti, ama nuk dua të harrosh kurrë se ky version i yti ishte i mbushur me gjallëri sa herë që dilte ndonjë album ose kur vendosej ndonjë këngë në radio. Meqë ra fjala te radioja, a të kujtohet koha kur i bllokove serverin Top Albania Radio-s për të vendosur një nga këngët e 5SOS?

Po kur hapje problem midis mamit dhe babit se kush nga ata do të të shoqëronte në koncert? Ose kur mbaronte koncerti dhe kordat e zërit e çdo pjesë tjetër e trupit të dhimbte dhe të kishte rënë gjaku në fund të këmbëve e duhej të flije me këmbët në mur? Ah s'e ke idenë sa jam duke qeshur në këto momente. Po kur refuzoje që të laje bluzën, të cilën ta ka hedhur Michael?

"Ia ka prekur fryma e shenjtë, mos të guxojë njeri t'ia lajë.", tallej mami me mua edhe ne të gjithë gajaseshim.

Kanë kaluar shumë vite dhe nuk e di se çfarë kë bërë me jetën tënde, por jam shumë e sigurt që do të kesh bërë zgjedhje mjaft të mira. Kushedi se çfarë pune je duke bërë ose duke mos bërë, ndaj, jam duke iu lutur zotit që të kesh zgjedhur një punë, me të cilën ti je e lumtur dhe e bën me dashuri. Nuk e di a ke arritur t'i bësh të gjitha ëndrrat e tua realitet apo nëse disa të kanë mbetur në sirtar, por një gjë dua ta kesh arritur, një gjë shumë të thjeshtë, një parim që unë e kam patur e dua ta kem gjithmonë... të punosh për të jetuar e jo të jetosh për të punuar. E di jeta nuk të fal dhe është shumë e vështirë, por në qoftë se nuk ke arritur ta mbash këtë parim nuk do të kesh patur një jetë të lumtur. A të kujtohet koha kur mendoje se kush ishte personi me të cilin do të kaloje jetën? Jam më se e sigurt, që ke zgjedhur një bashkëshort të mrekullueshëm, i cili të sjell mëngjesin në krevat dhe kujdeset për ty, sikur ti, të ishte personi i vetëm në botë, kushdo qoftë ai. A keni fëmijë? Nëse po, a ia ke vendosur emrin vajzës Lajza ose djalit Koman? Po në Sidnei a ke patur mundësinë të jetosh? A të kujtohet se sa shumë re në dashuri me atë qytet magjepsës? Uaa, me të vërtetë, tani që po e lexoj përsëri e përsëri këtë letër, me vijnë aq shumë kujtime, sa as vetë i gjithë libri nuk do mundte t'i mbante. Shpresoj që kjo letër të të frymëzojë për të qenë një njeri gjithmonë e më i mirë. Gjithashtu dëshiroj që të kesh krijuar një jetë të mbushur me njerëz që të duan dhe i do, e të kesh çdo gjë që zemra jote dëshiron.

Me shuuuumë nostalgji Vetja.

**Sara Rizaj 8F**



E dashur Ardisa!

Gëzuar ditëlindjen tënde! Sot ti mbush 35 vjeç shpresoj që ta festosh ashtu siç ke ëndërruar dhe dëshiron ta festosh ditëlindjen tënde. Mendoj se ke marrë shumë dhurata dhe urime nga të gjithë, mbase edhe nga miqtë e rinj që ke bërë dhe sigurisht nga familja jote. Unë mendoj se gjatë viteve nuk duhet të kesh ndryshuar shumë. Flokët besoj se i ke përsëri kaçurrele dhe të zeza, sytë e mëdhejë e të zinj e me qerpikë të gjatë, mendoj se ke mbetur përsëri bardhoshe, elegante dhe e gjatë. Mendoj se ke mbaruar shkollën për Arkitekturë dhe i ke bërë studimet në Amerikë dhe tashmë je një arkitekte shumë e zonja dhe shpresoj të kesh ndërtuar shumë vila dhe pallate të bukura e të veçanta. Mendoj se nuk je larguar nga "Federata e Dancit Sportiv", sepse kur ke qenë 13 vjeçe, adhuroje të kërceje dhe ishe e gëzuar të ishe pjesë e "Federatës së Dancit Sportiv". Mendoj se të kujtohet se sa gëzoheshe kur merrje pjesë në një kampionat kërcimi dhe fitoje medalje apo çmime të ndryshme dhe nëse nuk je larguar nga "Federata e Dancit Sportiv", shpresoj të kesh fituar çmime të ndryshme dhe shumica e tyre të jenë medalje të vendit të parë. Shpresoj të kesh mësuar 3 gjuhë të tjera, përveç atyre që di (Frengjisht, Spanjisht, Gjermanisht). Shpresoj të kesh bërë shumë udhëtime jashtë shtetit, sepse kur ke qenë 13 vjeçe adhuroje shumë të udhëtoje. Shpresoj të kesh shkuar në hotelin me 7 yje në Dubai ("Bujr Khalifa") apo në shumë vende të tjera të mrekullueshme. Dhe me një përmbledhje të shkurtër, shpresoj të jesh bërë një vajzë shumë e mirë dhe e zgjuar e të kesh të gjitha të mirat e mundshme dhe të uroj edhe një herë për Ditëlindjen tënde.

**Ardisa Beqja 8G**



I dashur Ardit,

Ti ecën drejt së ardhmes, për të cilën s'e di as ku mbaron. Askush s'ta pret rrugën dhe askush s'ta ndal hapin, ndonëse shumica e njerëzve nuk besonin tek ti. Jeta për ty ishte një drejtëz e pafund, ku çdo pikë e saj kishte një pafundësi pikash. Ti dite të vlerësoje minutë që të mos shkonte dëm ora, dita dhe e tërë jeta. Në moshën 35 vjeçare ti arrite të realizoje shumicën e ëndrrave të tua. Ti nuk i grise asnjëherë faqet e jetës, por dite t'i kthesh e të rifillosh aty ku gaboje, ndaj në këtë moshë ti feston sukseset e tua në këtë biznes të fuqishëm, që ngrite me aq mund, feston suksesin e një familjeje të mrekullueshme, që krijove, feston respektin e një emri të ndershëm, që le në shoqëri. Ti nuk u dorëzove kurrë. Ti ndërtove trenin e mbijetesës në mënyrë që ai të lëvizte suksesshëm drejt së ardhmes.

**Ardit Vogli 8G**



E dashur Izabela,

Shpresoj të jesh mirë dhe që bota të ketë treguar anën e bukur të saj tek ty. Shpresoj të jesh e lumtur me zgjedhjet, që ke bërë. Natyrisht unë nuk mund ta di se çfarë ti ke kaluar ose ç'njeri je ti tani, por kjo është një nga arsyet pse ti e ke shkruar këtë letër. Ti e ke shkruar këtë letër 22 vite më parë për të rikujtuar disa gjëra të rëndësishme.

Por së pari, kur ishte hera e fundit që ke folur me prindërit. Po me Ilarian dhe Emanuelin. Mos e harro se sa e rëndësishme është familja. Mos e harro se pavarësisht sado të vështira, që duken gjërat, ata i ke gjithnjë në anën tënde.

Tani që ta kujtova sa e rëndësishme është familja po të kujtoj që të bësh çfarëdo lloj gjëje, që të bën ty të lumtur pavarësisht ç'thonë të tjerët. Unë nuk po them injoroi plotësisht, por mendo për veten tënde. Siç thotë dhe fjala e urtë "Pyet 1000 vetë dhe bëj si di vetë." Gjithashtu, po të këshilloj që të kesh gjithnjë një mendje të hapur dhe të mendohesh mire para se të veprosh.

Mos lejo askënd të të shtypë me këmbë. E di që do ketë kohë të vështira, por mbaje kokën lart pavarësisht çdo gjëje. Ti mund ta gjesh zgjidhjen për çdo situatë që të jep jeta dhe mos ngurro t'i shfrytëzosh situatat që të jepen.

Mos ki frikë të bësh ndryshim. Ndonjëherë ndryshimi është i nevojshëm.

Këto ishin disa nga gjërat që unë dëshiroja të të rikujtoja.

Me shumë dashuri, Izabela 22 vjet më parë.

**Izabela Çupi 8G**



E dashur Diona

Po të shkruaj unë, Diona, ajo vajza 13 vjeçare me plot ëndrra për t'i realizuar. Ndoshta tani po kujtohesh për ato ëndrra që ti ke pasur. Ti gjithmonë ke dashur të ishe një avokate me karrierë. Besoj se tani duhet të jesh duke zgjidhur ndonjë problem të ndonjë prej klientëve të tu. Unë e di që pas asaj fytyre serioze prej avokateje, fshihet një vajzë e vogël, që kishte plot ëndrra. Nëse të kujtohet një ndër ëndrrat e tua ishte që të kishe një familje, një shtëpi të bukur, ku të jetoje. Besoj se edhe vëllai yt duhet të ketë një karrierë të mirë si futbollist. Po shoqet e tua?! Shpresoj që miqësia midis jush të mos ketë shteruar dhe ju të jeni përsëri shoqe. Unë e di që ti tani je më e pjekur dhe vendimet i merr vetë pa ndihmën e askujt. Pas kësaj letre duhet të jesh kujtuar për fëmijërinë tënde. Unë e di, se ti gjithmonë do të jesh ajo Diona e vogël, e qetë dhe e dashur.

Me dashuri Diona.

**Diona Shpani 8G**



I dashur Enes

Si je mirë? Ku je? Çfarë pune ke? Kam shumë pyetje, por në fillim po të them për veten. Këtë vit unë mbush 13-të dhe u ktheva prapë në shkollën time të preferuar edhe pse kam pak probleme në matematikë dhe në gjuhë, prapëseprapë unë përpiqem të bëj më të mirën. Unë kam bërë disa shokë, por jo shumë 3 ose 4. Vazhdoj të luaj "Minëcraft" dhe si gjithmonë unë nevríkosem tek të tjerët shumë shpejt edhe ndonjëherë edhe i kam gjuajtur. Unë vitin e kaluar jam zgjatur shumë edhe pse jam një nga më të shkurtërit e klasës. Mjaft fola për veten, kam disa pyetje që më interesojnë. Çfarë profesioni ke? Unë gjithmonë kam dashur të jem programues edhe shpresoj që të jesh. E di që është një punë e vështirë, por për diçka që do, duhet të bësh sakrifica. Kam edhe një pyetje tjetër. A ke fëmijë? Ku jetoni? Në qoftë se ke binjakë atëherë qenkam me fat. Unë mendoj të jetoj në Amerikë, por vend më të sigurt se Shqipëria nuk gjen. Këtu në Shqipëri nuk ka shumë hajdutë e as tërmete të fortë edhe nuk kam parë ndonjë tsunami këndeje rrotull. Çfarë teknologjie ka në atë kohë? Unë mendoj se do të ketë makina fluturuese, robotë shërbëtorë edhe ndoshta pas nja 100 vitesh mund edhe të ketë shtëpi në planetë të tjerë, edhe pse nuk mendoj se do jetoj aty gjatë sa për ta parë. Në qoftë se ke bërë gjëra që nuk të pëlqejnë, ti mund t'i rregullosh. Je vetëm 35 vjeç. Të lutem mos bëj gjëra që as vetë nuk do i bëja, mendo edhe të tjerët kanë jetën e tyre, familjen e tyre, edhe ndoshta edhe, e pëlqejnë jetën e tyre. Gjithmonë mos shih të kaluarën, por mëndo për të ardhmen. E di që për një djalë 13 vjeç, mund të dukem shumë serioz, por unë në fakt, jam një djalë gazmor edhe që e pëlqen jetën e tij. Unë mund të dua shumë gjëra që të ndodhin, por e vetmja gjë që unë dua nga unë, është që të jem gjithmonë i lumtur me atë që kam. Përgjithmonë i lumtur,

**Enes Yusuf Brucaj 8G**



E dashur Hannah,

Këtë letër po e shkruaj që ta lexosh kur të mbushësh 35 vjeç. Këto dëshirat dhe ëndrrat, që do të shkruaj këtu, ke dashur gjithmonë t'i realizosh, megjithatë me kalimin e kohës mund të kenë ndryshuar. Universitetin do ta mbarosh me nota të shkëlqyera në Oxford, Angli. Masterin do ta bësh në Australi dhe do të jetosh aty për dy vite me motrën. Pas masterit do të shkosh për të jetuar në Amerikë, ku do të punosh në 'NASA' si astronome ose fizikante. Nga udhëtimet e shpeshta nëpër botë, do të njihesh me shumë kultura dhe kombe të reja e të bukura. Do të jetosh në një vilë dykatëshe me bashkëshortin dhe dy vajzat e tua binjake. Meqënëse puna nuk kërkon aktivitet fizik, do të bësh shumë ushtrime për të qenë e shëndetshme.

**Hannah Shalsi 8G**





I dashur Evaristi 35 vjeç,

Unë jam Evaristi 13 vjeç dhe jam duke të të shkruar si motivim për ato qëllime që të kam vendosur dhe shpresoj që mos t'i kesh harruar apo të kesh zgjedhur një rrugë tjetër. Gjithashtu dëshiroja të të pyesja nëse ndihesh mirë dhe nëse je i kënaqur me çfarë ke arritur deri më tani. Kam shumë pyetje të tjera për të të bërë, por nuk më premtom koha për të gjitha ato pyetje. Më mirë po e lë në dorë të kohës për të kthyer përgjigjen e këtyre pyetjeve. Mezi pres të të takoj ty dhe familjen tënde.

**Evarist Bego 8G**



Përshëndetje Joni,

Tashmë jam rritur dhe nuk jam më ai djaloshi i dikurshëm, i cili ishte i pakujdesshëm. Tani unë kam ndryshuar. Gjatë jetës unë kam mësuar shumë gjëra të vlefshme, përshembull: Si të punosh. Por kam akoma shumë gjëra të tjera për të mësuar. Kur isha i vogël jeta më dukej shumë e lehtë, por tani që jam 35 vjeç i kuptoj vështirësitë që fsheh jeta. Unë studiova për IT (Inxhinieri informatike) dhe tani kam një punë shumë të mire lidhur me profesionin tim dhe kjo punë më pëlqen shumë. Unë merrem me mirëmbajtjen e programeve të ndryshme si Microsoft Poëer Point. Që kur kam qenë i vogël kam dashur të punoj në IT. Sot jam shumë i gëzuar që kam arritur deri këtu.

**Joni Fjora 8G**



E dashur Hrisa,

Jam unë, domethënë ti, vetëm se 22 vjet më e vogël. Ke pasur shumë ëndrra e dëshira, të cilat tani besoj se i ke realizuar. Besoj se tani gjithçka është perfekte, me jetën që ti ke dashur gjithmonë. Dëshirat e tua kanë qenë të pafundme, të çuditshme dhe ndonjëherë gati gati të pamundura. Besoj se shpesh mendon për shokët dhe shoqet e tua, (që nuk ke për t'i harruar kurrë), për momentet gazmore, të trishtuara, të mërzitshme, të sikletshme që keni kaluar bashkë. Besoj se mendon për familjen gjithmonë. Shpresoj që ti të kesh gjetur rrugën e duhur (sepse unë akoma nuk jam e sigurt për asgjë), për gjithçka që ke bërë. Jam shumë e sigurt se kur të lexosh këtë letër do të mendosh: "Vërtet i kam pasur gjithë këto ëndrra, që më dukeshin të pamundura?" dhe unë e di, sepse do ta mendosh këtë gjë, sepse siç ta thash dhe më parë ti do të jesh e mundur të bësh gjithçka. Tani që po të shkruaj këtë letër dua të shkruaj shumë gjëra, vetëm se nuk e di se si ose më saktë çfarë të them. Gjithsesi këtë letër do të doja ta mbyllja duke të të kërkuar diçka: Mos më harro kurrë dhe mbaj pak nga fëmijëria jote (domethënë Hrisa 13 vjeçe). Nuk dëshiroj të rritem. Ah! Dhe diçka. Mos harro. Jetoje çdo ditë sikur ajo të ishte e fundit. Shihemi pas 22 vjetësh.

**Hrisa Hyseni 8G**



E dashur vetja ime!

Unë tani jam në klasë të tetë, në shkollën "Turgut Özal", dhe jam trembëdhjetë vjeç. Unë kur të bëhem sa ty, do të doja të kisha një familje, e cila do të ishte e përbërë nga Unë, bashkëshortja dhe dy djem binjakë.

Unë kur të rritem do të doja të kisha një shtëpi, vilë, në SHBA me një pishinë të madhe dhe me një kopësht me lule. Do të doja shumë dhe një makinë klasike.

Ende nuk e kam menduar se çfarë profesioni do të preferoj kur të arrij në moshën 35-vjeçare, por do të preferoja një profesion, i cili të kishte lidhje me shkencat ekzakte.

Unë, në moshën që je ti, do të dëshiroja që të isha sistemuar me shtëpi, me shkollën e fëmijëve, në profesionin tim dhe bashkëshortja në profesionin e saj.

Kjo është jeta që preferoj të kem në moshën 35-vjeçare.

Me dashuri,

**Jamarbër Qyrdedi 8G**



Ç' kemi, Kledia!

Si je, mirë? Shpresoj që po. Unë për vete jam shumë mirë, kështu që mos u shqetëso. Të them të vërtetën këtë letër po përpiqem që ta shkurtoj sa më shumë, se deri nesër nuk do ta mbaroja së shkruari. Besoj tani që po e lexon po të vjen për të qeshur e do të thuash; çfarë kalamani. Pasi të lexosh letrën do ta kuptosh përse po të shkruaj. Në qoftë se të tjerët do të shkruanin këtë letër, do të thoshin disa porosi dhe disa parashikime, kështu gjërash. Edhe unë për afërsisht ashtu do të shkruaja. Po ndryshimi është i madh. Ti je 35 vjeçe dhe e ke harruar çfarë ke pas ëndërruar kur ishe fëmijë. Unë thjesht do t'i kujtoj. Në rregull, të fillojmë. Umm... Mos guxo, po ta përsëris, mos guxo ta prekësh cigaren, se pastaj ta tregoj unë ty! Ahh po, në qoftë se je martuar dhe besoj se po, të lutem merre një qen ose shumë qen se ti e di se i dashuroj. Hap biznesin tënd dhe bëhu pak bose, se pastaj po të sillesh urtë s' të bindet bjeri. Ama më e rëndësishmja; Mos harro të qeshësh, pasi kjo më bën të lumtur. Fëmijët kaliti pak, të forcohen. Siç ke qenë dikur me çunat e lagjes. Besoj e kupton që çunat e lagjes janë kushurinjtë e tu, që nga lindja e deri tani. Të lutem përshëndeti nga unë, pasi e di që jeni ndarë dhe lidhjet tuaja s'janë më si të dikurshmet. Ti dikur ke pas thënë se do të bëje një udhëtim, të ndërmerre rreziqe, pa u stepur e duke ecur përpara. Të ishte e lirë, pa kufij që të të mbanin, e të eksploroje natyrën dhe bukuritë e saj. Me pak fjalë, njësh me natyrën. Shpresoj që ta kesh shijuar jetën. Të dyja e dimë që jeta është plot surpriza, disa të hidhura e disa të lumtura, por të dimë t'i përballojmë. Ti njëherë jeto, pra shfrytëzoje në maksimum, pasi do të vij një ditë që do të pendohesh. Unë vërtet jam 14 vjeçe dhe njerëzit më



thonë je rritur, ama unë them që jam fëmijë. Të jesh fëmijë është gjëja më e bukur, pasi ti nuk e ke mendjen te problemet, por të jesh e lumtur, kurioze dhe mos të vrasësh mendjen për gjëra të vogla. Fëmija nuk e njeh stresin, vuajtjen, pasi është i çiltër diçka që njerëzve, duke u rritur, sa vjen e venitet. Të lutem gjeje fëmijën brenda vetes edhe pse mund të jetë zhdukur, mos u dorëzo që ta kërkosh. Besoj që kaq mjafton. Mbasi ta lexosh letrën, unë do të ndihmoj duke qenë gjithmonë pranë teje. Tani duhet të largohem. Të puth fort dhe të përshëndes, Fëmijëria jote.

**Kledia Boka 8G**



E dashur Johara,

Sot është ditëlindja jote dhe ti mbush 35 vjeç. Sa shumë dëshira do të vijnë për ty sot. Do të ketë nga dëshirat më të bukura deri tek ato më të çmendurat dhe emocionuese. Deri tani gjithë jeta jote mund të ketë ndryshuar, derisa ti të rilexosh letrën tënde kur ti ke qenë 13 vjeç.

Përpara, se ti 'i lexosh këto dëshira duhet të jesh e përgatitur ...

Gati?

Atëherë, fillojmë:

Dëshira 1; Mëso çdo gjuhë të botës (ta këshilloj, sepse do të të duhet për dëshirat e tjera). Dëshira 2; Bëj shok ose shoqe çdo person që të del përpara në rrugë.

Dëshira 3; Shiko të gjitha mrekullitë e botës.

Dëshira 4; Ngjit malin më të lartë në botë.

Dëshira 5; Hidhu me parashutë po nga ai mal.

Dëshira 6; Udhëto rreth botës.

Dëshira 7; Ngite makinën me shpejtësinë në maksimum.

Dëshira 8; Përfshihu 1 herë në një operacion sekret të C. I. A - s

Dëshira 9; Zbulo vetë piramidat të cilat arkeologët nuk mundën.

Dëshira 10; Shko në të gjitha koncertet e botës.

PARALAJMËRIM: Të fundit do të jenë më ekstremet dhe emocionueset!

Dëshira 11; Udhëto në vendet më të nxehta të botës.

Dëshira 12; Shko tek Bermuda dhe zbulo çdo sekret të sajën.

Dëshira 13; Zbulo Universin.

Janë 13 dëshira, sepse unë po të shkruaj kur isha 13 vjeç.

Këto janë të miat, por jam e sigurt se ti do të gesh dhe më të bukura.

Me dashuri, Johara.

P. S: Shijoje jetën, vetëm 1 herë të jepet mundësia.

**Johara Numanaj 8G**



Klaudios 35 vjeç

Ti sot je 35 vjeç. Prindërit tanë na dërguan në shkollat më të mira për të mësuar, por unë nuk i kushtoja shumë rëndësi mësimëve. Por tani unë u them të njëjtat gjëra fëmijëve të mi. Unë, përpiqem që t'ua ndriçoj të ardhmen dhe që ata të krijojnë familjen e tyre. Unë ndjehem krenar për familjen time. Në moshën e adoleshencës kam bërë gabime, për të cilat jam penduar dhe nuk dua që edhe fëmijët e mi t'i bëjnë. Ja pra, shihemi pas 21 vitësh.

**Klaudio Koka 8 G**



Përshëndetje Vetja ime 35 vjeç,

Do të shohësh se jeta është diçka e papritur dhe e papërshkrueshme, andaj është më mirë mos të presësh, por të jetosh. Ti je mjaft i zoti të dallosësh se çfarë është e mjaftueshme për ty.

Jeta nuk është lineare. Rrugëtimi yt do të jetë përplot udhëkryqe, probleme, prerje, ndërprerje, pengesa dhe shpesh do të kesh rrugë të hapur. Do të ketë kohë, që nuk do e dish se ku ndodhesh, mirëpo unë të them se je pikërisht aty, ku duhet të jesh.

Nuk dua të ligjëroj mbi atë se çfarë mund të bësh ndryshe. Kjo është rruga jote dhe mund të bësh çfarë të duash me të, pasi je i përgatitur.

Je i fortë sa duhet, i mençur, i guximshëm, andaj duaje veten dhe të tjerët përreth.

Pas gjithë këtyre, kur isha 13 vjeç, ëndrra ime më e madhe ishte të bëhesha doktor duke mbaruar studimet në një nga shtetet më të pasura ekonomikisht si Gjermania. Unë nuk arrita ta plotesoja këtë ëndërr, sepse nuk munda të bëhem doktor, por arkitekt.

Mendoj se jeta ime deri tani ka pasur shumë sfida dhe pengesa, por unë kam arritur t'i kaloj ato dhe të bëhem dikushi në jetë.

**Lejdion Hyseni 8G**



Çkemi Nejda,

Si je? Unë jam Nejda në të shkuarën. Si është e ardhmja? Shpresoj të jesh duke kaluar mirë!

Shpresoj të kesh gjetur një punë të mirë. Këtë nga unë gjërat nuk po shkojnë shumë mirë dhe nuk e di përse, por shpresoj të jetë kalimtare. Gjithashtu shpresoj të shkosh mirë me vëllain se unë nuk shkoj dhe aq mirë! Të them të vërtetën me mësimë jam shumë mirë, dhe ti duhet të jesh!

Do të doja të dija nëse i ke përmbushur detyrat që të kam caktuar dhe të kesh



lënë një sjellje të mirë gjithandej!

Po me shoqërinë si je? Je prishur me shoqërinë e vjetër apo vazhdon akoma? Ke zënë shoqëri të re? Me siguri po! Shpresoj që dhe me zënkat të kesh mbaruar, se unë sapo kam filluar!

Do të doja që të mos e kesh ndryshuar mënyrën e veshjes, siç të kam thënë! Epo nuk kam ç` të them më! Shpresoj t'i kesh përmbushur detyrat që të kam dhënë dhe detyrimet e tua! Kalofsh mirë!  
Me shumë dashuri Neida!

**Nejda Meka 8G**



E dashur Sara,

Kanë kaluar plot 22 vite dhe kjo letër tani ka mbërritur tek ty. Në fund të fundit, dihej që një ditë do ta merrje, sepse koha kalon, çdo gjë e ka një fillim dhe një fund. Kështu, kjo letër mbërriti në destinacionin e saj përfundimtar: 06.12.2038! Koha ka ndryshuar, të përbashkëtat midis nesh po ndalojnë së ekzistuari e ndryshimet po rriten gjithnjë e më tepër.

Ne jemi ndryshe: Unë jam një 13-vjeçare, e cila thur çdo ditë ëndrra dhe është e mbushur plot ambicie e synime. Ty ambicia nuk të mungon, por ajo nuk është në të njëjtat nivele me timen, sepse ti tani ke një punë, një familje të re, një burrë, fëmijët e tu, një makinë, një shtëpi të re, një llogari bankare, etj. Ti je duke jetuar në planet dhe ambiciet, që unë jam duke i krijuar!

Ndoshta ti mendon se je duke kaluar një jetë të qetë, pa stress dhe shqetësime, por e ke gabim! Jam unë ajo, që po e jeton ketë jetë të qetë. I vetmi preokupim i mirëfilltë i imi është shkolla. Mua nuk më shqetëson buxheti familjar, të paktën jo aq sa ti. Unë nuk kam përse të punoj për të tjerët, madje as për veten time. Unë dal me shoqërinë pa pasur nevojë për t'i studiuar mirë ata persona që mbaj afër vetes, bëj qejf, bëj gabime pa u përballur me pasojat, unë bëj gjithçka, që dua të bëj. Megjithatë jeta jote është e bukur, ndoshta edhe më e bukur se e imja.

Ti je e suksesshme në punën tënde, në familjen tënde e në shoqërinë tënde. Ti ke një temperament më të përmbajtur sesa unë. Ti je e rrethuar nga lëvdatat. Të gjitha këto mund të të lumturojnë pafundësisht, sepse ti po e kthen çdo synim tëndin në realitet. Ti je perfekte në realitetin tënd, por kurrë mos e harro, ti je krijimi i një ëndërrimtari!

**Sara Likaj 8G**



E dashur Rajna

Tani që po të shkruaj jam në dhomën time dhe po përpiqem të shkruaj me shumë kujdes që ti, doja të thoja unë, mos të qeshësh me veten, kur të jem 35 vjeç, sepse është shumë e vështirë dhe qesharake t'i shkruash vetes.

Shpresoj të jem mirë me shëndet dhe një të ardhme mjaft të mirë ekonomike. Gjithashtu jam mjaft kurioze të di se çfarë profesioni do të kem apo në çfarë qyteti ose shteti do të jetoj. Uroj shumë që librat më të preferuar që po lexoj ose i kam lexuar, t'i kem. Shpresoj që edhe kutia ime sekrete e kujtimeve dhe fotografitë që kam ruajtur të ekzistojnë. Dhëmbët e mi duhet të jenë kristal, se për çfarë po duroj dhimbjet e telave dhe llastiqet e mbajtura çdo natë. Po mbi të gjitha a do të arrij të kujtoj momentet më të lumtura dhe me gallatë me klasën time të çmendur? Epo shpresoj, sepse do të më mungojnë të gjithë, megjithëse ndonjëherë të acarojnë nervat.

Ndoshta kur të lexoj këtë letër, kur të jem 35 vjeç (nëse akoma kjo letër do ekzistojë) do të them me vete: seriozisht e kam shkruar unë këtë. Epo po e kam shkruajtur unë këtë, dhe mos të rri fare e habitur, sepse i kam bërë këto gjëra (çmenduri) dhe ndoshta do t'i vazhdoj t'i bëj.

Me dashuri Rajna.

**Rajna Kamberi 8G**



Ralf i së ardhmes,

Kam shumë pyetje për ty. Do të doja ta dija që tani se si e ardhmja është, por fatkeqësisht nuk mundem. Ja pse unë tani po të shkruaj një letër... në kompjuter.

Çfarë pune ke tani? Mos je programues? Mos je mësues? Mos je matematicien? Apo punon një punë monotone zyre?

A e mban mend veten duke shkruar këtë letër? A mban mend se çfarë lëndë kishim në shkollë? Po me notat si dole? A e ke mësuar kitaren? Po pianon? Ose ndonjë instrument muzikor në përgjithësi? A mban mend çfarë muzike dëgjoje kur ishe në moshën, që jam unë tani? Çfarë lloj muzike dëgjon tani? A ke krijuar familje? Sa fëmijë ke? Nga e ke gruan? Kush kalon më shumë kohë me fëmijët? Çfarë dëshirash kanë fëmijët e tu? A i ke çuar në vende të bukura? Ku jeton tani? Çfarë makine ke? Çfarë telefoni ke? Çfarë është teknologjia më e re? A luan më lojra elektronike?

Nga vetja jote, por në vitin 2016!

**Ralf Poni 8G**



E dashur vetja ime,

Më vjen mirë që po e lexon këtë letër pas gjithë këtryre viteve. Sot mbush 35 vjeç, urime. Shpresoj të jesh duke ia kaluar mirë. Festoje ditëlindjen tënde ashtu siç ke dashur gjithmonë ta festosh.

Kanë kaluar 22 vjet, që kur e ke shkruar këtë letër. Në të kujtohet apo jo, ke qenë shumë e fiksuar pas mësimëve. Shpresoj t'ia ketë vlejtur dhe të kem shkruar në një shkollë të mirë dhe gjithashtu shpresoj të kem një punë të mirë. Nuk e di nëse të pëlqejnë të njëjtat gjëra që të pëlqenin dikur. Ti gjithmonë bëje atë që doje dhe nuk të interesonte se çfarë thonin të tjerët për sa kohë ti ndiheshe mirë me atë që bëje. Ti ke qenë gjithmonë shumë e pjekur për moshën tënde dhe kjo më pëlqente shumë. Ke qenë shumë e ndjeshme dhe e fortë në të njëjtën kohë.

Në momentin kur po të shkruaja, nuk e kam ditur akoma se çfarë doja të bëhesha kur të rritesha. Shpresoj të kem zgjedhur diçka që vërtet më pëlqen. Nuk më ka pëlqyer të punoja në një punë të mërzitshme ose në një punë jo kreative dhe mendoj se e mban mend.

Arsyeja kryesore që e shkrova këtë letër, është që të bëj të kujtosh jërat që të pëlqenin, shokët dhe shoqet që ke pasur dhe të të bëj të kujtosh për adoleshencën tënde. Mos harro, bëj atë që do dhe ndjehu mirë me veten siç je ndjerë gjithmonë.

Me dashuri Vetja jote.

**Sara Hoxha 8G**



E dashur Riselda!

Kur ta lexosh këtë letër do të jesh 35-së vjeç. Me leximin e kësaj letre, ti do të kuptosh se sa prej ëndrrave dhe parashikimeve të bëra para 22 vitesh të janë realizuar në jetë. Ke mbaruar studimet e larta për stilim në Stamboll. Ke atelinë tënde dhe ke karrierë të suksesshme. Jeton në kushte goxha të mira, në një shtëpi private me bashkëshortin tënd dhe dy fëmijët e tu. Motra jote ka vazhduar studimet në Francë për Shkenca Politike, ndërsa prindërit jetojnë me vëllain. Ke udhëtuar në shumë vende të botës për turizëm dhe për punë. Stilimet e tua kanë marrë pjesë në Eorld Fashion Eëek në Paris, Milano dhe Neë York. Kohën e lirë ua kushton fëmijve duke qenë se je për një kohë të gjatë e angazhuar në punë. Për të mbajtur trupin në formë shkon në palestër dhe ha ushqim dietik. Herë pas here të pëlqen dhe ndjen si obligim të ndihmosh njerëzit në nevojë.

Pra, ky është vizioni im për Riseldën pas 22 viteve.

**Riselda Veliu 8G**



Përsëndetje vete,

Data që unë po e shkruaj këtë letër është 7. 11. 2016. Planifikoq që ta hap këtë letër në vitin 2038, kur të jem 35 vjeç.

Çkemi Rubin? Jam unë, shumë vite më para. Shpresoj që ti dhe familja jote të jenë mirë me shëndet. Janë disa gjëra që dëshiroj të kenë ndodhur kur të arrij moshën tënde. Fillimisht shpresoj që të kesh studiuar në një universitetin që do, dhe në degën që ëndërron. Duke njohur veten, besoj se gjatë gjithë këtyre viteve shkollimi, të kesh krijuar miqësi të mira, të cilat i ruan akoma. Së fundmi, shpresoj që të kesh gjetur një punë, e cila të jep kënaqësi dhe e bën me qejf.

Kaq kisha për të thënë. Me dashuri, Rubini 13-vjeçar.

**Rubin Sadushi 8G**



E dashur Vikena!

Po ta dedikoj këtë letër ty, që ti të më kujtosh gjithmonë. Sot më 4 korrik 2038, ti u bërë 35 vjeç. Kjo është dhurata ime për ty. Gëzuar ditëlindjen. Edhe unë gjithashtu kam ditëlindjen sot dhe kam menduar që ta festoj me shoqet e mia. Je shumë më e rritur tashmë dhe kanë kaluar 22 vjet. Nuk e di në e mban mend veten tënde, kur ke qenë e vogël, por po t'i kujtoj disa gjëra. Të kujtohen shoqet e tua? Kledia dhe Izabela? Momentet që keni kaluar bashkë, kur keni qenë të vogla. Shpresoj të jeni shoqe akoma, sepse gjithmonë kam dashur ta ruaj gjatë shoqërinë.

Si duket bota në vitin 2038? Besoj se teknologjia është shumë e zhvilluar dhe janë krijuar shumë gjëra të reja. Ndoshta janë krijuar mënyra të reja, që të shkosh në vende të largëta brenda një ore. Shpresoj të jesh e kënaqur me vendin, ku jeton. Tani je bërë një biznesmene me famë. Ke shtëpinë tënde dhe fëmijët e tu.

Këtu po e përfundoj letrën time. Shpresoj të kesh një ditëlindje sa më të bukur dhe t'ia kalosh mirë me familjen tënde ose me shoqet e tua.

Me dashuri Vikena!

**Vikena Hidri 8G**





Përshëndetje vetja ime 35 vjeç!

Besoj se tani duhet të jesh bërë burrë me mjekër, me një familje të madhe dhe të bukur. Besoj që ke një punë të mirë. Shpresoj të jesh bërë një biznesmen ose një futbollist, sepse këto janë dy ëndrrat e mia. Unë shpresoj shumë që të kesh vazhduar të mësosh shumë mirë dhe të kesh përfunduar gjithë arsimimin e duhur për t' u bërë një punëtor i mirë. Shpresoj të kesh ruajtur shoqërinë me të njëjtët shokë që kishe në 9-të vjeçare.

Të uroj fat në jetë nga vetja jote.

Arlind Laçej 8G

*Klasat e 7-ta*



E dashur Uesla,

Sot po të shkruaj këtë letër, që në fakt për mua është e vështirë. Nuk e di si do të jem në moshën 35 vjeçare, por po mundohem ta imagjinoj. Mendoj se do të jem një femër me një profesion të mirë, një femër që ka krijuar familjen e saj. Do të jem një njeri i pjekur dhe mbi të gjitha njeri i mirë. Do të jem si sot, e rrethuar nga njerëzit e mi më të dashur. Pamja ime sigurisht që do ketë ndryshuar, por kjo nuk do të më pengojë aspak për të bërë të gjitha ato gjëra që kam dashur të bëj që e vogël. Ndoshta shumë prej këtyre gjërave do t'i kem realizuar dhe do jem duke u përpjekur të ndihmoj njerëzit, të cilët do të kenë nevojë për ndihmën time, sepse e di që kjo gjë më bën të lumtur edhe sot. Sa më shumë ngjarje të kenë ndodhur në jetën time, aq më shumë do kem mësuar nga jeta. Kjo i bën njerëz më të ditur dhe më të përgjegjshëm, por njëkohësisht dhe ta duan jetën dhe ta jetojnë atë më mirë. Kjo letër do mbetet veçse një kujtim i fëmijërisë sime.

**Uesla Subashi 7A**



E dashur Elia,

Sot jam ulur aty, ku ti kalove momentet më të bukura të fëmijërisë tënde. Edhe në këtë moment po mendohem për to, se si do të jetë jeta ime pas 23 vitesh, por është shumë e vështirë pasi më vijnë plot mendime në kokë. Nuk mund t'i imagjinoj dot mendimet e mia pas 23 vitesh, më duken të pabesueshme. Gjithsesi, shpresoj t'i kesh realizuar dëshirat e tua. Nuk e di se si do jetë jeta jote pas 23 vitesh është e paimagjinueshme. Më vjen mirë që jam një person si ti me këtë karakter. Më bën kureshtare të di a do të kem jetë të lumtur, me familje dhe me zëra fëmijësh dhe me njerëz që më duan pa interes. Do të doja të dija në qoftë se do te vazhdoja profesionin tim të preferuar dhe të bëhem dikush në jetë, të jem e suksesshme dhe të kem ndërgjegje të pastër. Të këshilloj që tani që duhet të kesh besim të plotë në vetvete dhe jo frikë. Studio në universitetin më të mirë dhe përfundoi ato me sukses. Mbase ndonjë gjë e vogël mund të ndryshojë çdo ëndërr timen, po gjithsesi ajo Elia 12 vjeçare do të jetë gjithmonë pas teje me ëndrrat e saj dhe dëshirat. Mendo më të mirën për veten tënde dhe mos bëj si të thonë të tjerët. Duhet të jesh e fortë të përballësh me të gjitha problemet, që do të vijnë dhe mos harro që notat nuk janë asgjë para shëndetit tënd, pasi duhet të kujdesesh më shumë për veten në moshën 20-25. Ki dëshirë për të mësuar. Këtë letër po e fus në sirtaret e mia si kujtim tëndin dhe mos harro kur të mbushësh 35 vjeçe ta hapësh dhe të lexosh mendimet e mia. Shpresoj të të pëlqejnë mendimet e një 12 vjeçareje. Të uroj shumë fat në jetë, po pres me padurim këtë çast!!

**Elia Kondi 7A**



I dashur Marvi,

Jami i ulur në dhomën time dhe dëgjoj akrepat e orës që bëjnë tik-tak. Qepallat e syve rëndohen. Mendoj me vete: Duhet të ketë vajtur vonë, por kam dëshirë të mbaroj edhe rreshtat e fundit të librit. Papritmas, dëgjoj zërin e ëmbël të nënës. Kthej kokën dhe shoh pemën e shegës, që ishte rritur edhe ishte mbushur plot me shegë të kuqe. Sa çudi! Unë e mbaj mend të vogël. Përpara syve më del nëna. Flokët ishin thinjur, por buzëqeshja dhe rrezatimi i syve nuk kishte ndryshuar. I ëmbël kishte mbetur edhe zëri. Nuk po kuptoja asgjë, papritmas, ajo afrohet dhe më jep një xhaketë dhe një cantë të zezë. Më puth në ballë dhe më uron një ditë të mbarë. Dal te pragu i shtëpisë, atje ku luaj gjithmonë me shokët e mi, por ç' të shoh? Fusha nuk ishte më aty. Në vend të saj është një pallat shumëkatësh dhe shumëngjyrësh. Çfarë ka ndodhur me lagjen time? Çapitem i shkujdesur dhe shtangem para xhamave të një lokali. Po unë qenkam rritur!! Sa shumë që paskam ndryshuar!! Më pëlqen. Vazhdoj te jem akoma djalë i pashëm. Eci rrugës dhe para syve më del emri "MARVIN CO'". Nuk u besoj dot syve. Uau, ia paskam dalë!! Kam krijuar kompaninë time. Kam ecur në gjurmët e prindërve të mi dhe paskam plotësuar dëshirën e tyre për t'u bërë një njeri i suksesshëm. Hyj brenda dhe vështroj njerëzit që më përshëndesin. Vallë po zyrën ku duhet ta kem?! Vazhdoj të eci dhe shoh një derë bojëkafë. Në të dalloj emrin tim; president Marvin Bylyku. E shtyj ngadalë me ndroje, por aty nuk ka njeri. Afrohem te tavolina e punës dhe ç'të shoh një kartolinë fëmijësh. E hap dhe lexoj; I nderuar zoti president, faleminderit që ndërtuat shkollën tonë. Të premtojmë që do mësojmë më shumë. Nxënësit e fshatit Priskë. Sa shumë buzëqeshje duhet t'u kemi falur. Bie zilja e telefonit, përpiqem t'i pergjigjem, por nuk e kap dot. Zgjothem, jam në dhomën time me libër në dorë. Paska qenë një ëndërr e bukur, që shpresoj ta realizoj.

**Marvin Bykyku 7A**



\  
Si je Leonardo?

Sot jam kaq i vogël sa që nuk mund të kuptoj shumë gjëra. Ama kur të rritem, do të mund të kuptoj disa gjëra që deri më tani mund të mos i kem kuptuar. Kam gjithçka për të qenë i lumtur. Unë do të mundohem t'ia shpërblej familjes sime çdo gjë. Ata kanë bërë për mua çdo gjë. Prindërit e mi të dashur, nuk do ta harroj kurrë atë që keni bërë për mua dhe nuk e di në qoftë se do t'ua shpërblej dot aq sa dua.

**Leonardo Ndoj 7A**



Përshëndetje,

Unë jam Tedi 12 vjeçar.

Si i ke kaluar këto 23 vitet e fundit? Shpresoj të kesh realizuar ëndërrat e tua dhe gjithashtu që të mos e kesh harruar botën në sytë e fëmijërisë, sepse shumica duan ta harrojnë, përkundrazi bota fëmijënore na jep të gjithëve gjallërinë që e kemi mangut.

Besoj se deri atëherë do ta kesh bërë kampusin ose të paktën hotelin, nuk dua që shokët të kenë ndikuar tek ty për keq dhe shpresoj të mos i kesh harruar shokët e të 7-tës A. Gjithashtu të mos i kesh humbur lidhjet me të afërmit. Ti mund të kesh kaluar shumë kohë të vështira, por dua të më flasësh pak për gjyshërit: Si janë? Ç'bëjnë? A të sjellin më suvenire nga udhëtimet e tyre?

Dua që të dish se kohët e vështira nuk kalohen me lotë edhe pse ndonjëherë rrjedhin nga një fjalë e fortë, "Zhgënim". Dua që ta lexosh këtë letër jo me syrin e pjekurisë, por me syrin fëmënor. Bëji të fala mamit, babit dhe vëllait, sepse ata të kanë qëndruar më pranë se gjithkush.

Mirupafshim Tedi, shpresoj të mos e harrosh kurrë këtë letër.

**Tedi Juni 7A**



Përshëndetje Henri,

Tani unë jam 12 vjeç dhe ndoshta akoma nuk e di se çfarë do të bëhem në jetë. Di vetëm dhe i kam të qarta këto ide se dua të mbaroj shkollën me rezultate shume të mira. Kjo, jo vetëm për veten time, por edhe për prindërit e mi, që mundohen të më nxisin në rrugën e duhur.

Unë në fakt e imagjinoj veten time si një inxhinier i mirë, ku veprat dhe ndërtesat të mbajnë firmën time. Ku qyteti im të zbukurohet nga pallate e bukura dhe të forta të projektuara nga unë. E imagjinoj veten duke vajtur në zyrën time, e cila mund të jetë në katin e 30 të ndonjë qiellgërvishtësi gati për të nisur një projekt të ri. Të ëndërrosh nuk të bën keq madje shpesh ëndrrat bëhen realitet. E rëndësishme është që këto dëshira dhe ëndrra të kthehen në qëllim dhe shumë shpejt do t'i realizosh.

**Henri Jani 7A**



I dashur Mersini 35 vjeç,

Uroj dhe shpresoj që kur ta lexosh këtë letër t'i kesh arritur ëndrrat e tua, të kesh arritur të jesh njeri i suksesshëm. Shpresoj të kesh krijuar një familje të mirë. Të mos kesh lënë pas dore prindërit, të kesh një punë, të jesh profesionist, të ndihmosh të tjerët dhe të kesh të ardhura. Dhe e fundit, të jesh babai më i mirë në botë.

**Mersin Kasemi 7A**



I dashur Jordi,

Nëse ti po e lexon këtë, do të thotë që kanë kaluar plot 11 vjet. A të kujtohen ndeshjet, që luanim me shokët gjatë pushimeve? Duhet të të ketë marrë malli për ato kohë. Unë shpresoj që ti të kesh arritur të bëhesh një njeri shumë i pasur, por dhe shumë i ditur. Shpresoj që ti tashmë të banosh në atë shtëpinë e madhe që ti kishe ëndërruar dikur. Shpresoj që të jesh bërë shumë i famshëm dhe shumë i dashur me të tjerët dhe të kesh akoma miqësi me shokët e fëmijërisë. Mendoj që për pushime shkon me makinën tënde të preferuar, që me siguri e ke blerë. Gjithashtu, shpresoj që karriera jote të ketë ecur më së miri. Besoj je drejtori i përgjithshëm i kompanisë gjigante të teknologjisë ose të kesh arritur të drejtosh me sukses kompaninë tënde.

Në çdo hap të jetës tënde, kujto ato që ke ëndërruar dhe mos lër asnjë pa realizuar. Kujto që asnjë pengesë nuk është e pakalueshme.

Vetja jote e vogël.

**Jordi Thanasi 7A**



E dashur Uarda,

Shpresoj të të kujtohem sado pak. Jam ajo vajza e vogël, ëndërrimtare, mikja jote e së shkuarës, e cila besoj se t'i mbush mendimet me mall kur kthehesh pas në fëmijërinë tënde të paharrueshme. Veç ta dish se sa të mendoj. E di se tani ke një karrierë dhe një pamje plotësisht ndryshe. Në qoftë se do të të tregonin një foto timen a do më njihje vallë? Po ç'them kështu ti s'do të më harrosh kurrë apo jo? Tani duhet të jesh një femër e pavarur dhe e vendosur. Shpresoj që t'i kesh harruar ato lëkundjet dhe gabimet e fëmijërisë. Më e rëndësishmja duhet të kesh krijuar familjen tënde, që do të të mbështesë dhe do të pavarësisht të metave të tua, atë që ka bërë që në ditën e parë që erdhe në këtë botë. A i ke përmbushur ëndrrat e mëdha që një ditë të studioje në një nga shkollat më prestigjioze të botës? Besoj se pas shkollës ke arritur të ngjitesh lart e më lart në shkallët e jetës dhe me anë të karrierës tënde të kesh dhënë një kontribut të madh për njerëzimin. Pavarësisht, profesionit që ke zgjedhur politikane ose shkencëtare e di që je më e mira në punën tënde. Jam e sigurt që ke të gjitha virtytet, vlerat dhe cilësitë e një personi të rritur, matur dhe të sigurt për vendimet që merr në jetë. Shpresoj që të kesh vazhduar gjithmonë përpara me egon e sëmure që të karakterizonte që në hapat e tu të parë dhe ta kesh gjetur qëllimin e vërtetë të gjithë kësaj, qëllimin tënd të jetës. Me dashuri, mikja jote e së shkuarës, Uarda.

**Uarda Xhaferraj 7A**



I dashur Emiljano,

Si e mendoj veten 35 vjeç?! Në mendjen time ka me mijëra mendime dhe ëndrra, që sa e sa shtohen humbin në mendjen time. Tani jam 12 vjeç dhe për 23 vjet jam i sigurt që do të ndodhin shumë ndryshime në jetën time. Unë dua të bëhem futbollist me skuadrën e Milanit. Dua ta nderoj vendin tim jashtë trevave shqiptare. Ama nuk i dihet, ndoshta e ardhmja ime ndodhet brenda vendit tim, aty ku kam familjen. Kam shumë ëndrra që shpresoj që të më bëhen realitet. Mirupafshim vetja ime!

**Emiljano Brahimaj 7A**



I dashu Endi,

Sot e shoh botën ndryshe nga se e mendoj kur të bëhem 35 vjeç. Sot dua të bëj sa më shumë për të qeshur, ndoshta 35 vjeç do të jem më serioz. Sot e shoh botën më poshtë, sesa kur të bëhem 35 vjeç. Sot po jetoj në Tokë, ndoshta 35 vjeç do të jetoj në ndonjë planet tjetër ose në ajër. Sot po mësoj më shumë që kur të shkoj 35 vjeç të mos mësoj më shumë. Sot kam qejf të bëj gjëra që nuk më lejohen, si; t'i jap makinës e motorrit, por ndoshta atëherë do më jenë mërzitur e nuk dua t'i bëj më. Sot nuk kam mjekër e mustaqe, ndoshta atëherë mund të kem. Sot nuk e kam provuar të jem baba, ndoshta atëherë po. Sot nuk jemi aq të zhvilluar në teknologji sa mund të jemi atëherë. Prandaj dua ta shijoj jetën e sotme, se nuk e kam më nesër.

**Endi Leka 7A**



Si je?

Përshëndetje, unë jam Franklin 13 vjeçar. Si ia ke kaluar këto 22 vitet e fundit? Shpresoj me gjithë zemër që të kesh realizuar ëndrrat e tua dhe shpresoj që të mos kesh hequr dorë nga asnjë nga ëndrrat e tua.

Besoj se në qoftë se ke punuar fort, do ia kesh dalë të bëhesh futbollist profesionist. Ndërkohë mendoj se edhe shkollën e ke mbaruar dhe ke një familje të mirë. Shpresoj të mos kesh harruar asnjë nga shokët e tu dhe të jesh në kontakt me ta. Mund të kesh kaluar edhe kohë të vështira, por besoj se ia ke dalë me sukses. Dua që të lexosh këtë letër dhe të mos kesh harruar asnjë gjë nga e kaluara jote. Mirupafshim Franklin dhe shpresoj që ta kesh ruajtur këtë letër.

**Franklin Arbër Shehu 7A**



Ç'kemi vetja ime 35 vjeç,

Unë jam Henri Tozaj. Tani jam vetëm 12 vjeç. Tani jetoj në Tiranë. Unë studioj në shkollën "Turgut Ozal". Në shkollë lënda ime e preferuar është anglishtja dhe biologjia. Më pëlqen shumë të luaj futboll dhe basketboll. Në moshën 35 vjeçare, unë dua që të jetoj në kryeqytetin e Gjermanisë, Berlin. Atje dua të kem një vilë të madhe dhe të kem ndërmarrjen time. Dua gjithashtu të kem makina luksoze. Shpresoj që këto gjëra të realizohen. TAKOHEMI MBAS 23 VITESH.

**Henri Tozaj 7A**



I dashur Esli 35 vjeç,

Në këtë stad të moshës sime ku jam 35 vjeç, duke menduar për të kaluarën time kam kaluar eksperiencë të shumta, ku përveçse jam rritur, jam përmbushur në aspektin profesional dhe familjar. Një pjesë aq e rëndësishme kanë qenë edhe ëndrrat e mia, të cilat disa mund të më kenë humbur gjatë rrugës, por tek kujtoj secilën prej tyre mbushem me nostalgji dhe dëshirë për t'i jetuar sërish ato. Familja ime më ka inkurajuar për të ndjekur dëshirat dhe për të realizuar ëndrrën, e cila ka qenë dhe është gjithnjë basketbolli. Përkushtimi ndaj kësaj ëndrre ka nisur në një moshë shumë të hershme, kur unë isha 8 vjeç dhe e ndoqa atë për gjatë jetës sime.

**Esli Baçi 7A**



Përsëendetje Rajan,

Tani që jam i vogël mendoj se kur të rritem do të bëhem futbollist. Tani luaj për Internacional Tirana dhe kur të rritem, dua të jem pjesë e Kombëtares Shqiptare. Ëndrra ime më e madhe është që të luaj për Realin e Madridit. Unë dua të jem futbollisti më i mirë në botë dhe të më njohin të gjithë njerëzit në të gjithë botën, dua po ashtu të jem numri shtatë. Kur të mbaroj ëndrrën time mund të bëhem ndonjë trajner ose do të merrem me profesionin e babait. Kjo është ëndrra ime që dua patjetër ta realizoj, shpresoj që të bëhem futbollist kur të rritem.

**Rajan Subashi 7A**







E dashu Esli,

Sot mbusha 35 vjeç dhe po e festoj me shoqërinë time, kur papritur në dorë më erdhi një zarf, në të cilin aty shkruante:

"Sot 23 vjet më parë. Letër vetes sime 35 vjeçare".

U habita, u shtanga në moment, pasi nuk më vinte asnjë kujtim lidhur me këtë letër, të cilën e kisha shkruar vetë, por kishte mbetur në arkivën e shkollës sime "Turgut ÖZAL". Sapo e hapa përshtypja e parë ishte shkrimi im 12 vjeçar, i cili në ditën e sotme është totalisht ndryshe. Fillova ta lexoj .....

"Këtë letër po ia dedikoj vetes sime dhe dua që ta lexoj përsëri pas 23 vitesh kur të jem 35 vjeçe dhe të kujtoj fëmijërinë time. Ëndrrat, mendimet, të cilat nuk mund t'i imagjinoja kur të bëhesha 35 vjeçe. Dua të shpreh dëshirat dhe gjithçka lidhur me jetën time pas 23 vitesh, të cilat po i hedh në këtë fletë të bardhë. Dua të di se si do të jetë portreti im, çfarë do të ketë ndryshuar e çfarë jo. Ëndrrat mund të jenë akoma të pamenduara, por për një gjë jam e sigurtë; që jeta do të jetë më e mirë se sot. E vetmja gjë, e cila dua të mos ndryshojë nga sot, është uniteti i familjes dhe dua të jemi të gjithë bashkë si sot, shëndoshë e mirë. Me këtë dëshirë të fundit po e mbyll këtë letër dhe uroj që edhe kur ta lexoj të jem e lumtur si sot më datë 17.10.2016."

**Esli Bano 7A**



E dashur vetja ime 35 vjeç,

Kjo letër është për veten time kur të jem 35 vjeç. Pyes veten se sa shumë do të kem ndryshuar e të jem rritur deri atëherë. Jam shumë kureshtare të di se çfarë do të bëhem kur të rritem. Kush e di sa do të ketë avancuar edhe teknologjia. Jam e sigurt se deri atëherë bota do të jetë bërë një vend më i mirë seç është sot. Tani që po shkruaj këtë letër jam 12 vjeç dhe mezi pres ta lexoj pas 23 vitesh, kur të jem 35 vjeç. Shpresoj që deri atëherë të jem shëndoshë e mirë bashkë me familjen time. Ku i dihet nëse do t'i kem akoma miqtë që kam sot apo të kem zënë shoqëri të re. Eh, sa pyetje kam për veten time në të ardhme, por do të vijë një ditë që do të marrë përgjigjet e këtyre pyetjeve. Këtu po mbyll dhe këtë letër për veten time 35 vjeç dhe siç e thashë dhe njëherë pres me padurim ta lexoj pas disa vitesh.

**Uena Caushaj 7A`**





E dashur vetja ime,

Më duaj kështu si jam dhe unë do të ta kthej dashurinë njësoj. Më duaj dhe kur zgjedh siç ma thotë zemra, do të të dua dhe kur zgjedh me mendje.

Pse po e shkruaj këtë letër? Përgjigja ime është e thjeshtë dhe paksa e çuditshme. Këtë letër po e shkruaj për ta hapur kur të jem 35 vjeçe. Në kokë më vijnë mijëra mendime e ëndrra të fshehura. Teksa shkruaj mendoj veten 35 vjeçare dhe më lindin shumë pyetje në kokë. A do t'i realizoj ëndrrat e mia vallë? A do të jem e kënaqur me atë që do të ndodhë? A ia vlen të punoj fort për të qenë e lumtur? Tani për tani unë dua që në të ardhmen të bëhem arkitekthe dhe këtë profesion ta marr në shkollat më të mira jashtë vendit. Jo se më pëlqen që për një kohë të rri larg familjes e vendit tim, por mendoj se vendet jashtë janë më të zhvilluara. Ama kurrë nuk i dihet se në çfarë provash dhe sfidash do të vërë jeta. Sigurisht, që me kalimin e kohës do të ndryshoj mendim kjo është normale, sepse çdo njeri në çdo moshë mendon ndryshe dhe ka qëllime dhe objektiva "unike" për drejtimin që do të marrë jeta.

Ndonjëherë gjëja më e mirë që mund të bësh është të mos mendosh, të mos ëndërrosh, të mos imagjinosh. Vetëm merr frymë thellë dhe gjithmonë beso se cdo gjë do të shkojë më së miri.

Nga vetja jote 12 vjeçare, për ty një e panjohur me ëndrra të mëdha.

**Alisia Bami 7A**



Si e mendoj veten 35 vjeç?!  
 Në mendjen time rrokullisen me mijëra mendime, dëshira, por mbi të gjitha ëndrra. Në Shqipëri, Francë, Portugali apo edhe mbi re në ndonjë vend magjik, diku atje fshihet e ardhmja ime.

Çdo vit ato ëndrra rriten dhe bashkë me to vullneti dhe kurajo për t'i mbërritur ato. Epo jo secila ëndërr bëhet realitet, pasi vetëm përrallat nisin me magji dhe mbyllen po ashtu.

Nuk e di profesionin tim dhe s'kam dëshira. Letërsia do mbetet një pjesë e imja, do të mbetet si një këngë, që nuk mbaron apo unë nuk dua ta përfundoj, ku notat e saj lidhen si hallkat e një zinxhiri të artë me jetën time.

Sa ëndrra, sa profesione do mund të imagjinoja, ndodhi dhe jetën do mund ta përcaktoja, por janë disa gjëra në jetë, që s'janë në dorën tonë. Koha fluturon dhe unë nuk e kam akoma përgjigjen time.

Unë s'jam e qartë se çfarë dua. Pasi po jetoj një periudhë që nuk kthehet. Shumë shprehje thonë: "Jeto sikur do vdesësh nesër dhe mëso sikur do jetosh përgjithmonë."

Unë s'jam e qartë se çfarë dua. Pasi po jetoj një periudhë që nuk kthehet. Shumë shprehje thonë: "Jeto sikur do vdesësh nesër dhe mëso sikur do jetosh përgjithmonë."

**Adea Xibraku 7A**



E dashur Eanda 35 vjeç,

Si e mendoj veten në moshën 35 vjeç? Si çdo fëmijë tjetër edhe unë kam ëndrra dhe kam dëshirën e madhe, që secila prej tyre të realizohet. Pjesë e këtyre ëndrrave është të kem një shtëpi të mirë dhe një punë. Besoj se kur të rritem do të jem ekonomiste. Por ama edhe mund të ndryshoj në mendim gjatë pjekurisë dhe rritjes. Kur të rritem unë dua të jetoj jashtë shtetit. Dua të jetoj në vende të mirënjohura si: Franca, Italia, Gjermania, Amerika ose Anglia. Shpresoj që pas 23 vitësh kur të lexoj këtë letër gjëra të jenë zgjidhur. Le të shohim se si do të jetë e ardhmja ime pas 23 vjetësh. Shihemi pas 23 vjetësh.

**Eanda Pajaj 7A**



E dashur e Ardhme,

Sot ke mbushur 35 vjeç. Shpresoj që jeta jote të jetë e kompletuar dhe mos të kesh shumë problem. Pas diplomimit, besoj se ke gjetur një punë që të të pëlqejë e që ta bësh me pasion. Shpresoj që të kesh gjetur një njeri që të të bëjë të lumtur dhe të kesh arritur të bësh miq të vërtetë, miq që të të qëndrojnë gjithmonë pranë, në kohë të vështira, por edhe në momente gëzimi. Në jetë ka shumë vështirësi e sfida, që ke përballur e do të vazhdosh të përballesh, por asnjëherë mos hiq dorë. Gjithmonë shko pas ëndrrave të tua dhe bëj më të mirën për t'i realizuar ato.

Me dashuri, e Shkuara.

**Kludia Plevneshi 7A**



Ç'kemi Akil .... jam ti nga e shkuara!

Po të shkruaj nga dhoma ime. Në këto momente jam ulur në tavolinë, sapo kam mbaruar detyrat e shtëpisë dhe po shkruaj. E vështirë besoj ta mbash mend këtë letër, por po ta rikujtoj. Kjo është detyra e caktuar në gjuhë. Mendoj që tani do të jesh në punë ose në shtëpi, me siguri i rrethuar nga shoqëria dhe familja. Tani besoj po të kujtohet koha, kur ke qenë fëmijë. Shpresoj të kesh një jetë siç e kam ëndërruar, plot pasion në gjërat që bën, i mbushur me dashuri. Puna që bën të pëlqen shumë dhe je i lumtur. Ndiemon njerëzit në nevojë dhe je i rrethuar nga plot miq. Do gjesh shpirtin tënd binjak dhe do ndash me të pasionet e tua. Të uroj fat me jetën tënde, dhe shpresoj të ngelesh gjithmonë një shpirt i lirë.

**Akil Mara 7B**



Përshëndetje Albri,

Si jeni? Si ka vijuar jeta jote? A i ke plotësuar objektivat e tua? Shpresoj që i ke mbajtur premtimet? A e mban mend fëmijërinë që ke kaluar, dëshirat, shokët? Ato premtime të vogla, por me kuptim të madh për ty. Të kujtohet dëshira jote e parë? Gjithnjë ke dashur të kishe një varinks. Tani që po e lexon ndoshta po të vjen për të qeshur por po, çdo pjesë e dhomës ishte plot e përplot me lodra varinksash. Të dukej shumë interesante, gjigande për një fëmijë 5-vjeçar. Gjithë ajo makineri me një dorë shumë të madhe e të fuqishme që gllabëronte gjithçka që i dilte përpara. Vitet kaluan. Më në fund erdhi dita e parë e shkollës. Klasa e parë. Atje mësove shkronjat e para, kuptove se çfarë është shoqëria. Ne ndryshuam fizikisht, por gjithashtu edhe shpirtërisht. Në këtë kohë dëshiroje që të bëheshe shkencëtar matematike. E adhuroje shumë atë lëndë. Githmonë i pari në klasë ishe. Teksa çdo shok i yti numëronte me gishta, ti kishe arritur te bëje rrënjën katrore. Deri në klasë të pestë, ecje me këtë ëndërr. I përkushtoheshe shumë matematikës. Me motrën e madhe luanit shumë lojëra, por shpiknit gjithashtu. Erdhi dita që duhej t'i shpjegoje motrës së madhe disa ekuacione matematike. Uhh, atë ditë të lodhi shumë, por gjithsesi ia nxive jetën gjithë vitit, duke i treguar se nuk merr vesh në matematikë, por duhet ta pranojmë në lëndët shoqërore është më e mirë se ne. Vitet ecin pa ndaluar. Dalëngadalë filluam t'i kuptojmë gjërat më thellësisht. Mësuam të ndajmë të mirën nga e keqja. Dëshirat shtohen, hiqen, por edhe ndryshohen. E jotja ndryshoi sërish. Dëshiroje të bëheshe biznesmen. Të mbarosh 8-vjeçaren tek "Turgut Ozal". Gjimnazin ta mbaroje në Londër. Duke marrë parasysh, sepse kam edhe përkrahjen e gjithë familjes dhe motra ime ndodhet aty. Dhe mos të fillojmë tani për universitetin, normalisht që në HAËARD madje edhe një student shumë i dalluar. Të diplomohesh, pastaj të fillosh masterin. Pas masterit shumë biznese do të luten që të punosh për ata. Do fitosh shumë para. Do të ndihmosh çdo njeri që të ka ndihmuar dhe ata, që duan të të ndihmojnë, por nuk kanë mundësi. Tani që po e lexon ndoshta po mendon se çfarë fëmije kam qenë, plot me imagjinatë e objektiva ose ndoshta po thua; mos u shqetëso çdo gjë që kam ëndërruar e kam realizuar. Atë gjë nuk e di, po do ia lejoj të ardhmes të ma tregojë. Kurrë mos u dorëzo. Jeta është si deti i qetë, i bukur, i shndritshëm, por nga momenti në moment stuhia fillon. Të dalin përpara dallgë shumë të mëdha që dhe mund të të fundosin, por kurrë mos ndalo së notuari, sepse një ditë dielli do të dalë sërish. Shpresoj të jesh mirë dhe të kalosh një jetë sa më të lumtur dhe sa më të gjatë pranë njerëzve të tu të dashur.

Me dashuri

**Albri Kasmi 7B**



E dashur Paula,

Kemi shumë vite që jemi larguar dhe mua më ka marrë shumë malli për ty. Besoj se ke shumë gjëra për të më treguar. Ndërkohë unë po të shkruaj dhe po të përfytyroj, se si ke ndryshuar ti gjatë këtyre viteve. Je shkolluar në fakultetin ekonomik. Të përfytyroj një vajzë me trup të bukur, elegante, me flokë të gjata, të zeza. Nga fëmijëria kanë mbetur vetëm shkëlqimi i syve të tu dhe buzëqeshja jote. Ke qenë e suksesshme në biznes. Je martuar dhe shoku yt i jetës të qëndron gjithmonë në krah për të të ndihmuar. Ke një shtëpi të bukur të kompletuar me shije dhe e mbushur me cicërimat dhe zërat e gëzueshëm të vogëlushëve të tu. Si gjithmonë ti u qëndron pranë duke i ndihmuar në realizimin e lojërave të tyre dhe në përmbushjen e detyrave që ata kanë. Djali të ngjan ty, kurse vajza bashkëshortit tënd. Shpesh mblidheni me shoqërinë, duke kujtuar vitet shkollore dhe kjo ju bën t'i ktheheni fëmijërisë suaj ,që ndryshon shumë nga kjo e fëmijëve të tu. Besoj se kujtoni edhe mësuesit tuaj. Ata, të cilët nuk kursyen asgjë për t'ju mësuar juve gjithçka.

Paula!!!

Nuk e di nëse unë kam shkruar gjithçka që duhet, por dëshiroj gjithmonë më të mirën për ty dhe familjen tënde. Shpresoj që me këtë 35- vjetor të jesh e lumtur dhe e rrethuar nga familjarët dhe miqtë e tu më të mirë. Besoj se edhe unë do të jem e pranishme në një cep të vogël të zemrës tënde. S'besoj se më ke harruar. Po e mbyll letrën duke të uruar edhe njëherë: GËZUAR 35 VJETORIN!!! Qofsh e lumtur!!!

Të puth nga larg Paula 12- vjeçe.

**Paola Xho Vilajeti 7B**



Miku im më i mirë Erblin,

Megjithëse jam ende i vogël, ëndërroj që kur të rritem të realizoj ëndrrat dhe qëllimet që i kam vënë vetes. Dua të mbaroj studimet e larta si menaxher biznesi dhe të jem në krye të punës së biznesit tonë familjar duke e rritur e zhvilluar shumë atë. Dua që të jem një njeri i plotësuar me intelekt, me dije të gjuhëve të huaja, të njoh njerëz të ndryshëm nga vendet e botës dhe të jetoj në të gjitha dimensionet. Dua të jem një njeri i dashur e i respektuar për miqtë dhe familjarët e mi, të jem njeri pozitiv dhe të fal dashuri e respekt për të gjithë njerëzit. Më pas, vazhdimi i ëndrrës është krijimi i një familjeje perfekte. Dua të kem të njëjtën familje, siç e kam dhe unë sot. Të rris dhe të edukoj fëmijë të ndershëm e të edukuar, të rritur me dashurinë për atdheun dhe të ndihen krenarë për mbiemrin që mbajnë.

**Erblin Boletini 7B**



E dashur Ana!!

Po e shkruaj këtë letër si një forcë shtytëse për të ardhmen time kur të rritem. Synimi im është që të jem më e mira nga të gjithë dhe të kaloj një jetë sa më të bukur. Është e vërtetë që synimi im për të ardhmen ka nevojë për një dritë të fuqishme që të ma ndriçojë rrugën që do eci.

Kam dëgjuar se në të ardhmen do të përballem me shumë sfida, por unë do të jem e kujdesshme që t'i kalojë ato me sukses. Bota është e madhe dhe duhet që të përballemi me shumë njerëz të njohur e të panjohur, ku ndërmjet tyre ka edhe nga ata që janë të pafytyrë dhe arrogantë. Kur të rritem dhe pasi të jem pjekur dhe plotësuar si person, do vijë koha që unë të takoj njeriun e jetës sime, i cili do të jetë personi më i dashur dhe më i afërt për mua, do të jetë mbështetja ime. Në shumicën e sfidave me të cilat do të përballem, njeriun e jetës sime do ta kem një mbështetës të zjarrtë dhe një këshillues të mençur. Ndërkohë unë do të kem realizuar ëndrrën time për të pasur një karrierë personale dhe jam e sigurt, që do të jem mirënjohëse për atë që kam arritur. Përsëri dua të them që karriera nuk është gjithçka.

Gjatë jetës kemi shumë arritje dhe disfata, kështu që do t'i mendojmë disa herë ato, që të shkojmë në rrugën e duhur. Në qoftë se nuk e bëjmë këtë gjë, një ditë do të pendohemi për zgjedhjen tonë. Letrën, që po shkruaj shpresoj ta ruaj akoma edhe kur të rritem, sepse ajo është shumë inkurajuese. Nëse në të ardhmen do të përballem me ndonjë problem, shpresoj ta hap këtë letër dhe në të, të gjej disa këshilla të cilat do të më çojnë në rrugën e duhur.

**Ana Dumani 7B**



Kur të jem 35 vjeç....

Nëse do të mendoj që do të jem 35 vjeç, do të më duhet të imagjinoj. Unë do të kem mbaruar studimet në atë kohë. Do të kem krijuar edhe familjen time. Të kem një njeri si vetja në krah..., një familje të bukur me këtë njeri, edhe të punoj në profesionin që aq shumë e kam pasion. Si profesion do të jem stiliste, sepse më pëlqen shumë dhe kam filluar të stiloj që tani. Tani që po të shkruaj këto rreshta më duket çudi, por unë i kam vënë vetes qëllim se do të arrij deri në fund. Do të kem të ardhura mjaftueshëm, sepse do të stiloj me finesë për të gjitha moshat dhe për të gjitha masat. Të jem presidente e një kompanie të madhe veshjesh. Do të kem shëtitur shumë vende nëpër botë. Ndërkohë do jem një nënë dhe një grua e përkushtuar ndaj familjes sime. Shtëpinë time (një vilë të bukur), ta kem buzë detit, pasi mendoj që do të mundem më mirë të bëj stilimet e mia. E ardhmja ime do të jetë shumë e mirë. Kam pasion edhe për pikturën, që mendoj do ta vazhdoj ta ushtroj jo mbase si profesion, por për dëshirën time. S' di të shtoj më shumë, por e vetmja gjë që them me siguri është se synimet e mia do t'i çoj deri në fund. Dhe një gjë them me siguri: Unë nuk do të bëhem stiliste; Unë jam një stiliste.

**Bianka Burimi 7B**



E dashur Dea!

Tani që po të shkruaj jam në klasë të shtatë. Jam shumë kurioze të di se si do të jetë jeta ime pas 22 vitesh. Sa do të kem ndryshuar, çfarë do jem bërë kur të rritem, a i kam realizuar të gjitha ëndrrat e mia etj. Ndonjëherë kur e mendoj veten time 35 vjeçe më duket vetja e plakur. Kur të jem 35 vjeçe do kem shumë përgjegjësi, e cila më duket shumë gjë e vështirë për t'u mbajtu mbi supe. Tani për tani nuk jam gati për t'u rritur, por shpresoj që kur të jem 35 vjeçe të kem krijuar një familje, të kem mbaruar shkollën dhe të bëj një punë që më pëlqen. Tani që jam në klasë të shtatë dua të jem e rritur, por ndonjëherë ndryshoj mendje. Kur e mendoj kam dhe shumë rrugë për të bërë. Dua të mbaroj shkollën, të diplomohem, të shkoj në universitet. Shpresoj që shkollën ta mbaroj këtu në Kolegjin "Turgut Özal". Për mendimin tim kjo është një nga shkollat më të mira, që të ofron shumë mundësi për të ardhmen. Kjo shkollë të ofron dhe bursa për shkollat jashtë. Plus tani për tani nuk dua të largohem nga kjo shkollë, sepse kam miqtë e mi më të mirë që më kanë mbështetur gjithmonë dhe unë dua që të diplomohemi bashkë dhe të mbetemi miq gjithmonë. Po kur të jem 35 vjeçe dhe të lexoj këtë letër, ndoshta do të qesh ose ndoshta do të më kujtohet vetja sa e vogël kam qenë. Kjo gjë mbetet për t'u zbuluar. Tani i erdhi dhe fundi letrës sime.

Mirupafshim!

**Dea Boka 7B**



Ledio ç'kemi,

Shpresoj që kur ta lexosh këtë letër të mos qeshësh shumë me veten kur ke qenë 12 vjeç, por le t'i lemë mënjane këto fjalë dhe po të them se shpresoj që kur të jesh 35 vjeç të jesh mirë me shëndet në rradhë të parë. Pastaj dua të të pyes se si po të shkojnë punët në kompaninë që ti e kishe me aq dëshirë për ta patur? Shpresoj që në këtë moshë të kesh formuar familjen tënde dhe të jesh shumë i suksesshëm në punën që bën.

A i ke vizituar vendet, që kishe aq shumë dëshirë për t'i parë? A ke shkuar tek koncertet e këngëtarëve që i kishe kaq shumë qejf? Shpresoj të kesh shkuar, pasi ti i pëlqej shumë. Gjithashtu shpresoj të kesh shkuar për të parë Barcelonën, megjithëse Messi nuk luan më, sepse është bërë diku tek 60 vjeç, por prapë ngelet legjenda e futbollit.

Tani më lër të të pyes pak për familjen. Si është mami me babin, po motra me vëllain a janë mirë? A është bërë motra, ajo biznesmenia më e madhe, që ajo dëshironte të bëhej? Po vëllai a është bërë ai inxhinieri i famshëm, që të gjithë dëshirojnë ta marrin në punë? Shpresoj që të gjitha këto gjëra që thashë më sipër të jenë bërë realitet.

Mirupafshim Ledio shihemi në një të ardhme të afërme.

**Ledio Lala 7B**



I dashur Evjol,

Nëse nuk po të kujtohem, jam unë, Evjoli. Ai, Evjoli mistrec, i cili edhe pse është i rrëmujshëm e ndonjëherë moskokëçarës, gjen gjithmonë kohë për mësimet. Ai Evjol, që edhe pse ka shoqëri me shumë e shumë njerëz, rrallëherë ndodh, që vërtet të hapet më një person. Evjoli, që edhe pse merr mjaft lëvdata, shpeshherë është pesimist mbi aftësitë e tij. Ai, i cili sa e sa herë tentonte të gjente rrugë të shkurtra e shpesh përpiquej të devijonte fajin e tij. Për të të ndihmuar, po të jap një ndihmë të fundit; jam ai Evjol, i cili së fundmi ka filluar të rregullojë flokët, të dalë me shokët, të kujdeset për pamjen e tij të jashtme e ta ndiejë veten e tij adoleshent, por që në të njëjtën kohë, ka kuptuar se si vetëm të punuarit fort mund të të çojë në sukses e të të mundësojë të depërtosh në jetë.

Them se t'u kujtova. T'u kujtova unë e idetë e mia, aq sipërfaqësore e naive rreth së ardhmes, se si fare lehtë, do të bëhesha një fubollist, kitarist, biznesmen a ku di se unë se çfarë, e do të kisha një pasuri të pallogaritshme. E di, që në këtë moment po sjell ndërmend këto kujtime si në mjegull, e po ndien mallin e madh për ato ditë të vjetra. Mund ta marr me mend fare lehtë që nuk ka qenë aspak ashtu siç e mendoja unë. Jo, nuk po them se nuk ia ke arritur, madje kam një besim të madh që tashmë je një njeri mjaft i suksesshëm e me një status që sa vjen e rritet më shumë, por ajo që doja të thoja ishte se ke kaluar vështirësi të panumërta për të arritur aty ku je tani, një person që e respektojnë e që i respekton të gjithë. Edhe nëse kjo gjë nuk ka ndodhur, shpresoj që kjo letër të vlejë sado pak në motivimin tënd.

E ja ku je ti sot, në një kohë krejtësisht të ndryshme, më shumë se dy dekada më vonë, në një botë, sipas meje, shumë herë më të vështirë për t'u përballuar. Dhe ja përse ta shkrova këtë letër, për të të ndihmuar me aq sa mundem të çash në jetë. E di se ç'po mendon, e ç'mund të të mësojë ty, një personi të suksesshëm, unë, një mistrec i vogël që nuk ia ka aspak idenë jetës. Nëse e gjeta saktë, atëherë më beso, se këto fjalë naive, momentalisht të papërfillshme, herët a vonë mund të jenë shumë të vyera për ty.

Duhet të dish se jeta mund të të përplasë me vështirësi të pafundme, por ti nuk duhet të lëkundesh, e duhet të mësosh t'i kthesh ato në forcë për të vazhduar përpara. Qëndro i hapur ndaj ndryshimeve, pasi të lejojnë të jesh më i sigurt tek vetja, duke e ditur se gjërat e reja nuk të trembin. Po ashtu, duhet të jesh i sjellshëm e t'i dëgjosh të tjerët. Mund të njihesh me disa nga njerëzit më të mirë, të krijosh lidhje që mund të zgjasin një jetë të tërë e mund të zbukurosh ditën apo edhe jetën e dikujt vetëm duke u sjellë mirë e duke i dhënë një zë për të shprehur mendimin e tyre. Mos harro që gjithmonë të lësh pak kohë për t'u argëtuar, e të mos e dëmtosh veten duke e vrarë shumë mendjen për gjëra të parëndësishme, gjë që unë e bëj shpesh këto kohë. Së fundmi, kujtohu që gjithmonë të jesh vetvetja, e mos ndrysho vetëm





që disa njerëz të të duan. Rri vetvetja e njerëzit e duhur do të të afrohen. Do të shohësh që do t'i surprizosh të gjithë njerëzit e të gjithë do të të respektojnë. Më beso, unë e di si je ti. Fundja, unë jam ti. Me dashuri, Evjoli trembëdhjetëvjeçar!

**Ervjol Goga 7B**



Ç' kemi, Anejda!

Do të doja shumë të të takoja, por është e pamundur. Fundja unë jam ti dhe kur të rritem do të jem po unë, ajo që do ta lexojë këtë letër, që po shkruaj sot. Shpresoj që i mban mend gjërat që kanë ndodhur dhe njerëzit e tu më të afërt... dua të të them që ke pasur gjithmonë shumë shoqe, dy nga të cilat kanë qenë shoqet më të mira janë R.C dhe D.B., me të cilat ke ndarë të gjitha ato sekrete dhe keni kaluar mjaft kohë plot të qeshura e gëzim. Besoj që ke filluar të mendosh për kohët e vjetra dhe për këto që po të them tani apo jo?! Shumë njerëz më kanë thënë që i mungon shumë fëmijëria e tyre, dhe e di shumë mirë që kjo do të ndodhë edhe me mua. Të them të drejtën unë nuk dua të rritem, por nuk kam çfarë të bëj, sepse të gjithë rriten një ditë. A të mungojnë kohët e vjetra? Po shoqet dhe shokët? Sa do të doja të qëndroja gjithmonë fëmijë në trup dhe mendje, dhe të mos rritesha kurrë, por të jetoja gjithmonë në këtë sinqeritet dhe pastërti fëmimore...

Dua të di se ku jeton tani dhe shpresoj që të jesh e lumtur me familjen tënde të madhe. Unë gjithmonë kam dashur që të jetoj këtu, në Shqipëri dhe askund tjetër. Por nuk e di se ku ke zgjedhur ti të jetosh.

Dua të dish diçka... që kur ke qenë e vogël njeriu që ke dashur më shumë nga të gjithë ka qenë gjyshi yt. Ai të mësoi dhe të ndihmoi në çdo mësim, dhe asnjëherë nuk kurseu kur vinte puna tek ti dhe vëllezërit e tu. Prandaj në qoftë se sot ke një punë të mirë dhe një jetë me sukses duhet ta falenderosh pa fund...Dhe jam shumë e sigurtë që s'do ta harrosh kurrë dhe do të jetë gjithmonë në zemrën dhe mendjen tënde. Jo vetëm ai, por të gjithë pjesëtarët e tjerë të familjes. Sigurisht, që mamit dhe babit nuk do mundem kurrë t'ua shpërblej sakrificat që kanë bërë për ne, që të rritemi të shëndetshëm dhe të arsimohemi në kushtet më të mira të mundshme, por në radhë të parë që na mësuam të jemi njerëz... Prandaj mos u largo prej tyre dhe bëji krenar e të lumtur që kanë rritur fëmijë si ne, dhe në mënyrë që ata ta dinë që nuk janë vetëm, por kanë tre fëmijë të mrekullueshëm që mendojnë dhe kujdesen për ta.

Kjo mund të jetë letra e fundit që të shkruaj ose mbase jo, por ne nuk do të ndahemi kurrë dhe do të takohemi një ditë. Deri atëherë, mirupafshim...

**Anejda Llazari 7B**



E dashur Iljona!

Kjo është një letër, të cilën po ta dërgoj nga e ardhmja. Në letrën e fundit që më kishe shkruar ishe kurioze të dije për jetën që unë kam. Ja pra, këtu i ke të gjitha përgjigjet.

Tashmë kam një profesion, punoj si mjek. Kjo punë është pak e lodhshme, por sigurisht që të jep edhe shumë kënaqësi. Piktura ka ngelur akoma një prej pasioneve të mia. Kur kam kohë të lirë pikuroj, zakonisht në vende ku ka gjelbërim. Sigurisht që edhe të gatuarit më pëlqen shumë dhe s'e kam lënë pas dore, vazhdimisht gatuj diçka dhe gjithashtu krijoj gjëra të reja. Pra, kam një jetë të bukur e të thjeshtë, por që ka edhe aventura të reja e gjëra të veçanta.

Tani më duhet të shkoj. Pasi ta marrësh letrën dhe ta lexosh, më shkruaj patjetër! Mezi po pres që të flasim sërish!

Me dashuri Iljona!

**Iljona Hysenaj 7B**



I dashur Geri

Kur isha fëmijë mbaj mend që doja të isha shpesh i rritur, e tani që jam i rritur shpesh dua të kthehem fëmijë. Mbaj mend, që luaja poshtë pallatit me shokët e mi dhe ishte shumë e vështirë të më hiqje që andej. Doja të luaja pafund dhe të isha fitimtar. Kjo më ka bërë ndoshta të jem kaq i suksesshëm edhe sot, se ishte e pamundur të hiqja dorë nga diçka.

Më mungon klasa ime, aty ku kam bërë 9-vjeçaren, ku mësuesja ime kujdestare kujdesej shumë për mua. Ajo ishte shumë e dashur sikur s'e vinte re fare që unë bëja trazira. Mundohej shumë, që të më bënte të sillesha mirë dhe se shpesh unë e mërzisja. Sa do doja ta takoja sërish. Kam patur moshën që ka Klearti sot, djali im, dhe ndjehem shumë mirënjohës që ajo mësuese hyri në jetën time, sepse më bëri njeriun që jam sot.

Kur njoha gruan time isha një financier i thjeshtë në ndërmarrjen që më pas u bë ndërmarrja ime. Së bashku me atë që më pas u bë bashkëshortja ime punuam me shumë dëshirë dhe vullnet që të arrinim aty ku jemi sot. Ndërmarrja e mëparshme kishte falimentuar kur ne e blemë dhe ngritëm një ndër ndërmarrjet më të mira në treg që sot quhet "Is & Kle". Një ndërmarrje që mbulon shërbimet e hoteleve me 5 yje në të gjithë botën, tashmë mban emrin tim.

**Geri Dhame 7B**



Përshëndetje,

Sapo dola nga një operacion! Jam i gëzuar, sepse sapo shpëtova një jetë.

Unë quhem Itilo dhe jam 35 vjeç, i martuar me gruan time të bukur shtetase ruse, të cilën e njoha ndërsa vazhdoja studimet në Londër dhe me dy dritat e syve të mi, vajzat e mia, Nadja dhe Elizabet. Unë punoj si doktor zemre bashkë me vëllain tim dhe deri tani jemi shumë të suksesshëm dhe më të kërkuarit në Tiranë. Ne jemi frymëzuar po ashtu nga tre vellezër, të cilët janë mjekë kardiologë e që po ashtu janë shumë të njohur në profesionin që ushtrojnë.

Gjithashtu unë dhe vëllai im punojmë dhe tek një klinikë private në Tiranë.

Pra kjo është jeta jonë profesionale dhe shumë e ngarkuar, por që njëkohësisht na jep shumë kënaqësi. Ne jemi dy vellezër shumë të suksesshëm në jetë dhe me familje të mira.

**Itilo Broci 7B**



I dashur Mario, i vogël!!!

Unë quhem Mario dhe jam 35 vjeç. Po i shkruaj letër vetes sime për të kujtuar fëmijërinë e shtrenjtë, që të vjen vetëm një herë. Po ia nis që nga fillimi i jetës sime. Unë kam lindur më 26 Mars 2004, por për fat të keq nuk mbaj mend asgjë që kam bërë kur isha bebe, por prindërit e mi më kanë thënë se unë kam filluar të eci që një vjeç. Fillova të flisja pak me vonesë, tre vjeç e gjysmë dhe mësova të shkruaj kur isha pesë vjeç. Gjithashtu, kur isha katër vjeç kisha mësuar disa numra. Tani erdhi koha të shkoja në klasën e parë, që ishte shumë e lehtë. Në këtë kohë mësova shkronjat e alfabetit dhe më shumë numra. Kështu m'u duk edhe klasa e dytë, ku përvetësova dijet që kisha marrë nga klasa e parë. Po aq e lehtë ishte edhe klasa e tretë, ku për herë të parë mësova "Dituri Natyre", e cila ishte lëndë shumë elementare dhe një nga lëndët e mia të preferuara. Në këtë kohë babi filloi të më mësonte disa gjëra për matematikën dhe gjithmonë në këtë lëndë unë isha superior ndaj shokëve të klasës. Edhe klasat në vijim nuk u vështirësuan dhe aq shumë sa mendoja, por duhet të kisha fuqitë e duhura për të përballuar shkollën e mesme dhe të lartë. U përkushtova, dhe i pëballova plot tetë vjet mësimi dhe shumë teste. Në vitin e fundit unë kisha dalë me rezultate të shkëlqyera dhe gjeta një punë të mirë. Ja pra, kjo ka qenë e shkuara ime e suksesshme, por edhe me gabime, nga të cilat kam nxjerrë shumë mësim.

Mirutakofshim!

**Mario Topulli 7B**



E dashur Mejla,

Kur të jem 35 vjeç do të jem rritur dhe do të jem bërë një grua shumë e bukur. Puna që më pëlqen të bëj është të jem ARKITEKTE. Mbase bëhem edhe parukiere. Nuk i dihet asnjëherë se çfarë do të bëhem. Jetën time do ta zbukuroj duke krijuar një familje dhe të kem fëmijë të mrekullueshëm. Sa herë e pyes veten për ndonjë gjë, bëhem kureshtare për të ditur se si do të jem unë në të ardhmen. Do të vijë edhe dita ime kur unë do të jem 35 vjeçe. Atëherë edhe unë mund të bëj një gjë personale. Koha ikën dhe ne rritemi vazhdimisht dhe bëhemi më të arsyeshëm. Gjërat ne fillojmë t'i shikojmë në një këndvështrim tjetër. Atëherë kuptojmë se ç' do të thotë të rritesh. Kuptojmë se kur rritemi. Çdo njeri ka kohën e vet për t'u rritur dhe për të krijuar një fazë të re në jetë dhe në familje.

Me shumë dashuri për ty.

**Mejla Hoxha 7B**



I dashur Zhan,

Nuk jam më Zhani 12 vjeç, me faqet buçko e që i pëlqejnë shumë picat dhe akulloret, sepse e kam kuptuar që të ushqehesh në mënyrë të shëndetshme, është shumë e rëndësishme. Vazhdoj të kem shumë shokë e shoqe e vazhdoj të ndjehem shumë mirë me të gjithë ata. Pija ime e preferuar nuk është më Coca-Cola e ashtu si dhe miqtë e mi, i zgjedhim ato me kujdes gjithmonë. Flokët vazhdoj t'i kem shumë merak për të qenë gjithmonë brenda trendit të fundit dhe nuk shkoj më tek "Redi Sallon". Më pëlqen akoma të udhëtoj shumë me prindërit e mi. Kemi vizituar mjaft vende të reja, për të cilat ëndërroja atëherë dhe jam shumë i lumtur për këtë. Unë e di që nuk është e lehtë të pranosh gjithmonë këshilla nga të tjerët, por unë përsëri do të them që përpiqu të jesh sistematik dhe i rregullt në çdo lëndë e mos lër asgjë për ditën e nesërme. Dëgjoji më të rriturit, se ata vërtet këshillojnë drejt e pranoje, se me eksperiencën e jetës që ata kanë, janë në gjendje të na orientojnë mirë. Ditët, muajt dhe vitet kalojnë shpejt dhe ti e sheh veten befas, të rritur e me shumë sfida që kërkojnë dhe mendimin tënd për t'u zgjidhur. Dija nuk ka limit, zhvillimi nuk ka fund e ti duhet të arrish lart, ashtu siç edhe dëshiron! Sa mirë do te ndjehesh kur të kuptosh, që gjithë koha e mundi, që shpenzove për të studiuar në shkolla, ia ka vlejtur kaq shumë! E di që mërzhiteshe kur mami nuk të lejonte të shikoje gjatë TV apo të luaje por, sot e kupon se sa vlerë ka patur e gjitha kjo. Tani ti je dikush në jetë, tani je ti që orienton dhe drejton të tjerët, tani je ti që vendos rregullat, tani je ti shembulli për t'u ndjekur! A nuk doje vërtet të ishe i tillë? A nuk donin të njëjtën gjë dhe prindërit e tu? Jam i sigurt që e kupton shumë mirë.

**Zhani Toptani 7B**



E dashur vetja ime,

Unë jam ti, por njëzet e tre vite më parë. Tani jam ndryshe nga ti kam pasione të tjera, dëshira të tjera dhe opinionet e mia janë ndryshe nga të tuat. Ndërsa ti, je krejtësisht ndryshe nga unë dhe mendimet e tua janë më të pjekura, me plot eksperiencë dhe përvoja nga jeta. E di se sa të rrojmë do të mësojmë, prandaj të dyja kemi një rrugë të gjatë dijesh përpara. Dijet janë ato, të cilat na hapin dritaret e jetës, mundësitë e një të ardhmeje sa më të suksesshme dhe të sigurtë. Ato nevojiten në çdo çast të jetës, që nga situatat më të thjeshta e deri te ato më të komplikuarat. Ato janë një mënyrë të shprehuri, sepse pasurojnë fjalorin dhe të krijojnë mundësinë të lesh përshtypje të veçanta tek një person gjatë komunikimit. E di që paqen më të madhe shpirtërore e gjen kur ulesh në një peizazh të bukur dhe lexon një libër. Aty imagjinata jonë fillon të fluturojë dhe çdo fjalë libri duket si një fragment filmi. Por shumë herë mendoj se pse të dyjave ne na pëlqejnë librat e dhimbshëm, që na bëjnë të qajmë në fund. Por mendoj se e di përgjigjen ose mbase po mundohem të zbuloj diçka më shumë tek vetja. Sa herë që lexojmë diçka të dhimbshme, gjithmonë vë veten në vendin e protagonistit, kthej kokën prapa dhe mendoj se kush jam dhe kush mund të isha. Në këtë çast mendoj se bota është e padrejtë e se ndonjëherë është në favor të atyre të cilëve nuk duhej të ishte. Mësoj ta vlerësoj jetën ashtu siç është dhe të mos kërkoj asgjë më tepër. Për mua ka rëndësi momenti dhe perspektiva. Dua ta jetoj momentin dhe të mos i lë vitet që të ikin duke menduar për të shkuarën ose të ardhmen, sepse kurrë nuk i dihet si do të jemi nesër dhe çdo ditë mund të jetë dita jonë e fundit. Ama edhe e ardhmja ka rëndësi dhe e vetmja gjë që nuk i ndalohet njeriut është të ëndërrtojë. Kështu që, e di që ëndrrat e mia tani ti i ke plotësuar dhe jam plotësisht e sigurt që nuk do të më zhgënjesh. Jam shumë kureshtarë të vij tek ti dhe të të pyes se, nëse do të ekzistonte ndonjë makinë kohë do të doje të ktheheshe në moshën time apo të vazhdoje para, por e ardhmja është zakonisht mister. Kështu që edhe nëse do të zgjidhje atë, nuk do të mërzhitesha me ty. Shpresoj të mos kesh ndryshuar shumë dhe të të njoh kur të të takoj, sepse fundja ne jemi një, por kurrë nuk do të takohemi, sepse edhe kur të vijë çasti, ti do të më kesh harruar mua.

Të përqafoj dhe shpresoj të më kujtosh një ditë!

**Xhoia Mekollari 7B**





E dashur Nikol,

Sot është një ditë shumë e veçantë pasi është dita që u mbush 35 vjeç. Sa hapa sytë në dhomëzën time të dashur ngjyrë qumështi, ku dielli i mëngjesit hyn lehtësi përmes grilave. Familja ime dhe njerëzit e mi më të afërt ndodhen pranë meje. Fëmijët e mi i dëgjoj teksa luajnë shumë të lumtur në pishinën e vogël të shtëpisë sime. Krejt papritur gjithçka ndaloi. Koha fluturoi si një rrufe shumë kohë më parë në kohërat që mua ende më kujtohen si të kenë ndodhur sot. U ktheva në moshën time 5-vjeçare. Më kujtohet shumë mirë momenti kur fika qirinjtë e tortës dhe shpreha një dëshirë si çdo fëmije tjetër. Isha një fëmije i vogël dhe i lumtur që ende flinte në shtrat me mamanë. Më kujtohet fare mirë që dëshira që unë shpreha ishte që të kisha sa më shumë kukulla, dhe është një gjë që sigurisht u bë realitet. Kaluan disa vite dhe unë rritesha. Kur arrita moshën 7-vjeçare ndodhi një nga gjërat më të mira që i kanë ndodhur jetës sime. Në duar mbajta një foshnjë të vogël, e cila sapo kishte lindur. Ajo foshnjë, që unë e doja dhe e dua aq shumë është motra ime e dashur, Felisia. Kaluan ende disa vite të tjera dhe motra dhe unë sa vinim e rriteshim. Dita 10.12.2013, ishte një prej ditëve më të bukura. Unë mbusha plot 10 vjeç dhe më dukej vetja sikur isha rritur dhe nuk isha më ajo vajza e vogël dhe e llastuar e prindërve, megjithëse ata mendonin krejt të kundërtën. Vitet fluturonin. Kur mbusha 15 vjeç, kisha një shoqëri të stabilizuar dhe shumë argëtuese, në të cilën ende ruaja shokët e mi të fëmijërisë. Bëra një festë madhështore me shokët e mi më të afërt dhe sigurisht nuk harrova të festoja dhe me familjen time të dashur. Një festë e ngrohtë dhe e paharrueshme. Në moshën 18-vjeçare unë u largova nga atdheu im drejt Universitetit Amerikan "Yale School of Architecture", ëndrra ime e fortë dhe e shtrenjtë. E ndieja veten larg familjes dhe më dukej sikur kisha lënë pas një pjesë shumë të rëndësishme timen e cila më mungonte. Pas 5 vitesh shumë të suksesshëm dhe të bukur, unë u diplomova për arkitekturë dhe gjeta një post pune mjaft të mirë. Në moshën 24-vjeçare takova personin i cili do më shoqëronte mua gjatë gjithë jetës dhe me të cilin pas një viti bëmë betimin se do e donim njëri-tjetrin deri sa vdekja të na ndante. Pas plot një viti ndodhi sërish një nga gjërat më të mira që i kanë ndodhur jetës sime. Provova dhe shijova ndjesinë e të qenit mama për herë të parë, ndjesi e paharrueshme dhe aq shumë e këndshme dhe e gëzueshme. Me shumë dashuri dhe pasion, hapa studion time të arkitekturës dhe punoja me një vullnet dhe zell të madh duke hedhur në letër shumë projekte që i kisha ëndërruar në vite. Kisha një motivim shumë të fortë. Motivimi im i parë vinte prej prindërve të mi të cilët më mbështetën dhe më përkrahën gjatë gjithë kohës pa më lënë vetëm për asnjë sekondë dhe të cilët nuk më lanë kurrë të ndihesha vetëm edhe pse ndodhem shumë larg vendlindjes sime. Motivimi im i dytë është familja ime e re së cilës në moshën 27-vjeçare iu shtua dhe një anëtare e re. Pas suksesit të kompanisë sime dhe sigurisht të bashkëshortit tim, ne arritëm të ndërtonim shtëpinë e ëndrrave tona, në të cilën ne po



festojmë sot. Një shtëpi e ngrohtë, me një pishinë të vogël dhe me një studio, ku të dy ulemi ngushtësisht për të mbyllur projektin e fundit: kullën më të lartë dhe të çudishme në botë, e cila i ngjan fantazive tona të fëmijërisë. Tani janë bërë mbi 10 vjet që jetojmë ne vilë dhe gjatë këtij rrugëtimi në moshën 30-vjeçare lindën dy binjakët e mi të vegjël. Pas plot një viti, familjes sonë iu shtuan dy anëtarë të rinj të cilëve u ndërtuam dy kolibe të vogla. Sot teksa bëj 35 vjeçe, i shoh të gjithë duke qeshur dhe nuk e përshkruaj dot gëzimin dhe lumturinë që ndiej. Papritur teksa kisha humbur në mendime gjithçka shkriu. Fëmijët ende luanin të lumtur në oborr. Erdhi ai moment që kur isha e vogël mezi e prisja të ndodhte. Të fikja qirinjtë dhe të shprehja dëshirën. Të gjithë u mblodhën rreth e rrotull dhe gjithçka që unë shihja ishin buzëqeshjet e të afërmve të mi. Fika qirinjtë dhe shpreha dëshirën: "Shpresoj dhe dëshiroj që familja ime të jetë sa më e lumtur dhe buzëqeshja që çdo person ka veshur sot ta ruaj përgjithnjë."

Me shumë dashuri, Nikol 13 vjeç!

**Nikol Guri 7B**



Letër vetes sime kur të jem 35 vjeç!

Është data 28 tetor e vitit 2038, ka vetëm pak minuta që ka kaluar ora 00:00 dhe unë kam ditëlindjen. Papritur më vjen një dhuratë që s'do ta prisja kurrë nga dikush. Prindërit më japin në dorë një zarf dhe unë me kureshtje lexoj emrin e dërguesit. Sapo e lexoj kureshtja shtohet dhe çuditërisht shumë sepse dërguesi i zarfit jam vetë unë. Me padurim hap zarfin dhe brenda tij gjej një letër. Kjo letër ishte shkruar nga unë në moshën 13-vjeçare dhe i ishte drejtuar vetes pas njëzet e dy vitesh.

Me mallëngjim filloj të lexoj letrën. Ndërkohë që lexoj letrën pak nga pak kureshtja fillon të shuhet, por malli për fëmijërinë time shtohet. Në mendjen time shfaqen mijëra kujtime nga fëmijëria dhe brenda mendjes sime filloj t'i rijetoj përsëri këto momente. Në letër shkruhet:

E di që duket pak e çuditshme t'i shkruash vetes tënde një letër, por e shkrova këtë letër për një qëllim. Dua që të të kujtoj ty ëndrrat e fëmijërisë dhe të të them që të vazhdosh të ëndërrosh sepse s'ka asgjë të gabuar po të ëndërrosh.

**Hygen Amoniku 7B.**





E dashur Tea,

E mban mend kur ishe e vogël se sa shumë dëshiroje të punoje në zyra, nëpër zyra të mëdha dhe të bukura. Të ishe një arkitekthe e zonja dhe plot pasion. Kur ishe e vogël, ishe një vajzë me flokë bjond dhe sytë e kaltër si qielli i pastër. Tani duhet të jesh rritur dhe çdo gjë duhet të ketë ndryshuar. Shpresoj që çdo gjë të jetë siç dëshiroje ti. Shpresoj që të kesh krijuar familjen tënde të lumtur. Shpresoj që ti ke zgjedhur rrugën e duhur në jetën tënde. Duhet që të jesh zgjatur shumë dhe të jesh bërë një zonjushë e mençur. E mban mend kur shkoje në shkollë se me sa dëshirë shkoje. Kur i bëje detyrat me atë dëshirën e madhe, që ti më pas të praktikoheshe në pasionin tënd, i cili ishte kërcimi, vizatimi dhe volejboli. Kur fillove të mendoje si një e rritur dhe i shihje gjërat më qartë dhe ndjeheshe më e sigurt në veten tënde. Kjo ishte koha që ti mendoje se nuk do të mbaronte kurrë, por vitet kaluan dhe ti u rrite me dëshirën e madhe që ëndrrat e tua të bëheshin realitet. Ndoshta çdo ëndërr e porealizuar mbetet një kujtim i bukur në mendjen tënde dhe një tregim i bukur për fëmijët e tu, gëzimi dhe dashuria më e madhe në jetë. Familja jote është tani gjëja më e rëndësishme dhe lumturia më e madhe në këtë jetë. Sa bukur është kur kthen kohën pas dhe çdo kujtim i asaj kohe të bën të ndihesh krenare për veten dhe çdo gjë që ke arritur, sukseset, gëzimet, sakrificat, vuajtjet e çdo gjë tjetër që të rriti dhe të bëri këtë që je sot. Të përqafoj fort!

**Tea Meraj 7C**



Ç'do të bëhem kur të rritem?

Unë në moshën që jam sot, si të gjithë fëmijët, kam dëshirë më shumë të argëtohem, por e di që kur të rritem do të marr një profesion. Kjo varet shumë nëse unë i përkushtohem mësimëve me kujdes të plotë. Ëndrra ime është të bëhem biznesmene, por mbi të gjitha duhet të jem një njeri i mirë. Të dua siç dua tani natyrën, kafshët, muzikën, e cila është dhe pasioni im. Pse jo të vazhdoj të këndoj, pasi me muzikën ndihem si një zog i lirë. Me gjithë ëndrrat e mia, unë tani jam fëmijë dhe çdo gjë do t'ia lë kohës, mjafton që unë detyrat e shkollës t'i bëj në mënyrë sistematike dhe të jem e përgjegjshme për ato që unë bëj.

Të jetoj çdo ditë të jetës sime me dashuri për veten dhe të tjerët.

**Vivjan Kokeri 7C**







E dashur vetja ime,

Tani je rritur, je bërë 35 vjeçe. Punove, mësove, u përpoqe shumë dhe në fund arrite atje ku doje. I realizove të gjitha ëndrrat. U bërë çfarë doje. U bërë doktoresha që ti doje. Shpresoj të jesh e lumtur tani. Tani ke një mision tjetër. Deri tani prindërit e tu bënë gjithçka që mundën që ti të bëheshe kjo që doje. U bërë. Është radha jote tani. Gjithë mundin dhe djersën e tyre duhet ta kthesh mbrapa. Duhet t'i ndihmosh ata me gjithçka që ata kanë nevojë. Pasi ta bësh edhe këtë atëherë do të jetë tamam i plotësuar misioni yt. Shpresoj t'ia dalësh.

Të përqafoj vetja jote!

**Hikmet Emel Ergün 7C**



E dashur vete,

Ti mund ta lexosh këtë letër ose jo, por unë përsëri dua të të përshëndes pas gjithë këtyre viteve. Jam e sigurt që je rritur mjaftueshëm për të kuptuar se çfarë është jeta dhe se çfarë je ti dhe gjithashtu jam shumë e sigurtë që kur ta lexosh këtë letër do të qeshësh, mbase mund të qash, mbase do të kujtosh shumë ngjarje dhe kujtime nga fëmijëria. Tani mbase je në ndonjë vend të qetë dhe relaksues duke reflektuar mbi gjërat që kanë ndodhur kohët e fundit. Nëse ke kaluar një kohë të vështirë, mbase kjo letër të bën të qeshësh, duke të çuar pas në kujtimet e tua. Kjo letër të bën të mos harrosh lëndinat me lule poshtë shtëpisë, ku ke luajtur me qindra herë, të kujtosh kur ktheheshe nga shkolla dhe futeshe me vrap në shtëpi që të uleshe në divanin e ngrohtë në dhomën e pritjes. Besoj që kjo nuk ka për t'u harruar lehtë. Shpresoj që të mos harrosh gjëra të rëndësishme nga jeta jote, po të kujtosh çdo pjesë të saj. Lexoje këtë letër kur të jesh 35 vjeç, që nëse ke harruar ndonjë kujtim, ato të vijnë në mendjen tënde si një shirit mendimesh.

**Megan Xhaxhiu 7C**



E dashur Emiljana,

Jam shumë e re, por kam shumë ëndrra. Ëndrra që dalëngadalë mendoj se do bëhen realitet. Isha bebe dhe u rrita me përkedhelje e ledhatime. Kur je e vogël ka se kush kujdeset për ty, por kur rritesh fillon të ndjesh më shumë përgjegjësi. Je e lirë të mendosh, por me kujdes që të mos gabosh. Tani për tani dua të shkollohem, po kur të rritem a do të punësohem? Ku do të punoj? Ku do të jetoj? Sa e aftë do të jem që këtë jetë ta përballoj. Kam shumë ide dhe mendime, por më mirë ia lemë kohës t'i qartësojë. Se çfarë do të ndodhë kur të rritem vetëm koha do na e tregojë.

**Emiljana Kapollari 7C**



E dashur Dea 35 vjeç,  
Shpresoj që këtë letër ta hapësh kur të jesh 35 vjeç e ta kesh mundur kuriozitetin këto 23 vjet. Kam shumë pyetje për të të bërë, për të të kujtuar premtimet e bëra dhe ëndrrat që ke pasur. A je akoma shoqe me Raelën, Xhenin dhe Jonën apo tani që i përmenda po mundohesh të kujtohesh se kush janë? A e ke realizuar ëndrrën tënde të bëhesh gjyqtare apo e ke harruar ëndrrën e vjetër. A të bezdis më Gresa apo tani jeni bërë si shoqe? Këto janë vetëm disa nga pyetjet që dua të të bëj, por besoj se këto mjaftojnë për të më kujtuar. Me dashuri Dea 12 vjeç.

**Dea Bonjaku 7C**



Përsëndetje Bestjan,  
Kjo letër është nga ti para 22 vjetësh për të të kujtuar adoleshencën tënde. Dua të dish se këto kohëra janë të lumtura e të lira për ty. Të kujtohen ditët e bukura dhe të gëzuara që kaloje me familjen tënde. Në fakt jam i sigurt se këto gjëra do t'i mbash gjithmonë mend, por dua të di në qoftë se i ke kryer detyrat që i kishe vënë vetes para 22 vjetësh. Unë kam akoma për detyrë që kur të bëhem 35 vjeç të bëhem një njeri i arsimuar dhe i edukuar, të merrem me sport, të kem një jetë më të mirë dhe të krijoj familjen time. Ti duhet të dish se unë po mundohem të bëhem ky njeri, njeriu që unë dëshiroj të jem dhe e di se ky njeri je ti. Dhe tani dua të të them diçka: Mbase në kohën tënde gjërat mund të jenë ndryshe, por unë të kërkoj t'i kujtosh këto kohëra, të më kujtosh mua dhe veten tënde 13 vjeç. Kurrë mos më harro!

**Bestjan Mamo 7C**



E dashur vetja ime,  
Sot që po shkruaj jam 12 vjeç. Studioj në shkollën "Turgut Özal", gjithashtu jam në klasë të shtatë. Në përgjithësi për veten kam shpresa të mëdha, besoj se do të bëhem dikushi në jetë. Ëndërroj që një ditë mund të udhëtoj në të gjithë Europën, por kjo dëshirë duhet të presë. Lënda që preferoj më shumë është biologjia dhe aftësimi teknologjik. Më pëlqen që në të ardhmen të bëhem doktoreshë dhe të shpëtoj një jetë. Gjithashtu të hap klinikën time. Vendi që më pëlqen më shumë të vizitohet është Roma, sepse arkitektura e saj është madhështore. Stina e cila preferoj është dimri, sepse preferoj të ftohtin dhe dëborën. Shpresoj të të pëlqejë.

**Megi Çeta 7C**



E dashur Jona,

Dua ta filloj këtë letër duke të pyetur se si je dhe se si është jeta? Shpresoj të jesh mirë. Duket paksa e çuditshme t'i shkruash vetes një letër, por në fakt nuk është aspak një ide e keqe, përkundrazi më pëlqen shumë. Pra, ti je 35 vjeçe, pra unë, në të ardhmen, kush e di se sa shumë do të përjetoj deri në atë kohë. Prandaj unë dua të të pyes: Ç' punë bën? Ku jeton? Etj. Sigurisht më duket shumë e çuditshme të bëj një pyetje, por kurioziteti s'më le të qetë. Është thjesht i mahnitshëm fakti se kjo letër do të vijë përsëri tek unë pas 20 a më shumë vitesh. Kjo copë letre do të më kujtojë fëmijërinë, kujtime të pakrahasueshme.

**Jona Hudhra 7C**



Përshëndetje,

Kujdes, arsimohu mirë!

Kujdes, mos u fut në shoqëri të keqe!

Kujdes, mos harro të martohesh!

Kujdes, rri larg drogës!

Kujdes, mos u bë njeri me antivlera!

Kujdes, mundohu të bëhesh i pasur!

Kujdes, kurrë mos e harro familjen!

Kujdes, familja para shokut!

Kujdes, bëj gjithçka për të afërmit!

Kujdes, mos u dorëzo për fajin e të tjerëve!

Kujdes, mos ia fal atij që të bën keq!

Shpresoj ta hapësh këtë letër dhe të mendohesh çfarë ke arritur në jetë dhe jo.

**Alteo Malaj 7C**



Unë 35 vjeç,

Unë mendoj se kur të bëhem 35 vjeç, do të bëhem futbollist, por shkollën do e bëj për doktor. Në atë moshë unë do jem i martuar dhe do kem 3 fëmijë. Dëshiroj të kem 2 çuna binjakë dhe një vajzë. Djemtë do i kem të stërvitur për të mbrojtur motrën dhe veten. Vajza do të jetë me nota maksimale dhe të jetë e zonja e vetes. Por sigurisht edhe djemtë duhet të jenë me educate dhe me nota të mira, por dihet jo më shumë se vajza. Dhe kryesorja, dashtë Zoti të jemi gjallë deri atëherë.

**Kristian Nela 7C**



E dashur Raela,

Sot jam 12 vjeçe dhe jam në klasën e 7-të. Si do të jem unë vallë kur të jem 35 vjeçe?

Mbas 23 vitesh do t'i kem mbaruar studimet dhe mund të jem bërë inxhinieri kompjuterike. Kjo degë më duket interesante, pasi është degë e së ardhmes. Kushedi sa do të kenë ndryshuar gjërat deri atëherë.

Ja po e shoh veten time 35 vjeç. Jam duke punuar diku, duke programuar gjëra të reja dhe interesante me kompjuterin tim, të cilin e komandoj nëpërmjet zërit tim. Në zyrën time kam dhe një robot, që është asistenti im. Pastaj kthehem për në shtëpi me makinën time fluturuese, e cila e bën rrugën vetëm për pak çaste. Dhe ja, tani po pushoj në shtëpinë time. Nga kuzhina vjen aroma e këndshme e gatimit, të cilin ma servir roboti im personal i punëve të shtëpisë. Pasi ha darkë bisedoj pak me një shoqe në telefon. Eh, sa kanë ndryshuar mjetet e komunikimit. Më duhet të shtyp vetëm një buton në dorën time dhe ja ku shfaqet në 3D shtëpia e shoqes.

Tani po ngjitem për të studiuar në studion time, pasi po punoj për një temë të re. Po programoj diçka interesante që do t'i vijë në ndihmë njerëzimit.

**Raela Cani 7C**



Ç'kemi Mikel?

Shpresoj ta lexosh këtë letër. E shkruajta ti kur ishe 12 vjeç. Tani që je 35 vjeç shpresoj t'i kesh të gjitha gjërat që dëshiroje. Shpresoj të kesh gjetur një punë të mirë, doktor sigurisht. Uroj që ta kesh blerë atë shtëpinë e madhe që dëshiroje dikur. Dhe pse je 35 vjeç, jeta vazhdon. Jetoje deri në fund. Qofsh me shëndet. Mirupafshim!

**Mikel Seferi 7D**



Përsëndetje Engjëllushe,

Unë jam një shoqe e jotja e së shkuarës, ndoshta nuk më mban mend, por nuk të vë faj. Kanë kaluar gjithë ato vite qëkur unë isha në lojërat e tua të fëmijërisë, në mendimet dhe ëndrrat e tua, ka kaluar shumë kohë, që nga ato ditë me harenë fëmimore. Shpresoj të mos kesh ndryshuar shumë, të kesh ngelur po e njehta me cilësitë dhe karakteristikat që të veçonin nga çdo fëmijë tjetër. Uroj t'i kesh realizuar të gjitha ëndrrat e dëshirat për t'u bërë dikushi në jetë, dikush që do t'i mbahet mend emri për mirë. Gjithmonë shpresoj se ke mundur të zgjedhësh një rrugë, në të cilën gjithmonë ke dashur të udhëtosh. Shpresoj se ke arritur të kesh një karrierë të ndritur dhe të jesh bërë artistja që gjithmonë ke dashur të jesh. Gjithashtu uroj që gjatë gjithë këtij rrugëtimi të kesh pasur familjen pas, si pika më e fortë e mbështjetjes, ku e di se gjithmonë do të marrësh dashuri. Me siguri ke arritur t'i realizosh të gjitha këto me



ndihmën e pasionit dhe vullnetit, cilësi këto, që të kanë shoqëruar gjithnjë në fëmijërinë tënde të hareshme. Dua me gjithë zemër që të kesh marrë rrugën e ndriçuar të jetës, rrugën e drejtë për një të ardhme edhe më të ndritur nga ajo se ç'ke pasur më përpara. Epo më duhet të shkoj, por më beso se unë do të jem gjithmonë pas teje për të të dhënë kurajo, për të të kujtuar momentet më të bukura nga fëmijëria jote, të cilat do të të ndihmojnë t'i bësh ballë sfidave të mëdha që do të ndjeshesh në jetë.

Me shumë dashuri, shoqja jote  
Engjëllushja e së shkuarës.

**Engjëllushë Basha 7D**



Ç'kemi?

Këtë letër supozohet ta lexoj kur të mbush 35 vjeç, por jam i sigurtë se ose do të humbas ose nuk do të duroj dot pa e lexuar përpara kohe.

Së pari, e ke mbaruar shkollën? Shpresoj të kesh dalë vetëm me dhjeta. Mendoj dhe jam i sigurt se je bërë në jetë, ai që gjithmonë ke dashur. Po punë ke filluar?

Epo, mjaft me pyetje dhe të kalojmë te qëllimi kryesor i kësaj letre. Këtë letër po ta shkruaj që të kujtosh kohët e vjetra dhe të vyera të fëmijërisë. Atëherë, kur kishe plot kohë dhe mundësi të bëje thujse gjithçka. Momentet e bukura që ke kaluar dhe ato të trishtat. Por, mbi të gjitha, gjëja më e çmuar pas familjes, shokët dhe shoqëria. Nuk e besoj se i ke harruar ato momente të arta, gjithashtu sekretet, ndenjat dhe mendimet e asaj kohe.

Këtu po e mbyll letrën time me mendimin se me këtë "rifreskim" të vogël do të të kujtohen shumë herë më shumë, momentet e çmuara të fëmijërisë.

Me shumë dashuri për ty.

**Irdi Zeneli 7D**



Përshëndetje Ina,

Sapo mbusha 35 vjeç. E shoh veten të rrethuar me një familje të bukur, miq të shumtë dhe një karrierë të realizuar. Më kujtohet ditëlindja ime e 10-të, kur prindërit e mi më bënë një festë shumë të bukur me animatorë dhe personazhe të tjera. Ishte një ditëlindje e paharrueshme. Po ashtu edhe 12, 13, 14..... e me radhë. 18 nuk isha më me prindërit. Ditëlindjen e festoja diku në zemër të Evropës me lot në sy, sepse më mungonte familja ime. Një telefonatë surprize m'i thau lotët. Po vijmë..... ishin prindërit e mi, atëherë fillova të qaja nga gëzimi. Dhe tani që jam 35 vjeç festoj, por atmosfera dhe dashuria që më jepnin prindërit kur isha fëmijë nuk është më njësoj.

**Ina Kollçinaku 7D**



Miku im më i mirë, sa ëndrra kishe dikur!

Fantazia dhe imagjinata ime sot mbase i kalon kufijtë e realizimit të tyre. Të ëndërrosh për të ardhmen tënde është e domosdoshme. Ndryshe do të mungojë iniciativa dhe forca për t'i arritur ato. Në moshën 35 vjeç, e shoh veten time një njeri të rritur dhe të edukuar. Jam një njeri i arsimuar dhe me një kulturë të gjerë, veçanërisht në fushën e politikës. Kjo moshë do të më gjejë një politikan të zotin. Ky profesion më pëlqen se dua të ndihmoj popullin tim. Politikani është një figurë e njohur në shumë vende. Ëndërroj këtë profesion, sepse sot shoh te politikanët tanë njerëzit që nuk i zgjidhin problemet e popullit. Ata kanë vetëm oratori dhe asgjë tjetër. Kjo gjë më shtyn të bëhem një politikan i suksesshëm që t'i shërbej popullit tim.

**Klaus Likaj 7D**



E dashur Lea,

Po të shkruaj objektivat e mia që ti shpresoj t'i kesh plotësuar. Ëndrra ime më e madhe është të krijosh një familje, ku të ketë harmoni dhe plot dashuri. Familja është ajo që na mban gjallë. Një rol të rëndësishëm në jetë ka dhe puna, ajo na siguron një jetë më të mirë dhe atë që kemi ëndërruar. Do të kisha shumë dëshirë që të jesh një mjeke e zonja dhe e përkushtuar në profesion. Për të qenë një mjeke e mirë, në fillim duhet të jesh një njeri, një familjare dhe një kolege e mirë. Kam shumë dëshirë që t'i kesh realizuar këto objektiva ose në qoftë se mund t'i quajmë ëndrra.

Me shume dashuri Lea!

**Lea Vakiari 7D**



Si je vetja ime,

Fëmijëria, periudha më e bukur e jetës, ku gjithçka fillon aty. Periudha ku mëson të flasësh, të duash, të shkruash dhe ku ke kujtimet me të bukura ose më të hidhurat, që nuk do të harrohen kurrë. Shokët, personat që i njoh, aventurat, hidhërimet, arritjet në jetë të gjitha ndodhin në këtë periudhë të artë të jetës. Fëmijëria ime është e shkruar me shkronja të arta në kujtimet e mia. Mësuesit, njerëzit që i dua, do t'i dua dhe do t'i respektoj gjithmonë në jetë. Shokët, personat që më kanë bërë të qesh ose i kam bërë të qeshin, nuk harrohen kurrë. Aventurat e paharrueshme që i kam përjetuar me mësues dhe shokë, kujtime të papara. Njerëzit që i dua, personat që më kanë bërë të lumtur. Këto kujtime nuk mund të harrohen kurrë as për 30 vjet as përgjithmonë. Nuk do t'ju harroj kurrë. Faleminderit të gjithëve për gjithçka!

**John George Gordani 7D**



Përshëndetje Estel,  
 Tani je 35 vjeçe, si je?  
 A je bërë ekonomiste siç ke dashur? A të janë realizuar të gjitha dëshirat që ke?  
 Ke ndryshuar ndopak, edhe nga pamja edhe nga personaliteti?  
 A je akoma shoqe me shoqet që ke pasur kur ke qenë e vogël? Unë besoj se po.  
 A të ka marrë malli të jesh 12 vjeçe përsëri?  
 Po shkolla të mungon ndopak?  
 Po tani do të kishe më shumë dëshirë të ishe në shkollë apo në punë?

**Estel Reçi 7D**



E dashur Kristina,  
 Këtë temë dëshiroj ta prezantoj me shprehjen: "Ëndrrat përmbi re nuk kanë asnjë vlerë, nëse ato nuk vihen në punë". Personalisht për të ardhmen time në moshën 35 vjeçare kam shumë qëllime dhe ëndrra. Shpeshherë kam menduar se si do të bëhem në të ardhmen dhe a do mund t'i përmbush gjithë ëndrrat, që kam thurur në mendjen time. Dëshiroj që të kem një familje të qetë, plot me hare dhe dashuri. Dua të krijoj një jetë të qetë, me ndershmëri, të jem krenare për çdo arritje timen dhe të ushtroj një profesion të denjë. Gjithashtu dëshiroj të jem një femër e pavarur, punëtore, e vullnetshme dhe do të bëj të pamundurën t'i rritë fëmijët me dashurinë e nënës, me edukatë dhe të bëhen dikushi në jetë, pra të ndihem krenare për ta. Qëllimi im me pak fjalë është: Të kem një jetë plot ndershmëri, qetësi dhe dashuri.

**Kristina Haxhia 7D**



Përshëndetje Megan e së ardhmes,  
 Shpresoj që t'i kesh arritur dëshirat në jetë. Do të doja të t'i kujtoja edhe njëherë, që doje të shkoje në Amerikë dhe të vazhdoje për arkitekturë. Gjithashtu kishe dëshirë që në të ardhmen të vizitoje vende, të cilat ende nuk i ke vizituar. Shoqet, tashmë të vjetra, a i ke më shoqe? A do të doje të ishe përsëri 12 vjeçe? Edhe njëherë shpresoj t'i kesh arritur dëshirat në jetë.  
 Të përqafoj Megani, tani e së shkuarës.

**Megan Karapici 7D**



I dashur Keanu,

Do doja të të thosha që të jesh mirë në ato ditët e tua. Të kesh gjetur një punë, të kesh gjetur një familje etj. Unë tani jam në klasë të 7-të. Shpresoj që ti të kesh gjetur një punë me rrogë të mirë. Të kesh arritur objektivat e tua në jetë. Këtë doja të thosha dhe ditë të mbarë.

Nga Keanu i vitit 2016

**Keanu Senka 7 D**



I dashur Arnis,

Shpresoj që të jesh mirë në këto ditë që po jeton. Shpresoj të kesh gjetur një punë të mirë dhe një rrogë të bollshme që të mbash familjen, në qoftë se e ke krijuar një të tillë. Tani që po të shkruaj, jam 12 vjeç dhe po përpiqem të gjej se çfarë do të bëj në të ardhmen. I ke arritur të gjitha qëllimet dhe objektivat e tua në këtë moshë? Shpresoj që po, por unë po përpiqem akoma duke mësuar dhe po përpiqem që të jem djali ideal me një familje të shëndoshë, me një karrierë të suksesshme dhe një shoqëri të mirë.

Shihemi në të ardhmen, me respekt për ty.

**Arnis Rroji 7D**



Ç'kemi?

Kur të jem 35 vjeç kam menduar që të jem një aktore e famshme dhe të luaj në filma shumë të bukur me shumë aksion. Mua më pëlqen shumë aktrimi. Kam ëndërruar që të jem aktore për një kohë shumë të gjatë. Kam zgjedhur aktrimin, sepse është një punë që mund ta bëj me shumë qejf.

**Rana Sögütlü 7D**



Përshëndetje,

Sara, ka kaluar shumë kohë që nga koha që e kam shkruar këtë letër. Me siguri ti je rritur, je bërë vajzë e matur dhe e suksesshme. Rruga për të ardhur deri këtu do të ketë qenë e gjatë dhe e vështirë. Por dua të të kujtoj disa gjëra nga e shkuara.

Mos harro fëmijërinë tënde, ajo ka qenë e lumtur. Gjithmonë ke qenë e rrethuar nga njerëzit që të falin dashuri, shumë shoqe të mira, por ndonjëherë edhe vështirësitë e vogla. Të qenit e rrethuar nga këto njerëz për ty ka qenë një lumturi. Këtë mirësi u mundove t'ua japësh edhe njerëzve të tjerë. Doja të të pyesja a vazhdon të jesh ende vajza e dikurshme? Besoj se po, por më e rritur dhe më e pjekur në mendime.

**Sara Kollçaku 7D**





E dashur Sanja,

Më në fund arrite në statusin e 35-vjeçares. Jam e sigurtë, që në moshën 35 vjeçare do të jesh pediatre e suksesshme. Do të kesh fituar të gjithë respektin e punonjësve të spitalit, sepse profesioni im ka vlera morale dhe këto vlera do të shfaqen te të gjithë individët, pa i dalluar nga feja, gjinia, raca apo gjendja ekonomike. Gjithashtu, në këtë moshë, ti do të jesh duke punuar përsëri shumë fort për të përfunduar atë që ke nisur të ndërtosh.

Familja është dicka shumë e shtrenjtë dhe për të ndërtuar një të tillë të duhet shumë punë, guxim në vete dhe sakrificë. Durimi dhe të gjitha vlerat që ke mësuar duhet t'ia transmetosh pasardhësve të tu. Të dish ta ndash shoqërinë, rrugën e drejtë nga ajo e padrejtë. Gjithmonë të marrësh virtytet e tyre dhe të mësosh prej njerëzve që të rrethojnë sado të mirë dhe të këqinj të jenë. Dashuria, pozitiviteti, puna të bënë të jesh i drejtë me të gjithë, është një nga virtytet, i cili çdo person duhet ta ketë.

Shihemi,

**Sanja Nuredini 7D**



Ç'kemi?

Më mban mend mua? Ajo vajza që ishte e lumtur dhe asnjëhere nuk kishte lot në sytë e saj. Ajo vajza që nuk mendonte për përgjegjësitë, kushtet, kufijtë? Ajo që nuk i kuptonte kurrë prindërit e saj. Nuk mendonte kurrë se si do të përgojoheshin veprimet e saj. Ajo vajzë e lirë dhe e pastër në shpirt, që ndërgjegjja e saj e fortë nuk do ta linte kurrë në baltë. Skllave e dashurisë dhe e singëritetit, gënjeshttrat nuk i njihte as nuk donte të mesonte për to. Mbyllte sytë dhe fluturonte në gjithësi, në këtë hapësirë të pafundme, ku e qetë nuk mendon për asnjë gjë.

Hapi syte, je rritur tani, je me këmbë në tokë, përgjegjësitë s'kanë kufij, kërkesat po ashtu, ti e ke besimin në vetvete dhe ai do të të ndihmojë. Ti e di se mund t'ia dalësh mbanë. Koha është e çmuar, të dish ta vlerësosh atë. Unë jam ende në kohë, në periudhën më të bukur të saj dhe shpresoj ta shfrytëzoj sa më shumë pozitivisht.

Të uroj jetën më të mirë dhe sigurisht atë që ti meriton!!!!!!!

**Jona Malaj 7D**





Ç'kemi?

Po të shkruaja një letër zyrtare ose një letër miqësore do ta filloja me "e dashur Reyhan". Por sot do i shkruaj vetes. Këto, na tha zyshta, që do të botoheshin për një libër. Po të shkruaj vetëm për vete do të thoja edhe për gabimet dhe për të mirat. Tani fillojmë dhe zhytmi nëpër mendime. Unë eci në të ardhmen që s'e di kur mbaron. Por sërish vazhdoj të eci. Ndonjëherë mund të shkojmë nga anë të ndryshme. Sa herë që rrëzohem ngrihem prapë. Unë s'dua t'i di sfidat që do më kalojnë para dhe do mundohen të më rrëzojnë. Unë do i kapërcej. Nuk besoj se do jetë e thjeshtë, por prapë do mundohem. Shumë herë do të vijmë fytyra të panjohura, që s'dua t'i njoh dhe ca që më ndihmojnë për çdo gjë. Në jetë të vijmë gjithë ato mundësi, por edhe mundësitë duhet t'i zgjedhësh mirë duke i shqyrtuar mirë, sepse mund të jetë një rrugë pa krye. Shpresoj t'i kesh arritur të gjitha gjërat që fantazove dhe doje që të bëheshe kur të bëhesh 35 vjeç.

**Reyhan Tokcelik 7D**



Jam unë,

Pas shumë lodhjeve dhe mundimeve unë arrita të bëhesha ai që ëndërroja në jetë. Unë jam shumë i lumtur për të gjitha gjërat që kam arritur. Për këtë gjë falenderoj të gjithë ata që më kanë ndihmuar të bëhesha dikushi në jetë. Profesionimi im është inxhinier. Këtë profesion e ëndërroja që kur isha një fëmijë. Kur isha 5-6 vjeç nuk kuptoja asgjë, sepse isha shumë i vogël. Dija vetëm të argëtohesha me lodrat e mia dhe të shëtisja në park me familjen time. Në moshën 9-10 vjeç, unë isha rritur pak. Isha në klasë të katërt dhe fillova t'i kuptoja nga pak gjërat. Unë kisha shumë ëndrrat që doja t'i realizoja. Disa prej tyre ishin të përcaktueshme, atëherë nuk e dija sa e vështirë ishte jeta. Kur isha 11-12 vjeç unë i kuptoja shumë mirë gjërat. E kuptova se çfarë do të thoshte të mësoje dhe të punoje shumë për gjërat që do të arrish. Unë mësova dhe punova shumë, prandaj arrita të bëj ëndrrën time realitet.

**Egri Babasi 7E**



I nderuar Brendon,

Kanë kaluar 23 vite që nga momenti kur unë të shkruajta. Me siguri je i ulur në kolltuk duke parë gjërat që ti ke marrë nga Shqipëria, sepse tani jeton në një vilë në Amerikë. Ti ke një shoqëri të madhe në Amerikë dhe nuk je martuar akoma. Asnjëherë mos e humb besimin tek vetja. Po të kërkoj një gjë. Këtë veprim që unë po bëj edhe ta bësh edhe ti për veten tënde pas 23 vitesh. Me siguri do të gëzohesh tej mase. Të uroj që jeta të të shkojë sa më mirë. Asnjëherë mos u dorëzo!

Me dashuri, Brendoni

**Brendon Haloçi 7E**



Përshëndetje Bjorn,

Ti ndoshta mendon se përse unë po e shkruaj këtë letër. Epo unë fillova të mendoja, e pse të harrosh, pse të dorëzohesh në ëndrrat e tua nga fëmijëria? Unë jam këtu për të të kujtuar, motivuar dhe bindur për ëndrrat e tua tani. A i mban mend ëndrrat se si ti, doje të hapje kompani elektronike dhe elektro-shtëpiake në Gjermani, në periferinë e Berlinit dhe që doje të mësoje japonisht, koreance, gjermanisht dhe frëngjisht. Të shkoje në universitet në Oksford dhe të mundohesh që të merrje një bursë dhe që të mbaroje për administrim biznesi. Dhe mbasi të bëhej kompania e sukseshme në Gjermani, ta zgjeroje biznesin në vende të tjera si Franca, Anglia, Rusia, Turqia dhe Spanja. Gjithashtu shpresoj që ti të jesh bërë një person më artistik. Ti e di sa të pëlqen vizatimi dhe muzika klasike. Bjorni, shpresoj që ti e sheh këtë letër dhe të bën të mendohesh dhe të motivohesh që ti t'ia dalësh për të arritur qëllimet e tua dhe kjo është arsyeja që unë e shkruajta këtë.

**Bjorn Vila 7E**



E dashur vetja ime,

Ti sot mbush 35 vjeç. Jam ca vite larg nga ty dhe nuk të uroj dot nga afër, prandaj po të shkruaj këtë letër. A u bërë doktor? Ku fillove punë në nje spital privat apo shtetëror? A ke pasur shumë pacientë këtë javë? Cili nga ata të ka lodhur më shumë? Unë të shkrova këtë javë po ti nuk je përgjigjur. Mos ndoshta je zemëruar me mua? Te kujtohet atëherë kur vajtëm në plazh dhe unë u futa në ujë me telefonin tënd të preferuar? Të kujtohet kur u zgjodhe si notari më i mirë në plazh? Ato kohë kaluan dhe ti ndoshta e ke harruar fëmijërinë tënde. Ndoshta ke thënë që ajo kohë nuk do të hyjë më në punë, sepse ti tani je një i rritur dhe i përgjegjshëm. Mezi pres që të kalojnë 23 vite dhe ne të dy ta lexojmë këtë letër. Ndoshta do të qeshim kur ta lexojmë. Gëzuar 35 vjetorin vetja ime e dashur dhe shumë mall për fëmijërinë.

**Bredi Alla 7E**



Përshëndetje vetja ime 35 vjeçare,

Unë që po të shkruaj jam ti, por 13 vjeç. Unë kam shumë dëshira të ndryshme. Një nga këto është sporti dhe aktiviteti pasi unë e pëlqej lojën e futbollit. Ajo është një lojë mjaft e bukur. Në shkollë ne e zhvillojmë 1-2 herë në javë lojën e futbollit. Të qenit një fanatiks është një pasion i imi. Unë e ndjek pothuajse në çdo ndeshje të saj. Sidomos kur luajmë kundër Partizanit. Ky është thjesht hobi im, por gjithmonë ëndërroj të bëhem drejtuesi i saj. E ardhmja ime është gjithmonë një pikëpyetje. Unë dëshiroj që kur të jem 35 vjeç të kem një jetë e një punë të mirë dhe të jem dikushi.

**Omar Jakupi 7E**



Vetja ime në të tashmen,

Në këtë letër unë do t'i shkruaj vetes sime në të ardhmen. Do të shkruaj ëndrrat që kam dhe kam pasur. Në moshën 6-9 vjeçare kam pasur dëshirë të bëhem futbollist. Më pëlqente ky sport prej lojës në grup, pasave dhe golave të bukur. Futboli përmban matematikë dhe disiplinë, dy gjëra që më pëlqejnë më shumë. Në moshën 10-11 vjeçare kam pasur dëshirë të bëja planetin një vend më të pastër. Kisha mësuar dëmet që shkaktoheshin në Tokë dhe doja t'i jepja fund. Në moshat në vazhdim disa nga idetë e mia ishin bërë realitet, por njerëzit nuk i përdornin. Në moshën 12-13 vjeçare kam pasur dhe kam dëshirë të bëhem youtuber i suksesshëm. Më pëlqen që unë mund të bëj çdo gjë që dua, si të dua dhe kur të dua. Në këtë profesion dua që dhe kushëriri im të jetë me mua. Si përfundim, unë kam shumë ëndrra dhe që të them të vërtetën vetëm dy prej tyre dua që të bëhen realitet. Por realiteti është i ndryshëm dhe duhet të kesh talent, disiplinë dhe fat në atë që do të arrish.

**Gersi Hajdari 7E**



I dashu Ahmed,

Kanë kaluar 35 vjet që nga lindja ime më datë 1.8.2004. Unë tani jam bërë një futbollist i famshëm dhe luaj në skuadrën e Real Madridit. Që nga mosha 21 e deri moshën 35, unë kam fituar 17 kupa. Lekët që kam marrë, ia kam dhënë njerëzve të varfër dhe jetimëve. Unë tani kam bërë një familje dhe jetoj i lumtur. Babi dhe mami im akoma jetojnë me mua, por në një shtëpi të madhe në Madrid.

**Ahmed Abouseif 7F**



E dashur Rei,

Unë jam ti, por 12 vjeç. Ah, si fluturon koha! A të kujtohet momenti kur ishe e vogël, e po e shkruaje këtë letër? Epo, ja ku je tani. Unë nuk mund ta shoh të ardhmen, por jam e sigurt që në këtë moment të jetës tënde, ti do të jesh e lumtur. Besoj se tani ke shtëpinë tënde dhe familjen tënde gjithashtu, për këtë jam më se e sigurt. Ajo që më intereson është karriera e cila ti ke zgjedhur. Shpresoj të mos kesh hequr dorë nga bota jote artistike dhe të jesh futur në ndonjë punë të mërzitshme zyre. E di që dikush duhet të punojë atje, por ti nuk ke lindur për atë gjë. Krenohu dhe mos ki turp nga ato që di të bësh. Nëse ke zgjedhur të ndjekësh biologjinë ose mjekësinë e di që e ke bërë për një arsye të veçantë. Ti do ta ndihmosh botën me shpikje të reja e zbulime. Kudo të jesh tani e çfarëdo të jesh duke bërë, e vetmja gjë që mjafton për mua është të jesh e lumtur. Por dua që të të shikoj edhe duke bërë njerëzit e tjerë



të lumtur, familje ose shokë. Kujtohu që t'i mbash të gjithë njerëzit që të duan pranë dhe të kujdesesh për ta. Jepi sa më shumë dashuri prindërve të tu, për netët pa gjumë që ata kanë lënë për ty. Gjithashtu përpiku t'i rrisësh me të njëjtën dashuri fëmijët e tu. Mos i shtyj të bëjnë gjëra që nuk dëshirojnë dhe përkrahi në ato që duan. Qëndro larg nga influencat e ndryshme të këqija dhe edukoji sa më mirë e shpejtë. Mbjaj gjithnjë kontakt me motrën tonë të dashur Ami. Do të ketë momente, kur ajo do të jetë personi që të kupton më mirë. Mbi të gjitha, mos më harro mua. Vërtet tani je e rritur, por fëmijëria jote do të ndjekë nga pas në jetë. Ky është çelësi i kënaqësisë, të ngelesh gjithnjë fëmijë thellë në shpirt. Ajo do të të mbajë ty aktive, sociale dhe mbi të gjitha, një njeri të mirë. Pra, edhe nëse nuk arrin të bëhesh e famshme ose e njohur në tërë botën, të lutem vazhdo të jesh një njeri i mirë.

**Rei Korkuti 7E**



E dashur Ejona,

Sa e çuditshme! Jam unë ajo që po e shkruaj këtë letër në moshën 13 vjeçare dhe jam po unë ajo që do e marr këtë letër në moshën 35 vjeçare. Në këtë letër dua të tregoj disa gjëra lidhur me mua dhe ëndrrat e mia, që shpresoj të bëhen realitet në të ardhmen.

E vështirë do të ishte të përshkruaja çdo aventurë timen. Çdo minutë që kalon, për mua regjistrohet si një moment i mrekullueshëm i jetës sime. Koha që kaloj me shoqet e mia është e mbushur me çaste lumturie. Gjithmonë i themi njëra-tjetrës se asgjë nuk do të na ndajë. Ne kemi qenë, jemi dhe do të mbetemi shoqe të pandara. Në kujtesën time do të mbeten të paharruara shëtitjet dhe udhëtimet e gjata me të afërmit e mi, festat të cilat kanë mbushur jetën tonë plot ngjyra. Sa herë i jemi gjendur pranë njëri-tjetrit dhe kemi gjetur qetësi e mbështetje për çdo shqetësim tonin. Nëse do të më duhej të përshkruaja këto që kam kaluar do të më duhej shumë kohë dhe përsëri nuk mendoj se do t'i thoja të gjitha. Kujtimet, ëndrrat, aventurat e mia nuk përfundojnë kurrë. Ëndrrat. Ehhh, ëndrrat! Sikur të mund t'i përshkruaja me fjalë. Ato janë të pafundme. Gjithmonë kam dëshiruar që të mësoj pianon dhe të mund të luaj për familjarët e miqtë e mi. Në ëndrrat e mia tingujt dhe meloditë e pianos më kumbojnë në vesh dhe gishtat e mi vërviten lirshëm mbi tastierë. Pasioni dhe dëshira ime për këtë vegël magjike nuk do të shuhen asnjëherë. Shpesh ëndërroj veten të veshur me përparësen e bardhë të mjekut dhe në shërbim të njerëzve të sëmurë. Ky profesion fisnik më mbush shpirtin me dhembshuri, dashuri dhe krenari njëkohësisht. E di që duhet shumë punë, por guximi dhe vullneti nuk më mungon. Çdo ëndërr është një hap për të ecur përpara. Shpresoj që edhe e ardhmja të më hap dyert e suksesit. Premtoj se do të jap maksimumin për të realizuar ëndrrat e mia dhe do të dhuroj gjithë dashurinë time për çdo qenie humane në këtë botë.

**Ejona Domi 7E**



E dashur vetja ime 35 vjeçare,

Tani je 23 vjet më e madhe dhe dua të di nëse më është plotësuar dëshira që kam pasur në moshën 12 vjeçare, dëshira më e madhe për t'u bërë administrator biznesi si babai im. Gjithashtu dua të të pyes nëse gjithë këto vite a më është dhënë mundësia e artë për të udhëtuar nëpër vende të bukura si Anglia, Spanja, Gjermania, Amerika e Dubai.

A do të jetë biznesi im i suksesshëm dhe a do ta njohin të gjithë? E kam fjalën, a do të vazhdoj të ndihem i sigurt dhe komod? E përsa i përket ëndrrës sime i të qenurit arkeologu në kërkim të gjetjeve të pazbuluara ende? Ti e di mirë sa të plotësuar më bën të ndihem kjo shkencë.

Mezi po pres të të shikoj si një biznesmen të famshëm. Jam ende në pritje të përgjigjes tënde.

**Greis Nuri 7E**



E dashur vetja ime,

Sot unë jam 12 vjeç, por me shumë ëndrra për të ardhmen. Shpresoj që pas 23 vitesh, pra kur unë te jem 35 vjeç, unë t'i kem realizuar shumicën prej tyre ose, pse jo të gjitha? Si fillim unë dëshiroj shumë që të diplomohem në Universitetin e Tiranës në degën Administrim biznesi me rezultate të shkëlqyera dhe njëkohësisht të kem një karrierë si futbollist. Siç dihet, futblli është një sport shumë fitimprurës dhe me fitimet e mia si futbollist, të mund të hap biznesin tim personal dhe të vë në punë gjithë njohuritë e marra në universitet. Një tjetër dëshirë e imja dhe besoj e shumë shqiptarëve, është që Shqipëria të ndryshojë, të ofrojë një të ardhme për të gjithë rininë, gjë që tani nuk e ofron. Shpresoj që një ditë të gjitha dëshirat e mia të realizohen e mos të mbeten vetëm dëshira.

**Kevin Dragoshi 7E**



Përsëndetje Ester,

Po të shkruaj këtë letër për të të pyetur si je? E di që të punosh në fushën e marketingut është e vështirë dhe për më tepër të menaxhosh një biznes, të cilin ti e ke ngritur në sajë të fantazisë dhe punës tënde të palodhur. Të kujtohet vetja ime 12-vjeçare? Të kam lodhur shumë? Kam qenë vërtet ajo atletja më e mirë, e cila ia kalonte gjithmonë vëllait të saj të vogël në gara? Sa vite kanë kaluar që atëherë. Nuk e di a e mban mend. Të kujtohet në moshën 20-vjeçare, kur krijuam parfumin tonë të parë me aromë vaniljeje? Sa u gëzuam! Nuk kemi fjetur gjithë natën.

Kemi përjetuar të njëjtin emocion si Mary dhe Pier Kyri, kur zbuluan radiumin. Emocionet e asaj kohe tani janë kthyer në një punë, e cila të lodh,

të merr energji, por edhe të kënaq. Por tani ti nuk ke aspak kohë, as të më shkruash edhe mua. Të uroj gjithë të mirat dhe shpresoj që linja jote e re e parfumeve e quajtur Coach të jetë po aq e suksesshme sa linja jote e fundit. Mirutakofshim pas 23-vitesh.

**Ester Alla 7E**



E dashur vetja ime

Tani që po të shkruaj jam në klasë të 7-të, në vitin 2016. Të kujtohet ky moment kur unë po të shkruaja para 23 vitesh. Unë kam shumë ëndrra që dua t'i realizoj, por jo të gjitha janë të mundshme. Unë dëshiroj të bëhem doktoreshë për fëmijët e vegjël. Shpresoj që kjo ëndërr të jetë realizuar. Dëshiroj gjithashtu që të bëhem këngëtare, pasi unë e kam shumë qejf muzikën. Unë dua të bëhem edhe astronaute, por kjo nuk është e mundur të realizohet. Dua të bëhem aktore. Eh, sa ëndrra kam unë, por jo të gjitha realizohen. Ku jeton tani? Shpresoj që të jetë një vend i këndshëm. Në këtë moment duhet të jesh duke lexuar këtë letër bashkë me fëmijët e tu. Kam shumë dëshirë që në dhomën tënde të jenë medaljet e olimpiadave që ke fituar në karate para disa vitesh. Karateja, për mua, është diçka shumë e mirë dhe po përmirësohem dita-ditës dhe po më bën më të fortë. Shpresoj që ëndrrat e mia të jenë realizuar. Paç fat!

**Klarisa Pengu 7E**



E dashur Fatma,

Sot jam 35 vjeçe dhe kam shumë gjëra për t'ju thënë. Jam një arkitekthe e njohur dhe ndoshta ju vjen pak çudi, por kjo është e vërtetë. Më duket sikur nuk ka kaluar shumë kohë dhe më vjen ndër mend vetja ime kur kam qenë një fëmijë i vogël, i llastuar paksa, por e zonja me mësimet. Por edhe pse kam qenë e mirë me mësimet, kur unë iu thosha të tjerëve që do të bëhesha arkitekthe, askush nuk më besonte. Ju dukej çudi, sepse isha veç një fëmijë dhe më e shumta që të tjerët besonin se do të bëhesha ishte doktoreshë, dentiste apo ndonjë lloj profesioni tjetër, por askush nuk mund të jepte ndonjë mendim të qartë. E dija se përse ata nuk e përcaktonin dot këtë. Arsyeja ishte se unë në atë kohë, kisha çdo ditë nga një profesion në mendjen time dhe çdo ditë unë tregoja se çfarë do të bëhesha në të ardhmen. Veçse ata nuk ia vinin veshin një dëshirë times sa herë "ndërtoja grataçela", pra ndërtesa shumëkatëshe me kokën në qiell në fletë fletoreje dhe vizatimi, madje një herë e vizatova edhe një shami letre. Dhe ja ku jam, mbarova studimet dhe u bëra një arkitekthe e zonja, me fletë të rregullta projektesh dhe jo me ato fletushkat e shpërndara kudo dhe që në atë kohë më dukeshin ndërtesa "prej vërteti". Ato fletushka nuk i kam hedhur dhe nuk do t'i hedh, sepse me ato nisi ëndrra ime e vërtetë.

**Fatma Kafellari 7E**



Përsëndetje Tea,

Sot që po të shkruaj jam ende në bankat e shkollës. Aty ku fillon e ardhmja jote. Shpresoj mos t'i kesh harruar ëndrrat e tua të femijërisë. Ndoshta disa prej tyre mund të të jenë bërë realitet, por kthehu pak mbrapa dhe shiko. Shiko sa shumë ke luftuar për to dhe sa shumë ke sakrifikuar për t'i patur këto ëndrra përballë teje. Kujto ato momente kur ti dhe miqtë e tu vazhdonit përpara, pavarsisht se çfarë mund të ndodhte. Që këtu filloi rrugëtimi yt sado i vogël, por tepër i rëndësishëm. Ti je tashmë në zyra të mëdha apo në një vend ku mbizotëron dashuria me njerëzit e tu më të dashur. Ato personazhe dhe shumë persona të tjerë që ti do të doje t'i shikoje nga afër asnjëherë mos i harro. Këto janë ato që ne i quajmë kujtime dhe këto na ndihmojnë të ecim përpara. Kur të lexosh këtë besoj se do të të kujtohet gjithçka. Ditët e vështira e ato më të lumtura. Unë tani jam ende 12 vjeç dhe nuk di shumë për jetën aty jashtë ku ndodhesh ti, por mund të them se ke luftuar shumë për gjithçka dhe me mbështetjen e familjes, miqve dhe të tërë personat e tu të dashur ti je aty ku je sot. Shumë kohë kanë kaluar dhe do të thuash "UAU", por mos u mërzit, se ende nuk ka mbaruar aventura jote. Të lutem mos hiq dorë dhe mos u dorëzo kurrë. Shumë njerëz mund të na vrasin me fjalët e tyre, por mos i dëgjo, pasi do të ketë shumë të tillë ne jetë. Për pak harrova, mos harro kurrë dhe miqtë e familjen, pasi ata të kanë ndihmuar ty dhe nuk kam aspak dyshim për këtë. Udhëtim të këndshëm në jetën tënde.

**Tea Zeqo 7E**



E dashur vetja ime 35 vjeçare,

Kjo letër është shkruar në moshën 12 vjeçare, kur bota nuk është me një teknologji aq të përparuar si në kohën tuaj. Në këtë letër unë do të shpreh dëshirat e mia. Dëshira ime kur isha 4 vjeç ishte që të bëhesha futbollisti më i mirë në botë, atëherë fillova të luaja futbollin. Dëshira ime filloi pak e nga pak të realizohej pasi iu nënshtrova një kursi në moshën 5 vjeçare dhe vazhdova atë kurs për 5-6 vite me radhë, derisa erdhi koha që të mos vazhdoja futbollin, por të përqëndrohesha te mësimet, pasi nuk kisha më kohë të mësoja dhe të shkoja në kurs. Unë vazhdoj ta ndjek futbollin si pasionin tim më të madh të jetës. Dëshira ime tjetër është të bëhem një youtuber i njohur. Hapa faqen time me 5 video, ku kam 385 shikues të kanalit tim. Kësaj dëshire nuk i jap shumë rëndësi, por prapë se prapë mbetet një nga hobet e mia. Dëshira ime e tretë dhe e fundit është të mbaroj shkollën si një arkitekt, pasi vizatimi është lënda ime e parapëlqyer. Mësuesja e vizatimit mendon se unë duhet të vazhdoj shkollën e arkitekturës, pasi kam talent në këtë fushë, por unë do t'i realizoj me mund e me djersë të gjithë ëndrrat e mia. Shpresoj të të shoh duke luajtur me ekipe të mëdha deri atëherë "Mirupafshim!".

**Leart Qefalia 7E**





I dashur Sidrit,

Kur je fëmije ke shumë ëndrra e dëshira, por sa më shumë rritesh, aq më shumë je i ekspozuar ndaj realitetit. Kjo, sepse fëmijët e shohin botën me ngjyra, ngjyra që të rriturit i kanë humbur, sepse realiteti ndryshon nga ëndrra. Ëndrrat janë të thjeshta, ndërsa realiteti është shumë i vështirë. Dëshirat e mia kryesore janë të bëhem aktor ose programues etj. Sado të paarritshme të duken, këto nuk janë thjesht ëndrra. Këto duhet të kthehen në qëllime.

Prandaj na duhet të punojmë fort dhe pa u lodhur, që të arrijmë qëllimet tona në jetë, që të arrijmë ëndrrat tona. Unë kam shumë dëshira. Nëse njëra venitet, lulëzon një tjetër akoma më e bukur, e cila më zgjon dëshirën për t'u përgatitur më mirë, për të patur rezultate sa më të larta, me qëllim që ëndrrat të kthehen në realitet. Këto dëshira do më shërbejnë për të kujtuar fëmijërinë. Me dashuri vetja jote.

**Sidrit Hoxha 7E**



E dashur vetja ime,

Kanë kaluar 35 vjet që nga dita e lindjes sime, 5 Dhjetor 2003. Sa shumë vite kanë kaluar! Tani jam një 35-vjeçar, që kam mbaruar studimet e larta në shkencë ekonomike dhe punoj në Bankën e Shqipërisë. Kujtoj, që babai im donte që unë të bëhesha jurist si ai, por mua më pëlqente shumë matematika, shifrat dhe numrat. Prandaj vendosa të studioj në fakultetin ekonomik. Shpesh herë pyes veten: A kam bërë zgjedhjen e duhur në jetën time? Them se po. Ndoshta do të ishte më mirë sikur unë të vazhdoja studimet e larta në Gjermani, te halla ime, por kjo dëshirë nuk m'u realizua. Mbaj mend që u mërzita shumë kur nuk fitova bursën e studimit në Gjermani. Ky shtet kishte shumë kushte të forta për të studiuar dhe unë nuk munda dot të shkoja atje. Megjithatë periudhën e shkollës në Tiranë e kujtoj me shumë nostalgji. Periudha e shkollës 9-vjeçare te kolegji "Turgut Ozal" dhe gjimnazi gjithashtu, po në këtë kolegji, kanë qenë një periudhë shumë e bukur. Sa shumë aktivitete kemi zhvilluar! Sa ekskursione zbavitëse në rrethe të ndryshme të Shqipërisë. Sa shumë udhëtime interesante në vende të ndryshme. Gjithmonë kujtoj shokët dhe shoqet e klasës. Me ta kam kaluar shumë vite të bukura shkolle. Madje tani disa prej tyre janë miqtë e mi të ngushtë.

Pyes veten: A ndjehem i realizuar? Gjithmonë njeriu duhet të mësojë e të punojë, duhet të kërkojë sa më shumë nga vetja.

**Erlis Nazarko 7F**



Përsëndetje Egi,

Sot është përvjetori im i 35-të. Në këtë ditë kaq të veçantë mendova të shikoja kujtimet e mia të fëmijërisë. Mes atij grumbulli të madh gjeta një letër të futur në një zarf. Mbi të shkruhej: "Letër vetes sime 35-vjeçare." Nuk më kujtohet të kem bërë diçka të tillë me parë, por gjithsesi, me kuriozitetin më të madh nisa ta lexoja:

E dashur Egi,

Besoj se tani që po e lexon këtë letër je një 35-vjeçare, ashtu siç e kam shkruar edhe në fillim, sepse nuk dua ta lexosh para kohe.

Tani jam e sigurt që ti e ke krijuar jetën tënde. Mendoj dhe shpresoj se profesioni yt është arkitekthe. Është ëndrra ime dhe besoj se ti ma ke realizuar, sepse ti je person që lufton dhe përpiqesh shumë për të realizuar ëndrrat e tua. Deri tani duhet të kesh hasur vështirësi të ndryshme, sepse jeta t'i ofron këto gjëra. Shpresoj t'i kesh mposhtur të gjitha deri tani. Në qoftë se ke akoma ndonjë të pazgjidhur, mos u dorëzo, mos e humb shpresën, sepse do të vijë momenti që dhe ai problem do të zgjidhet. Duhet të dish se jeta është një rrugë me shumë kthesa, ku shpesh do të hasësh pengesa nga më të ndryshmet. Herë pas here kjo rrugë do të ndahet në dy drejtime, duhet të tregohesh shumë e kujdesshme të zgjedhësh atë të duhurin. Do të ndodhë shumë herë të rrëzohesh, por ti asnjëherë nuk duhet të mendosh se nuk ngrihesh dot. Mblidhi te gjitha forcat e tua, ngrihu dhe vazhdo rrugën sikur nuk ka ndodhur gjë. Kurrë mos humb besimin te vetja, kurajon, vullnetin dhe shpresën, sepse këto do të jenë çelësi i një jete sa më të mirë dhe të suksesshme. Mos harro se ke dhe prindërit, të cilët janë një pjesë shumë e rëndësishme e jetës tënde. Gjithmonë mund të kërkosh ndihmë nga ata duke qenë e sigurt se kurrë nuk ke për të marrë një "jo" si përgjigje. Ata duan që të të shikojnë gjithmonë të lumtur dhe do të bënin gjithçka për ta realizuar këtë pavarësisht cdo gjëje. Dua të më premtosh se kurrë nuk do t'i harrosh ata, se do t'i duash gjithmonë dhe se do t'u jesh gjithmonë mirënjohëse. Mos i harro ata!

Me dashuri vetja jote 12-vjeçare.

**Egi Lika 7F**



I dashur Erjon,

Unë shpresoj që fëmijërinë time ta ndjej sa më shumë. Nuk doja të rritesha, edhe pse do të ndodhte. Shpresoj të kem bërë mirë në jetë dhe gjithashtu të jem i sukseshëm. Kam shumë frikë të rritem, sepse bota nga me ngjyra do të më kthehet në bardh e zi. Por, nuk e mendoj "botën tënde" kaq keq. Tani që je i rritur mund të bësh shumë gjëra dhe shpresoj që të kënaqesh me festa dhe shoqërinë. Një këshillë nga unë, mos harro familjen, sepse ai grup është me njerëz që i do. Epo kjo ishte. Të uroj sukses dhe të mira.

**Erion Vathi 7F**



Si je ti, Jona?

Unë jam ti në moshën 12 vjeçare. Kanë kaluar 23 vjet që s'jemi parë. Qenke rritur shumë! Shoh se ia paske dalë mbanë për mrekulli. Ti tani je 35 vjeç, por nuk ke ndryshuar aspak. I ke përsëri flokët e drejta dhe kafe dhe sytë nuk e kanë humbur atë shkëlqimin, i cili tregon se je e lumtur. Paske krijuar nje familje të mrekullueshme dhe fëmijet e tu janë shumë të lezetshëm. Me sa duket ëndrra jote për t'u bërë një arkitekto nuk ka humbur dhe ke arritur shumë sukses në profesionin tënd. Dhe siç e prisja unë paske të njëjtët shokë e shoqe. Them se kam bërë një zgjedhje të mirë dhe e kam zgjedhur me shumë kujdes shoqërinë. Dua që ti të vazhdosh me këtë ritëm gjithmonë. Mos harro: Të kesh gjithmonë besim te vetja dhe të ndjekësh ëndrrat e tua. Ti ke arritur deri këtu ku je, me forcat e tua dhe besoj se kështu do të vazhdosh gjithmonë. Po të kesh ndonje problem, mos harro se gjithmonë do te kesh njerëz afër. Duhet të iki!

**Jona Nallbani 7F**



Përshëndetje,

Më lër të prezantohem, unë jam ti në moshën dymbëdhjetë vjeçare. Kur ti të jesh duke lexuar këtë letër, ndoshta ti do t'i kesh bërë realitet disa nga ëndrrat e mia, që kam për të ardhmen. Për shembull, për punën unë jam shumë e sigurt që ti ke zgjedhur një punë që ka të bëjë dhe me letërsinë dhe me matematikën.

Shpresoj të kesh krijuar një të ardhme të sigurtë dhe të kesh arritur të bëhesh ajo që ti dëshiron. E kuptoj që në atë moshë ti mund të mos ëndërrosh më për të ardhmen, por të lutem mundohu të paktën edhe një herë. Të lutem mundohu të ëndërrosh për të ardhmen dhe shkruaj edhe ti një letër vetes gjashtëdhjetë vjeçe. Një letër që tregon për ëndrrat që ti ke plotësuar deri tani dhe ato ëndrra që ti mund t'i plotësosh.

Mundohu ta shkruash një letër të tillë, pasi vetëm atëherë kjo letër mund të plotësohet. Shpresoj të më kujtosh mua në këtë moshë dhe të qeshësh me veprimet që unë bëj, sepse vetëm një buzëqeshje e jotja për mua ka shumë vlerë. Unë do të jem gjithmonë në zemrën tënde, sepse jam e sigurtë që kohën më të bukur e ke kaluar me mua, apo jo?

Epo, unë jam e shkuara jote, të cilën ti do ta kujtosh me mall. Sa herë të më duash unë do të jem në mendjen e zemrën tënde. Unë gjithmonë do të jem aty për ty. Shpresoj që ti të kesh mësuar nga gabimet e mia dhe të kesh bërë zgjedhjet e sakta në jetë.

**Eva Kasmi 7F**



Si je Anja e rritur?

Ne fëmijët e shohim botën ndryshe, me plot ngjyra. Po kur të fillojmë të rritemi ajo ndryshon. Kur te rritemi s' do të kemi kohë të luajmë, por do të vazhdojmë të mendojmë për jetën. Të gjithë njerëzit dëshirojnë të përsëritin fëmijërinë e tyre. Por kjo është e pamundur. Tani që jemi të vegjël mendojmë shumë për të ardhmen. Mendojmë se si do të ndryshojmë, por më tepër, se si do të ndryshojë bota. Kur të jemi të rritur do të kemi më shumë përgjegjësi se tani që jemi të vegjël. Do të ndryshojmë shumë. Do të na ndryshojnë idetë për të ardhmen. Madje mund të jemi ne ata që e ndryshojmë të ardhmen. Ndaj unë mendoj se tani sa jemi të vegjël duhet ta shijojmë fëmijërinë, sepse kur të rritemi, do të jetë shumë vonë të kthehemi pas.

**Anja Gjini 7F**



Ç'kemi!

Pra, ti je unë por 23 vite më e madhe. Jam e lumtur që po të shkruaj dhe tani që jam ulur e po e mendoj, a është vërtet e mundur t'i çoj një letër vetes time? Epo ja këtë po bëj unë tani; po të shkruaj një letër ty: e Ardhmja ime.

Kam shumë pyetje për ty, por që e di se do t'i zbuloj së shpejti. Besoj se tani ke jetën tënde që e vlerëson shumë, familjen tënde të shtrenjtë që e do pa masë, punën tënde që e ke fituar me guxim e me mund. Ke ecur përpara pa u ndalur e duke përballuar çdo pengesë. A je më ajo vajza e vogël që ke qenë? A i ke më ato ëndrra që ke pasur atëherë? Apo tashmë ato janë zhdukur ose harruar përgjithmonë. Mos ndoshta vallë ndonjë prej tyre është realizuar?

Siç mund ta dish unë kam patur një familje të mrekullueshme, në të cilën jam rritur plot me dashuri e ngrohtësi. Besoj se ti e ke akoma atë dhe për çdo vështirësi që do të kesh në jetë ata do të të gjenden gjithmonë pranë e do të të japin kurajo të vazhdosësh përpara, këtë ta siguroj unë, e shkuara jote. Jam shumë kurioze të di se çfarë profesioni ke ti tani, sepse për momentin nuk kam ndonjë ide të saktë, por e di që ti ke tashmë dhe je shumë e sigurt për atë që bën. Mezi pres të bëhem ti e të mësoj çdo të jetë e ardhmja ime, pra çfarë dhe si do të jesh ti? Vitet po kalojnë e unë sa vjen e po rritem. Kam jetuar e do të jetoj kohë te bukura e të vështira, kam njohur njerëz të mirë e të këndshëm, por edhe disa të tjerë që të them të drejtën s'më kanë pëlqyer. Por çdo pengesë do ta kaloj duke menduar për ty, duke menduar për një të ardhme sa më të mirë.

Gjithmonë kurioze për ty, e shkuara jote.

**Greta Merlika 7F**



Ç'kemi Tania,

Unë jam ti, por jam 12 vjeçe. Meqë ti je 35 vjeçe, domethënë je unë, në të ardhmen, atëherë ti je menaxhere marketingu dhe në këto çaste po bën një super reklamë dhe së shpejti mendoj se do të shkosh në Londër, sepse menaxherja e firmës "Victoria's Secret" të ka thirrur për të organizuar një super reklamë siç je vetë. Gjithashtu duhet të jesh e martuar dhe besoj të kesh katër fëmijë të mrekullueshëm dhe dy prej tyre janë binjakë. Do kesh dy vajza binjake, Anxhelina dhe Endëron dhe do kesh dy djem më të vegjël, Andre dhe Majki. Madje burri yt duhet të jetë patjetër doktor. Dhe mendoj se duhet të kesh një qenush, Papi dhe një mace, Kiti. Tani po vjen fundi i letrës, por më premtu diçka. Këtë letër nuk do ta hapësh deri 35 vjeçe, që të shoh a i ke bërë ato gjëra.

Me dashuri Tania e së shkuarës.

**Tania Kalaci 7F**



E dashur Vera.

E dashur mami Vera. E dashur shoqe Vera. E dashur vetja ime....

Sot që po të shkruaj këtë letër jam 13-vjeç, jam një fëmijë që ëndërroj çdo ditë aq shumë, saqë nuk di ende se në cilën prej ëndrrave do të përfundoj. Ti u rrite e kalove adoleshencë, rini, ngjite shkallë, u rrëzove, u ngrite prapë. Gjunjët t'u përgjakën, por ti vazhdove... gjatë kësaj kohe ti e forcove më shumë ëndrrën tënde për të qenë një agjente, një zbuluese, një njeri në shërbim të njerëzimit. Ia arrite dhe tani dashuron punën tënde, mundohesh ta bësh këtë botë më të mirë. U bërë prind dhe kuptove se në këtë jetë ka pasur edhe një anë tjetër medaljeje, familja me njerëz të cilët të kanë dhënë shpresën, forcën, përfaqimin dhe besimin. Këta janë prindërit e tu në role kryesore, por që kurrë nuk kanë dashur të dalin në skenë. Tani jeni ulur pranë oxhakut dhe po pini nga një gotë verë dhe ti e kupton se pa praninë e tyre në jetë, ti nuk di të ishe ajo që je sot. Po buzëqesh, po feston suksesin e një jete. Ia dole, në fakt ia dolëm. Por nuk duhet të ndalesh, duhet të ecësh, duhet të vraposh, duhet t'i mposhtësh të gjitha dallgët e kësaj jete. Duhet të krijosh një rrugë për fëmijët ashtu siç ta shtruan edhe ty, madje edhe ndriçoje këtë rrugë bëje më të lehtë. Gëzuar 35-vjetorin vetja ime!

Mos harro të dua shumë. Por, nuk të them gjë tjetër se fillon e të rritet mendja...

**Vera Biba 7F**



I dashur Kleon,

Kur të bëhem 35 vjeç e imagjinoj veten shumë ndryshe. Besoj se me karakter do të jem njësoj, por jo kaq me fantazi dhe gazmor.

E përfytyroj veten shumë më të gjatë ndoshta mund t'ia kaloj edhe babit. Shpresoj që në vitet në vazhdim të merrem me sport dhe të kem një trup të fortë dhe të bukur fizikisht.

Patjetër do të kem gjetur një punë të mirë, ndoshta mund të bëhem inxhinier siç kam pasur ëndërr kur isha më i vogël, ndoshta mund të bëhem edhe politikan dhe të vë rregulla më të drejta në ligj, ndoshta mund të bëhem edhe biznesmen.

Besoj se kur të bëhem 35 vjeç do të kem një familje të bukur dhe disa kalamaj trazovaç, siç jam dhe vetë. Mendoj se do të jetoj në një shtëpi luksoze në mal, bashkë me familjen. Kështu mendoj unë se do të jetë jeta ime kur të jem 35 vjeç. Shpresoj të bëhen të vërteta.

**Kleon Oshafi 7F**



E dashur vetja ime,

Po të shkruaj sot, sepse dje pata një ditë shumë të lodhshme me kompjuterat në punë. Kisha shume fletëpalosje për t'i parë. Në fakt unë punoj si drejtor banke. Unë jam shumë i përpiktë në punë, por prapë se prapë le t'ia lëmë këto, sepse unë sot kam ditëlindjen. Pata fatin që ishte ditë e dielë dhe kisha pushim. E çova familjen time për drekë në një restorant peshku bashkë me mamin e babin. Shkuam atje dhe atyre u pëlqeu shumë vendi. Si fillim porositëm nga një verë të kuqe, Napoleon. Pastaj morëm një pjatancë të madhe, në një krahë, kishte peshkun nga krahu tjetër, kishte karkalecat e rrethuara me dy limona dhe në mes kishte ca oktapodë të vegjël. Të gjithëve u pëlqeu dreka dhe ia kaluam shumë mirë atje.

**Klevi Bitaj 7F**



E dashur Erma,

Si po ia kalon? Besoj se tani ke një familje dhe një punë, por a i ke plotësuar dëshirat që dikur i besoje aq shumë? Mbase je bërë një shkencëtare ose një fizikante, si të duash ti, vetëm mbaj mend se gjithmonë është diçka që të pret, nëse jep maksimumin. Mbase ke vendosur të jesh naive dhe të mos mendosh shumë, ose të japësh maksimumin tënd të bëhesh e para gjithmonë e t'ia japësh shumë rëndësi punës. Epo ta dish se nëse ke zgjedhur të bësh një nga këto vetëm po humbet kohën. Kështu më mirë kënaq veten dhe shijojë jetën, sepse vetëm një herë jeton, por kjo të mjafton nëse e bën mirë, po gjithashtu mos harro të mësosh. Dije se njeriu i zgjuar, është ai që gjen kohën e duhur



edhe për të mësuar edhe për t'u gëzuar prandaj dëshiroj shumë që ti ta arrish këtë. Po ashtu edhe të ndryshosh, përshtatu me vendin që jeton kështu çdo kush do të të dojë e do të të dëgjojë.

Megjithatë mos harro të shikosh gjithmonë anën e artë të dikujt, jepi gjithkujt një mundësi të dytë, kurrë mos i braktis njerëzit që të duan dhe së fundmi, beso në vetvete dhe kurrë mos u frikëso të provosh diçka ndryshe e të re.

**Erma Zeneli 7G**



I dashur Marvin,

Këtë letër e ke shkruar kur ke qenë 12 vjeç. Ti ke shkruar një letër për përfytyrimin tënd në moshën 35 vjeçare. Le ta them se çfarë ti ke shkruar. Në moshën 35 vjeçare, unë do të jem një njeri i rritur, i zhvilluar dhe i ditur. Në atë moshë, unë do të kem profesionin tim dhe do të jem i pavarur. Do të kujtoj me mall vitet e fëmijërisë. Do të jem i stabilizuar në një shtëpi brenda ose jashtë vendit. Deri atëherë do ta shfrytëzoj shumë jetën e të qenurit fëmijë. Duhet të bëj gjërat që një fëmijë duhet t'i bëjë dhe një i rritur jo. Këtë gjë duhet t'ua them të gjithë fëmijëve sot, që ta shijojnë fëmijërinë e tyre dhe në një moshë të caktuar të piqen dhe të çajnë vetë në jetë.

**Marvin Metaj 7G**



E dashur Nikol,

Si po ia kalon? Kanë kaluar plot 23 vjet, por për ty duken shumë pak, pasi i ke kaluar këto vite.

Besoj se deri më tani ti e ke krijuar familjen tënde dhe jeton me të në një vilë të bukur. Pyes veten çfarë profesioni ke zgjedhur? Në këtë moment mua më pëlqen të bëhem veterinerë ose pianistë. Ej, mos harro ditëlindjen e mamit në nëntor. Ajo bën 78 vjeç. Edhe pse në këtë moment ajo bën 43 vjeç. Po Alesia si është? Ajo do të bëhet arkitekte në këtë moment.

Epo më duhet të iki. Shpresoj të kesh një jetë sa më të mirë, e të jesh sa më e lumtur e plot sukses.

**Nikol Dalipi 7G**





I dashur Gezjon,

Shpresoj që bota pas 23 vitesh, ose kur unë të jem 35 vjeç, të mos ketë probleme politike, shoqërore ose natyrore që unë të arrij qëllimet e mia më me lehtësi. Unë dua të ndjek rrugën që ka ndjekur babai im, si profesionist, njeri e familjar. Përveçse do mundohem ta zmadhoj biznesin, unë do mundohem ta përhap në rajonin e Ballkanit. Unë e mendoj veten me disa biznese, që do ta ndihmojnë vendin tim në disa fusha si: turizëm, prodhim dhe riciklim. Që Shqipëria të njihet në të gjithë botën, për vendet e saj të mrekullueshme dhe bukuritë e saj natyrore. Unë e shikoj veten me disa hotele luksoze. Përsa i përket anës familjare, unë mendoj që familjen time ta krijoj pas moshës 35 vjeçare. Familja ime mendoj se do të jetë një familje e vogël me dy ose tre fëmijë, ashtu siç është dhe familja ime sot.

**Gezjon Muça 7G**



E dashur Ergita,

Përshendetje! Këtë letër e ke shkruar kur ke qenë 12 vjeç dhe tani që po e lexon, do të jesh në gjendje t'u përgjigjesh pyetjeve të ltrës. Tani duhet të jesh në kulmin e karrierës. Jam shumë kurioze të di se çfarë profesioni ke zgjedhur. A të janë plotësuar ëndrrat që ke pasur? Jam e sigurt se çfarëdo profesioni që ke zgjedhur është i përshtatshëm për ty dhe të plotëson më së miri. Si e kalon ditën? Besoj se jo si diçka të mërzitshme, pasi çdo moment i jetës është i rëndësishëm dhe duhet jetuar deri në fund. Shpresoj që të kesh mbetur po e njëjta vajzë që pëlqente shkrimin dhe e vlerësonte botën. Po familja jote si është? Është e vështirë të kesh një familje dhe një karrierë të shkëlqyer në të njëjtën kohë, por unë besoj se mund t'ia dalësh. Besoj se ke fëmijë për të cilët je krenare dhe i do shumë. Rriti njësoj siç të rriten prindërit ty plot dashuri. Rriti që të dinë të vlerësojnë gjithçka që kanë, të mos përbuzin dikë që ndoshta ka më pak, të falin dashuri dhe ta vlerësojnë jetën me gjithçka që ajo të fal, mësoji të shohin botën ashtu siç e sheh ti dhe mësoji të jenë altruistë për të ardhmen për gjithçka që ajo sjell. Po mami dhe babi si janë? Kujdesu shumë për ta dhe gëzohu që të ka ardhur mundësia t'ua shperblesh për gjithçka që ata kanë bërë për ty. Ki respekt për ata dy njerëz që të duan më shumë se gjithë njerëzit e kësaj bote dhe kanë sakrifikuar gjithçka për ty. Ki respekt për dashurinë e sinqertë që ata të falin. Jam e sigurt që je e sukseshme në karrierë, por je njëkohësisht dhe një familjare shumë e mirë.

Mos harro që do kesh gjithmonë mbështetjen time {vetes} për çdo gjë

**Ergita Zenelhasani 7G**





I dashur Erik,

Sot je 35 vjeç. 23 vjet më parë, kur ti studioje në shkollën "Turgut Ozal" ia shkruajta këtë letër vetes tënde.

Të kujtohet vetja i vogël? Në atë kohë kishe pafund ëndrra. Kishe qejf të studioje jashtë shtetit dhe të krijoje një jetë atje, të bëheshe ekonomist, të krijoje një familje, etj. Shpresoj që këto dëshira të të jenë plotësuar dhe këtë letër ta lexosh në një vend sa më të mirë.

E di që tani je rritur dhe ke ndryshuar. Konceptin për jetën e ke ndryshe. Nuk të duket çdo gjë e lehtë apo një fushë me lule. E di që tani i njeh vështirësitë e jetës, por në të njëjtën kohë di edhe që do t'i kesh përballuar me sukses. Shpresoj të kesh gjetur njeriun e zemrës dhe të jeni martuar. Po ashtu them që do t'i kesh bërë dy fëmijë të bukur siç doje kur ishe fëmijë. Mundohu t'i dhurosh sa më shumë dashuri dhe t'i rritësh me maturi ata. Dëshira për të pasur një punë jashtë shtetit ka qenë gjithmonë prioritet për ty dhe jam më se i sigurt se do t'ia kesh arritur qëllimit. Në mbyllje të kësaj letre dua të të uroj më të mirat në jetë dhe paçi vetëm gëzime dhe lumturi në familjen tënde.

Me dashuri, Eriku.

**Erik Tomnini 7G**



E dashur Tea,

Po të shkruaj sot për të të thënë se sa larg ke arritur në jetë, ka kaluar shumë kohë rreth 23 vite. Jam e sigurt, që ndërkohë që e lexon këtë do të të kujtohet e shkuara dhe shumë gjëra, shanse të cilat ke humbur dhe dëshira të cilat nuk i ke plotësuar.

Duke ditur shumë për ty, jam e sigurt që ke arritur me mund aty ku je sot, madje edhe pse mund të ketë pasur gjëra të cilat të kanë penguar. Shpresoj që problemet që ke pasur mos të të kenë ndaluar rrugën tënde. Jam e sigurt që ke pasur shumë të tilla, por uroj që asnjë mos të të ketë lënduar shumë. Uroj të kesh një jetë sa më të lumtur. Besoj që je penduar për shumë gjëra, por mos harro që ato dhe të gjitha vendimet e tjera që ke marrë po të sjellin sot në ditën që ti lexon këtë letër. Pra, mos u pendo për vendimet që merr, sado që të të mërzhisin, sepse çdo vendim tregon se kush je ti dhe sa e fortë je.

**Tea Çerenishti 7G**



I dashur Ivjon,

Jam në moshën 35 vjeçare, i rritur e i përgjegjshëm për gjithçka që bëj. Me nostalgji kujtoj fëmijërinë time. Isha një fëmijë i qeshur, i dashur, i lëvizshëm e tepër energjik. Më pëlqente të bëja timen çdo gjë që shihja. Nuk doja që asgjë të hidhej. Me sendet që prishenin krijoja objekte të reja si: linjë telefonike, balona, pistoleta, etj. Kështu pasuroja këndin e lojrave dhe kështu pas vetes tërhiqja edhe fëmijë të tjerë. Isha fëmijë i dhënë pas lojrave elektronike.



Emisioni për fëmijë më pëlqente shumë. Improvizoja skena për të qeshur. E qeshura mendoja se të bënte të lumtur. Kur kishte skena varfërie ose keqtrajtimi ndaj fëmijëve, prekesha shumë. Kërkoja t'i ndihmoja, t'i jepja gjithçka që ata të shpëtonin nga kjo mizerje. Më kujtohet një shok kur luanim bashkë, më kërkoi topin tim. Atë top, që unë e pëlqeja shumë, gjithsesi sytë e tij lutës më prekën shumë dhe unë ia fala. Ai edhe sot e kujton atë moment lumturie.

**Ivjon Subashi 7G**



Përshëndetje Jesna,

Në këtë letër unë do të shpreh mendimet e mia prej 12 vjeçareje përsa i përket të ardhmes sime duke përfshirë: profesionin, ëndrrat, dëshirat, opinionet, mendimet e mia kur të jem 35 vjeç. është një periudhë e gjatë kohe, 23 vjet, edhe pse ato kalojnë shumë shpejt.

Mendoj se unë, por edhe bashkëmoshatarët e mi, në moshën 35 vjeçare do të kemi realizuar disa prej dëshirave tona si për shembull: gjetjen e një profesioni dhe zhvillimin e tij, familjen, të ardhurat e shumë e shumë gjëra të tjera.

Si çdo njëri nga ne edhe unë kam 2 dëshira parësore. Unë dëshiroj të bëhem mjekë e specializuar në një fushë të caktuar, qoftë stomatologe si mami apo edhe dermatologe. Kjo e fundit është një profesion mjekësor, por edhe estetik për lëkurën. Dhe po ashtu dëshiroj që shkollën ta vazhdoj jashtë vendit. Në moshën 35 vjeçare e mendoj veten një person serioz, me një karakter të fortë, me një profesion të mirë dhe e përgatitur për jetën.

**Jesna Demushi 7G**



Përshëndetje Kejsi,

Kur mësuesja na tha të shkruajmë një ese "Letër vetes sime 35 vjeçare", u çudita, m'u duk e pamundur t'i shkruaja vetes dhe aq më tepër vetes sime 35 vjeçare, një numër vitesh aspak normal për një 12 vjeçare. Nisa të shkruaj, por u ndjeva në vështirësi që në fillim. Së pari më dukej qesharake ta nisja si stuktura e të shkruarit të letrave, që nisin me fjalët standarde, e dashur apo e nderuar. Nuk e zgjata shumë dhe vendosa të mos mbështetem te kjo strukturë.

Kejsi, sa shpejt do të kalojnë vitet, si pa e kuptuar, do të kesh mbi supë plot 35 vite dhe nuk janë pak, por do të duhen edhe 15 vite që të mbushësh një gjysmë shekulli. Kur të shihesh në pasqyrë, gati sa nuk do ta njohësh veten, pasi ajo vajza e vogël me fytyrë feminare do të jetë zëvendësuar me një fytyrë fisnike, sytë nuk do të kenë më atë shkëlqimin lozonjar, do të jenë më të mprehtë dhe shprehës. Oh, trupi sa do të këtë ndryshuar! S' do të jetë ai trupi njomëcak, ato supë të brishtë. Vitet do të kenë bërë të tyren. Vitet do të kenë lënë gjurmë,



jo vetëm në pamjen fizike, por edhe në karakter dhe formim. Rrugëtimi i gjatë nuk do të këtë qenë i lehtë, do të kem patur plot udhëkryqe, probeme, pengesa dhe këto nuk do të më kenë surprizuar, pasi jeta dihet që s'është drejtvizore. Do të kem patur momente, ditë, kur nuk kam ditur ku ndodhem dhe çfarë duhet te bëj, por shpresoj që do të kem patur gjithmonë njerëz, të cilët do të më kenë mbështetur, orientuar, ngushëlluar apo përgëzuar. Shpresoj të kem patur fat dhe mundësi, që të punoj në profesionin që kam dashur që në fëmijëri, atë të mësueses. Profesioni sa i vështirë, po aq edhe i bukur, profesioni që të fal kënaqësi, të bën të ndihesh gjithmonë e re, pasi je në mes të fëmijëve, të cilët të falin vetëm mirësi dhe dashuri. Kejsi, nuk do të mërzitem sikur të kesh ndërruar mendje rrugës, pasi e di që do të kesh zgjedhur profesionin, që bën për ty dhe që ti mund të japësh më shumë nga vetja në ndihmë të njerëzve dhe të komunitetit. Oh, sa do të doja të kem mbetur ajo vajzë e qeshur dhe e dashur! Ajo vajza që vlerësonte veten dhe që nuk bënte kompromise me karakterin e saj.

Kejs, çfarëdo që të jesh bërë, unë do të ndihem krenare me ty.

**Kejsi Nuriu 7G**



E dashur Meri,

Si të duket e ardhmja? Besoj se në krahasim me të shkuarën do të jetë e mahnitshme. Në mendjen time unë e imagjinoj të ardhmen plot dritë. Makineritë e së ardhmes do ta lehtësojnë jetesën, do të jetë zhdukur varfëria në botë dhe me siguri që nga problemet e mjedisit s'do të ketë gjurmë. Shpresoj që ti t'i kesh plotësuar të gjitha ëndrrat e tua. I mësove të gjashta gjuhët e huaja? Nëse jo, mësoji pasi do të të duhen për të komunikuar me të gjithë miqtë u tu anëmbanë botës. Dashuria për kafshët të karakterizon ende apo jo? Shpresoj se po. Në moshën time i doje shumë të gjitha llojet e kafshëve. Aryeja që po ta dërgoj këtë letër është për të të këshilluar që mos ta humbësh kurrë shpresën, të mos dorëzohesh kurrë dhe të mos ta largosh kurrë buzëqeshjen nga fytyra. Ndihmoji njerëzit në nevojë, pasi nuk i dihet kurrë se çfarë mund të rezervojë fati për ty. Ndoshta nesër do të jesh ti, ajo që do të ketë nevojë për ndihmë. Mos harro, vlerat e vërteta vijnë nga zemra e nga sjellja. Do të shihemi pas 23 vjetësh.

**Meri Berisha 7G**





E dashur Kea,

Jam akoma e vogël për të qenë e formuar si duhet, por në vitet e mia të 35-ta do jem një zonjë e vërtetë, e cila ka arritur t'i kalojë vështirësitë, për të realizuar ëndrrat e saj. Ja pra, ti ke profesionin që ke dashur, ia ke dalë të kesh familjen tënde dhe je bërë një nënë e mirë që ashtu si nëna jote të qëndronte pranë, të këshillonte të ishe luftarake dhe të mos dorëzoheshe para pengesave, ashtu siç edhe ti sillesh me fëmijët e tu. Jeta nuk do të ishte e bukur dhe interesante, në qoftë se gjithçka do të ishte e lehtë për t'u arritur. Çdokush bën gabime gjatë rrugës së jetës së tij, por merita e njeriut është të mësojë nga këto gabime dhe të përmirësojë veten. Dhe pikërisht këto ti i di mirë, sepse i ke kaluar vetë dhe ke fituar përvojë. Pranë teje ke dhe disa nga shoqet e tua më të mira të shkollës, që nuk i ke harruar dhe kujtoni bashkë se si e imagjionit veten kur të rriteshit. Sot ti je 35 vjeçe, e do jetën, profesionin tënd dhe familjen tënde që është gjëja më e shtrenjtë. Ti je e realizuar dhe e plotësuar në çdo fushë të jetës dhe unë 12-vjeçarja ndihem krenare për ty.

**Stelakea Mërtiri 7G**



E dashur Xheni,

Po nis të shkruaj një letër për ty. Kjo letër do të bëjë një rrugë të gjatë deri sa të vijë te ty. Në këtë letër po shpreh mendimet e mia mbi të ardhmen time. Besoj se ke krijuar familjen tënde dhe ke një punë që të bën të lumtur. Nuk jam e sigurtë se çfarë profesioni ke zgjedhur, por e di se ke zgjedhur diçka që i përshtatet karakterit tënd, diçka të bukur dhe konkruuese.

Vras mendjen, ... a e mban mend fëmijërinë tënde? A i mban mend të gjithë shokët dhe shoqet? Shpresoj që t'i mbash mend këngët që ke dëgjuar kur ishe 13 vjeçe dhe shpresoj që nuk dëgjon opera apo këngë të atij lloji. Besoj, se kur të lexosh këtë letër, do të të vijnë ndër mend të gjitha këto momente dhe shpresoj që të fillosh të qeshësh me të madhe kur të mendosh për këto kohë. Dhe tani jam duke e mbyllur këtë letër, duke menduar se i ke realizuar të gjitha këto kërkesa, që lexove pak më parë duke mos e zhgënjyer veten tënde 13 vjeçare.

**Xhenifer Xhaferi 7G**



Përsëndetje Martini 35 vjeçar,

Si je? Si është e ardhmja? Besoj se duhet të jetë shumë e zhvilluar dhe e bukur. Jam i sigurt që ke udhëtuar dhe tani jeton në një vend jashtë Shqipërisë. Shpresoj të jetë Gjermania. Ke zënë shokë të rinj? Shpresoj shumë se po. Duhet të dish edhe gjuhë të huaja apo jo? Besoj se je bërë doktor si gjyshi dhe stërgjyshi. Duhet që të kesh nota të mira që të bëhesh doktor. Shpresoj që të jesh bërë kirurg ose kardiolog, pasi ato janë dy nga punët më të rëndësishme të një doktori. E flet mirë gjermanishten? Shpresoj shumë që bota të jetë



më mirë në ato kohë, pasi tani është pak si keq me luftërat dhe me ndotjen. Çfarë teknologjie të re ka? Ju duhet të keni makina me autopilot, shumë të avancuara, pasi edhe këtu i kemi por janë akoma në fillim. Edhe avionet, trenat dhe mjetet e tjera të udhëtimit duhet të jenë shumë të avancuara. Cila është gjëja që të pëlqen më shumë për kohën? Besoj se ke një shtëpi të bukur dhe të madhe. Sa herë shkon në Shqipëri ose në vende të tjera? Po Shqipëria si është? Është e avancuar apo pak a shumë si sot? Si janë prindërit? Besoj se i viziton shumë shpesh. Po shokët e vjetër të fëmijërisë si janë? Apo nuk i takon më? Në çfarë qyteti jeton? Në qoftë se je në Gjermani jeton në Berlin? Apo jeton në ndonjë qytet tjetër si Parisi ose edhe Tirana. Shpresoj, që ti, të kesh momente sa më të bukura dhe një karrierë sa më të sukseshme! Po jeta si të shkon? A je i martuar? Ke fëmijë? Shpresoj që të kalosh një jetë sa më të bukur dhe të suksesshme. Mirupafshim!

**Martini Mborja 7G**



E dashur vetja ime 35 vjeçare,

Dëshiroj të të kujtoj që të bësh kujdes në hapat që hedh në jetë, sepse jo gjithmonë fati na ndjek. Unë besoj se ti tashmë je duke punuar me Armelën dhe Enion në një kantier ndërtimi, duke ilustruar shtëpi të bukura dhe me forma të ndryshme. Them me forma të ndryshme, sepse mendoj se teknologjia ka ndryshuar tashmë, apo jo? Unë e di që arkitektura është e vështirë, por duhet të punosh për të arritur suksesin dhe të ecësh përpara me hapat e një personi të rritur dhe mirëkuptues. Doja të të thoja se asnjëherë të mos dorëzohesh dhe të ecësh përpara, duke mos u dorëzuar kurrë. Qëllimi ynë është të na plotësohen dëshirat tona. Mendoj e besoj se dëshirat e tua kanë ndryshuar dhe se të dyja ne do të mundohemi për ta bërë këtë vend më të mirë. Do të doja të të udhëzoja, sepse jeta ka edhe të papritura, sado të hidhura a të bukura. Mos ndiq gjithmonë hapat e atyre që të kanë sjellë në këtë jetë, sepse ata mund të kenë shkelur edhe në baltë dhe jo vetëm në tokë të thatë.

Prandaj, parashiko rrugën më të gjatë në jetën tënde, sepse jo gjithmonë kur kalon nga rruga e shkurtër del fitimtar. Të uroj shumë fat dhe bëhu e mira që do të doje të ishe!

Vetja jote 12 vjeçare.

**Livia Mandro 7H**





I dashur Besim,

Vite e vite kaluan. Tani jam 35 vjeç. Jam shpërngulur nga Shqipëria dhe jetoj në Amerikë tashmë, në qytetin e Neë York-ut. Jam shumë i lumtur. Puna ime është në kompaninë YouTube. Në këtë ëbsite hedh video duke luajtur lojëra të ndryshme. Kam rreth "10 Milion Subscribers/Ndjekës" dhe marr 4-5 mijë dollarë/për video. Është një punë shumë e lodhshme. Duhet të editoj rreth 7-8 orë e duhet të bëj 2 video në ditë, një për sot e një për nesër. Kam zënë shumë miq të rinj dhe më pëlqen vendi. Miqësinë me Rubinin akoma nuk e kam lënë pas dore. Jetojmë në të njëjtin pallat. Rubini është futbollist tashmë dhe luan për "NY FC". Çdo vit, në verë dhe në dimër vizitohet prindërit në ëashington DC. Të dy prindërit janë në formë të mirë dhe vazhdojnë të punojnë. Më kujtohen shumë mirë ato ditë të bukura të shkollës. Nuk di shumë për shoqërinë e vjetër. Disa kanë ndenjtur dhe disa janë shpërngulur. Bota ka ndryshuar shumë. Makinat tashmë nuk punojnë me benzinë, naftë ose bateri. Ato punojnë me panele diellore. Kjo ka bërë një zhvillim shumë të madh. Kafshët, që para 13 vjetësh ishin duke u zhdukur, tashmë janë duke u shumëzuar.

**Besim Pashaj 7H**



E dashur Vivien,

Po të shkruan një mike e harruar, një kujtim i së shkuarës, një zanafillë e hershme e jotja, dikush, i cili ka qenë pjesë në lojërat e tua të fëmijërisë. S' më mban mend? Epo, s' të vë faj. Besoj se ke ndryshuar paksa, më e gjatë, më e pjekur. Mirëpo, unë e ndjej se poshtë atyre rrudhave; që mund të jenë thelluar paksa, atyre fijeve të flokut, që janë zbehur, pasi mbi to është shkundur pesha e ca viteve më shumë, duhet të jesh po ti, një vajzë e vogël, e qeshur ngahera, ëndërrimtare dhe lozonjare. Tani, ç' po bën? Besoj se duhet të jesh në ndonjë zyrë duke punuar një projekt të ndonjë pallati, pasi besoj se e mban mend sa të pëlqente arkitektura. Gjithmonë ëndërroje me sy hapur se sa shumë projekte do të bëje, plane fasadash të mëdha, parqe, qytete...më pas zgjoheshe, kthjelloheshe dhe riktheheshe tek detyrat e matematikës. Ëndrren për t' u bërë arkitekthe e ke pasur që në vogëli, sigurisht, kur e more vesh se ç' do të thoshte ky profesion. Thjesht shpresoj me gjithë shpirt që kjo ëndërr në sirtar të bëhet realitet në të ardhmen me punë e studime.

Gjithashtu, shpresoj që të kesh dhe një familje, ku të mbështetesh kur ke nevojë, një shtëpi të madhe ku rrethohesh nga lumturia, sidomos kur mbledhet e tërë familja dhe një karrierë sa më të realizuar, ku çdo ditë të kesh frymëzim për gjëra të reja. Gjithsesi, tani do të largohem, por duhet ta mbash mend gjithmonë, se unë do të jem përherë një pjesë e jotja, një kujtim fëmijërie, që do të të shoqërojë në çdo hap të jetës, për të të sjellë herë pas here ndër mend viset e ëmbla të fëmijërisë.

**Vivien Shkodra 7H**



Enio,

Tashmë ti je i rritur. Ke bërë shumë vite shkollë dhe ke marrë shumë diploma për të patur një të ardhme sa më të mirë. Sa herë që kthen kokën pas dhe gërrmon mes vitesh për të parë të shkuarën, ti shikon një rrugë shumë të gjatë dhe të duket sikur je në fund të saj. Por jo, rruga që ti do të bësh do të jetë shumë më e gjatë dhe duhet të punosh akoma më shumë për të arritur në fund të kësaj rruge, sado pengesa të ketë.

Të kujtohet kur ishe fëmijë?! Ishe një fëmijë me ëndrra të mëdha. Disa prej tyre ishin aq të mëdha, saqë sot, ti e sheh që janë të pamundura. Asnjëherë nuk ke dashur të dëgjosh çfarë thoshin të tjerët për ty edhe pse ishe i detyruar t'i dëgjoje. Gjithmonë injoroje ata që përpiqeshin të të pengonin rrugën me fjalët e tyre të kota. Shpresoj që këtë gjë ti ta bësh përsëri me ata, që të pengojnë. Unë tani po qesh me veten. A e di pse? Po më kujtohet kur po luanim me shokët hapa-dollapa në plazh gjatë darkës. Aq shumë gëzonim dhe bërtisnim me njëri-tjetrin, sepse na dukej sikur plazhi ishte vetëm i yni. Në një moment, shumë pranë nesh, po festohej një ditëlindje. Ne gjurmonim njeri-tjetrin, kush e kush të gjente vendin më të mirë për t'u fshehur. Papritur dikush bërtiti: "Çuna largohuni!" Menjëherë, një mori fishekzjarresh mbuluan mjedisin ku po luanim. Të gjithë u frikësuam aq shumë saqë filluam të vraponim me sa të na hanin këmbët. Na dukej sikur fishekzjarret na ndiqnin dhe na afroreshin gjithmonë e më shumë. Dhe ti, për mos ta humbur atë çast, nxore telefonin dhe fillove të filmoje larminë e fishekzjarreve, ndërkohë që i jepje këmbëve nga frika. Ndërsa sot ke ndryshuar. Nuk rend më pas lojës dhe argëtimit, por çdo ditë e më shumë, minutë pas minute i kushtohesh punës, formimit akademik, ngritjes cilësore, profesionalizmit dhe harmonisë në familje.

**Enio Boçi 7H**



I dashur Blin,

Të imagjinoj një burrë tërheqës, të gjatë, me flokë të shkurtra dhe të veshur shik.

Besoj dhe pse vitet kanë kaluar, ke ruajtur po ato cilësi që ke patur në fëmijëri, zemërgjerësinë dhe këmbënguljen.

Jam kurioz të di degën që zgjedhe për studimet, ku i përfundove dhe ku je i stabilizuar me punë. Tashmë ti ke zgjedhur njeriun e jetës, ke krijuar familje e je bërë një baba shembullor dhe të uroj suksese në jetë.

Përzemërsisht Blini

**Blin Curaj 7H**



E dashur Era,

Besoje se je rritur tashmë. Shpresoj që të jesh bërë një femër me vlera, me vlerat e prindërve. Po filloj menjëherë me arsyen, se pse po ta shkruaj këtë letër.

Shpresoj që t'i kesh plotësuar ëndrrat e mia. E kam fjalën për ato premtimet që i bëje vetes kur ishe 12 vjeç, që do të bëheshe një aktore dhe jo si ato aktoret që luajnë një film dhe boll, por një aktore me famë, që gjithkush do të kishte dëshirë ta takonte, ta përqafoje, që njerëzit të qanin apo të bërtisnin nga gëzimi kur ta shohin. Mos lejo asgjë të të pengojë të realizosh ëndrrat e mia, ose më saktë, ëndrrat tona, sepse asgjë nuk është e pamundur.

Bëj ç'të duash, por diçka mos harro: "ASGJË, NUK ËSHTË E PAMUNDUR!"

Nga Era dymbëdhjetë vjeçare.

**Era Hoxha 7H**



New York, Amerikë 2033

Përshëndetje Erlisi!

Shpresoj të jesh mirë. Këtë letër po ta shkruaj për të të pyetur për jetën tënde.

Si fillim, shpresoj të kesh gjetur një shtëpi e të kesh ndërtuar një familje.

Shpresoj që t'i kesh përmbushur ëndrrat e tua. E di që me këtë letër nuk do të marr dot përgjigje, por do të përpiqem të të pyes për shumicën e gjërave.

Të filloj me universitetin, do të doja të të pyesja se ku e ke mbaruar. A ke ikur

në Amerikë, siç dëshiroje dikur a ke ndenjtur brenda Europës apo ke qëndruar

në Shqipëri? Sidoqoftë, shpresoj t'ia kesh kaluar mirë e të kesh mësuar. Për

çfarë dege ke studiuar? Shpresoj shumë, e jam shumë i sigurtë që ka qenë IT.

Po shokët si i ke pasur, a ke qëndruar me të njëjtët apo ke humbur kontakt

me shokët e vjetër e ke njohur shumë të rinj? Nuk është gjë shumë e mirë t'i

harrosh shokët e vjetër, por është edhe më e mirë të kesh mundësi të bësh

shokë të rinj, më të mirë se të vjetrit.

Tani dua të të pyes për botën. A ka ndryshuar, apo është ende njësoj si

para 22 vjetësh? Unë nuk mendoj se është njësoj. Teknologjia duhet të jetë

avancuar e mjedisi të jetë pastruar. Unë shpresoj që kjo ka ndodhur. Dhe, si

përfundim, dua të të pyes se si ka avancuar teknologjia. A është bërë realiteti i

argumentuar një gjë normale? A ekzistojnë robotët? Por pyetja kryesore është

kjo: A është zgjidhur problemi i makinave pa shofer? Si është rregulluar që

makina duhet të zgjedhë të vrasë pasagjerin/ët apo personin/at në rrugë kur

nuk funksionojnë frenat. Tani që po krijohen këto makina, ky është i vetmi

problem, i pazgjidhur, i cili nuk po i lejon që të dalin në treg.

Shpresoj që bota e së ardhmes të jetë më e mirë.

Me dashuri Erlisi 13-vjeçar.

**Erlisi Ciko 7H**





Hej, Ani 35-vjeçar,

Unë që po të shkruaj jam ti, por 12 vjeç. Unë dua të të pyes se si është të jesh 35 vjeç? Druaj të jetë periudhë e bukur dhe e vështirë gjithashtu apo jo? Gjithë ato përgjegjësi dhe detyrime, besoj se mezi të del koha. Të lutem, më premtro se nuk e ke harruar fëmijërinë. Mos i harro ëndrrat që kemi për të ardhmen, mos e harro kurrë se çfarë ke kaluar ndër vite, miqësitë, zënkat e të qeshurat etj. Mbaj afër miqtë, që kanë të njëjtin qëllim si ti dhe miqtë që të inkurajojnë. Shpresoj të kesh vazhduar me degën e informatikës ose të ekonomisë dhe të jesh bërë dikush në jetë. Uroj të kesh gjetur një punë të mirë, atë që gjithmonë kemi dashur ;). Gjithashtu shpresoj të kesh shpikur ndonjë gjë të vlefshme për njerëzimin.

Të kujtohet kur ishe i vogël, që dilje dhe luaje me shokët futbolli? Sa bukur ia kalonim! Gjithmonë këmbëngulje të bëheshe futbollist. Po atëherë kur mbaruam ASEF-in në klasën e gjashtë, të kujtohet? U mërzitëm pakëz që nuk fituam asnjë çmim, por të paktën rëndësi kishte pjesëmarrja, apo jo? Që atëherë na ka filluar të na pëlqejë informatika.

Besoj se duhet të jesh shumë i zënë për momentin dhe as unë nuk po të mbaj më gjatë.

PS: Shpresoj që të jesh i njëjti djalë çapkën dhe i pandreqshëm, i cili ishe edhe në fëmijëri.

Përzemërsisht nga Ani 12 vjeçar

**Ani Bitri 7H**



E dashur vetja ime,

A i ke arritur qëllimet e jetës tënde?

A je bërë një arkitekthe e zonja tashmë?

Shpresoj që po. E mban mend kur thoje se do të modeloje shtëpinë tënde? Kur do të projektoje shtëpitë, "vilat" e njerëzve të tu të dashur? Është shumë e rëndësishme që mjedisi që ke krijuar përreth teje të jetë i mbushur me qëllime të arritura, ëndrra të realizuara dhe njerëzit që do ti më shumë.

Sa e sa ëndrra, sa e sa plane ke thurur kur ke qenë e vogël. Ashtu siç projekton vilat tani, ashtu projektoje dhe ti jetën tënde kur ke qenë e vogël. E mban mend kur thoje se do të bëheshe jashtëzakonisht e suksesshme? Kur do të ndihmoje të varfërit? A je një njeri shpirtmirë siç doje? Shpresoj të jesh pasqyrimi i imazhit që ke dashur kur ke qenë e vogël.

**Armela Shahini 7H**



I dashur Noel,

Mos u habit se po të shkruaj. Pavarësisht se nuk shkruajnë, të gjithë mendojnë për bëmat e jetës së tyre qysh nga fëmijëria, e pastaj ia tregojnë me gojë prindërve dhe shokëve të tyre fëmijërinë e hershme. Tani që jam në moshë madhore, them se duhet të kisha më shumë vëmendje dhe përkushtim ndaj shkollës dhe mësimit, respekt më të madh për prindërit, mësuesit dhe shokët. Mirë thonë "i riu si veriu", por mua më duket se unë i kisha kaluar këto caqe. Tani mendoj që në jetë po dalin ca gjëra, që po t'i kisha vënë më shumë rëndësi mësimeve, nuk do të kisha probleme. Tani unë e vlerësoj më tepër kohën e humbur, kohën që kaloi, kohën që e shoh me mall dhe që s'mundem ta kthej dot më mbrapsht. Kur shoh ish mësuesit e mi, duart me dalin vetvetiu nga xhepat dhe i përshëndes me dashuri. Prindërit e mi, që tani mbushin të shtatëdhjetat e që më dërguan të mësoj në një nga shkollat më të mira, i dua pa masë dhe i respektoj. Kam bërë ca prapësira, por tani po i ndreq duke e shtuar më shumë kujdesin për ta. Pavarësisht se tani jetojmë veçmas, unë nuk ka ditë që nuk shkoj të kujdesem për ta, e t'i jap atë kënaqësi, që ndoshta nuk ua kam dhënë më parë. Këshillat që më kanë dhënë prindërit, kanë qenë shumë të rëndësishme në jetë dhe unë i falenderoj, që kurrë nuk më lanë vetëm për asnjë moment, e që pavarësisht halleve e problemeve që kishin, më ndihmuan për t'u bërë një njeri i mirë në jetë.

Respekt e dashuri për ju o prindër, respekt e mirënjohje gjithmonë për ju o mësues!

**Noel Arkaxhiu 7H**



Përshëndetje Bjorni! Si je? Shpresoj që të jesh mirë, sepse kur ke shkruar këtë letër, mirë ke qenë, pak i lodhur, por prapë mirë. Të kujtohet kur po shkruaje këtë letër apo jo; kur ishe akoma i vogël në klasë të shtatë. Pak ditë na ndanin nga takimi me prindër, por shpresoj të kemi dalë mirë. Ti duhet ta mbash mend, por gjithsesi më lër të të flas për të tjera gjëra.

Mendoj se duhet të kesh një punë të mirë tani, ndonjë punë kreative dhe jo nga ato punët e mërzitshme të zyrës, ndonjë punë fitimprurëse dhe tërheqëse njëkohësisht. E di që në punë nuk shkohet me qejf, por shpresoj që mos të jesh bërë nga ata tipa. Nuk e di nëse ke akoma kontakt me shokët e klasës dhe nëse je aq afër me ata sa jam unë sot, por, shpresoj që të paktën t'i njohësh kur i sheh në rrugë dhe t'i përshëndesësh ata. Me ata ke kaluar tërë ato vite dhe besoj se ti duhet t'i tregosh atyre pak respekt.

Gjithsesi, unë tani po e mbyll këtë letër dhe shpresoj që t'ia kalosh sa më mirë.

**Bjorni Hoxha 7H**



E dashur Estel,

Ku je tani? A je një arkitekthe e zgjuar në Paris? A e ke një shtëpi të bukur në zemër të Parisit, të cilën ndoshta e ke mobiluar vetë, ashtu si e ke dashur?

Ndoshta fjalën 'shok' tanimë e ke zëvendësuar me fjalën 'koleg' dhe fjalën 'shkollë' e ke ndërruar me fjalën 'punë', por mos harro se e gjithë jeta jote do të jetë një shkollë madje shumë e vështirë, sepse kurdoherë mund të bien provime të papritura dhe e ke të pamundur që shokët të të ndihmojnë, sepse asnjërit nuk i bien pyetje të njëjta.

Dëshira jote ka qenë që të lije gjurmën tëndë si një arkitekthe shqiptare në fushën e arkitekturës europiane dhe ta nderoje popullin tënd me arritjet e tua, një ndër to ishte të merrje pjesë në grupin e arkitektëve të përzgjedhur si më të mirët në Komunitetin European. Pasioni për profesionin të bën të spikatur mes kolegëve. Kjo kërkon më shumë punë se talent. Duke spikatur në profesionin tënd, ti njëherazi krijon vlera në mendimin shoqëror. Synimi yt do të jetë progresi dhe estetika.

Estel, je aty ku duhet. Ji krenare për çfarë je dhe çfarë ke arritur.

**Estel Fype 7H**



I dashur Erind,

Vetja ime, është hera e parë që po të shkruaj një letër. Me anë të kësaj letre dëshiroj të të shpreh disa mendime dhe ndjenja të sotme. Kam besim se fjalët e shprehura në këtë letër do të mbeten të gdhendura në të e do të shndërrohen në yje që do të ndriçojnë mendjen time edhe në vitet që do të pasojnë.

Do të dëshiroja, që kur të mbush 35 vjeç e të lexoj këtë letër, të ndihem krenar me veten time. Të ndihem krenar, që ëndrrat e mia fëmijore për t'u bërë një njeri i mirë, besnik dhe i ndershëm në çdo dimension, si dhe një profesionist i talentuar, më në fund janë bërë realitet. Për realizimin e këtyre ëndrrave, ti vetja ime do të jesh dëshmitarja e parë, ndër mijëra dëshmitarëve të tjerë, që do t'i japin jetë karrierës sime. I tillë do të jetë dhe profesioni im. S'ka rëndësi prokuror apo gjykatës, unë do të jem i drejtë me drejtësinë deri në pafundësi dhe ti vetja ime do të jesh udhërrëfyesja ime e vetme.

**Erind Hysaj 7H**



E dashur Elsina,

Tani je bërë një femër e pjekur dhe e përgjegjshme. Duhet të jesh prapë me të njëjtin karakter që ke qenë para 23 vjetësh; e qetë, e matur dhe që nuk ndikohesh nga të tjerët.

Vallë i ke harruar ëndrrat e tua kur ke qenë fëmijë? A e mban mend ëndrrën për t'u bërë një doktoreshë shumë e zonja? Po premtimet që i ke bërë mamit dhe babit? Shpresoj t'i kesh realizuar të gjitha. Po ta shkruaj këtë letër, për të të



dhënë disa këshilla me syrin e një 12 vjeçareje. Tashmë ke arritur një moshë, ku të gjitha janë arritur; familja dhe karriera. Duhet të çash sa më shumë përpara, për të mirën tënde, duhet t'ia dalësh ashtu si ia dolën prindërit e tu. Kjo botë është sakrificë, asgjë nuk është gati, askush nuk interesohet aq shumë sa thotë për ty. Asnjëherë, për asnjë arsye, mos e humb shpresën për t'ia arritur, për t'u bërë ajo që ti do. Gjithmonë mos harro ata dy njerëzit që sakrifikuan veten e tyre për ty. Ata që kurrë nuk i thanë JO, asnjë dëshire tënde, edhe kur ishin të panevojshme. Ata që të arsimuan për t'u bërë kjo që je. Gjithmonë duhet të jesh me ëndrrat dhe shpirtin e fëmijës së dikurshme!

**Elsina Buzi 7H**



E dashur Keltjona,

Pyes veten se mos vallë karakteri yt ka ndryshuar, apo se si dukesh nga pamja e jashtme. Gjithsesi, këtë letër po ta shkruaj për të të dhënë, ose të paktën për të të thënë, disa gjëra siç i mendoj apo i shoh unë me syrin e një fëmije edhe pse tashmë nuk jam më aq e vogël.

E mban mend atë ëndrrën që e vogël për t'u bërë juriste? Po pra, atë premtimin që i dhe gjyshit tënd që kur fillove klasën e parë? Mendoj se duhet t'ia arrijmë këtij qëllimi, ose edhe sikur t'ia kemi arritur të përmirësohemi sa më shumë. E di që ai është momenti i përshtatshëm për të krijuar familje, por unë dua t'i përkushtohesh karrierës. Jeta është e gjatë, prandaj nuk ka asnjë problem. Ka kohë për t'ia bërë të gjitha. Nëse ti, apo ne, le të themi, arrijmë të çajmë përpara dhe krijojmë kushte të mira për të jetuar, të gjitha vijnë vetë. Ah po, se mos harroj edhe një gjë të fundit: Mos harro të kujdesesh për familjen tënde. Kurrë, po kurrë mos harro, se ishin ata që të sollën deri këtu. Edhe nëse tani je një njeri i mirë në jetë e je bërë dikushi, kjo ndodhi vetëm falë tyre. Ishin ata që të dhanë mundësi kaq të mira arsimimi, të edukuan dhe të rritën...

**Keltjona Shpata 7H**



I dashur Rubin,

Ti mund të jesh duke e lexuar këtë letër ose edhe jo, nuk i dihet. Në kohën kur ta lexosh, jam shumë i sigurt, që do të kthehen shumë kujtime të bukura pas. Do jesh rritur goxha, do të kesh kuptuar më mirë se ç'është e mira dhe e keqja. Kushedi se ku mund të jesh ose dhe me kë. Shpresoj shumë që t'ia kesh arritur qëllimet dhe dëshirat më të zjarra. Në moshën 35 vjeçare, shkollën do ta kesh mbaruar dhe mund të kesh krijuar një familje. Për të arritur në moshën tënde, më duhen edhe 22 vite. Kështu që, për 22 vite, do të krijoj disa kujtime të paharrueshme. Ndihem shumë i lumtur që të shkruajta këtë letër. Me të vërtetë, më shumë për ty, mendoj që kjo letër është e rëndësishme edhe për mua. Një kujtim i bukur.

**Rubin Musta 7**

E dashur Martina,

Si je? Si është jeta? Shpresoj të jesh mirë me shëndet. Së pari uroj që kur ta lexosh këtë letër të jesh mirë emocionalisht, mos të të dridhen duart e mbi të gjitha mos të të vijnë në mendje ide të çuditshme. Është thjesht një letër që e ke shkruar ti në moshën 12 vjeçare.

Je e rrethuar me njerëz që i do dhe që të duan, që të falin mirësi në jetën tënde. Besoj se tani je duke jetuar në Amerikë, në një qytet plot lëvizje dhe gjallëri si Neë Yorku.

A i ke realizuar të gjitha ëndrrat e tua? A je bërë një modele dhe stiliste e famshme? Po studimet për arkitekturë i ke vazhduar? Më vjen keq që po të bëj kaq shumë pyetje, por jam shumë kureshtarë për të ardhmen time. Besoj se je duke e jetuar jetën ashtu siç ke ëndërruar gjithmonë.

E dashur vetja ime 35 vjeçare, këto kisha për të të thënë. Nuk pres dhe nuk dua përgjigje. Të uroj shumë suksese dhe lumturi. E jotja përgjithmonë! Martina.

**Martina Shkoza 7H**



E dashur Nensi,

Po të shkruan vetja jote 12 vjeçare. Dua të di si je? Si duket e ardhmja ime? Këtej nga fëmijëria jote gjërat e bukura nuk kanë fund. Çdo ditë, sapo sytë e mi hapen, nën trurin tim idetë e reja gurgullojnë. Shpresoj që dhe ty të të ndodhë e njëjta gjë. Gjatë rrugës për ne shkollë, po vështroja një të varfër dhe pa e menduar dy herë e ndihmova. Shpresoj që edhe ty të mos të të jetë zhdukur zemërgjerësia. Në klasë dy djem trazovaçë po më ngacmonin, por unë prapë i fala. Shpresoj që toleranca brenda teje të ekzistojë akoma. Fjalë jo të bukura përplaseshin në veshin tim, por unë i mbyllja veshët me duar dhe nuk i dëgjoja. Shpresoj që edukata të jetë ende një lule e lulëzuar brenda teje. Sapo erdha në shtëpi një përqafim të madh i dhurova prindërve. Shpresoj që dashuria të jetë ende një çelës në dyert e zemrës tënde. Mbas një dreke të mrekullueshme nga duart e arta të nënës sime, u ula te bëj mësimet. Shpresoj që disiplina të jetë ende një pjesë e jotja...

Më shkruaj sa më shpejt. Të uroj gjithë të mirat dhe mos harro se njëherë e një kohë ke qenë një fëmijë i lumtur, pa djallëzi, i mbushur plot e përplot me planet e së ardhmes. Mos më thuaj që i ke harruar!

Me dashuri Nensi, vetja jote 12 vjeçare.

**Nensi Mëçalla 7H**

*Klasat e 6-ta*



E dashur Ambeta,

Bota ime 12-të vjeçare është e veçantë! Familja ime përbëhet nga 6-të pjesëtarë, mami, babi, dy motrat, unë dhe vëllai i vogël, Megli.

Megli, na lumturoi jetën kur lindi, sepse pas 3 vajzash më në fund u bëmë me një vëlla, që e kishim pritur prej kohësh, e gjithë familja. Ai grindet shumë me mua, por gjithsesi ai është jeta ime. E dua pafund atë, më shumë se veten.

Nejse, familja ime për mua është gjithçka. Prej saj, kam shëtitur botën rreth e përçark. Babi dhe mami im, pothuajse m'i kanë plotësuar të gjitha dëshirat, ama nuk më kanë 11astuar, si ndonjë vajzë tjetër. Më kanë mësuar me një kulturë të veçantë, të cilën do ta zbatoj gjithë jetën time, deri në fund. E vërtetë, që babai im nuk të toleron në mësim, ama për mua është kënaqësi, sepse edhe unë të isha në vend të tij, të njëjtën gjë do të bëja.

Me kënaqësi them, se për familjen time jap edhe jetën!!!

**Ambeta Çupi 6A**



Përshëndetje Arlis,

Unë tani jam një 12-të vjeçar.

Kur të rritem, dua të bëhem doktor. Unë i kam vënë qëllim vetes, që të mësoj, të bëhem dikushi në jetë. Pa shkollë nuk ke ku të shkosh. Një nga pasionet e mia është futblli, por nuk dua ta ndjek dhe të bëhem profesionist, sepse synimi im i vetëm është të mësoj dhe dhe të kem vullnet për të mësuar, që të bëhem një doktor i mirë. Dëshira ime, që të bëhesha doktor lindi vetëm, kur unë isha 6-të vjeç dhe theva krahun. Aty vendosa të bëhesha doktor, sepse mënyra më e mirë për të shpëtuar njerëzit nga sëmundjet, është ky profesion. Dua të bëhem ortoped. Ortopedi për mua është një nga doktorët më të rëndësishëm, në një spital, pasi trupi ka shumë kocka. Kur theva krahun, para se ta fusja krahun në allçi ishte çasti më i vështirë për mua. Aty e kuptova, se njeriut përveç, Zotit i duhet edhe një njeri, që ta mbështesë në këtë jetë dhe pikërisht, ky njeri është doktori. Vetëm diçka do të kem parasysht, kur të rritem, pacientit tim do t'ia kthej përgjigjen e prerë dhe nuk do ta mbaj me shpresa të kota. Kur është keq, ai do të mërzhitet jashtëzakonisht, por kjo gjë ka edhe diçka të mirë, sepse ai do t'i japë vullnet vetes të mos mërzhitet, sepse ajo është në dorën e Zotit. Dëshiroj që ta trashëgoj tek pasardhësit e mi, që të jemi një fis i njohur për kockat. Studimet do t'i vazhdoj jashtë vendit, sepse Shqipëria nuk të jep asnjë lloj mundësie në këtë rrugë. Unë në shkollën e lartë do të jap maksimumin, që të marr rrezultate pozitive dhe të filloj punë direkt pas shkolle. Në atë vend, ku do të shkoj do të marr rreth 2 vjet eksperiencë dhe më pas do kthehem në Shqipëri, që të punoj një nga spitalet më të mira në Shqipëri.

Me shpresën te Zoti, dua që kjo ëndërr të më realizohet.

**Arlis Arapi 6A**



Përshëndetje Marla,

Kur të jem 35-së vjeç, do të kem krijuar familjen time dhe do të përpiqem të jem një mama trendy. Megjithëse, nuk i paragjykoj prindërit e mi, unë do të ndryshoja shumë gjëra në raport me fëmijët e mi. Para çdo gjëje do të preferoja që ata të ishin të lumtur dhe do të kenë mbështetjen time në çdo gjë pavarësisht gabimeve të tyre.

Gjithsesi askush nuk mund të parashikojë jetën e tij. Kushedi çfarë më del para. Ndoshta do të jem e realizuar në karrierë. Një aktore e suksesshme, që do të thotë të kem realizuar ëndrrën time, por jo të prindërve të mi.

**Marla Kazani 6A**



E dashur Romina,

Kjo që po shkruan je ti, e vogël, 12-të vjeçe. Unë tani po të shkruaj disa gjëra, që nuk besoj se ke për t'i mbajtur mend. Si fillim, shpresoj të jesh bërë një grua e suksesshme, me një familje të lumtur. Këtë vit je në klasë të gjashtë. Shkolla u vështirësua pak e nga pak, por ti vazhdove të mësoje dhe arrite rezultate të kënaqshme për prindërit. Tani ti, do të jesh rritur dhe po mban këtë letër në dorë për ta lexuar. Në klasë të gjashtë krijove shoqëri të reja dhe më të forta. Ndoshta tani që po mendon po thua se disa nga këto janë budallallëqe, por disa besoj se mund t'i mbash mend vete.

Me Dashuri Romina.

**Romina Gjana 6A**



Përshëndetje Sardi,

Mua më pëlqen shumë që të krijoj gjëra në mënyrë artizanale. Kur isha i vogël, vija gjëra të bashkuara me njëra-tjetrën dhe mendoja se kisha krijuar diçka. Tani që jam rritur, mendoj t'i krijoj gjërat më mirë dhe projektet e mia po marrin jetë. Tani është Viti i Ri dhe unë dua të krijoj diçka speciale për vëllain tim. Unë jam i mirë edhe në vizatim. Që i vogël, mamaja më thoshte, se arrija të shpreheshja më shumë me vizatim, se sa me fjalë. Kjo dëshirë vazhdoi të rritej dhe tani piktura zë vendin më të rëndësishëm dhe ka prioritet në jetën time. Unë vazhdoj ta shoh jetën me shumë ngjyra, si me sytë e një fëmije, kjo gjë reflektohet edhe në punimet e mia, ku nuk mungojnë të shtatë ngjyrat e ylberit. Mund të shkruaja rreshta pa fund, për veten time, por nuk më ka pëlqyer kurrë t'i bëj qefin vetes. Kur të shikoj veten time në pasqyrë, do të kenë kaluar të tridhjetat e mia. Do të më kujtohet, ai djali i vogël, që kishte shumë ëndrra. Jam i bindur se një pjesë e tyre janë realizuar.

**Sardi Molla 6A**





E Dashur Daris!

Po të shkruaj me shumë mall. Dua të të pyes për gjithçka; për gjërat që tani në të tashmen duken të paarritshme dhe të arritshme në të ardhmen; për familjen tënde dhe timen njëkohësisht; nëse ia ke dalë të realizosh ëndrrat, që ke pasur, kur ke qenë e vogël dhe....

Dua, që kur të lexosh këtë letër të kesh parasysh veten tënde 11-të vjeçare. Sa do të arrish ta mbash mend?? Të kujtohet, kur ishe e vogël, që përhumbje në botën tënde shpirtërore, pastaj detyrohesh t'u ktheheshe detyrave të shtëpisë? A e mban mend, sa dëshirë ke patur të ishe e famshme? Bëje vazhdimisht plane, se çfarë do të bëheshe? Më thuaj, a janë realizuar këto ëndrra? Më duket e tmerrshme të mendoj, se ëndrrat i ka marrë era. A e mban mend sa dëshirë kishe të bëheshe aktore dhe modele? Sa ka përparuar teknologjia? Vë bast, se ka arritur kulmin. Ka dalë telefon S200? Po mami dhe babi, si janë? A i viziton ndonjëherë? Vizitoi se mërzhiten dhe i merr malli për ty dhe fëmijët. Po fëmijët si janë? Sillu mirë se ti e di, si kuptojnë fëmijët, me të urtë e me të butë. Këtu po e mbyll dhe po të dërgoj një buzëqeshje të madhe Me shumë dashuri,

**Daris Nasko 6A**



Po e hap këtë letër me një përshëndetje

Dua të të them, si ke kaluar?

Unë tani jam 12-të vjeç, nuk mund të them, që jam e rritur plotësisht, por nuk e shikoj veten më si një fëmijë i vogël. Kam hyrë në mendime për veten time 35-së vjeçare. Kam shumë dëshira, por nuk e di, nëse të janë plotësuar. Doja të të pyesja për disa dëshira që kam patur. A je bërë një grua e fortë? A e ke jetën që ke dashur gjithnjë? A e ke më shoqërinë që ke pasur? Do të doja të dija më shumë rreth pamjes tënde, do të doja të dija nëse je bërë një modele, siç ke dashur. Dëshirat e mia nuk kanë fund, por më mirë le ta zbulojë koha, kur të vijë çasti i duhur.

Me dashuri, Sara ZHELEGU, 12-të vjeçare.

**Sara Zhelegu 6A**



Përshëndetje Korin,

Kur unë të mbush 35-së vjeç do të doja të kisha, 1 ose 2 vila private, 2 ose 3 makina personale. Mendoj se atëherë do të kem një klinikë private, sepse kur të rritem, unë dëshiroj, që të bëhem doktor. Besoj, se tani ti ke dhe një jaht të madh. Por më e rëndësishmja është që të bëhem i suksesshëm.

**Korin Harizaj 6B**



Përsëndetje Enes!

A t'u realizuan ëndrrat? Si është të jesh i madh? A je i realizuar në karrierën tënde? Sa të madhe e ke shtëpinë? Ku jeton në Shqipëri apo jashtë? A ke qen, mace ose ndonjë kafshë tjetër? Si është më mirë të jesh i vogël apo i madh? Je bërë youtube rendes, shpresoj.

Shpresoj të kesh një familje të bukur inshAllah.

Pafshim! Shihemi, kur të jesh 35-së vjeç.

Të përqafoj, Enes Toci, i vogël.

**Enes Toci 6B**



Ç'kemi Ester,

Si je? Shpresoj të jesh mirë. Si të shkon jeta, mirë? Besoj, se do të habitesh, kur të lexosh këto që ke shkruar, si një 11-të vjeçare.

Do të qeshësh, po po, do të qeshësh duke qarë. Besoj, se tani ti, ke një punë të mirë. Ke një kompani të madhe, siç ke ëndërruar gjithmonë. Mendoj, se ti tani ke familjen tënde. Ke një vajzë me emrin Seda dhe një djalë me emrin Kerem. Vajza është me flokë të gjata kafe dhe sy kafe, ndërsa djali me flokët e verdha dhe sy të kaltër. Ti gjithmonë ke dashur t'i kishe sytë e kaltër. Të përqafoj,

**Ester Lamçe 6B**



I dashur Alenis,

Unë jam Alenisi i vogël që po të shkruaj. Kemi shumë për të folur bashkë. Dua të të flas për dëshirat, për pasionet e mia. Unë çdo ditë punoj shumë që të bëhem dikushi në jetë. Dëshira të shumta kam, por jam i vetëdijshëm, që nuk do t'i realizoj të gjitha. Jam shumë kurioz të di: A do t'i realizoj ato? Gjatë viteve do ta zbulojmë. Gjatë këtyre viteve, kam shumë dëshirë të mbetem ai Alenisi fëmënor brenda, por me njohuri të reja. Kur ta lexosh këtë letër, ndoshta ti do të ndiesh emocione të ndryshme. Shpresoj t'i kesh arritur të gjitha ëndrrat e tua dhe të jesh i zoti në jetë!

Me dashuri, i vogli brenda teje,

**Alenis Ivanaj 6B**



E dashur Klea,

Nuk di nga t'ia filloj, kam aq shumë pyetje për ty. Si fillim; Si je? Çfarë pamjeje ke marrë me kalimin e viteve? Zgjedhe të jesh aktore, apo të kesh biznesin tënd? Them, se je e rraskapitur nga udhëtimet e shpeshta që bën. Po shtëpinë që doje në Paris e ke blerë? Sidoqoftë, jam më se e kënaqur që menaxhon më së miri kohën që shpenzon në punë dhe kohën që kalon me familjen. Për pak



harrova! Po shoqet e fillores; Martinën, Emën e Alesian, me të cilat ndaje çdo gjë a i takon më? Pyes veten; a të ka marrë malli për fëmijërinë tënde? Apo është më mirë të jesh e rritur? Më duket se po të marr shumë kohë prandaj po e mbyll këtu, ama dije se të uroj shumë fat në jetë.

Me shumë dashuri,

**Klea Shameti 6B**



E dashur vetja ime!

Tani që po të shkruaj jam ulur në krevatin tim. Kur ti të lexosh këtë letër ndoshta do të jesh 35-së vjeç. Ti mund të kesh krijuar familje, ndoshta ke dhe fëmijë. Mund të jesh larguar nga vendi yt, ndoshta je nga ana tjetër e botës. Tani ti mund të jesh duke u kthyer nga zyra jote ligjore ose nga studioja jote e pikturës. Do të isha shumë krenare për ty, nëse do të jesh bërë një nënë e përkushtuar dhe një grua e aftë dhe e suksesshme. Mundohu të jesh më e matur, në fjalët që thua. Shijoje jetën me të gjitha të mirat dhe të këqijat e saj. Qesh sa më shumë që të mundesh. Sillu si vetvetja, sepse të gjithë të duan më shumë siç je në të vërtetë.

Nga, Anja Korbi, 12- të vjeçare.

**Anja Korbi 6B**



Përshëndetje, Esli!

Bota tani më duket shumë e bukur dhe me shumë njerëz të sjellshëm. Punët më duken shumë të thjeshta. Puna në zyra, thonë, që ka shumë lodhje, por unë mendoj të kundërtën. Pastaj dhe rritja e fëmijës është shumë zbatimëse dhe aspak e lodhshme. Të paktën mua kështu më duken. Unë për vete kështu do t'i rris ata çamarrokët e mi të vegjël, të cilët do t'i quaj Ruanda dhe Anuari. Mirupafshim! Pas ca vitesh,

**Esli Qefalia 6B**



E dashur Ema,

Sot që po të shkruaj jam 35-së vjeç. Jam e rritur tashmë dhe nuk merrem me punë të kota. Ke mbaruar universitetin dhe ke një punë shumë të mirë. Ti mban mend shokët e shoqet e tua të fillores. Fatmirësisht i kujton nga fotot e shumta që ke në shtëpi. Po ashtu, edhe shoqet e tua të ngushta. Sigurisht që i ke akoma shoqe të ngushta, Klean, Martinën dhe Alesian. Mësuesit dhe



mësueset nuk besoj se i mban mend të gjithë, pasi ke pasur shumë. Të vetmen, që mban mend, është mësuese Mirela. Ajo të ka dhënë katër vite rresht mësim dhe ishte mësuesja jote e preferuar. Më pas ke pasur edhe mësuese të tjera, që të kanë mbetur në mendje. A e mban mend kur doje të bëheshe kërcimtare? Fatkeqësisht nuk je bërë e tillë, por e ke akoma pasion. Ti tashmë je një stiliste e famshme në të gjithë botën, të gjithë flasin për ty. Dashuria për këtë profesion lindi dalëngadalë dhe u forcua nga pasioni dhe puna e madhe. Unë mendoj, se ne ia kemi arritur qëllimit tonë falë përkushtimit dhe punës sonë të palodhshme.

E jotja,

**Ema Sadiku 6B**



E dashur Klara!

Një nga dëshirat e mia është, që të bëhem stiliste dhe të kem një studio të famshme dizenjimi. Mua më pëlqen të bëhem edhe arkitekte që të bëj pallate madhështore. Unë kam edhe pasione të tjera, siç janë kërcimi e këndimi të cilat i adhuroj shumë. Do të dëshiroja, që këto dëshira të më plotësohen në të ardhmen. Deri atëherë, duhet të mësoj shumë dhe të vazhdoj kështu, në këtë rrugë pa pengesa.

Me dashuri,

**Klara Elezaj 6B**



I dashur Noel!

Unë jam një nxënës shumë i mirë në mësimet, sidomos në lëndën e matematikës. I kam shumë qejf sportet, sidomos futbollin dhe basketbollin. Filmi im i preferuar është "Sfungjer Bob pantallon katrori". Kur të rritem, unë dëshiroj shumë, që të jem biznesmen i një biznesi të madh. Ky jam unë 11-të vjeç. Shihemi në të ardhmen.

**Noel Kraja 6B**



E dashur Sonia!

Dua të të tregoj disa gjëra. Unë kam një ëndërr: Të bëhem një avokate e zonja. Dua që të gjithë, kur të kenë nevojë, të vijnë tek unë. Kjo është një nga ëndrrat e mia më të rëndësishme. Ëndrra tjetër, është që të ndihmoj njerëzit e varfër këtu në Shqipëri. Dua të studioj në shkollat më të mira jashtë shtetit dhe të dal e shkëlqyer në mësimet. Përveç këtyre, kam edhe disa pyetje për të të bërë. A ke formuar familjen tënde? A ke ndryshuar shumë? Besoj, që shkollën e lartë



e ke mbaruar. A të janë bërë të gjitha ëndrrat e fëmijërisë realitet? A i mban mend shokët dhe shoqet e klasës bashkë me mësuesen, që ke pasur në fillore? A ke zënë shokë ose shoqe të rinj? Uroj, që të gjithë gjërat e mira, të të kenë ndodhur në jetë. Paç fat, në jetën e mëtejshme!

Me mall e dashuri,

**Sonia Lika 6B**



I dashur Tedi,

Shpresoj, që të kesh arritur gjërat, që ke dashur, kur ishe 11-të vjeçar, tani që je 35-së vjeçar.

Shpresoj, që të kesh mbaruar shkollën me rezultate të larta dhe të kesh studiuar në një shkollë shumë të mirë jashtë shtetit. Të kesh krijuar emrin tënd në këtë botë dhe të kesh një karrierë të mirë. Gjithashtu, shpresoj që akoma të gesh kohë në ditën tënde për të bërë gjërat që pëlqejë kur ishe 11-të vjeç si: sportet, videolujërat etj. Duhet të kesh shokë dhe t'i kesh pranë në kohë të vështira. Të jesh kujdesur dhe të kujdesesh për familjen.

Në qoftë se ke arritur të gjitha këto, e di se ke pasur dhe do të kesh një jetë të mirë.

Shihemi pas ca vitesh,

**Tedi Xhiani 6B**



Përshëndetje!

Unë 35-së vjeçe,

Sot, që po të shkruaj jam 12-të vjeçe, në klasën e gjashtë. Pasionet e mia janë basketbolli dhe gatimi. Të gjithë m'i lëndojnë gatimet, por në syrin tim nuk janë siç duhen. Shoqet e mia të ngushta janë në një klasë me mua dhe ne ia tregojmë çdo gjë njëra-tjetrës. Kur të jem 35-së, familja ime do të jetë e kompletuar dhe do të kem 2 fëmijë, që më duan dhe i dua. Do të jetoj në Tiranë, afër shtëpisë së prindërve të mi dhe do të kem një shtëpi të ngrohtë dhe dashamirëse. Mendoj, se do të vazhdoj si ekonomiste dhe do të kem hapur një fondacion në ndihmë të fëmijëve në nevojë. Me dashuri,

**Vikena Mera 6B**





I dashur Marini i madh,

Ti tani je rritur, ke mbushur 35-së vjeç dhe me siguri ke plotësuar ëndrrat e tua të realizimit të studimeve me rezultate shumë të larta. Gjithashtu, duhet të jesh duke punuar në ndonjë zyrë administrate, apo diku në ndonjë institucion, ku kontribuon në zhvillimin e profesionit tënd. Në këtë moshë besoj, se do të kesh krijuar familjen tënde, e cila të ka dhuruar fëmijë të vegjël, të porsalindur ose në vitet e para të jetës së tyre. Të kujtoj të mos harrosh kujdesin, që patën prindërit e tu, që ti të rriteshe në kushte të mira dhe të përqëndroheshe në rezultate të mira në të gjitha etapat e shkollës, që ke bërë. Prindërit e tu zgjodhën shkollën "Turgut Özal", si një nga shkollat më të mira të kohës. Ashtu sikurse, edhe ti, jam i sigurt, që do të kujdesesh për fëmijët e tu në mënyrë, që ata të rriten të shëndetshëm e të kenë rezultate dhe suksese në shkollat më të mira të kohës, ku po jeton. Gjithashtu, të kujtoj të kushtosh gjithmonë vëmendje prindërve të tu, që tashmë do të jenë bërë gjyshër e me shumë dashuri do të gëzojnë nipërit e mbesat e tyre me përkujdesje të veçanta, ashtu sikurse edhe gjyshërit e mi sot bëjnë po të njëjtën gjë. Është thelbi dhe qëllimi i jetës krijimi i një familjeje, rritja e fëmijëve të shëndetshëm e të shkolluar si edhe puna plot pasion e dëshirë, që të sjell jo vetëm të mira materiale për të jetuar, por edhe kontributi për zhvillimin e jetës në përgjithësi. Në këtë stafetë brezash, hallkë e të cilës edhe ti je, uroj që të lësh gjurmë të mira në brezat e pasardhësve e të të afërmeve të tu në përjetësi. Me dashuri Marin Stratoberdha, i vogël.

**Marin Stratoberdha 6B**



E dashur Ema,

Tani që po të shkruaj, është nëntor dhe për 12-të ditë mbush dymbëdhjetë vjeç. Jam shumë e emocionuar, pasi do të shpoj veshët për herë të parë. Unë jam shumë mirë dhe mendoj të jem kështu, edhe pas 23 vitesh. Të hënë, ishte dita e "Halloween", të cilën e thërras hallë e Vinit. Ishte ditë e këndshme, por prita shumë, për shkak të mbledhjes me prindër. Shpresoj, që edhe ti të mos presësh gjatë. Kam shumë ëndrra të cilat dua t'i arrij, por prindërit më thonë të jem me këmbë në tokë. Ndonjëherë, s'i kuptoj dot të rriturit!! Mezi pres të fle te shtëpia e re e motrës sime. Nga fotot pashë se ishte mobiluar bukur. Tani po të lë!!! Pafshim!!!

**Ema Koka 6C**



Përshëndetje Ardion,

Unë, tani jam 11-të vjeç. Mua më pëlqen shumë arti dhe sporti. Sporti im i preferuar është futbolla. Skuadra ime e zemrës është Milani. Gjithashtu, më pëlqen të lexoj libra jashtëshkollorë. Jam një djalë, 1 metër e 66-të centimetra dhe peshoj 60-të kg. Unë jam shtatlartë dhe i fortë fizikisht. Jam me flokë të zeza. Gjithashtu, jam një nxënës i mirë.

Po t'i shkruaj këto, që të kujtohesh për të shkuarën tënde, që të krahasosh të shkuarën me të tashmen tënde.

Nga vetja jote,

**Ardion Duçkollari 6C**



E dashur, vetja ime!

Si je? Si po ia kalon?

Unë jam në shkollë dhe po mësoj. Sa do të doja, të isha si ty që nuk ke shkollë. Kur të rritem, dua të bëhem president. Unë këtu kënaqem me shokët. Po ti, a po punon? Shpresoj të mos jesh pushuar nga puna, se pastaj do të ishte shumë keq. Gjithsesi, unë do të shkoj në Bosnjë dhe do të kënaqem. Shpresoj të kesh një celular, që kur të kem nevojë për ty të të kontaktoj. Edhe unë do të kem një celular të madh. Tani mësimet janë bërë të vështira. A të të bëj një pyetje? Si e kalove klasën e nëntë? Po universitetin? Duhet të kishe qenë i zgjuar, sepse ato janë të vështira. Sa shumë gjëra po mësoj nga ty. A do të m'i thuash gabimet që ke bërë në klasë të gjashtë, që mos t'i bëj gabim si ti? Shpresoj të takohemi!

**Amel Sula 6C**



Përshëndetje!

Besoj, se je rritur tashmë dhe je duke punuar. Me siguri, si parukiere ose menaxhere. Ke pasur pasion, dy profesione në fëmijëri dhe me siguri po ndjek njërin nga ata. Epo, tani je rritur dhe një familje të ngrohtë e ke krijuar. Ndoshta dhe një kafshë shtëpiake e ke marrë, me siguri një qenush të vogël që edhe nëse je mërzhitur e kalon kohën me të. Me siguri kjo letër i ka rënë në dorë njërit prej fëmijëve të tu, të cilët po kërkonin lodrën e tyre dhe më pas pyesin: "Mami, mami çfarë është kjo?" Ti më pas e hap këtë letër dhe kujton fëmijërinë tënde, me shoqet e tua të ngushta si Livia, Altea dhe Jona. Vazhdon të lexosh dhe çdo gjë të duket, sikur ka ndodhur dje. Ti këtë letër ua lexon fëmijëve të tu, me shumë emocione. Më duhet ta mbyll këtë letër, sepse më duhet të studioj. Mirupafshim!

**Ersja Hoxha 6C**



Ç'kemi Alesia,

Si je? Unë jam shumë mirë, shpresoj të jesh edhe ti. Mami dhe babi janë shumë mirë dhe mendoj se janë aty ku je ti. Ti, si shkon me punën? A je ajo këngëtarja dhe aktorja, që unë mendoj? A je martuar? A e ke atë vajzën e bukur me emrin Aisela? Po atë shtëpinë gjigande e ke? A jeton në Kanada? Shpresoj që të gjitha gjërat të jenë, siç unë mendoj.

Tani të të tregoj pak për gjërat që po ndodhin këtu. Klevi është në parashkollor, por mendoj se s'do t'i pëlqejë fare shkolla. Që tani ka filluar e bën naze, se s'do të bëj ato pak detyra që ka ai. Elta është në Kanada, sepse po studion për arkitekturë. Klea si gjithmonë shumë e përkushtuar në mësimë, celular dhe kompjuter. Mami po mban një dietë që ia ka dhënë një italiane. Babi si gjithmonë punon shumë dhe nëna është në Francë tek tezza. Tani jam në klasë të gjashtë. Mësuesja kujdestare quhet Desdemona, që është mësuesja e fizikës dhe shoqja ime e ngushtë është Isla. Mësuese Desdemona më pëlqen shumë. Ajo ka një djalë, sa Lieli. Në shkollë është organizuar konkursi i këngës, që është organizuar për çdo vit. Deri tani është zhvilluar faza e parë dhe e dytë dhe unë kalova. Tani, po përgatitem për finale, që është më datë 16-të, kur Lieli bën 10 muajshe. Këtë vit në shkollë organizohen më shumë projekte, se vitet e tjera. Ne bëjmë nga një projekt për çdo lëndë. Nesër duhet të përgatitem për projektin e matematikës. Dua shumë, në festën e 28-29 Nëntorit, të jem unë një nga solistet. Mirë, tani po e mbyll, por mos u mërzit, sepse jam e sigurtë se do të flasim përsëri.

Me dashuri Alesia Pulti 11-të vjeçare.

**Alesia Pulti 6C**



E dashur Jona,

Kur unë të jem 35-së vjeçare, do të kem mbaruar shkollën me rezultate të larta. Do kem ndjekur hapat e vëllait tim duke u bërë një biznesëoman e famshme. Dua që të hap një biznes të veçantë, në të cilin unë mund të fitoj shumë dhe me të ardhurat që fitoj, veç familjes sime, unë të ndihmoj edhe njerëzit në nevojë. Kam shumë dëshirë të shikoj dhe të udhëtoj rreth botës, sepse ka shumë gjëra të reja për të eksploruar, për të parë e provuar. Dhe këto aventura dua që t'i realizoj me njerëzit e afërt, që i dua e më duan shumë. Mendoj se pushimet e verës do t'i kaloj në vende të bukura turistike, sidomos në vendet ku mund të mësojmë më tepër nga historia, traditat dhe kultura e popujve të ndryshëm nëpër botë.

Unë, kur të kem fëmijët e mi, do të bëj më të mirën që ata të kenë një arsim të mirë, por sidomos, që të jenë të lumtur e të dashur me njëri tjetrin, me fëmijët dhe të gjithë njerëzit.

Më shumë dashuri për ty.

**Jona Nuredinaj 6C**





E dashur Ketlin,

Unë dua të të rikujtoj një pjesë nga fëmijëria jote. Unë tani, që jam 11-të vjeç, pëlqej të këndoj. Seriali im i preferuar është, "Violetta". Po ashtu, më pëlqen vizatimi, basketbolli, volejboli, etj. Në shkollë kam shumë miq, që më duan dhe i dua. Lëndët e mia të preferuara janë matematika, fizika, vizatimi dhe aftësimi. Mësuesja e re kujdestare, Desdemona, është shumë e mirë bashkë me mësueset e tjera. Notat e mia në shkollë janë të mira. Në basketboll kam shoqe shumë të mira, gjithashtu. Kam lënë, gjënë më të rëndësishme, pa të thënë familja. Ajo është më e mira në botë, për mua. Kam dy motra të vogla, çapkëne, që më argëtojnë dhe më dhurojnë dashuri. Vëllai i madh është, ai që më mbron dhe më përkrah në çdo situatë. Ai, që më shton të qeshurën dhe lumturinë. Mami është një person shumë i rëndësishëm, sepse më rrit, më mbulon me dashuri. Ajo është si një shoqe për mua, që më lejon të flas lirshëm dhe të shpreh ndjenjat me të. Ajo më do për atë që jam dhe nuk më lë kurrë pas dore. Babi është po ashtu shumë i rëndësishëm, pasi ai lodhet për të më rritur, edukuar mua dhe për të më ushqyer. Ai më shton gëzim në jetë dhe përkujdeset shumë për mua. Gjyshet dhe gjyshi janë shumë të mirë, ata më argëtojnë shumë dhe më përcjellin kulturën. Me historitë e tyre nuk ngopem kurrë të dëgjuari. Shpresoj që të kesh katër fëmijët e tu dhe ta kesh gjetur princin tënd të kaltër. Gjithashtu, ta kesh realizuar ëndrrën për t'u bërë doktoreshë ose bizneswoman dhe të ndihmosh njerëzit në nevojë. Shpresoj, që të kesh ruajtur sineritetin dhe miqësinë tënde dhe mos të jesh mposhtur nga egoizmi i të tjerëve.

Të uroj fat në jetën tënde,

**Ketlin Marku 6C**



I dashur Aleks,

Si je? Me shëndet mirë? Si është jeta jote tani? Shpresoj, të kesh gjithë të mirat! Unë jam Aleks në klasën e gjashtë në shkollën "Turgut Ozal". Po të flas për fëmijërinë që po kaloj. Kjo fëmijëri është e bukur sa më s'ka. Me shokë të mirë, me kushte të mira dhe më e rëndësishmja me familjen më të mirë në botë. Fëmijëria, po më duket e bukur, sa shpresoj që koha të ndalë këtu, por shkolla dhe notat e mia janë për mrekulli. Nga klasa e parë deri në të pestën, kam qenë me gjitha dhjeta. Tani, jam kualifikuar në olimpiadën e matematikës. Shpresoj shumë, ta kaloj testin e dhjetorit. Përveç matematikës, të tjera lëndë, që më pëlqejnë "shumë" janë: Anglishtja, English Reading, Gjeografia, Historia, Biologjia, Fizika, Vizatimi dhe Fiskultura. Kur të rritem, dua të bëhem si babi, i cili na ka dhënë kushtet më të mira të mundshme dhe me një super familje.

Gjithë të mirat!

**Aleks Ndreu 6C**



I dashur Arlind,

Kur të jem 35-së vjeç, dua të jem një kirurg dhe së bashku me vëllain tim të kemi disa nga spitalet më të mëdhenj në Amerikë. Unë dua, që shtëpia ime të jetë në një zonë të qetë, në Amerikë. Dua që gjithmonë të rri afër me vëllain tim dhe të jetoj afër tij. Mua gjithmonë më kanë pëlqyer shtëpitë afër detit.

Nga,

**Arlind Pashaj 6C**



Përshëndetje, Arseli 35-së vjeçar,

Ti tani je rritur dhe shpresoj të kesh realizuar shumë nga ëndrrat e tua që ke pasur kur ke qenë 12-të vjeç. Nuk do të luash më me lojëra elektronike me shokët, por do të jesh i zënë me punë. Me motrën dhe vëllain më të madh, nuk do të grindesh më, por do të vraposh tek ata sa herë të kesh ndonjë problem, apo të të duhet ndonjë këshillë. Ata do të jenë të parët, që do të të gjenden pranë në çdo gëzim e sukses tëndin. Kur të kesh pak kohë të lirë, nuk do të shkosh më në kinema me mamin apo babin, por me fëmijën tënd. Do të të marrë malli për prindërit e tu, por do t'i takosh rrallë, pasi prokupimet e tua familjare e profesionale do të të marrin shumë kohë, por mos kujto se ata s'do i marrë malli për ty, përkundrazi ata do të të telefonojnë çdo ditë, për të të kujtuar, që të shkosh t'i vizitosh. Them se do të jesh po aq i ndjeshëm e i dashur, sa atëherë, kur ke qenë një 12-të vjeçar. Tani që je rritur dhe je bërë prind da ta kuptosh, se çfarë kanë ndjerë prindërit e tu për ty. Shpresoj, që çdo gjë të të shkojë mbarë, ashtu siç ke dashur gjithmonë.

Me dashuri e respekt,

**Arsel Demaj 6C**



E dashur Livia!

Po të shkruaj përsëri,

Për ty si ndoshta dikur, kur shkruaja ditarin tim. Vitet do të kenë kaluar dhe bashkë me të edhe fëmijëria ime. Gërshetat e mi të bukur, do të jenë bërë flokët e krehura të një zonje. Çanta e rëndë e shkollës, që mbaja mbi supe, do të jetë ndoshta një çantë e vogël biznesi. . . . .

E mban mend, sa herë i thojë mamin, që doje të bëheshe "bisneswoman". Shpresoj t'ia kesh arritur dhe brishtësia në fytyrën tënde feminare, të jetë kthyer në një portret të një zonje të fortë, e cila përballon familjen, punën e çdo gjë tjetër. Shpesh, shprehja dëshirën që Altea, Jona dhe Ersja të jenë pranë meje, në çdo etapë jete. Mbase ashtu si dhe ti, ato do të kenë realizuar shumë në jetë dhe shoqëria jonë të jetë më e fortë, se dikur. Mamëza ime e thinjur duke qëndisur në vendin e saj, të më presë e buzëqeshur, ashtu si dikur, kur kthehesha nga shkolla. E di, Amore nuk do të jetë më, të më presë te dera...

Ah, sa do të më mungojë! Shpresoj, me familjen time të re, ndoshta mund të ketë vend dhe për dashurinë e një kafshe shtëpiake.... Tani po e mbyll, shpresoj të takohemi shumë shpejt.  
Me dashuri,

**Livia Çaushaj 6C**



I dashur Joni,

Sa dua të mos rritem!

Ti Joni 35-së vjeçar, mund të qeshësh, të shkrihesh së qeshuri me këtë mendim. Ti Joni 35-së vjeçar, mund të bëhesh një aktor i famshëm, si ke ëndërruar në fëmijërinë tënde, por kurrë s'do të luash "MINECRAFT" në atë qoshen e preferuar të dhomës. Ti Joni 35-vjeçar, mund të takosh e të zësh shokë pafund në rrugëtimin e jetës tënde, por kurrë më, nuk do të "shkelmohesh" me vëllain, nëpër dyshemetë e katit të dytë të shtëpisë. Ti, Joni 35-së vjeçar, ke ndeshur shumë situata të lumtura deri tani, por kurrë më, s'do të provosh lumturinë e përkëdheljes së dorës së nënës e princeshës 6-të vjeçare, Aja. Ti, Joni 35-së vjeçar, do të njohësh e takosh shumë shoqe e mikështa, por do të mungojnë zënkat dhe ecejaket me Ajën buzë mbrëmjeve, nën strehën e ngrohtë të familjes. Ti, Joni 35-së vjeçar, jetoje jetën dhe kujdesu, që vazhdimin e saj ta bësh po aq të bukur, sa fëmijëria jote, po aq të ëmbël, sa përkëdheljet e mamit e motrës, po aq të fuqishme sa krahët e ngrohtë të vëllait mbi supet e tua. Ti, Joni 35-së vjeçar, qofsh po aq i lumtur, çamarrok e zemërmadh, sa dhe Joni 11-të vjeçar! Mos harro kurrë, të mbash zemrën tënde të pastër e të ngrohtë, për këdo që ke pranë.

**Joni Pashako 6C**



I dashur, Sidrit!

Sidriti 35-së vjeçar ka shkëlur rreth 1/3 e rrugëtimit të jetës së tij. Sidriti 35-së vjeçar ka mbaruar një pjesë të rëndësishme të shkollimit të tij, ka krijuar listën e miqve më të mirë, ka krijuar familjen e tij të dashur. Por ç'mund të ndiejë, Sidriti 35-të vjeçar? A mund të ndiejë po atë entuziazëm, që ndien Sidriti 12-të vjeçar, kur shënon një gol në fushë?

A mund të ndiejë po atë dashuri, që ndien Sidriti 12-të vjeçar, kur përfaqon motrën e tij të dashur? A mund të ndiejë po atë mall, që ndien Sidriti 12-të vjeçar, kur hidhet në krahët e mamasë e mbytet nga puthjet e saj magjike? A mund të ndiejë, po atë krenari që ndien Sidriti 12-të vjeçar, kur hyn babi në derë dhe ai me vrap i hidhet në qafë?!

Sidriti 12-të vjeçar e ndien se ka jetuar një fëmijëri lumturisht të bukur. Ai i uron Sidritit 35 vjeçar të vazhdojë të jetojë e ta ndërtojë të ardhmen veç mbi lumturinë e bukurinë e shpirtit të pastër e të drejtë. Qofsh i lumtur Sidriti 35 vjeçar!

**Sidrit Pashako 6C**



Vetes!

Unë quhem Vanesa Aliko. Jam 12-të vjeçe, në klasën e 6-të C dhe studioj në shkollën "Turgut Özal". Më pëlqejnë shumë filmat "Manga", sidomos "Dragon Ball Z", "Teen Titans" dhe "Sailor Moon". Në shkollë, unë ua tregoj shokëve të mi këto filma nga USB-ja ime, në orën e Informatikës. Lëndët që më pëlqejnë më shumë në shkollë janë fizika, biologjia dhe aftësimi teknologjik. Të gjitha mësueset në shkollën tonë janë shumë të mira dhe nga ana e karakterit dhe nga ana mësimore. Mësuesja jonë kujdestare quhet Desdemona Ruçi. Të them të drejtën, mësuese Desdemona më pëlqen pak më shumë se mësueset e tjera. MOS IA THUAJ NJERIU !!!! Mësuese Desdemona, na jep lëndën e Fizikës, (të them të drejtën, kjo është një nga arsyet, pse më pëlqen Fizika). E di tani, mësuese Gidiola po e lexon këtë letër dhe besoj se është disi e nxehur me mua. Këtë vit unë bëra, një shoqe të re. Emri i saj është Kaltra dhe gjithashtu ajo është shoqja ime e ngushë. Kaltra është një vajzë e sjellshme, e zgjuar dhe mbi të gjitha është dhe shumë zemërgjerë. Unë kam një motër të vogël. Emri i saj është Riana. Ndonjëherë, zihem me të, por shuuuuuummmëëë rrallë. Ajo studion gjithashtu në shkollën, ku studioj dhe unë. Riana është shumë e qetë dhe shumë e dashur, por ka diçka të keqe, Riana preket shumë shpejt. Mami dhe babi im janë të dy persona shumë të zgjuar dhe zemërmirë. Unë, kam shumë dëshirë të bëhem si ata, kur të rritem. Nga Vanesa Aliko 12-të vjeçe,  
Për Vanesa Alikon 35- së vjeçe.

**Vanesa Aliko 6C**



Përshëndetje, vetja ime 35-së vjeç!

Unë ty, të përfytyroj kështu: Besoj, se do të kesh krijuar një familje të bukur. Ti do të kesh mbaruar shkollën, me notat maksimale. Shpresoj, ta kesh mbajtur premtimin, që i ke bërë vetes, të bëhesh një arkitekthe e famshme në vendin tënd. Do të dëshiroja që pasionin tënd për pikturën, ta ruash për kohën e lirë. Do të dish të gatuash ushqim të mirë, apo jo? Shpresoj, që ta kesh realizuar ëndrrën tënde për vilën me oborr. Po ashtu, shoqet, Livian, Ersjan e Jonën, s'keni për t'i harruar. Se mos harron të marrësh një këlysh?!

Ka edhe më shumë ëndrra të tjera në sirtar, sa nuk del veç një letër për t'i shkruar ato. Por, shpresoj t'i kesh realizuar edhe ato po ashtu.

P. S. (Shpresoj, që të mos qeshësh me mua.)

Me dashuri Altea Bollano 12-të vjeçare.

**Altea Bollano 6C**



Përshëndetje Amelia,

Tani është viti 2016. Jam 11 vjeçe dhe jam akoma një fëmijë, që nuk e kuptoj botën e të rriturve. Një botë pa ngjyra, pa lojëra. E tillë që çdo ditë është një sfidë më vete. E mendoj veten shumë ndryshe kur të bëhem 35 vjeçe. Do të jem shumë e pjekur dhe do ta vlerësoj jetën siç duhet. Do të kem një jetë të lumtur dhe një familje të lumtur gjithashtu. Mendoj se do të jetë një jetë me sfida dhe vendime të vështira. Gjithmonë do të jap më të mirën time, në çdo aspekt të saj. Puna ime do të jetë arkitekthe. Do të kem një familje të lumtur. Asnjëherë nuk do të harroj të kujdesem për prindërit e mi, që do të jenë më të vjetër. Gjithmonë do të gjendem pranë tyre. Sot jam e vogël, kam ëndrra si çdo fëmijë, jeta është e papritur dhe me surpriza, por shpresoj që çdo gjë të realizohet. Tek e fundit, të gjitha këto janë thjesht imagjinatë. Bota e të rriturve është një botë e rrezikshme. Me guxim duhet t'i përballoj sfidat në çdo hap të jetës. Natyrisht, nëse gjithmonë do t'i fitoj me guxim ato, jeta ime do të jetë e qetë dhe e lumtur. E imagjinoj veten time duke e lexuar këtë letër dhe duke qeshur. Do ua tregoj dhe fëmijëve të mi, të cilët do të më shohin të çuditur. Natyrisht që atëherë të gjitha gjërat do të jenë ndryshe. Ata do të kenë lindur me një kulturë shumë ndryshe dhe fëmijëria jonë, do të jetë shumë e pakuptueshme për ta. Fëmijët do t'i edukoj në mënyrën më të mirë të mundshme. Do t'ia bëj jetën e gëzuar ashtu si edhe timen. Tashmë mendoj se duhet ta mbyll letrën time këtu. Shihemi pas 24 vjetësh.

**Amelia Duxha 6D**



Përshëndetje Aini,

Në televizor po jepet një emision për garën presidenciale në vend.

Duke dëgjuar fillova të mendoj: "Po unë kur të jem 35 vjeç ç' do bëj?"

Një mendim më shkrepri në kokë: "Do bëhem presidente! Jo kryeministre!" Do luftoj që të fitoj e të bëhem kryeministre e vendit, do të bëj shumë spitale dhe do ndërtoj shkolla e kopshte. Unë do ndihmoj të gjithë të varfërit, do të ndërtoj ura e rrugë e do bëj parqe e biblioteka. Unë do jem gjithmonë pranë shqetësimeve të popullit tim e do e bëj vendin më të vizituar të Evropës. Unë do të jem gruaja e hekurt e këtij vendi të vogël edhe.....

- Aini, çfarë po bën moj vajzë? – më përmbledh zëri i mamit.

Befas shoh veten time që hidhet përpjetë dhe një mendim qesharak më mbini në kokë: "Ah, moj mami, unë isha 35 vjeçe dhe po punoja si kryeministre....".

**Aini Karamuçha 6D**



Kur të jem 35 vjeç...

Kur të jem 35 vjeç ëndërroj zyrën time të avokatisë, të mbushur me letra mbi tavolinë dhe persona, të cilët hyjnë e dalin nga zyra. Kur vjen ora e caktuar për të vajtur në shtëpi bëhem gati tërë ngazëllim të takoj familjen time të dashur. Bashkë me vajzat dhe prindërit e mi, mendoj sikur ikim në parqe, kinema, lodra të ndryshme, etj. Kur vjen koha të kthehemi po prap në shtëpi, të gjithë bëhemi gati për ditën e nesërme dhe më pas të gjithë bashkë kalojmë edhe pak kohë në shtëpi duke folur ose duke parë ndonjë film. Pasi vë fëmijët të flenë, mbyllem në studion time të vogël dhe filloj të punoj. Pasi mbaroj plotësisht punën e caktuar, rehatohem në divanin para televizorit dhe ndjek të rejat e ditës ose ndonjë gjë interesante, të cilën e japin kanalet televizive dhe sigurisht më pas kontrolloj fëmijët dhe shtrihem e qetë duke menduar për ditën që më pret. Mirë se vjen e ardhme!

**Alina Jani 6D**



I dashur Harelson,

Unë që po të shkruaj jam miku yt i fëmijërisë. Ti tani je rritur dhe je bërë një arkitekt i zoti. Ëndrra jote e madhe për t'u bërë arkitekt është realizuar. E mban mend kur thoje se sa dëshirë të madhe kishe të dizenoje qytetin tënd. Sot qyteti ynë është shumë i bukur. Tashmë ti je më i pjekur, ke shumë ide dhe projekte të tjera për të ardhmen. Ke dhe familjen tënde që të mbështet për çdo gjë. Por edhe unë do të shoqëroj gjithmonë me kujtimet tona të bukura të fëmijërisë.

**Harelson Demiraj 6D**



Erdhi moment kur po takohemi përsëri dhe ku unë do të të shkruaj ty ose me saktë vetes sime. Po të drejtohem në këtë mënyrë, pasi dua, që kur të bëhem 35 vjeç, gjithçka të jetë ashtu siç kam dëshiruar gjithmonë. Të takohemi gjithmonë në kujtime të bukura e magjepsëse. Këto çaste fëmijërie të ngelen momente të bukura e të paharrueshme në zemrën tënde. Çdo hap që unë të hedh, mos ta mendoj dy herë. Dua që e ardhmja ime të jetë plot aventura e gëzim. Kam dëshirë që kur ta lexosh këtë letër të buzëqeshësh sadopak, në çfarëdolloj momenti të gjendesh dhe të më kujtosh mua ose më saktë veten tënde kur ke qenë fëmijë. Dua që mos të harrosh ditën e parë të shkollës, fjalën e parë, shëtitjen e parë me biçikletë dhe çdo përkëdhelje të prindërve. Ti do të jesh bërë e madhe dhe e rritur, por këto momente nuk duhet t'i harrosh kurrë.

**Amabel Kola 6D**



I dashur Alvin,

Kur të lexosh këtë letër shpresoj të jesh i rrethuar me dashuri dhe miqësi. Gjithmonë ke dashur të jesh midis miqve të vërtetë. Shoqërinë e ke vënë gjithmonë në vend të parë. Për ty miqësia e shokëve vlen shumë. Mirënjohja për ty është një vlerë që të karakterizon. Të lutem mos e humb! Jeta do të përballojë me shumë vështirësi dhe me shumë njerëz, bëhu i fortë dhe bujar. E di që ti ia ke dalë, sepse shpirti yt ka shumë për të dhënë, fantazi, ide dhe gjëra të bukura. Ëndrrat e tua do të jenë realizuar. Sa shumë ëndërroje edhe për futbollin! Dëshiroje të ishe një kampion i vërtetë. Mos i humb këto pasione, sepse njeriu pa pasione është si një fotografi bardh' e zi pa ngjyra të shpirtit. Pasionet janë ngjyra e shpirtit dhe ti ke shumë. Të shikoj duke punuar në kompaninë tënde, të shikoj të realizuar, por mos ndalo ëndrrat nuk kanë fund. Nëse për një moment ndjehesh vetëm dhe i menduar, kthehu disa herë dhe lexo këtë letër dhe do të shikosh sa shume ke ëndërruar dhe sa shumë energji dhe dashuri ke patur brenda një djaloshi të moshës 11-vjeçare. Kur të marrësh këtë letër do të kuptosh çfarë ke arritur falë kësaj force dhe dëshirave që ke patur për t'i realizuar.

Me dashuri Alvin 11 vjeçar.

**Alvin Sejdiaj 6D**



Përshëndetje Rajla,

Ja ku u takuam përsëri, në botën tonë ëndërrimtare. Hera e tretë që shprehem me ty.... . më saktë me mua, dhe ndihem shumë qesharake. Do doja të të kujtoja çdo moment të bukur që ke kaluar. Ndoshta mund të të bëjnë të ndihesh e lumtur. Ti ndoshta ke një familje tani, je një mama e kujdesshme dhe je në një post shumë të lartë. Nuk e di se si është jeta jote aty ku je dhe në atë kohë që je. Të them të drejtën nuk jam shumë e entuziazmuar për të ardhmen time. Këtë e shikoj edhe te të rriturit. Ata nuk argëtohen si ne dhe nuk kanë aq kohë sa ne. Jam shumë e sigurt se tani je shumë e zënë, por thjesht dua të argëtohem me mendimet e mia, të luaj me ëndrrat e mia. Në jetën tonë mund të kemi edhe momente të trishta, por ne mund t'i kalojmë me qetësi dhe durim. Më duket sikur edhe ti do të më thuash çfarë ke kaluar e të gjitha gjërat që çdo fëmijë do të donte t'i dinte, por në të vërtetë kjo është e pamundur. Në fakt ajo kohë do të vijë shumë shpejt...., aq shpejt sa unë nuk do ta kuptoj as vetë. E dashur "unë", ndoshta gjërat nuk janë të lehta në jetë, ndoshta jo gjithçka bëhet realitet. Por, e di çfarë? Nuk e di, ti Rajla 35-vjeçare, a do të mundesh që gjithçka të bukur që po kalon sot, ta ruash diku, në një sirtar të kujtesës tënde, sepse e di që në një moment, çdo gjë do ta kujtoj me nostalgji. Gjithsesi vitet do të rrjedhin e unë do t'i pres me kureshtje.

**Rajla Çulli 6D**



I dashur Baran,

Sot kam një familje shumë të lumtur. Kam një shtëpi shumë të madhe, karrierë shumë të mirë dhe shumë lekë, sepse tani jam rritur dhe jam bërë 35 vjeç. Tani ti je 12 vjeç, por shpresoj kur të rritesh të bëhesh dhe ti si mua. Prindërit e mi janë në gjendje shumë të mirë. Asnjëherë mos hiq dorë nga dëshira jote, sepse edhe unë nuk hoqa dorë dhe jam bërë një nga futbollistët më të mirë në botë. Tani që jam 35 vjeç, kam një jetë më të vështirë, sepse kam një tifozëri shumë të madhe dhe nuk i kam prindërit pranë meje. Ti tani po kalon periudhën më të bukur në jetë, sepse ke shokët pranë gjithashtu edhe prindërit. Tani në këtë moshë kam disa gjëra më shumë se ty p.sh: mund të përdor makinë, fitoj lekë, etj... Shpresoj që je në një gjendje të mirë dhe të uroj që të marrësh sa më shumë nota të mira në shkollë. Tani jam duke të shkruar me nxitim, sepse do shkoj në stërvitje, sepse nesër kam ndeshje futbollit. Shihemi herës tjetër kur ti të rritesh dhe do të të tregoj disa foto se sa i madh jam.

**Baran Ustundag 6D**



E dashur Amy e së ardhmes,

Sot u krodha në mendime dhe fillova të të imagjinoj ty, pra veten time 35 vjeçare, se si do të organizoja jetën time, ç' punë do të bëja, ç' familje do të krijoja e shumë e shumë të tjera.

Dua që një ditë ti të hapësh albumin e fotove të fëmijërisë, sepse e di që do të të zgjojë kujtime të veçanta. Gjithashtu, dëshira ime e madhe është që ti ta shijosh jetën e të jetosh plot pozitivitet, së bashku me familjen tënde. Krahas familjes e jetës tënde personale, dua që paralelisht të ecë edhe profesioni im i dëshirave, të cilin ti po e bën realitet, të qenët biologe.

U futa aq thellë në botën tënde, sa arrita e pyeta veten: "A je e lumtur tani si 35 vjeçare?" Në atë moment, dy zëra të brendshëm filluan të bënin një duel të heshtur në brendinë time:

- Po, patjetër që ndihesh e lumtur. Ke familje, të ardhura, punë që e do, shtëpi e pozitivitet në vetvete, - tha zëri i pozitivitetit.

- Jo, nuk je, normalisht që nuk je. A nuk e sheh që të mungon diçka shumë e rëndësishme brenda teje, -kundërshtoi zëri i brendshëm i negativitetit.

Kjo luftë e tmerrshme dhe e pandalshme vazhdoi për disa minuta, të cilat m'u dukën të gjata pafund. E kur, falë Zotit, ky duel mbaroi, arrita të qetësohesha e të merrja verdiktin përfundimtar lidhur me gjendjen time aktuale shpirtërore, që ishte: "Po, jam e lumtur, sepse gjatë këtyre viteve pavarësi e kam kuptuar se kjo jam unë, kjo është jeta ime, kjo është gjendja ime e përhershme shpirtërore dhe se nuk mund ta ndryshoj dot veten. Gjithashtu, kam kuptuar që kjo veçanti e këto të meta më bëjnë mua një person shumë të veçantë. Këto gjëra nuk më kanë penguar që të kem një jetë të suksesshme.

Me dashuri Amy e fëmijërisë.

**Amy Gaxha 6D**





I dashur Berke,

Sot ishte një ditë shumë e ngarkuar për mua. Një situatë shumë e pazakontë më ndodhi gjatë kohës që isha në punë. Sot në zyrë më erdhi një familje shumë e këndshme. Ata më kërkuan që unë të ndërtoja shtëpinë e tyre të ëndrrave. Deri këtu nuk ka asgjë të pazakontë, sepse unë jam një arkitekt dhe kjo është puna ime, por kjo shtëpi do të ndërtohej në majën e malit të Dajtit dhe do të ishte e gjitha me dru. Mendoj se ky do të jetë projekti më i vështirë që do të bëj. Tani jam në shtëpi dhe sapo ia tregova këtë gjë prindërve të mi. Ata më mbështetën, dhe për mua kjo është e rëndësishmja.

**Berke Ustundag 6D**



E dashur Anda,

Ja ku u takuam ne përsëri. Ndihej çuditshëm kur mendoj që po flas me vetveten, por gjithashtu ndihem më e hapur për të shprehur mendimet e mia. Kjo bota ime ëndërrimtare, ku nuk më shpie. Kam menduar dhe për ty në ëndrrat e mia, por ndryshe nga mendimet e tjera ky më frikëson. "Ç' do të thotë të rritesh?" një pyetje të cilën ia drejtoj shpeshherë vetes, por asnjëherë nuk i gjej një përgjigje. Sa do të doja të më përgjigjeshe, por koha nuk na e lejon këtë dhe pse shumë do të doja të të njihja e të të flisja e ty, të të përqafoja e të shihja si do ishte kjo eksperiencë e çuditshme nga mendimet e mia. Tani mendoj për kohën. Ç' faktor i çuditshëm, por a ka ndonjë mënyrë për ta ndaluar? Nuk mendoj se ndodhet kjo zgjidhje, por sikur, jeta sigurisht do të ishte më e lehtë. Nonjëherë mendoj a mund të qëndrojë përgjithmonë fëmijë, sa do ta ëndërroja këtë. Por do të rritem aq shpejt, sa as vetë nuk do e kuptojmë se si u gjendëm aty ku jemi, aty ku je ti. Tani që e mendoj, kushedi se si e jeton tani jetën. Kur dikur ishte ajo vajza me sy jeshil e flokë gështenjë që po e shkruan këtë letër tërë interes e pritje drejt mijëra pyetjeve në mendjen e saj, plot me kureshtjen që e karakterizon. Nëse do të rritem e nuk e ndaloj dot, kush duhet të jem unë në një të ardhme të largët? Gjithmonë mendoj për idhullin që duhet të kem në jetë. Drejtohem gjithmonë nga nëna ime, por fundja unë do të jem unë. Duhet ta jetoj jetën me mendimin se unë jam kjo që jam dhe duhet të eci përpara pa frikë, por me besim në vetvete. Jam kaq e vogël dhe e paditur, jeta më vonë do të më përballë me situata të ndryshme, të cilat do kenë nevojë për zgjidhje. Nëse tani nuk i përgjigjem një pyetjeje, si do mundem ta vazhdoj jetën, nëse ajo kthehet në një pikëpyetje për mua. Shpresoj që kur ta lexosh këtë letër të qeshësh nga lumturia e të kujtohet ky moment kur ishte kaq e paqartë dhe momentet kur këto pyetje e morën shpjegimin e tyre. Ndihej shumë e lumtur që të kam ty. . . . . më saktë mua, dhe dua ta dish që jeta jetohej vetëm një herë. Kështu jetoje pa frikë dhe e lumtur plot besim në vetvete e dashuri.

**Anda Shurdha 6D**



E dashur Fiona,

Sa herë që eci në rrugët e qytetit tim, sa herë që luaj në këndet e lojërave dhe në lulishtet e tij, sa herë që ndaloj në semafor dhe sa herë që pres në stacionet e autobusit, më tërheqin vëmendjen fëmijët e vegjël që janë pranë meje. Shikoj buzëqeshjen e tyre kur janë të gëzuar dhe ndihem e lumtur. Shikoj kaçurrelat e tyre, që tunden dhe më vjen t'i përkëdhel. Shikoj mërztitjen në ndonjë rast dhe ndiej keqardhje. Shikoj sjellje kapriçoze, llastime ose dëgjoj fjalor të papërshtatshëm dhe ndiej nevojën për ndryshim. Po të kisha mundësi do të doja të ndryshoj mënyrën e rritjes dhe edukimit të tyre, të përmirësoja familjet dhe shkollën. Ndash do të desha të bëhem një mësuese e mirë, e devotshme dhe e dhimbsur, e kujdesshme dhe e dashur, korrekte dhe kërkuese. Fëmijët kanë nevojë që prindërit të kujdesen për ta, t'i ushqejnë, t'i veshin, t'i edukojnë dhe t'i çojnë në shkollë. Nga ana tjetër, mësuesit duhet të plotësojnë edukimin e fëmijëve, që nesër të bëhen qytetarë të mirë e të zotë. Fiona e dashur, prandaj po të shkruaj, se ti je më e rritur se unë dhe mund ta shikosh ëndrrën time të realizuar. Ti punon çdo ditë në mes të fëmijëve dhe ndjen çapëknllëqet e tyre, por edhe dashurinë që ata të falin. Më vjen mirë kur të shikoj që je bërë një mësuese siç të kisha dëshiruar, një mësuese që edukon me durim e qetësi brezin e ri, me dashurinë për njëri-tjetrin, me respektin për njerëzit, me dashurinë për atdheun dhe me dëshirën që të bëhen qytetarë të ndershëm të tij. Mos harro e dashur Fiona, mësuesja që je bërë ti sot ka ardhur si rezultat i një pune dhe shkollimi 35-vjeçar, ka ardhur si rezultat i përpjekjeve të tua për të lexuar, shkruar e punuar pa u lodhur, por ka ardhur edhe si rezultat i dëshirave dhe ëndërrimeve të një vajze 12-vjeçare, të Fionës së vogël.

Me dashuri për ty nga larg në kohë.

**Fiona Semini 6D**



I dashur Arsi,

Kur të lexosh këtë letër do të jesh 35 vjeç. Ja kështu e mendoja veten time 35-vjeçar, kur isha në moshën 11-vjeçare.

Do të kisha krijuar familjen time. Do të kisha dy fëmijë, një vajzë dhe një djalë. Do të jetoja në një vilë afër malit. Do të kisha makinën më të shpejtë të asaj kohe. Do të kisha mbaruar studimet për inxhinieri elektronike. Do të punoja si menaxher i kompanisë më të famshme në botë. Gjatë verës do të takoja prindërit dhe do t'i ndihmoja me çdo gjë që u duhej. Po ashtu do të takoja gjithë shokët e mi të fëmijërisë dhe do të luanim lojëra me playstation ose kalçeto.

Do të kisha fondacionin tim të bamirësisë që do të ishte në shërbim të gjithë njerëzve në nevojë. Mos harro kështu të dua kur të jesh 35 vjeç.

Nga Arsi 11 vjeç.

**Arsildo Veliu 6D**



Melisa e së ardhmes,

Tani unë kam diçka të rëndësishme për të të thënë.

Dua që ti të kesh parasysh çfarë mund të bëhesh ose çfarë mund të kesh. Unë do të kisha dëshirë, që ti të bëje një jetë të gëzueshme, të bësh një punë që të pëlqen, në të cilën të të vlerësojnë dhe të kesh një familje të mirë, ku të të duan dhe ku mos të jesh shumë e rreptë me ta. E di që ti mund të mos kesh dëshirë ta lexosh ose ta shikosh këtë letër, por të lutem lexoje deri në fund, sepse mendoj që do të të ndihmojë. Ti më në fund je rritur edhe pres që të dish mesazhin ose të kuptosh çfarë përmban kjo letër. Do të doja të kishe parasysh gjithmonë që të mendosh para se të flasësh, sepse njerëzit do të mendonin se je e nxituar. Mos i bërtit ndonjë fëmije të vogël pa arsye, e kuptoj që ti je e madhe, por nuk është shumë nevoja. Do të propozoja që të jetoje në një vend të bukur edhe të qetë. Duhet, që kur të jesh me fëmijë, nëse do të kesh, të jesh e qetë dhe jo shumë e rreptë.

Më mirë t'i mësosh me rregulla dhe t'i edukosh sa më mirë.

Poooor, duhet të jesh edhe ti e edukuar edhe e rregullt, kjo ka më shumë rëndësi.

**Melisa Idrizaj 6D**



Gëzuar 35 vjetorin!

Jam ca vite larg dhe nuk të takoj dot, prandaj po të shkruaj këtë letër. A u bëre dot ai futbollisti i shkëlqyer, që luante mesfushor qendre dhe jepte pasa të përkryera? A je akoma ai golashënuesi më i mirë, që shënonte në çdo ndeshje që luante? Pastaj u kënaqëm shumë kur shkua në Bosnje me shkollën. Sa bukur ishte! Për mua ajo është një ndjesi e paharrueshme. A ka ngelur akoma ndonjë thërrime e vogël nga ai çapkëni i vogël me flokë të verdha?

Eh, sa kohë ka kaluar. Mezi po e pres ditën që të ulemi bashkë dhe ta lexojmë këtë letër. Kjo letër me ty mund të zgjasë sa një roman, por tani duhet ta mbyll.

Mirutakofshim pas 24 vjetësh, Vetja ime.

Përsëndetje Rei

Unë kur të rritem do të bëhem këngëtar, sepse më pëlqen muzika. Por do të bëj dhe shumë vepra të mira, si përsëmbull duke dhënë shumë ndihma për njerëzit në nevojë, në veçanti për të sëmurët me kancer, aids, me sëmundje zemre dhe diabet.

Gjithashtu dëshira ime është të ndihmoj të varfërit, njerëzit që jetojnë në kushte të vështira ekonomike, duke i siguruar veshje, ushqim dhe një vend më të mirë për të jetuar, ku të gjithë të ndihemi të barabartë.

**Rei Bushati 6D**



I dashur Berk,

Shpresoj të jesh mirë. Kam dëgjuar që ke ngelur në klasë. Puno më shumë. Këtë nuk e bën për mamin, babin, motrën ose vëllain, e bën për veten. Tani të gjitha punët i bën babi, por në të ardhmen nuk do të jetë babi, do të jesh ti, ai që do të paguash, kështu që puno më shumë. Po nuk mësove nuk do të kesh punë. Po nuk pate punë, nuk mund të kesh para që ta mbash familjen në këmbë. Dhe mos harro; po mësove do të kesh sukses në jetë. Ja po të jap edhe një mesazh: "Punën e sotme mos e lër për nesër". Mos mërzit asnjë. Mbaje nderin e familjes. Mos u grind. Ja edhe një thënie: "Ndonëse një grindje në rrugë është një gjë për t'u urryer, pajtimi dhe energjitetë, që shpalos ai janë të mrekullueshme; edhe njeriu më i zakonshëm në pajtimin e tij shpalos një nur të veçantë."

Një letër nga vetja jote para 24 vitesh.

**Berk Cemil Oksan 6D**



Përshëndetje,

Unë jam vetja jote përpara 24 vitesh. Në këtë moment mendoj se kur do të lexoj letrën, do të jem një person i suksesshëm në arkitekturë. Do të ishte mirë në qoftë se do jetoja jashtë vendit për shembull në Amerikë. Sa mirë! Do të kem makinën time personale. Nuk do të ishte keq të kisha një shtëpi me oborr. Kushedi sa e gjatë do të jem, apo flokët çfarë ngjyre do t'i kem? Ndoshta edhe mund t'i kem lyer. Po fëmijët e mi si do të duken? A do të jenë të pushëm? Shpresoj që të kem një kafshë shtëpiake! Kushedi sa kolegë do të kem? Po prindërit e mi si do të duken? Po vëllai, a do të jetë duke punuar në bankat e Gjermanisë?

Mirutakofshim në të ardhmen!

**Era Shpofi 6D**



I dashur Brendon,

Tani ke mbushur 35 vjeç. Je rritur njaft për të kuptuar se çfarë është jeta. Tashmë ke gjetur një punë dhe je bërë i zoti i vetes. Ke gjetur një bashkëshorte të denjë për ty dhe je me një fëmijë të vogël, që mbush shtëpinë gjithë gëzim. Shkon në palester çdo ditë dhe je i shëndetshëm. Je i njohur në vendin tënd për projektet e tua. Jeton një jetë shumë të mirë dhe të pëlqen kjo jetë e qetë dhe pa shumë pengesa. Shkon në punë çdo ditë dhe vjen vonë në darkë, por familja të mbush me gëzim kur je i lodhur. Je shumë i rregullt dhe shumë i vendosur. Nuk të mungon asnjë gjë dhe i ke të gjitha. Falenderon të gjithë ata që të kanë ndihmuar të ndërtosh këtë jetë dhe ia shpërblen atyre. Por prapë vëllai akoma të flet sikur të ishit të vegjël. Del çdo të shtunë dhe luan me shokët që ke pasur në klasë.

**Brendon Janku 6D**



E dashur Hera 35 vjeçare, ose më saktë, vetja ime.

Kjo është diçka që dua ta lexosh në të ardhmen, diçka që dua të të japë një impakt special, shumë të veçantë. Dua që kur ta lexosh, të më kujtosh. Sepse Ti je unë e unë jam ti dhe sepse je shumë speciale. Në ëndrrat e mia, Ti gjithnjë ke qenë dikushi, ke qenë Unë. Unë gjithnjë të kam ëndërruar duke e jetuar jetën në maksimum, ndoshta edhe pak si fëmijë, si unë. Kam jetuar duke plotësuar dëshirat e mia për të vizituar botën, sidomos lojërat që janë si në Disney Land, duke provuar pa frikë gjithçka argëtuese që të ka pëlqyer. Duke mos e humbur guximin.

Më merr gjithnjë malli kur të mendoj!

Me dashuri, Vetja jote 11 vjeçare e hallakatur, Hera!

**Hera Hadëri 6D**



Përshëndetje Rubin,

Duhet të çohem herët çdo ditë. Gjithmonë të ha një mëngjes të shëndetshëm. Si një lojtar tenisi, unë duhet të bëj vrap ditë për ditë. Por nuk duhet të harroj për familjen time, sepse unë, si burri i shtëpisë duhet t'i jap sa më shumë avantazhe dhe sa më pak disavantazhe fëmijëve të mi dhe gruas sime. Çdo ditë, duhet të shkoj në shtëpinë e mamit dhe babit, sepse nuk mund të harroj sa shumë të mira mora prej tyre. Edhe pse Perla mund të jetë jashtë shtetit, gjithmonë do ta kontaktoj, kështu që mund të ndihem sikur ajo ndodhet këtu. Do të përpiqem shumë për t'i dhënë fëmijëve të mi një jetë sa më të mirë. Pres nga ata që të kenë rezultate të shkëlqyera në mësimet dhe të na e kalojnë mua dhe Perlës. Shpresoj që familja që po krijohet, të jetë sa më e mirë dhe e bashkuar. Mbaj mend gjithmonë se duhet t'i trajtoj fëmijët e mi sikur të jemi shokë, në mënyrë që midis nesh të ketë një lidhje të fortë e të pandarë. Do të bëj të pamundurën që këtë familje, për të cilën po flas, ta kthej nga fantazi në realitet.

Mirutakofshim Rubin!

**Rubin Muja 6D**



E dashur vetja ime,

Është hera e tretë që po të shkruaj. Edhe këtë herë dua ta ripërsëris që ndihem krenare dhe tepër e lumtur për arritjet e mia. Kam gjithçka që më nevojitet dhe kjo falë punës, guximit dhe dëshirës time. Ia kam dalë mbanë deri tani me çdo sakrificë timen dhe do të vazhdoj më tej. Kam një punë dhe një familje të mrekullueshme. Falenderoj shumë Zotin që m'i dha këto mundësi të mira e më bëri kjo që jam sot. Çdo gjë po shkon më së miri dhe kjo falë edhe prej atyre personave që më kanë mbështetur gjithmonë. Mjafton me kaq. Mirupafshim!

**Xhejvisa Qafalij 6D**



Pse ikën vitet kaq shpejt? Kur unë u bëra 35 vjeç dhe ende kam nostalgji për fëmijërinë time, për adoleshencen time. Sa shumë vite shkollë. Një udhë e pafund. Sot jam një pedagoge e kompletuar me të gjitha. Një drejtoreshë e suksesshme, ndonëse e re në moshë. Synimin tim për shkollë dhe karrierë profesionale e arrita. Me shume miq e shokë. Duke udhëtuar gjithmonë nëpër botë. Tani kam për të krijuar familjen time. Pak e vështirë po më duket kjo zgjedhje. Por do të vazhdoj dhe pak singëll. Unë përmbush çdo synim që i kam vënë vetes, sepse kështu është edukuar karakteri im.

**Sindi Shutina 6D**



Ç'kemi!

Po ndihem pak çuditshëm tani në këto momente duke ditur që po i shkruaj vetes sime, por gjithsesi nuk e shoh shumë si detyrë, sepse jam shumë e hapur në këtë letër. Jam e sigurtë, që kur ta lexosh, do të qeshësh me të madhe duke kujtuar me mallëngjim fëmijërinë. Atëherë do të jetë viti 2040 dhe gjithçka do të ketë ndryshuar shumë. Besoj se do të dish se çfarë ndodh këndeje. Thjesht shkollë, gjithçka është krejt normale. Por po flasim vetëm për mua, dua të di më shumë rreth jetës në atë vit. Besoj dhe shpresoj që gjithçka të jetë mirë, sepse pasojat e veprimeve të tua, do të ndikojnë në jetën time, kështu që besoj se e kuptove që duhet të kesh kujdes. Dhe unë si këmbim e gjithashtu shpërblim po përpiqem sa më shumë në detyrat e mia. Ti e di rezultatin, por nuk ka gjë, le ta mbajmë si një sekret të vogël mes nesh, pasi e di që edhe unë do ta mësoj rezultatin. Kam pak frikë për të ardhmen, sepse unë do të ndikoj në jetën e shumë njerëzve të tjerë. Nuk dëshiroj që një brez i tërë të më urrejë, kështu që si unë edhe ti, duhet t'i vëmë forca vetes. Për mendimin tim jeta në atë kohë nuk do të jetë aq e vështirë aq sa thonë të rriturit tani, në vitin 2016. Gjithmonë të rriturit na thonë këto fjalë kur ne jemi të mërzitur: "Mos u mërzit! Në qoftë se ti mërzitesh për këto gjëra, nuk do t'ia dalësh dot kurrë në jetë". Neve na duken thjesht si fjalë ngushëllimi e për të na dhënë kurajo, por do të të bëj një pyetje të sinqertë: "A janë të vërteta këto fjalë që na thonë të rriturit?" Tani pres përgjigjen e letrës dhe pyetjes gjithashtu!

**Jasmin Grace Selba 6D**



Gëzuar 35 vjetorin!

Jam ca vite larg dhe nuk të takoj dot, prandaj po të shkruaj këtë letër. A u bëre dot ai futbollisti i shkëlqyer, që luante mesfushor qendre dhe jepte pasa të përkryera? A je akoma ai golashënuesi më i mirë, që shënonte në çdo ndeshje që luante? Pastaj u kënaqëm shumë kur shkuaam në Bosnje me shkollën. Sa bukur ishte! Për mua ajo është një ndjesi e paharrueshme. A ka ngelur akoma ndonjë thërrime e vogël nga ai çapkëni i vogël me flokë të verdha?



Eh, sa kohë ka kaluar. Mezi po e pres ditën që të ulemi bashkë dhe ta lexojmë këtë letër. Kjo letër me ty mund të zgjasë sa një roman, por tani duhet ta mbyll.

Mirutakofshim pas 24 vjetësh, Vetja ime.

**Ralf Alla 6D**



Për Nikin,

Unë jam një fëmijë shumë i lumtur. Prindërit më plotësojnë çdo dëshirë. Në shkollë kaloj mirë me shokët dhe marr nota shumë të mira. Çdo ditë e pres me padurim. Më pëlqen edhe kur luaj futboll mbas mësimet. Futbollit është sporti im i preferuar dhe jam i gëzuar, sepse do të kemi një kampionat futbollit. E di që klasa ime do të fitojë, sepse kemi disa nga futbollistët më të mirë të paralelit si: Donaldi, Kejsi, Rei, etj. Unë dëshiroj që të kaloj shumë kohë me motrën time. Ajo mendon, se unë nuk e dua, por unë e dua me gjithë zemrën time. Në kohën e lirë luaj me të dhe kënaqemi pa masë. Kur vij nga shkolla, shkoj tek nëna ime. Ajo ka qenë mësuese gjuhe dhe për mua, është mësuesja e gjuhës më e mirë në botë. Dashuria që më jep ajo, nuk krahasohet me asgjë në të gjithë universin. Tani do të flas për gjyshin tim. Ai është njeriu më punëtor, që njoh. Nuk lodhet asnjëherë. Gjithmonë më do dhe më mbështet. I vlerësoj gjithmonë ato që ai bën për mua. Le të vijmë tek babai im. Ai më mbështet në çdo kohë dhe në çdo vend. Kur ndodhem në vështirësi, kujtoj atë dhe më ikën e gjithë frika. Në fund do të flas për njeriun më të veçantë për mua, mamanë time. Më do dhe rri gjithmonë krah meje. Unë e dua, aq shumë sa është i madh universi. Nuk ka fjalë për të shpjeguar dashurinë dhe mirësinë e saj. Ky jam unë dhe këta janë shokët dhe familja ime dhe jam i gëzuar, që ata janë pjesë e jetës sime.

**Niki Osmani 6E**



Përshëndetje Sara,

Shpresoj, që të arrish ta lexosh këtë letër. Fillimisht, do të doja që të keni gjetur një punë të mirë. Po ta them këtë, sepse tani për tani nuk e imagjinoj dot, se çfarë do të bëhem, kur të rritem. Nuk e di, nëse e keni marrë patentën e shoferit, por ti e di, sa qejf kam dhe po pres me padurim, ta arrij moshën e të kem makinën time. Ti e di që mua më pëlqejnë ushqimet pikante prandaj unë shpresoj, të kemi shkuar për pushime me familjen, në Meksikë dhe të kem shijuar naçosat pikante me salca të saj. Sa do të doja, të na pëlqente ngjyra e zezë, por ti e di që i kam vënë qëllim vetes, se nuk do të vishem me të zeza. Unë nuk e di, se si do të jenë gjërat në të ardhmen, por shpresoj të jeni mirë. Me kaq e mbyll letrën time.

Nga vetja jote,

**Sara Huqi 6E**



E dashur Xhesika,

Tani që po shkruaj këtë letër, jam në klasë të 6-të në kolegjin "Turgut Ozal". Kur të rritem dua të jem një shembull i mirë për familjen time, edhe pse ndoshta tani jam pak mistrece. Përpiqem të mësoj nga gabimet e mia dhe përpiqem t'i korrigjoj ato. Mendoj, që kur të jem 35-vjeçe, të kem mbaruar shkollën e lartë me rezultate shumë të mira dhe të kem krijuar familjen time. Tani që po shkruaj këtë letër, po e shkruaj sikur të isha një princeshë me të gjitha kushtet dhe dëshirat e mia. Prindërit e mi kanë punuar dhe e kanë bërë jetën sa kanë mundur më të përshtatshme dhe luksoze për familjen e tyre prandaj edhe unë duhet të punoj për të arritur atë që dua. Të gjithë njerëzit në ditët e sotme kanë gjetur një mënyrë për të fituar dhe për të qenë të suksesshëm. Ajo që doja të thoja është se ka shumë mënyra se si ti mund të bëhesh dikushi në jetë, mjafton vetëm të punosh.

Me dashuri.

**Xhesika Begaj 6E**



Për ty,

Kur të jem 35-së vjeç, unë do të jem një futbollist i zoti, që merr një rrogë shumë të mirë. Do të blej nga makinat më të shtrenjta në botë dhe do të krijoj një markë të njohur, e cila do të jetë ndërtuar nga unë. Marka ime do të jetë një mark parfumi. Emri markës do të jetë REPRO gjatë, (Rei Products). Unë preferoj, që të luaj me skuadrën e Realit të Madridit. Do të jem një futbollist, i cili luan titullar, në çdo ndeshje. Unë do të jem një person, i cili reklamon firmën, NIKE. Kjo është dëshira ime, kur të jem 35-së vjeç.

**Rei Mile 6E**



Përsëndetje Noel,

Kur të bëhem 35-së vjeç, kam dëshirë të bëhem dikushi në jetë. Kur të hapet kjo letër, unë ndoshta do të jem bërë doktor, sepse kam shumë dëshirë të shëroj njerëzit. Ndoshta, mund të jem bërë një futbollist i zoti. Mendoj që ta ruaj miqësinë që kam me shokët. Kur të jem 35-së vjeç, besoj se do të krijoj familjen time. Kur të bëhem 35-së vjeç, shpresoj që të shkoj në Rio. Atje kam dëshirë të shikoj stadiumin Ndërkombëtar të Rios dhe statujën e famshme. Gjithashtu, në Rio dua të takoj futbollistin e famshëm Neymar. Kam shumë dëshira, por një dëshirë tjetër e rëndësishme është të shkoj në Egjipt dhe të shoh piramidat e famshme atje.

Mirutakofshim Noel!

**Noel Papajani 6E**





I dashur, Luis!

Unë kur të jem 35-së vjeç, e imagjinoj veten, me trup të gjatë, i sjellshëm me njerëzit edhe nëse nuk i njoh. Në punë unë do të bëja çmos që të isha më i miri nga të gjithë. Do të doja që të kisha shumë shokë e shoqe nga vende të ndryshme, që të flisnim për problemet e punës sonë. Ato do të më mbështesnin mua, kur unë të kisha ndonjë gjë për të zgjidhur. Me mundin tim do të dëshiroja që të kisha një shtëpi të madhe moderne, një makinë shumë të bukur dhe të mirë. Mbi të gjitha do të isha shumë i shëndetshëm dhe nga ana profesionale shumë i mirë.

**Luis Plava 6E**



I nderuar Prof. Dr. David DERVISHAJ,

Po ju shkruaj unë, e kaluara juaj e largët, në moshën 11- të vjeçare. E para, që ta dini, keni pasur një fëmijëri shumë të pasur me mundësira. Por çdo e mirë e ka një të keqe. Edhe fëmijëria juaj e ka pasur këtë gjë. Ishte e mbushur plot me gënjeshtër. Plot me të këqija. Ato s'kishe nga t'i prisje. Kudo të vinin. Fantazia jote ishte pakufi. Ajo vinte nga pasja e një I-Phone klasik origjinal 2G (duke e përdorur si I-Pod), deri në shpikjen e telefonit të imagjinuar, që nuk kishte nevojë të karikohej, (duke pasur parasysht telefonin tënd Samsung Galaxy Note, të cilit i binte bateria 5%, çdo 2 minuta). Pastaj janë edhe gjyshërit, të cilët i doje shumë. Nuk e di, nëse do jenë gjallë apo jo në atë kohë, por ti dhe unë i kemi dashur shumë ata.

Me përshëndetje të ngrohta,

**David Dervishaj 6E**



Për Roaltin, 35-së vjeç

Unë tani jam 12-të vjeç dhe do dhe 23 vite, për ta hapur këtë letër. Këto janë shumë vite. Unë mendoj, që do të kem shoqen e jetës, gruan time dhe të kem 2 fëmijë të mrekullueshëm. Mendoj pas 23 vjetësh të jem një doktor në një spital të madh dhe modern, shpresoj të kem miqësi me dy shokët e mi Noelin dhe Elgysin, çfarëdo profesioni, ata të zgjedhin. Shpresoj, që Shqipëria të jetë bërë një vend më i mirë.

**Roalt Doka 6E**





Përschendetje Keis,

Kur isha i vogël, mezi prisja të rritesha e të bëhesha si gjithë të tjerët. Doja, që mos të më shikonin, si atë djalin e vogël dhe të paaftë. Doja që të m'i thoshin edhe mua ato problemet dhe sekretet, që për mua ishin të "ndaluara" dhe nuk duhet t'i dëgjoja. Gjithmonë kërkoja që njerëzit të më shikonin me një tjetër sy. Mos të më shikonin si një fëmijë. Tani që jam i rritur, dëshira ime e madhe u zbeh. Tani e shikoj botën me një sy tjetër. Bisedat e më të rriturve, të them të drejtën, nuk më duken aq interesante sa mendoja. Çdo bisedë e të rriturve është e mbushur plot me ankesa. Tani që njerëzit nuk më shikojnë më si fëmijë, unë nuk jam i lumtur ashtu si mendova se do të isha. Nuk më pëlqen kjo botë ku ndodhem tani. Një botë pa ngjyra, plot stres e probleme. Sikur të kisha një shkop magjik, ta ndryshoja këtë realitet dhe të ndihmoja gjithë fëmijët në botë. Të dhuroja shumë lumturi dhe të kthehesha pas në kohë. Të isha prapë ai fëmija i lumtur, që i intereson vetëm loja, buzëqeshja, që nuk largohet kurrë. Në botën e tyre, nuk ka interes, nuk ka ambicie. Fëmijët komunikojnë shumë mirë me njërin-tjetrin. Ata e njohin shumë mirë faljen dhe nuk e dinë ç'është urrejta! Lumturia ekziston dhe çelësin e saj e kanë vetëm fëmijët dhe jo ne të rriturit, që pretendojmë se kemi gjithçka, por në të vërtetë nuk kemi asgjë. Të uroj shumë fat e suksese!

**Keis Saker 6E**



Unë 35-së vjeçar?!

Sa larg më duket ajo ditë, por megjithatë po përpiqem të përshkruaj ëndrrat e mia, që shpresoj të bëhen realitet. Në atë kohë do jem një djalë i rritur dhe i plotësuar, dua të them, për shkollimin tim dhe të gjitha llojet e specializimeve që do të bëj. Nuk dua të ndalem te gjatësia ime trupore, që jam i bindur, se do të arrij të jem, të paktën sa babai im, mbi 1 m e 85 cm. Gjatësi e një basketbollisti apo jo?! Në atë kohë mendoj të kem një studio time, pasi që tani e mendoj të bëhem një inxhinier kompjuterash i mirë. Kompjuteri, është një nga hobet e mia dhe nuk mendoj ta ndaj asnjëherë. Besoj do të kem edhe një makinë foristradë X6-ta, tamam i shkon për shtat edhe trupave të gjatë. Megjithëse, me shpejtësinë do të jem i kujdesshëm, se e kam merak që të respektoj rregullat e qarkullimit rrugor. E mendoj edhe zërin e mamit, që gjithnjë ashtu kërkuese do të vijojë të më japë këshilla, Ditmar bëj këtë, Ditmar kujdes në këtë, ndërsa babi me fytyrën e tij të butë, do të ndërhyjë, hë me lerë të qetë .... Me vëllain besoj do të kem një lidhje shumë të mirë, megjithë diferencën në moshë, po ashtu e mendoj rebel dhe ndoshta do të dëshiroj që të jetoj jashtë Shqipërisë. Në fakt, këtë nuk e di akoma, se në të 35-at ndoshta edhe unë e mendoj të jem andej, ndoshta në Gjermani, ndoshta edhe më tej ... Eeee, nuk di të them, po 35-së vjeç mund të kem krijuar edhe familjen time, e rëndësishme është ta kem ta bukur, si familjen, ku po rritem! Deri atëherë mendoj ka kohë, dhe gjërat mund të ndryshojnë, por ëndrrën e prindërve të mi, që të bëhem njeri i mirë, do ta realizoj patjetër!

**Ditmar Drenofci 6E**



I dashur Arbër,

Sot ti mbush 35-së vjeç. Jam i sigurt se do të buzëqeshësh, kur të lexosh këtë letër. Shpresoj që të kesh realizuar shumicën e ëndrrave që kemi pasur. Besoj se tani je duke ngrënë një darkë të këndshme me familjen tënde, ke marrë këtë letër në dorë dhe po ua lexon atyre. Po u tregon ëndrrat dhe dëshirat që ne kemi hedhur në këtë letër. Fëmijët e tu ndihen të lumtur e të ngazëllyer, kur ti u shpalos Arbrin fëmijë, atë fëmijë, që shpresoj të jetë aty me Arbrin e rritur. Përshëndeti nga unë! Jam i bindur se ti je i realizuar më së miri profesionalisht. Tani je një inxhinier kompjuterash i zoti. Inovacionet që ti ke krijuar, të kanë bërë një njeri të famshëm. Të imagjinoj duke shkuar në punë me makinën tënde fluturuese. Po Spanja si të duket? Po Camp Nou-n e ke vizituar më? Të kujtohet vizita jonë me babin? Besoj se i kemi akoma ato baluke. S'më pëlqente fare kapelja. Besoj se tani e ke përfunduar mësimin e gjuhës spanjolle dhe gjermane. Sado që të jesh rritur, ti do të mbetesh miku im më i mirë.

Me dashuri, Arbri.

**Arbër Elezaj 6E**



Përshëndetje Lorna,

Mbasdite do të doja të kisha më shumë kohë të lirë. Mësimet të mos ishin kaq shumë të ngarkuara. Nëpër lagje të ketë më shumë parqe për fëmijë, ku ne mund të luanim dhe të shëtisnim me biçikleta. Gjatë periudhës së verës, të mos kalonim aq kohë brenda në shtëpi dhe kampet verore për fëmijë të ishin më të sigurt. Prindërit, të tregohen me liberalë me ne dhe të na tolerojnë më shumë për përdorimin e mjeteve elektronike dhe jo vetëm të lexojmë libra artistikë. Zënkat me vëllain do të doja të ishin të rralla. Do të doja të kem një mace ose një qen, por prindërit nuk janë dakord. Ata mendojnë se kafshët shtëpiake mund të mbahen në shtëpi private dhe jo në apartament. Do të doja të kaloja më shumë kohë në natyrë, por mësimet dhe puna me orar të gjatë e prindërve, nuk ma lejon. Edhe pse kam parë shumë filma për fëmijë në televizor, do të doja të shkoja më shumë herë në kinema. Do të doja një mjedis më të pastër për qytetin, ku jetoj. Plehrat të mos hidhen nëpër rrugë. Pallatet, që ndërtohen të jenë më uniformë.

Pas 35-së vjetëve shpresoj, që Tirana të jetë më e pastër dhe më e bukur se sot.

**Lorna Lufi 6E**





E dashur Emili,

Tani po filloj t'ju tregoj botën time 12-të vjeçare të fantazisë. Juve një kalë mund t'ju duket një kafshë e zakonshme, por për mua, është një kafshë fantastike. Tigri i bardhë, ju thoni se ai është kafshë e egër, por mund të them me plot gojë, që ai është kafsha më e ëmbël, që kam parë ndonjëherë. Po të ngrini kokën lart, do të shihni Afërditën, që ju përshëndet. Nëse ecni pak më tutje, ju do të shihni një shtëpi të mbuluar me karamelle dhe akullore. Për të kaluar nga ana tjetër, duhet të kalosh një lum me shurup çokollate dhe copëza biskote nën të. Pra, nëse edhe ju të dashur miq do të fantazoni pak, mund t'i shihni edhe ju këto gjëra mahnitëse dhe të mrekullueshme.

**Emili Doçi 6E**



I dashur Klevis,

Ndoshta, do të jete letra e parë dhe e fundit që të shkruaj. Teksa ti do të lexosh letrën time do të buzëqeshësh dhe ngazëllesh me të, por më parë le të prezantohem.

Unë quhem Klevis, por ti tashmë, je mësuar të të thërrasin Klev. Jam një djalë në moshën 11-të vjeçare me shumë ëndrra dhe dëshira për të ardhmen. Teksa ti tashmë ke realizuar ëndrrën tënde për të qenë inxhinier, lexon këtë letër, më lejo të të shpjegoj se; kjo ëndërr, që të ndërtosh rrugë dhe pallate, ka lindur duke shkruar në këto rreshta. I ngazëllyer nga detyra, që na dha mësuesja e matematikës, për lidhjen midis matematikës dhe arkitekturës vendosa, që ky do të jetë profesioni i së ardhmes sonë. Të premtoj, që nuk do të lodhem duke mësuar matematikën, fizikën, kiminë dhe informatikën. Pasi ia tregova mamit dhe gjyshes këtë dëshirë më mbështetën dhe e dinë, që ky është pasioni ynë. Megjithatë, unë kam pasione të tjera, si futbollli dhe noti. Të premtoj, që për këtë ëndërr do të punoj shumë, sepse duhet shumë mund e vullnet. Të përshëndes dhe më vjen mirë, që po e lexon këtë letër.

**Klevis Sina 6E**



Përshëndetje Patris,

Mendoj se gjërat shkojnë shumë mirë për mua dhe se kështu shkojnë për të gjithë. Më pëlqen të shkoj me pushime me prindërit e mi dhe kështu do të bëj gjithmonë, sepse ata më argëtojnë dhe më bëjnë të qesh e të ndihem mirë. Mami dhe babushi m'i plotësojnë të gjitha tekat dhe dëshirat, normalisht, sepse një gocë kanë. Me ta do të argëtohem gjithmonë, sepse kështu dua. I dua shumë, shumë, shumë dhe fort, fort, fort. Mendoj se me ta do të rri gjithmonë. Por..., a do të mendoj kështu, kur të rritem? Apo do të mendoj ndryshe? Si do të jenë mendimet e mia, kur të jem 35-së vjeç?

Nuk mund të jem aq e sigurt, po mendoj se kam filluar të mendoj ndryshe!

**Patris Haxhiu 6E**



E dashur Selma,

Shpresoj, që kur ta marrësh këtë letër të jesh shëndoshë e mirë. Jam ulur në tavolinën time të studimit dhe koha sikur po fluturon në këtë ditë shiu. Ëndrrat e mia po ndryshojnë, çdo ditë e më tej, një herë të bëhem okuliste, një herë dentiste. Shpresoj, që ti të kesh zgjedhur një rrugë të duhur për t'u bërë dikushi në jetë dhe që ti të jesh e lumtur me vendimet dhe zgjedhjet e tua. Në këto momente jam shumë e emocionuar, sepse të mendoj ty duke qarë, në momentin kur të marrësh këtë letër dhe ta kesh në duart e tua.

Shumë faleminderit që ti po e lexon këtë letër.

Përqaftime të përzemërta!

**Selma Mehmetaj 6E**



I dashur Joel,

Kur të jem 35-së vjeç, pasi të kem mbaruar shkollën e të kem kaluar disa vështirësi, e imagjinoj veten si një djalë të gjatë, simpatik e me trup të formuar mirë. Syzet nuk do t'i kem më, sepse kur të mbush 18-të vjeç, do bëj një ndërhyrje me lazer. Besoj, se do të kem një punë më të mirë, pse jo, një biznes timin. Në kohën e lirë veshja ime do të jetë kryesisht sportive, e ndërthurur ndonjëherë me stilin klasik. Mendoj se sporti do të zërë një pjesë të kohës sime të lirë. Deri atëherë do të kem krijuar një shoqëri timen me miq të mirë. Shpresoj, që kur të jem në atë moshë të kem një shoqe të mirë të jetës, mund të jem i fejuar, ndoshta i martuar, por jo me fëmijë. Kësaj të fundit nuk i dihet! . .

**Joel Gjidia 6E**



I dashur Geri,

Si je? Si po të shkojnë punët?

Besoj se ke ndryshuar shumë, që kur ke qenë 12-të vjeç. Më lër të tregoj, se si ke qenë. Ti ke qenë përgjithësisht i gëzuar dhe shumë pesimist. Kontradiktor. Ishe shumë i qetë dhe hoj-broj. Ngaqë e kishe mendjen në shumë gjëra njëkohësisht, kështu që nuk ishe shumë i përqendruar. Ti asnjëherë nuk ke pasur qejf të kopjoje. Ke pasur një imagjnatë shumë të zhvilluar. Ty të vinin në kokë mendime të ndryshme. Ke qenë shumë i zgjuar, por ke qenë edhe i turpshëm. Nuk e ke harruar ëndrrën tënde më të madhe, besoj?

Bëra shaka. Ëndrra jote më e madhe ka qenë të bëhesh një programues kompjuterash.

Unë besoj se ti e ke realizuar atë.

**Geri Mamillo 6E**



Përsëndetje,

Unë quhem Altea dhe jam 35 vjeç. Jetoj në Zyrih në Zvicër.

Kam mbaruar shkollën për arkiteturë, në universitetin ETH në Zyrih. Aktualisht kam studion time, për dekorimin e ambienteve të brendshme të shtëpive. Mua më pëlqen shumë puna ime, sepse përveçse më jep kënaqësi, unë mund të shfaq përmes saj idetë e mia. Interior disagner është një punë e lodhshme, por edhe artistike. Aktualisht jetoj në një apartament në qytet, të cilin e kam dizenuar vetë. Kam dy fëmijë të vegjël, vajzën dy vjeç dhe një djalë shtatë vjeç. Vajza quhet Rhea dhe është në kopësht, dhe djali quhet Elian dhe është në klasën e parë. Pushimet i kaloj në Shqipëri, pasi aty jetojnë prindërit dhe të afërmit e mi. Por ka dhe raste, që pushimet i kaloj në Zvicër, pasi ndonjëherë kam shumë punë edhe gjatë sezonit të pushimeve.

**Altea Xhemo 6F**



E dashur Ami,

Këtë letër po e shkruaj tani që jam 11 vjeç.

Besoj se të ka marrë malli për fëmijërinë. Besoj se të kujtohet kur ishe e vogël e doje të vishje rroba moderne e për vajza të rritura, make up ose taka. Po kur të çonte mami me detyrim te kursi i notit? Po kur luaje me shoqet e lagjes ose dhe të klasës? Ose kur rrije në telefon me shoqet tërë ditën? Kur shkoje te parku ose dilje me shoqet? Po ato detyrat e shtëpisë, ah, sa të vështira ishin. Besoj se e mban mend kur shkonim me mamin për të blerë rroba dhe ti doje gjithçka. Por tani ti je 35 vjeç. Dhe nuk luan më, nuk ke as shumë kohë të lirë. Tashmë je rritur dhe nuk ke më naze. Të them të drejtën, nuk ma priste kurrë mendja t'i shkruaja një letër vetes. Po sikur ta kenë lexuar fëmijët e tu? Shpresoj që ti ta ruash këtë letër. Me siguri ti po puth këtë letër e po qan, se të ka marrë malli për fëmijërinë.

Këtë letër ta ruash e mos ta hedhësh.

Me dashuri Ami Hoxha 11-vjeçare. Për Amin 35-vjeçare.

**Ami Hoxha 6F**



I dashur Arbër,

tani pas dy letrash besoj se e ke marrë vesh se çfarë fëmije ke qenë. Çfarë fëmijërie ke kaluar dhe me çfarë kushtesh je rritur. Unë nuk kam më mundësi të të shkruaj. Kjo është letra e fundit që po të dërgoj. Shpresoj që ato dy letra të kenë ndikuar pozitivisht tek ty. Siç e ke kuptuar deri tani, kjo është një letër lamtumire. Dua që tani e tutje të kalosh një jetë të mirë me familjen tënde, të jesh i shëndetshëm dhe të kalosh çdo çast me njerëzit që do.

**Arbër Rama 6F**



E dashur Anesa,

Unë kur të bëhem 35 vjeç, do të shkoj në të gjitha vendet e Shqipërisë dhe të gjitha vendet e botës. Udhëtimi i parë do të jetë në Egjipt. Do shikoj disa piramida dhe Sfinksin (një tempull i madh). Udhëtimi i dytë do të jetë në Murin e Madh të Kinës. Do të vrapoj për 2-3 kilometra të gjata për ushtrime shëndetësore. Por mos të harroj se do të udhëtoj edhe në Valbonë. Do të fotoj shumë lule dhe pemë për koleksionin tim për gjelbërimin. Ndoshta do të udhëtoj në Francë, në Meksikë, në Amerikë, në Brazil, në Spanjë, në Itali, domethënë kudo në botë.

Uroj që të gjitha dëshirat e tua të realizohen.

**Anesa Hoti 6F**



Përshëndetje Angelo,

Angelo, po të flas nga viti 2016, të lutem po munde mos i harro ato momente dhe ato festa, ditëlindjet, Halloween dhe plot festa të tjera. Mos i harro momentet që ke kaluar me shokët dhe pse je i rritur. Mundohu t'i përsëritësh dhe t'i rifestosh. Përveç këtyre mundohu të bësh gjëra ekstreme si not me delfinët. Në kohën tënde të lirë, bëj hedhje me parashutë, të bësh gara me makina dhe të kesh makinën më të shpejtë. Kaq doja të të thoja.

**Angelo Duçkollari 6F**



Përshëndetje Aurel,

Epo..., derisa të bëhem 35 vjeç, mund të më vijnë shumë mendime ndërmend, por këto janë ato që dua të realizoj...

Unë, kur të bëhem 35 vjeç, kam dëshirë që të kem një familje të lumtur dhe të formoj një kompani të suksesshme besoj me emër "The Sun". Familja ime dua që të kem një djalë me emrin KRIST gjatë KRISTIANO dhe një grua besnike, babain trim dhe mbështetës gjithashtu, ndërsa mamanë të kujdesshme dhe përkrahëse në çdo hap që do të bëj. Kompania: emrin "The Sun", produktet cilësore...Tani do ju flas për të, më shumë. Ajo do të jetë me shumë pika fabrike në të gjithë botën mbarë. Disa nga krijimtaritë që do të bëjë janë: Isun (telefon ose celular i një teknologjie të madhe), Tsun (televisor TV i një rezulucioni të lartë LHD), Osun (tablet me një teknologji si aji e Isun), LHD (do të jetë një pamje akoma më e mirë se ajo HD). Të gjitha këto nuk pretendoj që t'i arrij i vetëm, por me ndihmën e familjes. Në familje si ndihmë kam: babain, motrën, mamanë, vëllezërit, gruaja dhe sigurisht Elisi (vëllai i motrës, kemi lidhje të ngushta bashkë). Do të punoj shumë dhe nuk pretendoj që të humb lehtë. Jam i sigurt që nuk do t'i zhgënjëj të gjithë ata që besojnë tek unë.

**Aurel Domi 6F**



E shikon ditar, jam duke të shkruar përsëri.

Dëshira ime për të shkruar në shkollë, përsëri nuk ndalet. Do doja të takoja sërish mësuesit, nxënësit dhe miqtë e mi të vjetër. Kur kemi qenë të vegjël, nuk e vlerësonim shumë shkollën, na dukej si një lodhje e pakuptimtë. Por nga gabimet mësojmë. Pra, ne kemi bërë gabim që kemi menduar kështu, por shpresoj që në të ardhmen të jem dikushi.

**Dea Fjora 6F**



E dashur Denada,

Ja zbardhi edhe mëngjesi i ditëlindjes tënde të 35-të. Është një agim i ftohtë dhjetori, që për çudi më duket pranveror. Nuk e di se ç' do të ndodhë deri në mbremje, por jam e sigurt që mami dhë babi, edhe pse të moshuar, do më kënaqin si gjithmonë me ndonjë surprizë të vogël. Nuk e di, por sot ndihem nostalgjike. Para syve, më shfaqet një vajzë e vogël me kostum balerine, me këmbë të brishta mbi puante dhe me flokët e artë të mbledhur lart. Është Denada e vogël, besoj se 10-11 vjeçare. Kujtoj ëndrrat e mia, dëshirën më të madhe për t' u bërë një balerinë profesioniste. Ishin emocione të bukura, orë të tëra të harxhuara mes pasqyrës dhe sallës së baletit. Në vesh kam akoma duartrokitjet e shokëve te salla e koncerteve. Por vetëm kaq!

Me kalimin e viteve një pasion tjetër ngriti krye. Ishte drejtësia. Doja të bëhesha një juriste e zonja. Orët në sallë, u zëvendësuan me orët në dhomë, pasqyra u zëvendësua nga kompjuteri dhe tavolina. Tashmë Denada juriste kishtë fituar mbi Denadën balerinë. Megjithatë, pasioni për baletin ka mbetur i njëjtë. Sot ndihem mirë me veten. Dua të kërcej si Denada balerinë, të vesh edhe njëherë puantet dhe të fluturoj me kostumin rozë të baletit. Por, e di që nuk më vjen më! Jam rritur! Por, brenda meje ka mbetur një dritëz e bukur fëmijërie. Mes ashpërsisë së ditëve dhe çekiçëve të gjykatësve, kjo fjollëz fëmijërie më bën të lumtur.

Eeh. . . U bërë shumë melankolike Denadë! Je vëtëm 35 vjeç. Kushedi se ç' do të shkruash kur të jesh 70 vjeç?!

Të shohim! Me dashuri Denada 11-vjeçare.

**Denada Roçi 6F**



E dashur Enia,

Ti tani je 35 vjeç. A mendon ndonjëherë për çastet kur luaje "e ka kush e ka" me shoqet e tua, ose kur grindeshe me motrën e vogël për ndonjë copë çokollate? Tani je rritur, ke mbaruar shkollën e lartë dhe besoj që ke shtëpinë tënde. Mezi pres të rritem aq sa ti.

Shihemi së shpejti, Enia.

**Enia Xhaferraj 6F**





E dashur Eljada,

Kur të bëhem 35 vjeçe do të kujtoj me mall shkollën. Do të kujtoj mësuësit, shoqet dhe shokët. Të gjithë ne do të kemi marrë drejtimin e jetës. Do të kujtoj mëngjeset, që nxitoja për në furgon, do të kujtoj orët e mësimëve, të lodhshme, por edhe argëtuese. Nuk do të harroj testimet e shpeshta, që na krijonin ankth. Kurrë nuk do harroj GDS-të, në të cilat mundohesha të punoja saktë. Notat e mira më bënin të lumtur mua, mësuësit, por dhe prindërit. Do të kujtoj ekskursionet, panaiëret dhe koncertet e bukura që zhvilloheshin.

Eh, me sa shumë mall dhe nostalgji do e kujtoj shkollën!

**Eljada Pjetri 6F**



Përshëndetje Glejdi 35 vjeç!

Unë jam femijëria jote. Ti e di që kur ke qenë 11 vjeç, ishe shumë kurioz për gjithçka. Por jam shumë i çuditur përse nuk më ke shkruar asnjë letër. Për këtë jam shumë i mërzitur. Por të kam falur, nëse në letrën që do më shkruash, do të më tregosh për profesionin tënd dhe dua të di se çfarë jete bën. Unë shpresoj që ti të mos e kesh ndryshuar ëndrrën tënde më të madhe, që të jesh doktor. Nëse nuk je bërë doktor uroj të jesh bërë arkitekt. Po udhëtimet të pëlqejnë? Ke provuar të bësh rafting? Më kanë thënë që është qejf. Glejdi e mban mend kur ishe i vogël? Ndërsa tani kushedi si je bërë. Do dua të di, a i bie asaj violinës së ëmbël. Shpresoj që t'i biesh dhe të kënaqesh, sepse gjë më të bukur se t'i biesh violinës nuk ka. Edhe pianoja është e bukur, por ne të dy bëjmë për violinë. I mban mend mësuëset e para sa të mira ishin? Po klasën e 6-të e mban mend sa e bukur ishte? Ne thonim që na pëlqente shumë matematika. Tani po të lë në punët e tua, të cilat ti i ke me shumë pasion.

Të fala, Glejdi 11 vjeç.

**Glejdi Shahu 6F**



Përshëndetje Rigers,

Sic ju thashë në letrën e parë dhe të dytë, unë jam një njeri që kam shumë profesione. Tani po bëj shkollën e basketbollit. Domethënë që tani jam me një profesion më shumë. Profesionet që kam janë: doktor, futbollist, balerin, valltar, kitarist, biznesmen i Range Rover-ave. Basketbolli është hobi im. Pas basketbollit është futbollit. Unë kam zgjedhur këto profesione, sepse dua të kem një karrierë të shumëllojshme dhe të suksesshme. Përfitimet dhe arritjet që kam nga këto profesione janë maksimale, sepse përpiqem dhe punoj me mish e me shpirt. Gjithë këto arritje kaq të mira, janë falë përkushtimit ndaj shkollimit. Unë i këshilloj të gjithë lexuesve që të vazhdojnë shkollën, sepse njeriu pa shkollë është si një pemë pa rrënjë.

**Rigers Zypçe 6F**



I dashur vogëlushi im Lukas,

Dje mësuesja jote kishte përgatitur një detyrë të veçantë. Intervistoni njeriun më të famshëm që njeh më mirë. U çudita shumë, kur ti erdhe tek unë. Për çfarë të jem e famshme? Kur isha në moshën tuaj ëndërroja të bëhesha këngëtare dhe luaja volejball. Zbulova se këtë ëndërr e kishte më shumë mami, domethënë gjyshja jote. Në moshën 13-vjeçare dëshira ime ndryshoi. Ëndërroja të bëhesha ekonomiste dhe të punoja në firmën e babit tim. Ai gjithmonë dëshironte të punonim bashkë. Të drejtoja biznesin e familjes brez pas brezi. Më pëlqente të ulesha me të, e të shikoja e dëgjoja se si ai punonte dhe komunikonte me të tjerët.

Sa habi! Pas dy-tre vitesh ndryshova prapë dëshirë. Mendova të bëhesha mjekë. Të ndihmoja të sëmurët, të shpëtoja jetë, të rilindja besimin tek ata që vuanin. Të kujdesesha për fëmijët e sëmurë që të buzëqeshin në çdo kohë. Studiova fort, me këmbëngulje dhe ndihem e lumtur me çfarë jam tani. Nuk mërzhitem për orët e gjata, as për netët pa gjumë pranë pacientëve të mi të vegjël. Më vjen keq kur nuk jam pranë teje duke lexuar përralla.

Faleminderit i vogli im dhe jam e lumtur që ti po bëhesh një djalë me një shpirt dhe mendje shumë të bukur.

Të puth plot dashuri mami Hensara.

**Hensara Muça 6F**



E dashur Klea je 35 vjeç,

Je rritur tani dhe nuk je më e vogël.

Përgjegjësitë e tua janë më të mëdha dhe shumë më të rëndësishme. Tani besoj të jesh Klea, që kam menduar unë se do të bëhej kur të isha 35 vjeç. Vajza që besonte se do ta ndihmonte botën nëpër veprat dhe mirësitë që do të bëje kur të rriteshe. Tani u je përkushtuar ndoshta familjes tënde dhe e ndihmon mamin me biznesin dhe me shtëpinë.

Por pyetjet e mia janë shumë të mëdha:

Po tani a e sheh botën me një kuriozitet të madh? A udhëton shpesh? E takon më nënën të shtunave dhë të dielave? Po tani a të lë mami që të dalësh e vetme me shoqet? Kur mendoj se do të bëhem 35 vjeç, më duket pothuajse e pamundur, madje ndonjëherë them mos të ndodhë shumë shpejt, pasi tani po filloj të shikoj me një këndvështrim tjetër; shkollën, jetën dhe shoqërinë. Jeta është e gjatë, por nuk mund të presësh shumë nga ajo, pasi sërish ndoshta të vjen dëshira për të qenë një fëmijë.

**Klea Karaxhaj 6F**



E dashur Larisa,

Jam ulur në një dritare, duke qenë se koha është e zyrtë, më kaplojnë lehtësisht mendimet për shumë gjëra. Kur jemi të vegjël kemi një dëshirë të madhe të rritemi, të mos jemi ata fëmijë lozonjarë e të dashur me të gjithë. Por shumë paskemi gabuar, sepse tani që kam kaluar disa stade të rëndësishme të jetës ndiej, që në fakt rritemi aq shpejt. Ja ku gjendem pranë parvazit të dritares, sodis me përhumbje rënien e pikave të para të shiut, të cilat këtë radhë më shpunë në dëshirat, hobet e mia, në rininë time. Dëshira ime për të ndjekur sportin e dashur të volejbollit m'u shfaq papritur. Tashmë jam në një moshë, që përveç arritjeve të mia profesionale e familjare, përpiqem t'i kërkoj vetes llogari dhe të kthehem pas në kohë, të bëj gjërat e lëna mangët. Përpiqem të gjej arsye dhe të justifikoj veten pse nuk kam gjetur hapësirë të mjaftueshme për t'iu dedikuar hobit tim të madh, volejbollit. Koha ka fluturuar tashmë, nuk e gjej dot veten lehtë në vitet e adoleshencës apo rinisë, për të cilat ndihem e penduar, që nuk kam ndjekur hobin tim të hershëm të volejbollistes, por shoh me nostalgji moshataret e mia që iu bindën dhe u qëndruan fort pasioneve të tyre përtej anës profesionale e familjare. Nga kjo përhumbje e thellë në të shkuarën time, më zgjon zhurma e fortë e pikave të shiut, shndërruar në breshër tashmë. Ja ku kthehem në të tashmen, e cila nuk më ndihmon aspak t'i përmbush boshllëqet e së shkuarës, ndonëse të vogla. Megjithatë kjo shërben si një mësim i mirë për mua, më ndihmon të mos hedh asnjë hap tjetër pa u menduar gjatë.

**Larisa Demiraj 6F**



Përshëndetje Samed,

Një ditë të bukur me shi po kujtoja fëmijërinë. Kishin kaluar shumë vite që nga përfundimi i shkollës. Shumë kujtime, mbresa më erdhën në mendje atë çast. Tani kishin ndryshuar shumë gjëra dhe unë nuk isha më i vogël, por një 35 vjeçar që kishte ndryshuar shumë nga ai Samed i vogël. Atë çast më erdhi në mendje një pyetje? Pse njerëzit janë bërë kaq të rremë e mashtrues? Sipas meje shkaku i kësaj ishin lekët, pijet alkolike dhe lëndë të tjera. Frika ime më e madhe është, se këta mashtrues mund të ndikonin për keq tek nxënësit e shkollave nëntëvjeçare e të mesme. Kjo botë është mbushur me padrejtësi e hipokrizi, por fatmirësisht ekziston edhe e mira, njerëzit e mirë e të sinqertë. Ata që do të mundësojnë ndryshimin e botës dhe të jetës sonë. Mirësia nuk mbetet vetëm tek ti, por transmetohet edhe tek të tjerët. Mirësia është një ndjenjë që kthehet tek ti me më shumë shpresë. Secili prej nesh duhet të përpiqet të pasqyrojë sa më shumë mirësi e energji pozitive.

**Samed Kokiçi 6F**



Përsëndetje Kevin,

Koha kur isha i vogël kaloi. E vetmja gjë e mbetur janë kujtimet. Puna nuk është e lehtë, por po mësohem. Jam rritur dhe po përballem me vështirësitë e jetës. Me vëllain tim të dashur dhe motrën time të vogël punojmë në të njëjtën klinikë dentare, ashtu sikundër ishte edhe ëndrra e prindërve tanë të dashur. Sa më shumë kohë kalon, aq më tepër po kuptoj sakrificat e prindërve dhe arsyet se përse ata ishin aq kërkues ndaj nesh kur ishim në shkollë. Unë e di që jetën do e shijoj me familjen më të dashur në botë, familjen GURAKUQI. Shpresoj që së shpejti edhe unë të krijoj vetë një familje po kaq të bukur.

**Kevin Gurakuqi 6F**



E dashur Serena,

Serena, ti tani je 35 vjeçe dhe je veterinere. Këtë gjë e ke dashur që e vogël si profesion. Ti i do shumë kafshët dhe tani po i ndihmon ato. Ke dy fëmijë të mrekullueshëm dhe një bashkëshort punëtor. Jeton bashkë me familjen tënde në një shtëpi private dhe gjëja e parë që bëni i përkushtoheni fëmijëve. Prindërit e tu jetojnë bashkë me ty, Serena. Ju jetoni në Los Angelos. Ke një vajzë njëmbëdhjetë vjeçe dhe një djalë tre vjeç. Dëshira jote është të kesh edhe një fëmijë. Dhe ju si familje, keni dy qenë dhe një mace. Fëmijët e tu Serena, i duan shumë kafshët. Vajza jote e ka ditëlindjen në 20 gusht dhe djali në 14 qershor.

**Serena Malaj 6F**



I dashur Sidriti 35-vjeçar,

A të është plotësuar ëndrra që kishe? Tani duhet të jesh bërë një avokat shumë i suksesshëm. E kuptoj shumë mirë ëndrrën tënde për një karrierë të gjatë dhe të palodhur. Ti gjithnjë ke qenë një njeri i drejtë dhe shpesh të kam parë tek ndihmoje njerëz të pambrojtur. Kurrë s' të ka pëlqyer gënjeshtria apo përfitimi nga dobësia e të tjerëve. Jam i bindur se karakteri yt i vendosur dhe vullneti i fortë për t'ia dalë mbanë në çdo situatë, nuk do të të lënë në baltë asnjëherë. Dëgjova se je martuar dhe jeton i lumtur me familjen tënde, në shtëpinë e re. Uroj që fëmijët e tu të kenë jetë të gjatë dhe të të ngjajnë sadopak. E di që ata ndihen krenar për ty...

Me dashuri, Sidrit Rustemi 11-vjeçar.

**Sidrit Rustemi 6F**



I dashur Sidrit,

Ti sapo mbushe 35 vjeç. Ke krijuar familjen tënde e një shoqëri të re, dhe ke plotësuar ëndrrën e profesionit të doktorit, që kishe në fëmijëri. Ndoshta jo gjithçka që ke ëndërruar, është realizuar. Profesionit yt nuk të lë të shpenzosh kohë me familjen tënde, për këtë jam i sigurt, sepse profesionit i doktorit kërkon udhëtime në vende të ndryshme të botës. Mos harro nënën dhe babain tënd, sepse ata të duan më shumë se çdo gjë tjetër në botë. Ata nuk do të të harrojnë kurrë ty, mos e mohoj këtë. Ti merresh me sport, por jo aq shumë sa je marrë kur ishe më i ri. Në këtë letër nuk dua të shkruaj gjëra që mund të të mërzisin apo të bëjnë të ndihesh keq. Me sa duket, shkakut i gjithë këtyre që sapo kam shkruar, është profesionit i doktorit. Gjithsesi, le të shohim anën pozitive. Ky profesion do të të bëjë më të ditur dhe të mençur. Do të shëtisësh shumë vende të botës, duke qenë se do të kesh shumë konferenca dhe takime jashtë shtetit. Është diçka e bukur, që do të të lërë mbresa dhe kujtime të paharrueshme. Përveç profesionit të doktorit, ti ke organizuar një shoqatë bamirësie për njerëzit e varfër. Kjo ka qenë një ëndërr tjetër e jotja që në fëmijëri. Të mbusheshin sytë me lot kur shihje njerëz që kërkonin lëmoshë ose që shisnin gjëra të vogla, vetëm për bukën e gojës. A të kujtohet? Ke bërë një ndryshim në jetën e njerëzve të varfër, dhe shumë njerëz të tjerë të kanë marrë si shembull. Të lumtë Sidrit! Më fal, por më duhet ta mbyll letrën. Mirupafshim!

Me dashuri, Sidriti.

**Sidrit Kokiçi 6F**



Përshëndetje Tomi,

Kur të rritem dua të bëhem ose biznesmen ose inxhinier. Mbas 24 vitesh, kur të marrësh këtë letër, do falenderoj të gjitha zyshat. Zyshën e gjuhës, të matematikës, të anglishtes, fizikës, biologjisë, kimisë dhe nëndrejtorët dhe drejtorin në shkollën "TURGUT ÖZAL". Kjo shkollë më ka dhënë shumë eksperiencë dhe miq pa fund si Unejsi, Rigersi, Leo, Marvi etj. . . .

Kur të rritem, dua të jem një baba sa më i mirë dhe fëmijëve të mi t'u jap kushtet dhe mundësitë siç m'i ka dhënë babai im mua. Dua të mësoj shumë dhe të jem një idhull për fëmijët e mi. Të jem me një familje, ku të gjithë kanë edukatë dhe mirësjellje.

**Tomi Llanaj 6F**



Përsëndetje Unejs,

Kur të rritem kam dëshirë të bëhem biznesmen. Dua të menaxhoj një kompani të madhe telefonash. Të drejtoj kompaninë dhe të fitoj të gjitha tenderat. Dëshiroj të jem prind i mrekullueshëm për fëmijët e mi. T'u siguroj një arsim të plotë dhe pa asnjë gjë mangët. Gjithashtu kam dëshirë, që fëmijët e mi të mësojnë dhe të ma shpërblejnë sakrificën time për ta. Unë dua të udhëtoj me ta në shumë vende të ndryshme. Po ashtu dua t'u përcjell atyre veçoritë më të mira të një njeriu fisnik.

Këtë letër ia dedikoj vetes sime kur të mbush plot 35 vjeç.

**Unejs Kondi 6F**



E dashur Alfrida,

Po të rikthehem përsëri për të shkruar, pasi çdo gjëje duhet t'i rikthehesh disa herë që ta bësh më të saktë dhe të plotë, si autorët e mëdhenj. Ja ku jam unë nga fundi i rinisë sime, por siç thonë çdo gjë ka kohën e vet dhe jo të gjitha zgjasin përgjithmonë. E di që të gjithë mendojnë se 2039 do jetë shumë ndryshe, por bota është njësoj dhe gjërat më të rëndësishme janë ruajtur dhe kanë mbetur të njëjta. Por patjetër që teknologjia ka ecur shumë, kurse bota thjesht është ndotur më shumë dhe nuk është më ashtu siç ishte e gjelbëruar. Tani kujtoj, kur rrezet e diellit ndriçonin mbi barin jeshil dhe lulet me aromë ndjellëse. Në Los Angeles ku unë jetoj, karriera po më shkon shkëlqyeshëm dhe familja, e cila vjen e para sigurisht. Familja ime është paksa e madhe, pasi unë dhe bashkëshorti im, i duam shumë fëmijët dhe kemi vendosur që përveç fëmijëve biologjikë të adoptojmë dhe fëmijë të tjerë, pasi dhe fëmijët e jetimores kanë të drejtë të kenë një familje. Këto kohë sapo doli filmi më i ri, ku aktrova unë në rolin kryesor dhe ky film pati shumë sukses. Për ju që nuk e dinit unë jam aktore dhe një nga netët më të bukura të jetës sime, ka qenë nata e ndarjes së çmimit "Aktorja më e mirë". Sigurisht pra unë e fitova çmimin dhe kur prezantuesja tha emrin tim zemra ime filloi të rrihte më shpejt se kurrë. Por dhe lotët bënë të vetën, ata filluan të dilnin pa e pritur dhe po mbulonin gjithë fytyrën. Pjesa më e keqe ishte kur mora çmimin në dorë dhe nuk e mbaja dot, sepse duart po më dridheshin. Më pas çdo gjë shkoi shumë mirë.

Kjo pra ishte një pjesë e vogël, por e këndshme e shkëputur nga moshë ime 35 vjeçare.

**Alfrida Alimema 6G**



E dashur Era,

Po të shkruaj unë, ti e vogël. Besoj se nuk më mban mend dhe ndoshta e ke harruar fëmijërinë. Një arsye është, pasi ti dëshiron të fokusohesh tek pjesa tjetër e jetës, por nuk ka problem. Tani je 35 vjeç dhe besoj që gjërat e tua në jetë janë sistemuar. Do të isha tepër e lumtur nëse je sot ai person që ke ëndërruar. Je shumë energjike dhe shpresoj që vazhdon të jesh akoma e dashur me të tjerët, shumë emocionale sidomos. Bota jote kthehej në një stuhi kur ndonjë nga mësuesit të qortonte, jo për keq. Besoj se e ke formuar një familje, ku të mbështetesh gjithmonë dhe se e ke krijuar karrierën tënde të artit, pasi e adhuroje atë. Këtu unë po e mbyll këtë letër tani. Mirutakofshim!

**Era Metaj 6G**



Përshëndetje Ana,

Sot në ditëlindjen time të 35-të, po të shkruaj për të të treguar jetën time deri tani. Ëndrra për aktrimin nuk u shua asnjëherë dhe jam shumë e kënaqur që ajo ëndërr u realizua. Gjithçka filloi kur familja ime dhe unë, u shpërngulëm në Amerikë. Në fillim isha e frikësuar për jetën atje, por me kalimin e kohës e kuptova se çdo gjë ishte shumë e bukur. Ora e mësimit atje ishte shumë argëtuese dhe plot me njohuri te reja. Fëmijët ishin shumë të shoqërueshëm, aq sa që ditët e para unë u miqësova me ta. Në shkollën ku unë studioja, organizoheshin shumë konkurse dhe evente të ndryshme. Gjithmonë isha e para që kërkoja të merrja pjesë nëpër konkurse, veçanërisht në konkurset e aktrimit. Pasioni dhe dashuria për aktrimin bënë që unë të fitoja shumë konkurse. Mësuesja, duke parë talentin dhe pëlqimin tim për aktrimin, më prezantoi me disa regjisorë të filmave amerikanë për fëmijë. Fatkeqësisht familjes sime iu desh të shpërngulej në Kanada. Ajo ka qenë një nga ditët më të këqija të jetës sime, pasi m'u desh të lija të gjithë shokët e shoqet e bashkë me ta dhe sukseset e mia atje, por jo për shumë kohë. Ne u shpërngulëm në Kanada, ku unë mbarova universitetin, dhe më pas, unë, e vetme shkova përsëri në Amerikë për t'iu kthyer atje talenteve të mia.

Pas pak vitesh, shndërrohem nga një emigrante, në një aktore të talentuar Hollivudi. Në këto kohë ëndrra ime e dytë u plotësua, pasi takova aktorët e mi të preferuar hollivudian. Nuk e besoja dot, që më në fund isha një pjesë e tyre! Tani unë ndodhem në shtëpinë time në Kaliforni, dhe pas pak orësh filmi im i parë do të promovohet dhe unë jam protagonistja kryesore. Por ëndrra ime e tretë është të bëj një film me aktorë hollivudian, por për vendin tim të lindjes, Shqipërinë. Në atë film dua të tregoj vlerat dhe të bukurat e vendit tim të lindjes, Shqipërinë.

**Ana Kendella 6G**



E dashur Anda e së ardhmes,

Ndoshta nuk të kujtohet por je ti, pra unë, që e ke shkruar këtë letër në fëmijërinë tënde. Me siguri tani je duke xhiruar filmin tënd në "Paris" ose akoma më mirë, duke u kthyer në shtëpi nga ceremonia e çmimit "Oskar", në të cilën ti sigurisht fitove. Kudo që të jesh ti, sigurisht që do të kesh mjaft kohë për të lexuar këtë letër. Po e shkruaj këtë letër për të gjetur sadopak kohë brenda teje që të kujtosh vërtet ato që kanë rëndësi, kujtimet. A të kujtohenato sekonda, kur binte një qetësi e madhe dhe ti nuk duroje dot, prandaj duhej të filloje të flisje me të madhe? Ditët që shpresoje të merrje nga një dhjetë për çdo lëndë, muajt e parë të shkollës, në të cilët ishe e vendosur se do të dilje shkëlqyeshëm në çdo test dhe mos harrojmë atë ditë që hidheshe pupthi nga gëzimi pasi kishte lindur motra jote. Si duket bota tani që je 35 vjeç? A ishin të vërteta dëshmitë e ekzistencës së Ufo -ve? Shpresoj që koha të ka shpërblyer mirë në të ardhmen dhe se je e lumtur. Asnjëherë mos harro ta jetosh çdo moment si kurrë më parë dhe të përhapësh energji pozitive. E di që nuk është shumë veprim i zgjuar të këshillosh një tridhjetë e pesë vjeçare, por gjithmonë mbaji mend këto gjëra.

**Anda Bushi 6G**



E dashur Anjeza 35 vjeç!

Këtë letër po ta dërgoj për të të bërë disa pyetje, për të cilat jam shumë kurioze t'i di përgjigjet.

Nëse mund t'i përgjigjesh do të isha shumë e lumtur. Po filloj duke i rreshtuar pyetjet:

Çfarë pune bëj? A e ruaj lidhjen me miqtë që kam tani? (Shpresoj që po)

Ku jetoj? A vazhdoj ta pëlqej baletin si tani? (Shpresoj që po)

A jam e pasur? Çfarë shkence ka përparuar më shumë që në vitin 2016? A kam marrë vendimin e duhur siç më thotë mami gjithmonë "Merr gjithmonë vendimin e duhur për jetën"?

Kjo ishte pyetja ime e fundit. Le të flasim pak për jetën time në të ardhmen. Besoj që kam formuar familje të mirë. Pasi të gjithë më thonë se jam vajzë shembullore dhe se do t'i bëj ballë vështirësive në jetë. A është e vërtetë kjo? A do të jem aq e zonja sa t'u bëj ballë vështirësive në jetë e vetme? Epo, kaq kisha unë për të thënë. Të kërktoj shumë ndjesë për harxhimin e kohës tënde, pasi e di se koha është e çmuar.

Me respekt, Anjeza 11 vjeç.

**Anjeza Brahimaj 6G**





Kur të jem 35 vjeç,

Deri atëherë do të kenë kaluar shumë vite, e brenda këtyre viteve do të shkruhet çdo gjë e bukur apo e keqe, këtë nuk e di, por ajo që di me siguri është se në gjithë këtë udhëtim pres të marr më të mirën nga të mirat, të mësoj nga gabimet e kështu nuk do të rritet vetëm mosha ime, po më e rëndësishmja është ajo, për të cilën luftojmë gjatë gjithë jetës "dija". Pa të, nuk do të kishte kuptim asgjë, këto vite do të ishin bosh. Dhe siç e thashë ka shumë gjëra që nuk i di çdo të ndodhë, por atë që parashikojmë të gjithë që tani në fëmijëri, është të mendojmë veten të shkolluar, në profesionin, në të cilin ne kemi investuar kaq shumë nga jeta jonë që në hapat e ABC-së. Ndoshta pse jo, e mendoj veten edhe në një vend tjetër jashtë Shqipërisë. Do të doja shumë këtë të fundit, sepse kjo është ëndrra me të cilën po rritemi "për një jetë më të mirë". E di shumë mirë që është e vështirë gjithçka deri kur t'i arrij këto e të shoh veten aty ku dua, por të gjithë në jetë kemi qëllime dhe unë do të punoj për t'i përmbushur. Mund të ketë plot gjëra të tjera që mund të kenë ndodhur deri në atë moshë, por synimet e mia ishin këto, sepse për këtë e kemi në dorë ne vetë.

**Ballëm Gega 6G**



Jam 35 vjeç,

E ndiej veten te rritur, sepse unë po bëj një jetë më vete, familje më vete, punë më vete dhe shtëpi më vete. Kam kuptuar se çfarë do të thotë jetë. Jetë do të thotë, një luftë për veten dhe për familjen time. Kam kuptuar se çfarë do të thotë i zoti i vetes. Do të thotë që veten dhe familjen tënde ta nxjerrësh në pah. Kam kuptuar çfarë do të thotë punë. Punë, do të thotë një sakrificë që ti bën për familjen tënde, dhe mbi të gjitha për fëmijët tuaj, për të cilët mundohesh të japësh të pamundurën për shkollimin e tyre.

Kjo ishte letra ime. Me dashuri nga zemra,

**Boiken Nallbani 6G**



Përshëndetje Dardi,

Epo s'kam çfarë të them më, sepse të gjitha mendimet më kanë ikur. Megjithatë argëtimin nuk e kam përmendur, kështu që do e përmend tani. Në moshën 35 vjeçare, do të doja të bëja pakëz argëtim. Gjithçka e përfshirë me familjen, pra me gruan dhe fëmijët. Në argëtim do të shtoja shumë udhëtime të ndryshme që do t'i zhvilloj me miqtë e mi më të mirë. Kohët e bukura, që do të kaloj, do të më rifreskojnë memorien për kohët e paharrueshme që po kaloj në këtë moshë ku aktualisht jam. Tani duhet ta mbyll këtë letër, sepse do të mendoj për vendet dhe detajet e vogla, që do të kryej kur të jem 35 vjeç.

**Dardi Peka 6G**



Miku im i mirë Denio,

Kur të jem 35 vjeç gjithçka do jetë ndryshe. Do jem më i ndërgjegjshëm dhe i zgjuar. Do më pëlqente të bëhesha këngëtar ose aktor dhe biznesmen. Do të blej makina të shpejta. Por do dhe shumë kohë të bëhem 35 vjeç, prandaj do bëj shumë gjëra të tjera deri sa të vijë ajo kohë. Nëqoftëse njerëzit do fluturojnë dhe s'do kenë nevojë për oksigjen do ta ndërtoja jetën në Neptun. Do të kem komshinj alienët. Shtëpinë do e ndërtoj shumë teknologjike. Do të blej Iphone 45 plus.

**Denio Gashi 6G**



Përshëndetje Emi e së ardhmes,

Unë jam ti, por 24 vjet më e vogël. Meqë ra fjala te mosha, si dukem? A jam plakur ndopak, më ka dalë ndonjë rruzhë ose ndonjë thinjë? Jo, apo jo? Të paktën kështu shpresoj! Çfarë po ndodh atje, në botën e së ardhmes? A po shkon mirë me shoqërinë që të rrethon? Shpresoj që po, sepse nëse është e kundërta do të më duhet ta kaloj të gjithë jetën time duke u mbajtur mëri njerëzve të tjerë! Meqënëse e përmenda mërinë, a e kam akoma atë vesin e mbajtjes së inatit pas zënkave? Po shkollën po e vazhdoj akoma? Mos më thuaj që po, sepse nuk dua të më shkojë jeta vetëm shkollë, sepse duhet të bëhet dhe pak qejf, po ti si mendon? A kemi të njëjtat mendime unë dhe ti? Besoj se jo, sepse ti duhet të jesh pak më e pjekur apo jo?

Emi më bëhet qejfi që të shkrova. Shpresoj të jesh mirë ti dhe të gjithë njerëzit përreth teje!

Me shumë dashuri, red blue, vetja jote 24 vjet më e re!

**Emi Baloshi 6G**



I dashur Ernani 35-vjeçar,

Shpresoj që deri tani të kesh krijuar një jetë sa më të bukur e të mirë për veten. Mezi po pres të zbuloj nëse ke një familje të re dhe nëse ke akoma shoqërinë e mirë që kishe në shkollë. Kam shumë pyetje për të të bërë dhe jam shumë kurioz të di përgjigjet e tyre. Por do të pyes vetëm pyetjet më të rëndësishme, sepse të tjerat i zbuloj vetë. A ke krijuar një jetë të mirë për veten? A i ke akoma Tenon dhe Boikenin shokë të ngushtë? A je martuar? Në cilin shtet jeton? Çfarë profesioni ke? Doja të të bëja edhe disa pyetje të tjera, por nuk dua të të lodh, sepse përgjigjet e tyre mund t'i marr vesh vetë pas disa vitesh. Por gjëja më e rëndësishme dhe kryesore është që të jesh mirë me shëndet, të kesh krijuar një familje me njerëz që i do dhe të duan dhe të kesh një profesion që e bën me qejf.

Plot dashuri, Ernani 11 vjeçar.

**Ernan Nuri 6G**



Si e mendon veten Klest kur të jesh 35 vjeç - më pyeti Noeli?

Ja bash kështu:

"Si një djalë i kulturuar dhe i shkolluar në një universitet shumë të mirë, me dije të thella dhe të kem mbaruar për degën e fizikës."

Do të kem një shoqëri të madhe edhe jashtë shtetit, me të cilët do të mbaj marrëdhënie shumë të mira dhe do të shkoj t'i vizitoj herë pas here. Edhe ata do të vijnë të më vizitojnë mua shpesh. Shpresoj të mund t'ia dal kësaj ëndrre duke qenë një fizikant dhe të kem laboratorin tim me disa shokë të mi të ngushtë. Tek ai laborator do të bëjmë eksperimente, studime dhe zbulime e konkluzione të mëdha. Do të kem një familje të mirë e të shëndetshme me tre kolopuça të vegjël, të cilët do t'i rris me shumë dashuri. Do t'i shkolloj mirë dhe do të jem shumë i rreptë për mësimet, sepse dua që ata të kenë dije të qëndrueshme dhe të bëhen dikushi në jetë. Atëherë Noel kështu e mendoj veten unë shpresoj t'i realizoj gjithë këto që thashë dhe tani po iki t'i shkruaj në një letër fiks për këtë temë në mënyrë që t'i mbaj mend. Provoje edhe ti mund të jetë efektive."

-Jo s'ka gjë nuk dua ta provoj Klest.

-Dakord unë ika ta shkruaj.

**Klest Gadeshi 6G**



Përshëndetje Martin,

Është viti 2040 dhe unë jam 35 vjeç dhe jetoj në Angli. Jeta që kam më pëlqen shumë, pasi ky qytet është fantastik. Këtu çdo njeri mund të jetojë, sepse ka çdo kusht që i nevojitet. Për fëmijët ka parqe pa fund, ku mund të kalosh një ditë shumë argëtuese. Pas një jave të lodhshme, stresuese dhe të zhurmshme, dalja jashtë Londrës dhe kontakti me natyrën janë një alternativë shumë frymëzuese. Ajri i pastër, gjelbërimi, pyjet e bukura, fushat, lumenjtë të ftojnë çdo fundjavë pranë tyre. Një alternativë tjetër, është të vizitosh muzetë që janë shumë interesante. Aty mund të vështrosh sende të ndryshme, të mësosh për kulturën e shumë gjëra të tjera, që vijnë prej dhjetëmijë vjetësh. Gjithashtu më pëlqen shumë puna që bëj, pasi më jep mundësinë të ndihmoj shumë njerëz. Të jesh mjek është një sfidë dhe luftë e përditshme, ku jeta duhet të jetë medoemos fitimtare. Njëkohësisht jam i kënaqur që pranë vetes kam miq, kolegë dhe shokë të mirë, por mbi të gjitha që kam pranë vajzën, shogën dhe njeriun më të mirë, me të cilën shumë shpejt do të martohem dhe do të jetojmë vetëm ditë të lumtura.

**Martin Lipe 6G**



Përshëndetje Mei,

Nuk e imagjinoj dot veten time kur të jem 35 vjeçe, sepse unë do të kem një punë dhe mund të jem bërë prind. Kur të kem fëmijë, unë do të kujtoj gabimet që u kam bërë prindërve. Po mendoja për të ardhmen dhe po thoja me veten time: "Çfarë shoqesh do të kem? Si do të jetë bota?" Këto pyetje ia bëj shpesh vetes sime, por besoj se bota do të jetë krejt ndryshe, do të vendosë rregulla të ndryshme, do të zbukurohet me sa më shumë qendra, besoj se do të vendosim më shumë parqe, etj. Kam dëshirë të punoj sa më shumë tamam si prindërit e mi, por duhet edhe të mësoj shumë. Shpresoj që këto që po them deri tani të realizohen. Ndihem e çuditshme që kjo letër po mban ndjenjat e mia dhe mendimet e mia. Këtë letër do ta ruaj dhe kur të jem 35 vjeçe do ta lexoj dhe do të ndihem e lumturuar. Tani sa jam e vogël po mendoj për të ardhmen, por kur të rritem do të mendoj për të kaluarën, për gabimet që do doja shumë t'i ndreqja. Duhet ta shijoj sa më shumë këtë jetë që po bëj, sepse jeta nuk kthehet më pas. Ndoshta kur të jem 35 vjeçe do mund të jem në një shtet tjetër dhe mund të punoj aty. Pra i uroj vetes sime një jetë sa më të gjatë dhe të lumtur.

**Mei Aliko 6G**



Përshëndetje!

Shpresoj që kjo letër të ketë mbërritur te ty. Nëse po, kjo i përgjigjet pyetjes tënde në lidhje me teknologjinë. Këtë letër po ta shkruaj unë nga e shkuara, për t'iu përgjigjur pyetjeve të tua.

Unë tani jetoj në Angli dhe jam shkrimtare. Kam udhëtuar disa herë në Azi, Kinë ose Japoni etj. Meqë pyet historia është botuar, por me pak ndryshime. Do ta marrësh vesh pas ca kohësh. Unë e kam akoma shoqe Junën. Jetojmë në të njëjtin pallat dhe takohemi pothuajse çdo ditë. Kam dy qenë, Yatonnjë Husky dhe Yukinënjë ShibaInu Nësë. Do të gjëj një Norëich Tërriër dhe do t'ia vë emrin Hiyori. Tani që jetoj në Angli, nuk është se nuk shkoj në Shqipëri. Shkoj tetë herë në vit dhe rri pesë deri në shtatë ditë. Për pushime dimërore, nja një javë e gjysmë.

Epo deri tani kaq mund të të them, pjesën tjetër do ta zbulosh vetë.

**Mei Et-Hemaj 6G**





Përshëndetje Mishel,

Mezi pres moshën 35-vjeçare. Atëherë do të jem e rritur e të jem bërë e zonja e vetes. Mamaja më thotë që duhet të shijoj fëmijërinë, sepse kam kohë të rritem, ndërsa fëmijë nuk bëhem dot më. Mamaja dhe babai im janë shumë të përgjegjshëm për ne dhe për punën e tyre. Ashtu dua të bëhem edhe unë, por më parë të mbaroj shkollën e pastaj flasim. Dua që kur të jem 35 vjeç të kem një familje. Nuk e di akoma se sa fëmijë dua të kem, por jo më shumë se dy. Sigurisht që dua edhe një punë të mirë. Dua të jem një person që ta ndihmoj sadopak botën që të bëhet një vend më i mirë për të jetuar. Tani që jam duke shkruar, në këto momente, më duket sikur këtë letër po ia nis dikujt tjetër, dhe jo vetes sime. Jam shumë e emocionuar, gjithashtu në të njëjtën kohë sikur nuk e di se çfarë po shkruaj, sikur po shkruaj marrëzira dhe se asnjëherë nuk do të bëhem 35 vjeç.

Epo shpresoj që të ketë mjaftueshëm imagjinatë prej një fëmije të moshës 12-vjeçare.

**Mishel Karafilaj 6G**



E dashur Nikol,

Nuk do të të shkruaja tani, por meqë e kam për detyrë, ja ku jam. Shpresoj dhe uroj t'i kesh arritur ato që ke dashur të bësh në jetë. Të imagjinoj Zonjë shtëpie shembullore, duke bërë më të mirën për familjen tënde. Me siguri tani po mendon sa e lehtë ishte, kur ishe më e vogël dhe ishin të tjerë që kujdeseshin për ty. Kam dëshirë të të sjell ndërmend disa kujtime të paharrueshme të fëmijërisë. A të kujtohet kur hyre në klasë, sesa e frikësuar u ndjeve? Qave pak, por mami të qetësoi. U ule në bankë me një vajzë që quhej Alesia.

Po në klasë të pestë? Atëherë ti ndryshove shkollë. Ishte një periudhë shumë e vështirë. Nuk njihje askënd. Askush nuk të fliste, por me kalimin e kohës krijove shoqëri të forta. Në klasë të gjashtë, a të kujtohet, sa shumë ngarkesë ke patur. Shqetësoheshe për provimet e projektet. Doje të ishe më e mira, por jo gjithmonë ndodhte kështu. Tani nuk ke më detyra dhe teste. Të kujtohet kur të thoshte mami se në jetë do të kesh më shumë përgjegjësi dhe stres dhe çdo ditë në punë është si një provim i rëndësishëm në shkollë. Po me vëllain që ziheshe çdo ditë, madje edhe për gjërat më të vogla. Ndoshta këtë gjë po bëjnë edhe fëmijët e tu. Mund të jesh duke qeshur me vete në këtë moment me kujtimet që të solla ndërmend. Duke e mbyllur dua të të jap një mesazh jo prej fëmije, as prej të rriture, por prej vetes tënde:

Duaje jetën dhe shijojë atë, bëj më të mirën që mundesh për veten dhe të tjerët, pranoji humbjet pa u lodhur kurrë së kërkuari fitoret. Jeta është e bukur në çdo moshë!

Me dashuri e tashmja.

**Nikol Tushaj 6G**



Përshëndetje Onejda,

Unë tani jam në moshën 35 vjeçare. Kam kaluar shumë vështirësi në jetë. Kam luftuar shumë me jetën time. Kur isha e vogël unë mësoja shumë. Mërzitesha shumë për minuset e rralla që merrja. Mërzitesha shumë, pasi nuk i doja fare ato. Kisha një qëllim atëherë që të merrja nota sa më të mira në mësim. Në disa lëndë kisha vështirësi, me të cilat mësohesha me kalimin e kohës. Kisha shumë dëshirë të bëhesha doktoreshë dhe ia kam arritur qëllimit. Dëshiroja shumë që të shëroja dhe të ndihmoja njerëzit në nevojë. Në fëmijëri unë mendoja se do të ishte shumë e lehtë të bëheshe një doktoreshë. Por e kam pasur gabim, pasi nuk ka qenë fare e lehtë të arrija deri në këtë pikë ku jam sot. Kam bërë shumë vite shkollë, pasi për t'u bërë një doktoreshë duhej të mësoje shumë. Tani kujtoj me mall gjërat që bëja me vëllezërit dhe familjen time. Bënim shaka të ndryshme, lojëra të ndryshme dhe shumë gjëra të tjera. Kënaqeshim shumë bashkë. Edhe tani bëjmë shaka, por jo si atëherë, sepse jemi të rritur tashmë. Një ëndërr tjetër që kam pasur ishte që të lëvizja në shumë vende të ndryshme. Tani që jam në këtë moshë, e kam realizuar edhe këtë dëshirë. Kur isha e vogël dëshiroja shumë të kisha një jetë sa më të mirë. Mendoj që të gjitha ëndrrat e mia të fëmijërisë i kam realizuar. Tani çdo ditë ngrihem herët për të shkuar në punë. Bëhem gati shpejt dhe nisem. Kur arrij atje çdo mërzë që kam kaluar apo që kam më zhduket, sepse puna ime më qetëson shumë. Besoj që edhe njerëzit e tjerë që janë doktorë apo doktoresha kanë të njëjtin mendim me mua. Përsëri duhet të punoj fort pasi nuk i dihet asnjëherë se çfarë sjell jeta. Kam akoma gjëra për të realizuar, por do t'i plotësojë edhe ato me kalimin e kohës.

**Onejda Sheshori 6G**



Përshëndetje!

Mirë se erdhët në të ardhmen pas 23 vitesh. Pra le t'ia fillojmë nga bizneset e mia. Këtu pra është biznesi im i parë, i cili është një bar restorant, i cili është shumë i madh edhe ka një kënd lojrash po aq të madh. Tani po ju shoqëroj në biznesin tim të dytë, i cili është një mobileri me shumëllojshmëri artikujsh. Edhe biznesi i fundit, është një furrë buke edhe një pastičeri shumë e madhe, edhe këto të gjitha janë të përmbledhura në një kompani të vetme e cila quhet M&M. Kjo kompani quhet kështu, sepse janë marrë dy shkronjat e para të emrit tim dhe të vëllait tim Marisild dhe Marjo, të cilën e kemi të trashëguar nga babai ynë. Ai e drejtoi këtë biznes derisa ne u rritëm edhe tani na e trashëgoi neve. Ja pra, kjo ishte e ardhmja ime modeste. Tani le të kthehemi përsëri në realitet.

Mirupafshim!

**Marisild Qato 6G**



Rea, përsëndetje!

Isha shumë kurioze të të shkruaja ty dhe kur ti ta shohësh letrën, do të të kujtohem unë, sepse kam pasur dëshirë të të shkruaja dhe të imagjinoja ku do të jesh tani. Tani kur të shkruaj, shumë pyetje më vijnë në mendje:

Ku do të jesh tani? Çfarë je duke bërë? Si e ke jetesën? A jemi akoma bashkë? Vitet do të kalojnë, unë do të ndryshoj, ti do të më takosh, por prapë nuk do ta harrojmë njëra-tjetrën kur ishim në kohë të ndryshme. Se kështu e ka koha dhe jeta, s'i ndalojmë dot. Ja po të shkruaj, por si do të më mbash mend ti kur të takohemi? Unë nuk të njoh akoma, por do të njihemi dhe s'do të ndahemi. Prandaj, Rea, mos më harro, më kujto gjithmonë, sepse kur të më kujtosh mua, do të të kujtohet fëmijëria jonë e lumtur që shumë na mungon. Rea, edhe unë dua të mendoj për ty, jo vetëm ti për mua. Siç të thashë, nuk të kam takuar ende, por dua të të mendoj ty sipas imagjinatës sime tani. Ja po të përfytyroj tani, bashkë me familjen tënde ku je e lumtur, me një punë të mirë e me të ardhura. Kaq mund të të them tani, sepse akoma nuk të kam takuar, por kur ajo kohë të vijë, unë do të të pres me krahë të hapur për të vazhduar bashkë rrugën e madhe.

Rea, unë do ta mbyll tani, por mos harro se unë do të të takoj dhe ti do të më presësh.

Ky nuk është fundi, por vetëm fillimi i rrugës.

Do të shihemi! Rea Manoku 11-vjeçare.

**Rea Manoku 6G**



Përsëndetje Teno 35-vjeçar,

Si je? Si po të shkojnë punët? Me çfarë po merresh? Je futbollist apo pilot? Mos vallë je biznesmen? Me cilën skuadër futbolla je? A je i martuar? Me kë jeton? A vazhdon të jetosh në Shqipëri? Po motrat e tua si janë? Me çfarë po merren? Ti çfarë makine ke? Ke bërë tatuazh? Shpresoj që jo, pasi nuk më pëlqejnë. A ke udhëtuar në tërë botën? Cili ka qenë vendi që të ka pëlqyer më shumë? Vazhdojnë ende krudot të jenë ushqimi yt i preferuar? Çfarë ushqim tjetër të pëlqen më së shumti? Çfarë gjërash mendon që do bësh në të ardhmen? Uroj që të më kthesh përgjigje sa më shpejt të jetë e mundur!

**Rustem Brahimaj 6G**





E dashur Suada,

Një bllok që ka qenë dikur ditari im, tashmë është pjesë e paharruar e letrave që të janë nisur ty. Nuk kam "I dashur ditari" në krye të tyre, ndërsa "e dashur Suada" duket se do të më ndjekë pas edhe në ëndrra.

Përse dua të të flas? Përse dua të di si ndjehesh ti?

Unë nuk di asgjë për ty, as elementët më të vogla të pjesëzave që të bëjnë ty një Suadë më vete nga ajo që jam unë. E prapë se prapë, a jam e plotë unë? A jam unë një "Suadë" që është krejt e plotë ashtu siç është, ashtu siç është rritur? Asgjë s' duket të ketë fjalë mbrapsht kur të shkruaj ty, ndërsa pyetje vetëm zgjohen dhe asnjë s' vendos të flerë. Suada, a ia dole?

Ditët rrotullohen rreth vetes, marrin trajta rrumbullake, ndërsa unë dua vetëm të di a ia dole pas gjithë asaj që jetove? Ndërkohë që vazhdon të jetosh atë që të duket fillimi i jetës sate të re, një femër pas të tridhjetave që ulet në një kolltuk dhe... ndoshta ka një fëmijë dhe një familje, ndoshta vendos të ecë kundër rrymës dhe të jetë familja e vetvetes, dua të di a mendon se e përmbushe gjithçka kërkoje të arrije? Suada, a je e lumtur? A ia dolën zgjedhjet e tua të të sjellin lumturinë, të të kënaqin sedrën dhe të të përmbushin brendinë tënde plotësisht të ngarkuar me emocione? A i plotësove gjithë pritshmëritë e tua në jetë? A ndjehesh sot vajza e madhe, e vogël, që ecën me këmbët e veta në një botë të madhe po kaq sa të vogël? Unë jam në klasë të gjashtë, ende e vogël, nuk të dukem? Jam e vogël, ndërsa ti s' do mend që as ke ndërmend të dëgjosh mendimet e një nxënëseje në klasë të gjashtë nëse e dëgjon të të drejtohet në rrugë, mirëpo as mua s' do të më dëgjoje. Premtimet që bëre nuk i kujton, ndërsa rrugët e qytetit tënd mund t' i kesh harruar duke u endur mes qyteteve të reja, horizonteve të reja. A i kam ëndërruar unë ndonjëherë ato? A e dije se një ditë, ndoshta, do të ishe ku je sot?

A plotësove ndonjë nga ëndrrat e mia?

Po sot, a ke ëndrra, Suada? Çfarë mban sirtari yt në fshehtësinë e tij të errët? Suada, a ke ndërmend, ndonjëherë, përpara se vitet të grumbullohen edhe një herë, të ma tregosh të vërtetën që fshihet pas pyetjeve? Do të ma tregosh përse pikëpyetjet më ngjethin më shumë se pikëçuditjet? Do të ma tregosh përse e fshehta josh dhe e njohura bëhet monotone?

Me dashuri,

Suada.

P. S. Të lutem, mos thuaj që nuk e di. Unë po shpresoj kaq fort tek njohuritë e tua prej të rriture. Shpresoj që dielli të jetë ende i fortë dhe ndriçimi i tij të ngrohë edhe në kohën tënde.

**Suada Xholi 6G**







I dashur Xhoel,

Në këtë përvjetor të 35-të besoj se ke aritur shumë nga objektivat që i kishe vënë vetes. Tani ti je në periudhën më të mirë të jetës dhe ke forcë e energji për të vazhduar të ecësh përpara. Është në karakterin tënd, që gjithmonë të shikosh nga e ardhmja dhe vazhdimisht të kërkosh shumë nga vetja. Shpresoj që kjo letër të të gjejë të realizuar, ashtu siç ti ke dashur dhe ëndërruar gjithmonë. Besoj dhe uroj se ke realizuar shumë nga ëndrrat dhe dëshirat që ke pasur. Për ëndrrat e parealizuara mos ndalo së provuari. Jam i sigurt se jeta jote është e mbushur plot me ngjarje të bukura, por dhe me shumë sfida dhe vështirësi. Përpiqu që gjithmonë të shohësh anën e mirë të gjithçkaje dhe mos u dorëzo para asnjë vështirësie. E di që çdo ditë do ta shijosh në maksimum, se jeta veç një herë jetohet dhe është e kotë të mërzhitesh për gjëra të vogla. Jeta do të të vendosë para shumë vështirësish dhe problemesh, por e di, që ti gjithmonë do të gresh rrugën për t'i zgjidhur. Besoj se akoma, edhe pse je rritur, vazhdon ta shohësh botën po me të njëjtat ngjyra. Shpresoj se akoma vazhdon të ëndërrosh dëshira të reja, që mund të duken të pamundura, por po të kesh vullnet gjithçka mund të realizohet. Shpresoj dhe besoj se je po i njëjti Xhoel si dikur. Ai, që gjithmonë e gjente diçka për të qenë i lumtur dhe imagjinata e të cilit kalonte çdo kufi. Shpresoj mos të kesh harruar, çfarë ti ke ëndërruar, kur ke qenë i vogël. Ndoshta tani mund të të duken si dëshira të kota dhe pa kuptim. Por jo, vazhdo, përpiqu t'i realizosh. Qoftë edhe thjesht për të mbajtur premtimet që i ke bërë vetes. Si atëherë, kur i the vetes që do vizitoje çdo vend të botës. Gjithashtu the që do të bëheshe një nga mjekët më të mirë dhe do të ndihmoje çdo ditë njerëzit në nevojë.

E di që je forcuar në karakter dhe nuk mërzhitesh më kur jo gjithçka shkon siç dëshiron.

E di se je bërë i pasur. Gjithashtu e di që kjo nuk ka shumë rëndësi për ty. Ti gjithmonë ke ndihmuar të tjerët. Ke dhuruar edhe atëherë kur nuk kishe vetë mundësi. Gjithmonë iu je lutur prindërve të tu, të ndihmojnë fëmijët në nevojë, që dhe ata të ishin të lumtur, ashtu siç ti ke qenë përherë. Ndërsa tani, këtë mundësi ti ia ke krijuar vetes. Gjithmonë je pranë njerëzve që kanë nevojë.

Gjithashtu, shpresoj të kesh krijuar një familje të madhe e të lumtur. E di që, këtë gjë e ke dashur gjithmonë. Gjithashtu ke dashur të kesh edhe një qen, të cilin prindërit nuk ta merrnin, se babi yt ishte alergjik ndaj tyre. Uroj që tani e ke një të tillë! Për fëmijët, jam i sigurt që do t'i rritësh me aq dashuri dhe përkujdesje sa të rritën prindërit e tu dhe me po aq sakrifica. Por, mos harro, jepu këshilla të vlefshme për jetën dhe gjithmonë gjendju pranë! Përpiqu t'i kuptosh dhe kurrë mos i kërko të jenë diçka që s'janë.

Mbi të gjitha shpresoj të jesh i lumtur dhe i gëzuar me zgjedhjet që ke bërë.

Të përqafoj,

**Xhoel Përmeti 6G**



E dashur Xheni

Unë jam ti para 25 vitesh. Uroj që ëndrrat e tua të jenë realizuar. Shpresoj që të jesh po aq e çiltër, e dashur dhe e lumtur sa ke qenë edhe para 25 viteve të fundit. A të mungon fëmijëria? Po shokët dhe shoqet që ke pasur në shkollë a janë akoma aty për ty? Kam shumë pyetje për të të bërë, por më shumë dua të të them që të mos ndalosh së ecuri përpara dhe të zbrazësh sirtarin e ëndërrave duke i sjellë ato në jetë. Besoj se je bërë dikush në jetë. Vazhdo të jesh krenare për veten tënde, siç ishe para 25 vitesh.

Të përqafoj Xheni 12 vjeç.

**Xheni Bega 6G**







